



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE
FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I LETËRSISË
Tel/fax:+355 4 369 987 www.fhf.edu.al



Tezë doktrature
Individualiteti i prozës së Koço Kostës
(Në kërkim të gradës “Doktor i Shkencave Letrare”)

Përgatitur nga:
Ermelinda Kashah

Udhëheqës shkencor:
Prof. Dr. Ymer Çiraku

TIRANË, 2015

TEZË DOKTORATURE

*Punuar dhe paraqitur nga: Ermelinda Kashah
Në kërkim të gradës shkencore “DOKTOR”
Specialiteti: Letërsi*

Individualiteti i prozës së Koço Kostës

Udhëheqës shkencor: **Prof. Dr. Ymer Çiraku**

Mbrohet më dt..... para jurisë:

1 _____	kryetar
2 _____	anëtar (oponent)
3 _____	anëtar (oponent)
4 _____	anëtar
5 _____	anëtar

Pasqyra e lëndës

Mirënjohje.....	5
Hyrje	6
0.1 Objekti i punimit.....	6
0.2 Metodologjia dhe struktura e studimit	7
Kapitulli I.....	9
1 Proza e Koço Kostës. Qasje të brendshme e të jashtme (referenciale me letërsinë shqipe)	9
1.1 Disa karakterizime të prozës së tij	12
1.2 Dy periudhat në krijimtarinë e autorit. Evolucioni i brendshëm letrar.	32
1.3 Kalimi nga fakti apo prototipi real, në personazhin apo situatën artistike	34
Kapitulli II.....	42
2 Koloriti i fshatit shqiptar në prozën e K. Kostës.....	42
2.1. Pikëtakime dhe risi në raport me traditën letrare	42
2.2 Raportet e kritikës me prozën e autorit	49
Kapitulli III	54
3 Profili kompleks i personazheve të Koço Kostës.....	54
3.1 Personazhet e tregimeve dhe novelave	55
3.2 A mund ta quajmë prozë të karaktereve kundërvënëse prozën e Koço Kostës?.....	66
3.3 Determinimi i personazheve nga syzheu (Tipizimi dhe individualizimi)	67
3.4 A mund të jetë personazhi determinim i aksionit?.....	71
3.5 Figura-personazh në strukturën artistike të veprës së autorit.....	72
3.6 Personazhet e novelës “Ata të dy dhe të tjerë”	76
3.7 Personazhet e dy periudhave të krijimtarisë së autorit.....	82
Kapitulli IV	87
4 Veçori të prozës rrëfimtare të Koço Kostës	87
4.1 Parimi i ajzbergut si veçori kryesore.....	95
4.2 Proza e shkurtër si strukturë pararomanore.....	101
4.3 “Nata e Sofie Kondilit” si kulmi i fazës së dytë të krijimtarisë së shkrimtarit.....	102
4.4 Pasuria gjuhësore.....	113
4.4.1 Leksiku si bërthamë e etnoligjërimit.....	115
Përfundime	117
BIBLIOGRAFIA	120
1. Vepra të Koço Kostës	120
2. Literaturë teorike dhe kritika letrare e shfrytëzuar.....	120

3. Kritika letrare mbi veprën e Koço Kostës.....	125
ABSTRAKT	128

Mirënjohje

Para së gjithash do të shprehja mirënjohjen time për profesorët e Departamentit të Letërsisë, të cilët kanë qenë një mbështetje e rëndësishme për dijet dhe informacionin e përcjellë në *Shkollën Doktorale*, si dhe në fazat e diskutimit të këtij punimi.

Një meritë e veçantë i takon udhëheqësit tim shkencor, Prof. Dr. Ymer Çirakut, për besimin dhe kurajon e dhënë për realizimin e kësaj teme doktorature.

Me mirënjohje të thellë u detyrohem prindërve të mi, të cilët më ushqyen me pasionin për librin.

Falënderoj gjithashtu miqtë e mi për ngrohtësinë dhe inkurajimin që më dhanë gjatë kohës që u punua kjo tezë, e sidomos falënderoj bibliografin e Bibliotekës Kombëtare në Tiranë, z. Maks Gjinaj, për ndihmën e pakursyer që më ka dhënë duke më konsultuar e vënë në dispozicion burime të ndryshme bibliografike.

Falënderoj familjen time, së cilës i detyrohem pa masë, për kohën që i kam marrë.

Hyrje

Ekzistenca e formave dhe e strukturave të ndryshme ligjërimore, krijon dhe efektet e ndryshme estetike.

Në arealin letrar shqiptar, proza e Koço Kostës është një model që tenton drejt një trajte të re të së rrëfyerit, duke kombinuar me mjeshtëri teknika narrative tradicionale me ato moderne, duke u dhënë teksteve dinamizëm e njëkohësisht një thyerje artistike, duke fituar ligjërimin e shkathët, larg monotonisë. Ky tipar shfaqet edhe në hapësirën e ngushtë të tregimit, ku shquajnë konciziteti e dramatismi, si dhe tablotë e karaktereve të përshkruara me pak viza.

Koço Kosta ka dëshmuar, në tërë harkun e krijimtarisë prej afër 4 dekadash, profilin e vet krijues, të dalluar tashmë nga prozatorët e tjerë bashkëkohës si: Vath Koreshi, Naum Prifti, Sotir Andoni, Zija Çela, Nasi Lera etj. Duhet kujtuar se ky autor, në temat e trajtuara, në përcjelljen e mesazheve – përmes personazheve atipikë për doktrinën socrealiste, krijonte në jo pak raste polemika në kritikën letrare të kohës, e cila, në bastionet më të indoktrinuara të saj, lëshonte akuza anatemuese për autorin. Në disa vepra, por sidomos në novelën “Ata të dy e të tjerë”, ai u gjykua ashpër si autori plëngprishës, i cili nuk kishte bërë pak, veçse kishte sfiduar diktaturën me tërë strukturat dhe moralin e saj, të trumbetuar nga propaganda zyrtare si gjasme e panjolllosur nga kurrfarë e mete/defekti.

Sigurisht që nisur prej doktrinave estetike, K. Kosta bën pjesë ndër ata autorë që krijimtarinë e tij e ka të ndarë në dy faza, para dhe pas viteve `90-të. Por nisur prej prirjeve *rebeluese* të shfaqura dhe më parë, mund të pohojmë se tek ky autor nuk kemi kapërcime estetike e filozofike *in extremis*.

0.1 Objekti i punimit

Teza “*Individualiteti i prozës së Koço Kostës*”, ka për qëllim të evidentojë në disa linja atë çka është origjinale në prozën rrëfimtare të këtij autori dhe të përcaktojë vendin që zë kjo prozë në letërsinë shqipe bashkëkohore. Duke u mbështetur në vëzhgime analitiko-artistike, kemi synuar të sjellim/japim arsyetime - për të mbërritur në vlerësime e në cilësime të atilla, që të tingëllojnë si gjykime sa më përgjithësuese, sigurisht, pa rënë në pozita imponuese, pasi dihet se studimi i letërsisë nuk është veçse laryshi e interpretimeve nga lexues të ndryshëm e në kohë të ndryshme. Do të synojmë të shpjegojmë pse krijimtaria e shkrimtarit bënte pjesë në përpjekjen e atyre krijuesve që, përmes veprës së tyre mbartnin/realizonin mbijetesën e letërsisë shqipe nën trysninë e dogmës së realizmit socialist, edhe pse ky mision letrar ishte i detyruar të funksiononte në kushtet e një censure tejet të rëndë. Pra, disa çështje janë ngritur në rrafshin analitik të shqyrtimit të problematikës së veprave konkrete, por sipas rastit edhe në atë teorik.

Pjesa analitike e studimit i trajton çështjet në kompleksitetin e veprave, duke i shoqëruar edhe me shembuj konkretë nga veprat që kemi marrë në shqyrtim. Kjo metodë i shërben ngritjes së hipotezave të studimit, për të shqyrtuar si shfaqet edhe konteksti artistik, nëpërmjet mishërimit të personazheve në veprat e autorit dhe veçorive të teknikës rrëfimtare. Pra, tentohet të depërtohet edhe në formë, duke analizuar veçoritë e përgjithshme që i lidhin,

si edhe realizimin e veçantë të çdo krijimi (tregimi, novele, romani). Në këtë mënyrë, synohet që krijimtaria e Koço Kostës të inkuadrohet në kontekstin e kohës, të evidentohen tiparet e papërsëritshme të saj dhe pastaj të jepen vlerësime për vendin që ai duhet të zërë në letërsinë bashkëkohore shqipe. Është shfrytëzuar një literaturë e gjerë, ku, krahas njohjes së krijimtarisë së autorit, është shfrytëzuar edhe literaturë teorike, si synim i rëndësishëm i këtij studimi, për t'i dhënë atij një mbështetje sa më solide të jetë e mundur.

0.2 Metodologjia dhe struktura e studimit

Të gjitha metodat janë të mira, përderisa mbeten mjet e nuk bëhen qëllim më vete.¹ Duke qenë se tema e zgjedhur për këtë studim është e lidhur ngushtësisht me formën, duke pasur të bëjë pra me literalitetin e krijimtarisë së autorit, por nga ana tjetër lidhet me kushtet e krijimit të shkrimtarëve në diktaturë dhe në mënyrë të veçantë me rastin e një autori që iu shmang zbatimit strikt të rregullave të drejtimit të realizmit socialist, në fillim në “mënyrë të butë”, duke anuar nga realizmi me tone kritike e strukturat tekstore moderniste, atëherë kemi gjykuar se kjo lëndë studimi do të kërkonte një bashkërendim të metodave të qasjes së brendshme (sipas teorive strukturaliste të hetimit të poetikave specifike), por edhe një kombinim me metodat sociologjike dhe biografike.

Për të ndihmuar në një hulumtim sa më korrekt dhe të saktë, gërshetohen metodat e studimit. Metodatat ofrojnë të “vërtetën” e tyre dhe secila metodë operon me kategoritë dhe terminologjinë e saj.

Nëpërmjet metodës analitike hulumtohen veçoritë kompozicionale, syzheike, motivacioni, monologu, tipat e komentit etj. Në këtë studim, poetika nuk konceptohet si disiplinë “anatomie”, e cila merret vetëm me zbërthimin e përbërësve dhe të pjesëve, të cilat e konstituojnë tërësinë. Duket si disiplinë me funksion “fiziologjik”, e cila ka për qëllim hulumtimin e funksionit të pjesëve, brenda tërësisë dhe raportit të tërësisë me pjesët.

Pra, dihet se ka disa metoda: gjenerativiste, biografike, psikanalitike, marksiste, sociologjike, strukturaliste etj.

Ne në punimin tonë kemi ndjekur metodën strukturaliste, të kombinuar me metodën kontekstuale/sociologjike, si dhe sipas rastit me disa vëzhgime të natyrës stilistike.

Aplikimi i metodës formaliste-strukturaliste, na ka lejuar të depërtojmë/vëzhgojmë në teknika të tilla narrative të prozës së K. Kostës si: ndërtimi i figurave të personazheve, ndërtimi që evoluon nga tipizimi realist i periudhës së parë me elemente të natyralizmit, në tipizimin realist të ndërthurur me modernizmin, i cili zbulon “krizën e identitetit” dhe të individit, rolin e rrëfimitarit në këtë prozë, që herë identifikohet me një personazh që tregon në vetë të parë, i cili mund të jetë ose jo protagonist, herë mishërohet në zëra të ndryshëm, duke i dhënë rrëfimit karakter polifonik, herë shkrihet me rrëfimitarin tradicional të *gjithëdijshëm*.

Parimi i ashtuquajtur i *ajsbergut* i përdorur/përcjellë nga K. Kosta, i jep rëndësi të veçantë nëntekstit. Një tipar tjetër është dhe zbulimi i dramatzimit të fshehur nën të

¹ Tzvetan, Todorov. *Letërsia në rrezik*, përktheu nga origjinali frëngjisht Mehdi Halimi, Shtëpia Botuese “Gjon Buzuku”, Prishtinë, f. 79.

zakonshmen, analizohet gjithashtu roli i dialogut, i cili është i natyrës lirike dhe që kombinohet sipas rastit si *dialog narrativ* dhe *dialog si veprim*.

Gërshetimi i metodave formaliste me metodën sociologjike dhe biografike, na ka lejuar të rikrijojmë atmosferën historike, shoqërore, politike, në të cilën u zhvillua krijimtaria e Koço Kostës. Po kështu krijohet mundësia që të kuptohet parapëlqimi zyrtar i kohës për një drejtim letrar që u merrte frymën individualiteteve krijuese siç ishin, krahas realizmit socialist, ndërhyrja brutale e partisë-shtet në çështjet e brendshme të letërsisë, ideologjizimi i kritikës dhe trysnia që kjo e fundit ushtronte mbi lexuesin, rrethanat jetësore në të cilat u zhvillua personaliteti i shkrimtarit dhe që ushqyen talentin dhe përvojën e tij, si njeri i lindur në fshat dhe më vonë si mësues dhe gazetar, përvoja këto që e afruan me realitetin, ashtu siç ai realitet ishte në thelbin e vet autentik dhe jo i deformuar nga lentet rozë të propagandës. Këto rrethana e afruan të ndjekë poetikën realiste, mund të themi në vazhdë të modelit estetik të Lukaçit.

Kapitulli I

1 Proza e Koço Kostës. Qasje të brendshme e të jashtme (referenciale me letërsinë shqipe)

Koço Kosta mbetet nga prozatorët e spikatur në prozën shqipe të pasluftës së dytë botërore. Ndonëse kritika letrare përgjithësisht ka qenë e kursyer në vlerësimet ndaj këtij autori, prania e individualitetit/autoritetit të tij krijues, ka qenë evidente dhe një pikë reference për të dëshmuar tiparet e një proze komplekse, e cila i tejkalonte skemat e letërsisë së angazhuar, duke përcjellë jo thjesht dhe vetëm atmosferën ikonike të kontekstit kolektivist, por edhe përsiatjet dhe zinxhirin e sfidave njerëzore nëpër rropatjet me rrugëdalje sfiluese e fare të pasigurta.

Pra, ky autor, ka arritur të përcjellë tek lexuesi për një periudhë të gjatë kohe, qysh nga fundi i viteve `60-të e në vazhdim, një prozë specifike: mjaft jetësore, me realizëm deri të ashpër, me kolorit të pasur, sidomos nga fshati shqiptar - në zgrip të jetës së tij ekonomike e morale (veçanërisht të përcjella këto në ato krijime që i takojnë periudhës së para `90-ës). Karakteret e personazheve të K. Kostës mund të themi se janë një galeri e larmishme, gdhendur e skalitur jo me stërhollime e zbulime, por endur me stilin realist e në një sfond ironie e deri sarkazme, ku këta personazhe, prezantohen para lexuesit - me tërë vlerat dhe, pse jo, sipas rastit, edhe me deformimet e tyre karakteriale e deri psikofizike. Këto tipare kanë qenë edhe shkas jo i paktë keqkuptimi prej censurës konformiste zyrtare të kohës, keqkuptim që në fakt ishte i iniciuar/kalkuluar/kërkuar me sa duket ndërgjegjshëm prej vetë autorit, pasi i projektonte këto paradigma me sens të qashtë provokues, brenda vizionit të tij estetik antikonformist.

Sikundër u përmend dhe më sipër, K. Kosta mbetet nga ata autorë jo aq të vënë re nga kritika, mbase edhe për arsyen e shenjave provokuese që përcillte proza e tij. Mund të thuhet se ai është zë i veçantë e origjinal, para së gjithash, sepse kishte prirje ta çlirojë prozën e tij nga tonet rozë, entuziaste dhe sidomos nga modeli doemos i vështrimit/interpretimit në kahje pozitive, vështruar kjo në rrafshin konceptual apo në ndërtimin e figurave letrare.

Ndonëse në tablotë e prozës endet një realitet shpesh i deformuar, me befasira, artificie e jo pak nonsense në vështrim të parë, këto nuk krijojnë si ndjesi pasigurinë, kotësinë ekzistenciale dhe eterne të njeriut, si një qenie e pafuqishme, që mbetet i destinuar të vuajë fatalisht e pafundësisht dënimin e tij të paracaktuar. Shkrimtari nuk shkon në këto linja filozofike, sado të ashpra e të errëta të jenë tonet e derdhura prej tij nëpër tekstet e kësaj proze. Duke qenë arsyetues i hollë i realitetit, ai arrin të depërtojë edhe në ato zona, që japin shpresën dhe besimin se e mira dhe humania nuk humbasin, sado të jenë të mbuluara nga hija/mjegulla e ceneve njerëzore si: arrivizmi, prepotenca, servilizmi, injoranca. Këto dukuri, të përthyer artistikisht, gjejnë shprehje në shumë tekste të këtij shkrimtari dhe përcjellin kontrast e dramatikizëm, deri në kufijtë e tragjizmit. Sidomos ambientet rurale zënë shumë

vend në veprat e autorit dhe mund të them se në to vërehen ndikime e paralele, qofshin këto dhe intuitive, me frymën groteske dhe rebele që përcjellin tregimet tek libri *Zhurmëra e erërave të dikurshme* i D. Agollit, apo *Tregimet e Donit të qetë* i M. Shollohovit, apo ato të Nikollaj Gogolit. Këto paralele mund të kenë ardhur si ndikim leximesh, apo dhe për shkaqe rrethanash të ngjashme jetësore, po të kemi parasysh faktin se K. Kosta, fshatin e kishte jo vetëm vendlindjen ku kishte kaluar edhe vitet e rinisë, por edhe të jetesës prej vitesh, kryesisht në momentet kur ai atje kryente ndëshkimet e urdhëruara nga instancat zyrtare.

Jeta në fshat, nisur dhe prej rrethanash specifike personale, sigurisht që psikologjikisht do të ketë lënë gjurmët e veta, duke krijuar edhe raportet e veta me realitetin, të cilin ka rastin ta prekë e ta përjetojë vetë drejtpërsëdrejti dhe jo ta thithë brenda studios së shkrimtarit prej jehonës së trumbetave të propagandës zyrtare. Prej këtij raporti krijues vjen dhe origjinaliteti që ky prozator sjell në modelimin e personazhit, brenda një hapësire autentike dhe jo të selitur në laboratorët sterilë kolkozianë të kohës.

Narratori i kësaj proze është sugjestiv, kur i modelon shenjat e identitetit përmes situatave psikologjike. Dhe në këto raste, shkrimtari sikur e rrënon kufirin ndërmjet realitetit dhe irealitetit, për të vizionuar pikëshikimin e personazhit përbrenda asaj bote, ku ai e ndërton imazhin e vendlindjes apo të mallit, si për diçka të humbur, duke endur një tis të kudoshfaqur mallëngjimi apo dhe pikëllimi njerëzor.

Sado me nota të mprehta realiste, proza e K. Kostës e ka të pranishme edhe frymën apo dozat romantike, që mendojmë se shfaqen si refleksi i shpresës - për ta parë më të mirë botën e njeriut, e cila, edhe nëqoftëse deformohet në shumë aspekte apo raporte të saj, e ka të dukshme rezistencën apo qëndresën e saj.

Mund të pohojmë se ky shkrimtar, mes dy kohëve, pra, para dhe pas '90-ës, nuk ka ndonjë zhvendosje të dukshme artistike, sidomos në mesazhet e përcjella. Kjo ndodh pasi ai bën pjesë ndër ata krijues, të cilët, e kanë pasur të dukshëm antikonformizmin estetik, gjë që i ka sjellë edhe konsekuenca jo të pakta në raport me censurën kanonike. Por këto rrethana s'e kanë penguar autorin që të preferojë të ndjekë pasqyrimin në skajet më të vërteta të realitetit të kohës, që në fakt, dukej se shfaqeshin edhe më të besueshme, pa shkëlqimin dhe butaforinë fals të realizmit socialist. Pikërisht ky perceptim artistik i jetës, e ka bërë veprën e tij, jo vetëm të zotërohet nga origjinaliteti, por edhe t'i qëndrojë kohës së pritshme.

Rrethanat biografike mendojmë se janë ngjizur e kanë influencuar jo pak në veprën e këtij autori, prandaj dhe përmendja e vlerësimi i tyre nuk mbetet një kureshti rutinë.

Shkrimtari ka lindur në maj të vitit 1944 në fshatin Suhë të Lunxhërisë në Gjirokastër. Mësimet e para i mori në vendlindje. Shkollën tetë-vjeçare e kreu në Gjirokastër. Në Tiranë vazhdoi shkollën e mesme ekonomike dhe më pas nisi studimet në Fakultetin e Histori-Filologjisë. Rrugën e krijimtarisë së tij e nisi me tregimin "Në rrugë"² i cili do të pasohet më pas nga "Shënime përmes shiut",³ një libër ky me reportazhe, portrete dhe skica. Me përmbledhjen "Unë dhe komiti" merr çmimin e parë në konkursin kombëtar të letërsisë, me rastin e 25-vjetorit të çlirimit. Me të mbaruar studimet, emërohet mësues në fshatin Picar dhe

² K. Kosta. *Në rrugë*, Tregime dhe novela, Shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1967.

³ K.Kosta. *Shënime përmes shiut*, Skica, portrete, reportazhe, Shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1968.

më pas në një fshat të Mallakastrës, ku dhe boton përmbledhjen “Krishtë mes gurgullimash”⁴ dhe me veprën “Bisedë në mesnatë”⁵ vazhdon rrugën e tij të suksesit.

Koço Kosta bashkëpunon me disa organe si: “Zëri i Rinisë”, “Bashkimi”, “Drita”, “Ndryshe”, boton tregime, novela, romane, herë me emrin e tij, e herë me pseudonime letrare. Më pas boton “Dadmadhja”,⁶ “Buka e një stine me borë”,⁷ “Era e Udhëve”,⁸ “Tregime të zgjedhura”,⁹ “Paradite me shi”,¹⁰ “Ata të dy dhe të tjerë”¹¹, vepra këto, të cilat do ta vendosin shkrimtarin në radhët e prozatorëve më të mirë të kohës. Me romanet “Nata e Sofie Kondilit”¹² dhe “Absurdi” autori ngjalli interes të veçantë te lexuesi.

Në kohën kur K. Kosta filloi krijimtarinë letrare, proza shqipe kishte njohur mjaft arritje. Këtu u pikëtakuan shkrimtari dhe letërsia shqipe, dhe që nga kjo kohë, do të shtegtonin së bashku në shumë vite. Natyrisht, ky nuk ishte një shtegtim i thjeshtë, pasi krijimtaria e tij ka shënuar pikat më të larta, ashtu si dhe krijues të tjerë gjatë asaj kohe. Ndër pengesat më kryesore në rrugën e kësaj letërsie ishte censura. Në Shqipëri zotëronte censura ideologjike, ku çdo vepër duhej të kishte qëndrim pozitiv ndaj ideologjisë së kohës. Autorët e tyre, ia caktuan kufijtë vetes deri ku mund të shkonin dhe ishin të vetëdijshëm për rrezikun që i priste nëse e kalonin këtë kufi.

Në periudhën e diktaturës për një fare kohe autori pati pëlqimin e kritikës.

Kur shkrimtari thyen përsëri heshtjen, rikthehet fuqishëm para lexuesve me romanin e tij “Absurdi”,¹³ një klimë tjetër kjo, e cila do të krijohet për shkrimtarin pas botimit të këtij romani dhe do të kristalizonte qëndrimin e shkrimtarit, duke dëshmuar disidencën artistike si dhe vetëdijen e kthjellët qytetare të tij. Shumë prej letrave të tij janë dhe sot dokumente psikologjike.

Citoj: “Do ta ruaj identitetin, po ndodhi ndryshe e të më lënë pa shpresë, do të vras veten. Po nuk jam aq i dobët”.¹⁴

Në vijim të këtij mendimi, po marrim një shembull. “Ishte viti 1985, kur shkrimtari Koço Kosta jetonte në Fier dhe punonte me profesion të lirë të shkrimtarit, thirret në sallën e Lidhjes së Shkrimtarëve. “Shkrimtari rrëfen se asnjëherë në jetë nuk e ka ndier veten në pozitë më të vështirë”.¹⁵

Po asaj kohe, jeta e shkrimtarit mori një kthesë të papritur, pasi përjashtohet nga komiteti drejtues i Lidhjes së Shkrimtarëve, si dhe i hiqet e drejta e lejes krijuese.

⁴ K.Kosta. *Krishtë mes gurgullimash*,⁴ Tregime dhe novela, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1969.

⁵ K.Kosta. *Bisedë në mesnatë*, Tregime dhe novela, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1971.

⁶ K.Kosta. *Dadmadhja*, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1976.

⁷ K.Kosta. *Buka e një stine me borë*, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1979.

⁸ K.Kosta. *Era e Udhëve*, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1981.

⁹ K.Kosta. *Tregime të zgjedhura*, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1985.

¹⁰ K.Kosta. *Paradite me shi*, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1991.

¹¹ K.Kosta. *Ata të dy dhe të tjerë*, Shtëpia botuese Enciklopedike, Tiranë, 1994.

¹² K.Kosta. *Nata e Sofie Kondilit*, Roman, Dudaj, Tiranë, 2007.

¹³ K.Kosta. *Absurdi* Shtëpia botuese, Dudaj, 2009.

¹⁴ *Refleksione. Shkrimtari rrëfen vetveten*. Në Tema. - NR.1641, 9 dhjetor, 2005, f.20-21.

¹⁵ Ilir Bushi. *Si më shpëtoi Kadareja nga hekurat e burgut*, botuar në “Telegraf”, 10 dhjetor, 2010.

Revista “Nëntori” e asaj kohe nxori një shkrim ku theksohej se masa e ndëshkimit do të vazhdonte edhe më tej ndaj tij, pasi novela “Ata të dy dhe të tjerë” nuk mund të cilësohej veçse si novelë thellësisht e gabuar.¹⁶

Shumë më vonë, Koço Kosta do të ketë shpresën për ta botuar jashtë shtetit atë novelë “të mallkuar”.

Ja si shprehet autori: “Do të shkoj tek shtëpia botuese “Gutenberg” dhe që tani përfytyroj një zotëri të qeshur i cili më pret. Në njërën dorë do të ketë në gjuhën greke “Ata të dy dhe të tjerë”, të botuar me aq kujdes. Nderime dhe mirënjohje për ju që bëtë të njohur dhe të mundur që një vepër e imja të flasë në gjuhën e lakmuar të grekut dhe që bën që personazhet e mi të kenë jo pak rëndësi....!”¹⁷

Sado ndërlikime e privacione të rënda që i sollën atij këto raporte me institucionet e kohës, ato nuk ia ndrydhen dot pasionin për të vazhduar të shkruajë, duke derdhur me po aq nerv e frymëzim realitetin e gjallë të jetës, sidomos të jetës së fshatit, në prozën e tij. Dhe kështu ai mbeti me konsekuencë një individualitet i spikatur, krijues e njeri me vizione të lira, që e begatoi universin letrar.

Fëmijërinë e tij ky shkrimtar e kishte të mbushur me ëndrra dhe një mori impresionesh të gjalla, të cilat do të kishin një ndikim të madh në origjinalitetin krijues të tij.

Sigurisht që Koço Kosta është ndër ata krijues që pati fatin për të njohur edhe kohën tjetër, atë që e kishte aq të ëndërruar, por sigurisht të ndaluar, si dhe për krijues të tjerë. Pra do të jetonte kohën kur do të rrëzoheshin tabutë dhe çdo krijues do të projektonte i lirë kornizat e veprës së tij, pra, brenda *kornizave* të tij stilistike që nuk do të urdhëroheshin më nga *kornizat* e tjera, jashtëletrare, që më shumë ishin zinxhirë të vërtetë kufizues, atrofizues. Kjo atmosferë lirie i dha impuls të ri krijimtarisë së tij, prej nga do të lindte romani “Nata e Sofie Kondilit”, një vepër ku ai përjetoi në fushën e artit atë që protagonistja e po kësaj vepre përjetoi në fushën e dashurisë.

1.1 Disa karakterizime të prozës së tij

K. Kosta para së gjithash mbetet një krijues i spikatur i prozës së shkurtër, por në krijimtarinë e tij mbeten me vlerë edhe dy romane, njëri prej të cilëve i përket periudhës së “realizmit socialist”, i titulluar “Buka e një stine me borë”, dhe, i dyti, periudhës së mëvonshme, i titulluar “Nata e Sofie Kondilit”. Në romanin e parë mbizotëron problematika sociale, problemet e jetës së fshatit në kohën e diktaturës, që shkrimtari e trajton me një realizëm të mprehtë, i cili i kundërvihet ngurtësisë tematike të rregullave të këtij realizmi, që në atë kohë, autori s’kishte mundur dot të çlirohej krejtësisht nga vetë censura. Në këtë roman, gjithsesi autori nis të aplikojë dhe prirje risie e modernizmi, përmes futjes së lirizmit në roman dhe thërrmimit të subjektit të tij, krahas prirjes epike të romanit.

Romani i dytë, i shkruar në kohën e mëvonshme të krijimtarisë së K. Kostës, ka në bazë të vet një problematikë ekzistenciale: dashurinë, erodin, që është më i fortë se tabutë e

¹⁶ Revista “Nëntori”. Shënim i redaksisë. Mbi novelën thellësisht të gabuar, nr. 5, Tiranë 1986.

¹⁷ Koço Kosta. *Refleksion: Koço Kosta rrëfen vetveten: Diçka për veten dhe për veprën: “Ata të dy dhe të tjerë”*. Në: “Tema”, nr. 1641, 9 dhjetor 2005, f. 20-21.

shoqërisë patriarkale me normat morale të saj, rregullat e mprehta të luftës, dhe afirmohet në emër të jetës dhe të së drejtës së njeriut në përgjithësi për dashuri e lumturi. Për të arritur te këto romane, që paraqesin në njëfarë mënyre kulmet e dy periudhave të krijimtarisë së tij, autori ecën nëpërmjet rrugës së tregimeve, nga më të shkurtrat deri te novelat. Të gjitha këto u ngjajnë mikrobërthamave, që do të zgjerohen për të krijuar një mikrobotë, sa e vogël aq edhe e gjerë.

Dimë fare mirë se letërsia shqipe e botuar në Shqipërinë shtetërore në vitet '45-'90, nëpërmjet censurës kufizuese të asaj kohe, u gjend e pambrojtur përballë shumë rrethanave të cilat nuk e lejuan veprën e shkrimtarit të realizohej në tërësinë e vet. Kjo bëri që kjo letërsi të ketë edhe keqinterpretime të ngushtuara. Këto ishin rrethanat e panatyrshme apo të pazakonshme që përfshinë letërsinë e botuar brenda shtetit shqiptar. Dashur pa dashur, shumë faktorë kanë çuar në formimin psikomoral dhe letrar të shkrimtarëve të realizmit socialist. Dikush bëri emër dhe karrierë, duke e përqaftuar atë metodë ose drejtim letrar me rregulla të ngurta, pra mediokër që u përshtatën lehtë, por pati dhe të talentuar, duke bërë që dhe qëndrimet e shkrimtarëve të ishin të ndryshme. Kjo ishte vërtitja e mospërputhjes së subjektit krijues me ato rrethana për të mbijetuar letrarisht. Pikërisht, Koço Kosta e ka pasur të domosdoshme të realizojë individualitetin e vet krijues, apo poetikën individuale, duke kapërcyer edhe “vijat e bardha” të drejtimit letrar zyrtar. Shumë shkrimtarë patën pritje të pazakonta, por pavarësisht nga kjo, letërsia e tyre pati një zhvillim të ndjeshëm. Realizmi socialist u zhvillua si vazhdimësi dhe si thellim i një tradite klasike, duke iu përgjigjur kuptimit revolucionar që kultura e socializmit i përvetësoi të arriturat e njerëzimit në të gjitha epokat.

Letërsia e realizmit socialist shqiptar, ka lindur në kohën e utopisë së re, komunizmit, duke e kthyer utopinë në ideologji, për t'u ngushtuar kështu në letërsi të tendencës, e cila u mbështet në letërsinë shqipe. Realizmi socialist, i themeluar/aplikuar në krijimtari nga Gorki, synonte në fillim të shkrinte realizmin me romantizmin, pra, të ishte një realizëm i një lloji më të lartë. Me rënien e sistemit komunist në Shqipëri, që e natyrshme që duhej riparë edhe ajo çka u krijua në atë kohë në letërsi. Një gjë e tillë sollti domosdoshmërinë e ridimensionimit të letërsisë, pjesa më e madhe e letërsisë së krijuar në atë kohë, nuk plotësonte as kushtet më minimale për të vijuar komunikimin, ndërsa një pjesë e paktë, e pati rrugën të hapur të shihej më me vëmendje se çfarë i kishte shpëtuar valës “shkretuese” të socrealizmit dhe letërsia serioze të vijonte komunikimin.

Shumë shkrimtarë të kushtëzuar nga rrethanat në formim, nuk mund të mohonin dot se ç'ka nxirrte ajo ideologji. Kjo bëri që veprat e tyre të shiheshin si dukuri jashtë letrare. Letërsia e Koço Kostës, e krijuar më herët, iu shmang ndjeshëm ideologjizimit. Kjo bëri që K. Kosta vijoi të komunikonte me lexuesin në postdiktaturë, me një lloj komoditeti, që ka fatin ta ketë në vetvete ajo letërsi që nuk iu nënshtrua totalisht ideologjizimit. Kjo do të thotë se vepra letrare e tij nuk u refuzua, siç u refuzua një pjesë jo e pakët e letërsisë së krijuar në atë kohë.

Sipas profesor Ali Xhikut: “Prej kohësh është ndier se historia e letërsisë së një kombi, e ndërtuar si renditje kohore e jetës dhe e veprimtarisë së shkrimtarëve më të shquar

të saj, është e pamjaftueshme për ta kuptuar atë letërsi si një proces ndryshimesh të paprera”.¹⁸

Me të drejtë është shkruar për këtë autor dhe ai është vlerësuar nga lexuesit dhe nga kritika, duke qëndruar në kushtet e vështira të diktaturës, në kufijtë e një “letërsie të ndershme”.

Në rrafshin e përgjithshëm të mesazhit dhe të formës, proza e tij është prozë realiste, e përcaktuar prej realitetit jetësor. Kjo ishte vlera kryesore e krijimtarisë së tij. E parë si krijimtari në vijueshmëri, letërsia e tij do të shënonte në vitet e mëpastajme vlera të tjera të përnjëmendta në të gjithë përbërësit që parasheh një vepër letrare, e parametrave të tillë, sa lexuesi tashmë s’mund të vendosë mure ndarëse ndërmjet kohëve fizike të krijimit të veprës. Kohezioni i veprës, ka të bëjë me ekzistencën e një lirie të padukshme, por të gjithëfuqishme në qenien e shkrimtarit dhe që frymon dhe materializohet në krejt veprën e tij letrare.

Autori konsiderohet si një ndër përfaqësuesit kryesorë të prozës sonë të shkurtër. Ai u shfaq dukshëm në botën letrare shqiptare në ato vite, duke hyrë në plejadën e atyre shkrimtarëve, që e pati mund të thuhet qysh në nisje të krijimtarisë vëmendjen e kritikës dhe sidomos interesin e lexuesit. U vlerësua ndjeshmëria ndaj realitetit dhe spontaneiteti e lirizmi i hollë. Angazhimi në vitet e para në publicistikë, sidomos me reportazhe e përshtypje udhëtimesh nëpër vise të ndryshme të vendit, me sa duket do të linin gjurmët e veta, duke e ngopur prozatorin e ardhshëm me motive e ngjarjesh e profile karakteresh mjaft interesantë, që vinin drejt e nga realiteti, pa zbulurime dhe artificie skematike.

Koço Kosta mbetet një shkrimtar në thelb realist, poetika e hapur e prozës së këtij autori arrin të krijojë natyrshëm hapësirën për shprehjen e polifonizmit të ideve; në të u artikuloan zëra brenda një tipi ligjërimi të përzier. Ai bën pjesë në atë grup shkrimtarësh që vetëdijshëm u përpoqën që në krijimet e tyre të respektonin dhe të artikulonin një ligjërim që të funksiononte brenda ligjësive të artit, pra, të respektohej tek e fundit autonomia e tekstit letrar, që ai të projektonte dhe të përcillte maksimalisht energjitë e veta artistike.

Madje, është vështirë të gjejmë ndonjë shkrimtar shqiptar që të ketë një vijë jete dhe krijimtarie, të pasur, dinamike e të dhimbshme, por edhe aq heroike sa vija e jetës dhe e krijimtarisë së këtij autori. Tërë jeta e tij ishte mundim e përpjekje (shoqërore e krijuese). Në duelin me shtetin, ky autor doli i fituar, pasi sot vepra e tij del para lexuesit si dëshmi e një stili të ri në letërsinë shqipe, e dimensioneve dhe hapësirave të reja, apo e një ndjeshmërie tepër të vlefshme.

Në krijimtarinë e tij letrare ndihet qartë rrjedha e ngjarjeve politiko-shoqërore, kjo ndodh jo vetëm në ditarët letrarë, aq regjistruar e aq të ndjeshëm ndaj kohës, por edhe në tregimet dhe novelat e tij, ndihen tallazet dhe vorbullat nëpër të cilët kalonte shoqëria e kohës. Lexon tregimet dhe sheh si stigmatizohen të pasqyruara përmes shpirtit të heronjve plagët shoqërore. Autori përcjell tek lexuesi luftën e klasave, ndarjen dhe humnerën që imponohej mes njerëzve dhe rrëfimtari (zëdhënësi i autorit), duke u munduar të ruajë ekuilibrin e urrejtjes, nuk merr pjesë në asnjërën anë, i bindur se punët rregullohen pa urrejtje dhe gjakderdhje, por pa frikë dhe me bindjen se virtyti dhe morali human nuk mund të rrëgjohen dot nga barrikadat ideologjike, sado ashpër dhe sado gjatë të godasin ato. Disidencat letrare do të ishte një luks për komunizmin shqiptar dhe prandaj nuk mund të gjykojmë se tek

¹⁸ Ali Xhiku. *Letërsia Shqipe si polifoni*. Shtëpia botuese “Dituria”, Tiranë 2004.

ky autor ajo ka funksionuar lirshëm e hapur. Por antikonformizmi, një prirje për t'iu shmangur/larguar temave festive dhe për të mbetur gati i obsesionuar pas personazheve të *rëndomtë* të jetës, e jo pas personazheve të së ashtuquajturës hierarki të *personazheve pozitivë*, e bën shkrimtarin një lloj *deleje të zezë* në referencat e kritikës, e cila, për pasojë, ose e neglizhon – ose sistematikisht i kujton me arrogancë *vijat e bardha* të shkelura. Manierat artistike/stilistike që përdori Koço Kosta në përshkrimin dhe realizimin e portreteve të veprave të tij, ishte pleksja tragjike e sharmit hyjnor që shfaq jeta, e kompleksit kontradiktor mes pasionit të shpallur dukshëm dhe mbylljes/frenimit në pavetëdije, midis emocioneve dhe shpërthimit të pavetëdijes emocionale në kufijtë e një zjarmimi të padurueshëm.

Vetë letërsia e asaj kohe ishte si një dritë-hije. Letërsia shqipe nëpërmjet censurës kufizuese të realizmit socialist dhe botëkuptimit, ishte një letërsi e paragjykuar. Për arsye jashtëletrare, rifutja në komunikimin e letërsisë së ndaluar, qoftë e traditës, qoftë ajo bashkëkohore, këqyrja e letërsisë vetëm si tekst dhe jo si jashtëtekst (shpërfillje e tekstit), nisi të krijonte vetvetishëm një panoramë tjetër të letrave shqipe, ose së paku, u vu re një dëshirë për të realizuar një gjë të tillë. Padyshim, shkrimtarë si Koço Kosta, me të drejtë i quajmë si krijues që dolën nga sirtari i ngushtë i kohës, duke dalë në dritën e krijuesve të veçantë, me një botë të pasur e specifike interesimesh tematike. Kishte shkrimtarë që nuk arritën ta shmangnin thujtë intencën e shkrimit të angazhuar, pra të letërsisë si burim i mësimi edukativ.

Gjithsesi, u lëkund ndjeshëm hierarkia e vlerave letrare të paracaktuara dhe të parapara deri atëherë, çka do të thotë se nisën të qortoheshin dhe të anashkaloheshin. Theksojmë se, interpretimi i letërsisë shqipe bashkëkohore ka qenë detyrim moral. Misteret e asaj kohe i krijoi censura, pikërisht për të vlerësuar pa fjalë veprën, duke bërë që shumë shkrimtarë të kalojnë në kalvarin e gjatë të mundimeve shpirtërore. Aq më tepër, që procesi i krijimit të shkrimtarëve ka qenë në një trysni të fortë.

Dimë fare mirë, që në fund të viteve '50 e në fillim të viteve '60, kemi një grup shkrimtarësh të cilët kërkonin të praktikonin modele të reja të ligjërimit, duke shfaqur kështu një pasion dhe prirje noviteti artistik e kulturor.

Proza e tij iu shmang skemave fikse të shkrimit të letërsisë në ato vite dhe kjo i dha mundësinë shkrimtarit të komunikonte me një rreth më të gjerë lexuesish, përtej kohës në të cilën u shkrua. Fryma dhe dashuria e asaj kohe ishte afrimi më i madh shpirtëror i të rinjve letrarë. Koço Kosta e thyen me guxim horizontin e pritjes së lexuesit të asaj kohe mbi të cilën rëndojnë skemat e realizmit socialist, këtij drejtimi që nuk e lindi vetë programin e vet estetik, po e thithi atë nga një burim ekstra-letrar.

Nisur prej risive që sjell kjo prozë është vlerësuar se “Koço Kosta është i njohur si njëri prej prozatorëve më të talentuar dhe letërsia e krijuar nga ai, shquhet për një realizëm ngjethës, për një narracion të situatave, ngjarjeve dhe personazheve tronditëse dhe prekëse njëkohësisht”.¹⁹

Do të shtonim më tej se shkrimtari i shpërthen këto skema, duke iu rikthyer nga njëra anë traditës së realizmit kritik shqiptar të viteve '30, që sigurisht nuk arriti të zhvillohej dot plotësisht, dhe nga ana tjetër, duke thithur burimet e modernizmit, të cilat sigurisht që mund

¹⁹ Lazër Stani. *Proza e jokonformitetit: “Ata të dy dhe të tjerë”*. Në “Drita”, 11 qershor 1995, f. 3.

të përcilleshin me mjaft vështirësi në arealin letrar shqiptar. Ato burime mbeteshin *mollë të ndaluara* dhe sistematikisht të anatemuara, porse të talentuarit arrinin sa mundeshin që t'i bënin të vetat ato ndikime, përmes teksturave të rafinuara. Në këtë proces të ndërlikuar, tek ky autor dhe të tjerë të talentuar, kjo marrëdhënie/lojë me artin e vërtetë nga njëra anë dhe me censurën nga ana tjetër, krijonte një produkt letrar pse jo mjaft tërheqës, pasi viheshin në funksion e me kapacitet të lartë paradigmat e ironisë, të nëntekstit, të simbolit dhe të asosacioneve nga më të sofistikuarat.

Rruga nëpër të cilën ka kaluar letërsia shqipe për të fituar përmasat e një letërsie me profil të plotë artistik ka qenë sigurisht e gjatë, e vështirë dhe e ndërlikuar. Ajo ndoqi fatin e popullit të saj për një kulturë kombëtare. E themi këtë, pasi dhe shkrimtari që kemi për objekt studimi është një individualitet me rrezatim të gjerë dhe me peshë specifike në ecurinë e letrave shqipe, një pikë referimi kjo në rrjedhën dhe drejtimet e kulturës shqiptare.

E gjithë jeta e tij ka qenë një sakrificë për hir të pasionit për të shkruar. Koço Kosta me sa duket ka qenë i udhëhequr nga bindja se shkrimtar i vërtetë është ai që sakrifikon për artin dhe se ai i takon asaj race që sakrifikon për letërsinë. Pra, sikundër shkruhet në një tekst kritik për të, ai e ka bërë zgjedhjen e tij dhe ka bindjen e plotë se e ndien veten me fat që për profesion ka pasionin/artin/letërsinë.²⁰

Nisur prej këtyre tipareve të shkrimtarit një studiues shprehet se: “Vërtet historia, ashtu siç ka thënë Marksi, përsëritet për herë të dytë si farsë, veç jo gjithmonë si një farsë komike e mirëfilltë, por shpesh edhe si një komedi e humorit të zi, e cila në përmbajtjen e vet është një tragjedi. Dhe me atë që morën përsipër shkrimtarë dhe artistë përparimtarë si Koço Kosta, për t'i thënë “ndal” së keqes, japin mësim kritikë, duke e ngritur veten në lartësinë e personaliteteve të mëdha shoqërore”.²¹

Në vijim përmendim vlerësimin e kritikut D. Dilaveri, i cili thotë: “Që të vlerësosh prozën e një shkrimtari padyshim që është një punë e vështirë. Brenda letërsisë ka sprova e ekskursione mendimi. Në një kuptim, të shqyrtosh vlerat, shqetësimet e brendshme, kronologjinë e zhvillimit të artit të tij, është më e vështirë se të merresh me studimet ose veprat letrare të tij, edhe pse prodhimi letrar i periudhës në fjalë shquhej për rritje cilësore”.²²

Kemi mendimin se është vështirë të gjykohet veprimtaria krijuese e një autori apo disave në kushtet e mungesës së lirisë krijuese. Por letërsia ka ligjet e veta të brendshme, që sfidojnë diktaturat. Edhe drejtimi i realizmit socialist nuk arriti nivelimin e individualiteteve krijuese, të cilat, në rast se mbështeteshin mbi një talent të lindur e të zhvilluar, kanë mundur të çelin edhe në atmosferën mbytëse të diktaturës. K. Kosta pati talentin e lindur si prozator dhe guximin krijues që të shpërthente kanunet letrare. Zgjerimi i skenave dhe i episodeve me perceptimin e fuqishëm, është ajo që i jep prozës ngjyresa individuale dhe një fill ndjeshmërie që lidh tregimet me njëri-tjetrin. Mjafton të përmendim kohën dhe hapësirën që

²⁰ Esmeralda Bardhyli. *Të rrezikosh për letërsinë: Koço Kosta, shkrimtari që theu rregullat e letërsisë së realizmit socialist*. Në “55”. - Nr. 318, 1 dhjetor, 2005, f. 19.

²¹ Skënder Demolli. *Kjo anomali duhet të ndalet, është urdhër kombëtar*. (Marrë nga interneti).

²² Dilaver Dilaveri. *Disa karakterizime të prozës së Koço Kostës*. Në librin: “D. Dilaveri”, në rrugën e zhvillimit të prozës sonë të shkurtër: studime dhe artikuj kritikë, Tiranë 1982, f. 141.

përputhen në tregimet e tij, me kohën dhe hapësirën në të cilën ka ndodhur ngjarja së cilës i referohen tregimet.

Vendi që ka zënë K. Kosta si shkrimtar në historinë e letërsisë shqipe ka qenë i kufizuar, ashtu siç kanë qenë të pamjaftueshme studimet e veçanta mbi krijimtarinë e tij letrare. Është e vërtetë, se bilanci sasior i kësaj sfere në veprimtarinë e gjithanshme paraqitet i paktë, por sikundër shprehet një studiues: “Në art, dihet se nuk është kurdoherë sasia që përcakton vlerën e një shkrimtari, por pasqyrohet jetësorja në letërsi dhe art njëkohësisht”.²³

Edhe pse bilanci sasior i krijimtarisë së tij artistike është i kufizuar (kjo jo për faj të tij), në të vërtetë ai u mor me letërsi tërë jetën.

Studiuesi Rifat Ismaili ka shprehur mendimin e tij se: “Nuk janë të rralla rastet kur në letërsinë botërore shprehet fati i krijuesit në mënyrë simbolike dhe figurative përmes veprës letrare”.²⁴

Që në leximet e para që iu kemi bërë veprave të këtij shkrimtari, kemi ndjerë se po lexonim krijime me specifikën e vet, të ndryshme nga autorët e tjerë. Ky mendim do të forcohej më pas, duke gjykuar se Koço Kosta është shkrimtar i veçantë në letërsinë shqipe. I veçantë me tematikën, me idetë, me strukturën e veprave, i veçantë me stilin dhe me gjuhën. Gjatë punës së tij ka shkruar dhe ka botuar vepra duke iu përmbajtur parimit të njohur: shkruaj e boto. Opusi i tij krijues është i larmishëm dhe dëshmon për synimin e tij që të lidhej me publikun e kohës dhe që t’i japë ushqim të zgjedhur estetik. Midis publikut, në kuptimin e lexuesit elitare dhe kritikës zyrtare të kohës, e ideologjizuar dhe e prirë nga zhurmat, Koço Kosta zgjedh lexuesin, i kuptuar si lexues “model”, domethënë, synon të krijojë lexuesin e vet. Për këtë arsye, ky shkrimtar në kohën e diktaturës ku edhe nxori në dritë krijimtarinë e vet të fazës së parë, komunikon me pjesën më të avancuar të publikut, intelektualë që ishin ushqyer me kulturë të pasur teorike dhe letrare, në luftë me censurën dhe njerëzit e thjeshtë, që gjenin vetveten në krijimet e këtij autori. Kjo është edhe arsyeja që ky autor ka mbetur aktual edhe sot.

Duke analizuar brendinë e poetikës së veprës së tij, vlen të përmendim: subjektet e ndërtuara mbi bazën e një materiali të larmishëm e të freskët jetësor, format e shumëllojshme kompozicionale të veprave, përdorimin me mjeshtëri të mjeteve artistike, të mënyrave të rrëfimit, të dialogut, peizazhit, portretit, monologut të brendshëm, përpjekjen e autorit për t’i dhënë dorë një pasqyrimi më realist, me më forcë artistike e psikologjike, të karaktereve dhe heronjve në tregimin e këtyre viteve.

Mund të thuhet pa ngurrim se invencioni krijues prej prozatori i Kostës, si askund tjetër, del në pah në tipin e tregimeve, ku spikat aftësia e modelimit kritik të botëperceptimit të dukurive, situatave dhe fenomeneve të realitetit jetësor, mbi bazën stilistike të veçorive realiste, duke e pasuruar realizmin me elemente të modernizmit.

Falë talentit që kishte shfaqur para lexuesve, edhe në vitet kur autori e kishte të ndaluar të drejtën e botimit, mbetej i gjallë imazhi se ai do të merrte pjesë aktive në jetën letrare të vendit.²⁵

²³ Dilaver Dilaveri. *Nëpër faqet e prozës sonë*. Naim Frashëri, Tiranë 1977, f. 5.

²⁴ Rifat Ismaili. *Aspekte të prozës sonë*, Rilindja, Prishtinë 1981.

²⁵ Shpend, Topallaj. *Koço Kosta- shkrimtari që foli aq trimërisht*. Në: “55”, nr. 33, 8 shkurt, 2003, f. 20-21.

Proza e K. Kostës i ka ruajtur interesimet themelore të burimeve të veta. Më tej, autori kur e shkruan prozën, e ka parasysh edhe lexuesin e veçantë, të cilit, ia dedikon veprën e vet. Vepra e tij komunikon me lexuesin sepse ai është autor që e ka njohur thellë jetën, problemet e saj, ka hyrë në domethënien dhe shkaqet e tyre.²⁶

Kjo tregon për raportin e letërsisë me jetën, të cilin e ka shtjelluar gjatë kritika soc-realiste. Proza nuk ngurtësohet e nuk kufizohet në disa personazhe me po të njëjtat karakteristika, por personazhe të shumtë që dallojnë nga mënyra e të qenit, të menduarit e të vepruarit. Ka personazhe që shpesh përshkohen nga ankthi, zhgënjimet e sfidat që u parashtron jeta, shpesh vuajnë prej absurditetit, por në fund të fundit karakterizohen nga brishtësia. Secili ka veçantitë e tij, por të gjithë i lidh lufta për ekzistencë, qëndresa që secili i paraqet formave dhe brutalitetit që i parashtron jeta. Megjithatë, njeriu i pranon ato sfida dhe i përballon me anë të revoltës, lirisë e pasionit. Shpesh personazhet e Koço Kostës gjenden përballë vetmisë, endjes dhe pritjes, këtu autori zbulon në mendimin e tij edhe kuptimin e ekzistencës, ritmi i së cilës përcaktohet nga alternimi i krijimit, nga kënaqësia dhe vuajtja, e mira dhe e keqja. Kjo është pjesë e karakterit, e personalitetit dhe psikologjisë së tyre.

Proza e shkrimtarit, sidomos tani pas rikthimit të letërsisë së ndërprerë, shfaqet si një befasi e re për lexuesin, si një befasi pothuajse e veçantë.

Shikuar në përgjithësi, Koço Kosta është shkrimtar i ideve dhe i gjykimit të thellë, shkrimtar i cili sintetizon në mënyrë harmonike urtësinë dhe mençurinë popullore, me reflekset dhe gjykimet intelektuale.

Shkrimet për këtë autor të letërsisë shqipe më tepër janë artikuluar në formën e recensionit, me rastin e daljes në dritë të veprave të tij, e më pak të vështrimeve më të thelluara e përgjithësuese. Vetëm fakti se këtu te ne, përveç shkrimeve më të gjata, janë shkruar edhe libra për autorë, krijimtaria e të cilëve ka qenë gjithmonë në nivelin e krijimtarisë së K. Kostës, duket sikur na shtyn të mendojmë, se ky shkrimtar thuhet pa të drejtë është lënë sadopak anash.

Vepra letrare është vepër e hapur dhe si e tillë lejon mundësinë e leximeve të ndryshme. Ky studim është një përpjekje që krijimtaria e këtij shkrimtari të lexohet në tërësi, me synimin që të vihen në pah vlerat e saj të pamohueshme, por edhe dobësitë eventuale. Kujtojmë këtu romanin “Nata e Sofie Kondilit”, e cila është një befasi e këndshme dhe një përjetim i posaçëm artistik, një ndër kontributet më serioze në prozën tonë. Koha reale e veprës, ka një prani të reduktuar hapësire, brenda tre a katër vjetësh, me një radius veprimi po ashtu të rrudhur gati brenda veprimit.

Me romanin e tij, ai u shfaq plotësisht si prozator i talentuar në letërsinë shqipe, i cili ngre në një shkallë më të lartë ato veçori të rrëfimit, që i kishte shfaqur që në prozën e shkurtër dhe sublimon mesazhet që i kishim njohur që në tregimet dhe novelat e tij. Në krijimtarinë e tij hasen dy qëndrime diametralisht të kundërta ndaj ideologjisë së kohës, komunizmit, pranimi total të saj, që ndodh në shumicën e veprave të krijimtarisë së shkrimtarit, sidomos në ato të viteve ’60, dhe mohimit total të saj, që ndodh në krijimtarinë e tij në vitet ’90.

Megjithatë, që në fazën e parë të krijimtarisë së tij, vihet re një kontradiktë midis idealit dhe realitetit. Personazhet e tij, bartës të idealit moral, luftojnë ashpër me jetën dhe

²⁶ Dilaver Dilaveri. *Nëpër faqet e prozës sonë*. “Naim Frashëri”, Tiranë 1977, f. 5.

nuk gjejnë mbështetje veçse në “happy-end”-et e sforcuara (fundet e lumtura), shkrimtari ka një ideal të vetin etik që bazohet tek filozofia popullore dhe vetëm formalisht identifikohet me idealin komunist. Edhe në krijimtarinë e tij të kohës së diktaturës, ndeshet një dramizëm në caqet e tragjizmit ku jo gjithmonë e neutralizon “happy-end”-i.

Me romanin e tij “Nata e Sofie Kondilit”, shkrimtari tregoi talent të jashtëzakonshëm në fushën e prozës. Vetë forma e këtij romani do t’ia lehtësojë punën e tij në këtë drejtim, meqenëse bërthama të kësaj forme mund t’i gjejmë edhe tek proza e tij e shkurtër. Megjithatë, në tregimet e tij, fusha e të shprehurit është më e gjerë, si shkrimtari ashtu dhe lexuesi mund të frymojnë më lehtë, shkrimtari futi në to mesazhin e kohës me të cilën u përpoq të ndikojë proceset shoqërore. Në shkrimet e tij shfaqet figura e intelektualit të angazhuar, të njeriut që jeton intensivisht me fatin e popullit të tij. Ai, përveçse e përjeton rëndë një realitet të tillë, përveçse angazhohet për ta thënë fjalën me të cilën do ta emërtojë këtë realitet, jo rrallë hedh idenë sesi mund të përballohet gjendja e rëndë, si të veprohet në një gjendje të tillë. Situata të reja apo veprime të përshkruara, nën skena të përshkruara me një vrotim të hollësishëm, të cilat renditen sipas një studimi të paramenduar që prej fillimit të veprimit, mund të ndërtohen nga një prozë e tillë. Kujtojmë këtu, Peshkun e Kuq, që shpreh një ndërgjegje të paekuilibruar. Këtu, fazat e aksionit janë tentativa dhe veprimi është i parashikuar. Në studimet e derisotme të letërsisë shqipe, vetëm nëse e vështrojmë kështu prozën e këtij shkrimtari, duke u marrë me psikologjinë, figurën dhe zbërthimin e shpirtit, është bërë e modës që në formën e mesazhit dhe të përgjithësimit, personazhi të kapërcejë caqet e tipit, karakterit apo “heroit social”.

Ndërsa për sa i përket lexuesve, vepra e tij përherë është pritur me interes të veçantë. Ajo është lexuar nga lexues të niveleve të ndryshme. Megjithëse shkruhet nga këndvështrime të ndryshme dhe për pjesë të veçanta të krijimtarisë së K. Kostës, duke e parë atë shkoqur nga rrjedhat historiko-letrare, një pjesë e shkrimeve, të studiuesve e kritikëve të letërsisë, të shkruara për veprën letrare të autorit, në rrafshin e teknikës së qëllimit, do të karakterizohen nga uniformiteti, meqenëse mbështeteshin në metodën sociologjike të zyrtarizuar në kohë të diktaturës, ndërkaq, tipari dallues ndërmjet tyre do të shtrihet në rrafshin e përmbajtjes së atyre qëllimeve. Forma e veprës së këtij shkrimtari ka mbetur pothuajse në hije dhe kjo ka penguar një depërtim të thellë dhe një karakterizim të qartë të individualitetit të tij.

Shpleksja e ngatërimit, përzierjes dhe ndërvarësisë së kriterëve në punë të klasifikimit dhe grupimit të tregimeve, mbështetet në kriterin e dominanteve të tyre tematike e strukturore, për të kaluar pastaj në shqyrtimin dhe përbërjen e përbërësve të poetikës së secilit grup të tregimeve veç e veç. Veçoritë e veprës letrare të këtij shkrimtari, janë rezultat i erudicionit jetësor e kulturor të tij dhe i parimeve të qëndrueshme estetike të tij për letërsinë.

Po përmendim disa nga këto veçori:

1. Krijimtaria e tij karakterizohet nga fryma kritike.
2. Fatin e intelektualit ai nuk e sheh të shkëputur nga fati i popullit.
3. Vepra e tij ka edhe dimension etik, humanist, njohës dhe kombëtar.
4. Trajton tema që lidhen me një religjion të caktuar, por arrin t’i universalizojë kuptimisht.

Veprën e tij letrare, por edhe veprën e tij në përgjithësi, e karakterizon një stil i jashtëzakonshëm, duke bërë që ky shkrimtar në letërsinë shqipe të sjellë risi, ide, mendime,

vizionet e një ndjeshmërie të re, të cilat krijojnë vepra me strukturë origjinale. Vetë shkrimtari e konsolidon gjuhën intelektuale në prozën shqipe, gjuhë e cila karakterizohet nga një stil mjaft specifik. Po të vëmë re dialogun, ai është i motivuar nga gjendje dhe situata konkrete, ku funksioni primar i tij është plotësimi i rrëfimit, karakterizimi i personazheve dhe krijimi i idesë, lidhur me atmosferën e përgjithshme që mbretëron. Gjendja shpirtërore dhe mendore e personazheve, zhvillohet në situata të veçanta dhe këtë e plotëson dialogu, i cili është në funksion të rrëfimit.

Duke analizuar veprat e tij, do të gjejmë shumë përgjigje në pyetjet dhe konstatimet e mëparshme.

Studiuesi Ali Aliu është shprehur se: “Proza e tij është një trajektore ngjitëse, një evoluim i natyrshëm, një gjithanshmëri analizash dhe vëzhgimesh, një bagazh i pasur shprehjesh dhe nocionesh teoriko-letrare. Ishte koha kur shoqëria shqiptare si dhe kultura e saj dhe letërsia në veçanti, po hapeshin ndaj botës dhe modeleve të një filozofie letrare dhe perëndimore”.²⁷

Shkrimtari gjeti fillin e një komunikimi të lirë me lexuesin shqiptar. Në prozën e tij (nëse nisemi nga narracioni), autori heton “pozicionin” dhe perspektivën e narratorit autorial në raport me funksionimin e personazhit si figurë e karakterizuar. Kur lexojmë veprat e tij, padyshim depërtojmë në shenjat dhe kodet e personazheve. Proza e tij është prozë e ideve. Leximi i veprave të tij ka vlerë dhe na mbush me ndjeshmëri të thellë estetike.

Sipas studiuesit Isak Shema: “Këtu shpjegohet dhe roli i veçantë i lexuesit, si gjurmues i suksesshëm vlerash dhe domethëniesh letrare”.²⁸

Në rrafshin e artikullimit të ideve dhe koncepteve, subjektiviteti ndërlidh domethënien historike dhe kodin ligjërimitor përcakton formën letrare. Vizionariteti i fuqishëm i tij, flet për idetë, për aktin e inspirimit, për vizionet, për mendimet filozofike, për rilindjen e shpirtit njerëzor, për teorinë e receptimit, duke shtresuar imazhin mrekullitar të shpirtit njerëzor dhe duke dhënë vlerën përcaktuese të riciklimit të imazhit suprem, duke u ngjitur në shkallët e ligjërimit dhe duke shfaqur karakteristikat e tekstit si një proces dhënie-marrje me temat dhe idetë. Pikëshikimi i veprimit vezullon me gjithë kuptimet dhe domethëniet e shtresuara në vepër. Si një krijues me shpirt të gjallë e kërkues, me kërshtëri të theksuar ndaj gjithë asaj që ndodh në jetë dhe në art, njeri idealist dhe shkrimtar i angazhuar, sakrifikoji në jetë dhe në krijimtari, vetëm që t’i mbetet besnik këtij ideali etik dhe humanist. Vepra letrare e autorit është sintezë artistike e fatit të njeriut që ka kaluar nëpër rrugën më të vështirë gjatë historisë, që në thelb është fati tragjik i jetës së njerëzve, ku siç thotë edhe studiuesi Sh. Topallaj: “Dënimi i mendimit të lirë e të guximshëm është shumë i lashtë”.²⁹

Në traditën e studimeve rreth karakterit dhe tipologjisë së prozës së këtij shkrimtari, përgjithësisht është theksuar moderniteti formal dhe ai i mendësisë që shfaq ky autor në rrugën e gjatë të krijimtarisë së vet, studimet për vendin e veprës së tij i referohen kontekstit dhe vlerave të tij. Potenciali i ideshmërisë dhe veprimet që kryhen, e nxisin lexuesin të mendojë dhe të shtrojë shumë pyetje. Përmes përshkrimit të hollësishëm të veprimeve njerëzore sigurohet një funksion i karakterizimit të personazheve.

²⁷ Ali Aliu. *Koha dhe krijuesi*. Prishtinë: Rilindja, 1975, f. 65.

²⁸ Isak Shema. *Aspekte të letërsisë*. Prishtinë: Rilindja, 1985, f. 192.

²⁹ Shpend Topallaj. *Koço Kosta- shkrimtari që foli aq trimërisht*. Në: “55”, nr. 33, 8 shkurt, 2003, f. 20-21.

Dimë fare mirë, se narratori nuk është indiferent ndaj rrëfimit të tij dhe ndaj personazheve për të cilat rrëfen.

Studiuesja F. Dado shpreh mendimin e saj se: “Një mënyrë e tillë e rrëfimit, flet për raportin e narratorit me personazhet: ai rrëfen për personazhet të cilat i ka njohur shumë mirë, me të cilat ka pasur raporte nga më të ndryshme, - ky rrëfim ngërthen brenda vetes ndjenjat e tij”.³⁰

Edhe pse ndonjëherë vepra e autorit karakterizohet nga përsëritjet, nga më të ndryshmet, nuk shkakton ndjenjën e lodhjes dhe të monotonisë të lexuesit, por përkundrazi.

Për të absolutizuar pavarësinë e veprës, sipas prof. Alfred Uçit, - “disa përfaqësues të estetikës strukturaliste përmendin fakte nga historia e artit, kur kuptimi, domethënia morale e veprës artistike, sjellin dhe pasionin e fortë të një shkrimtari”.³¹

Theksojmë se, vepra e këtij shkrimtari është “rritur” bashkë me letërsinë e sotme shqipe, ndaj të shfletosh krijimtarinë letrare të Koço Kostës, do të thotë të kthehesh në fillimet e letërsisë shqipe bashkëkohore, ndërsa të shkruash për veprën e tij do të thotë të shkruash një pjesë të historisë të kësaj letërsie (duke përfshirë edhe traditën).

Jo pa të drejtë, megjithëse ndonjëherë edhe apriori, disa studiues dhe shkrimtarë, kanë këmbëngulur vazhdimisht në mendimin se vepra e këtij autori është e pasur në cilësi, veçori dhe organizime estetike të shumëllojshme dhe origjinale. Bota e veprave të tij, sido që nuk zë volume të shumta në sasi, i ofron studiuesit të çdo kohe mundësi të mëdha gjykimi, shtrat të begatë për analizë dhe interpretime përgjithësuese. Në thjeshtësinë dhe sinjeritetin e saj, të kuptuar vetëdijshëm si origjinalitet, vepra e K.Kostës, jo vetëm që sugjeron vlera dhe kuptime letrare për lexuesin, objeksione dhe metodikë shkencore për kritikën, por, po kaq bujarisht, ajo kënaq në më të shumtën e rasteve teorinë dhe kriteret universale të shkrimit letrar. Nën këtë logjikë, ajo që kemi paralajmëruar qysh në faqet e para të këtij punimi, nuk është gjë tjetër, veç një sprovë modeste dhe studimore rreth problematikës. Vepra letrare është njëra prej mëvetësive të dallueshme të rrëfimit. Shkrimtari ka pasuruar së shumti natyrën e zhanrit, veçori jo e paktë kjo, për t’u dëshmuar. Edhe përthyerja e realitetit, realizohet në kompleksitetin njerëzor dhe njëkohësisht formësohet nga procesi ekzistencial i individit.

Kjo është letërsia, ky është teksti shumë përmasor me gjerësi dhe thellësi lënde. Këto janë segmentet e shumta kuptimorë dhe stilistikë.

Ndodh që personazhet të marrin frymë dhe natyrshmëri sipas një parimi të njohur se ato “duhet të përngjasojnë me vetveten” (sipas M. Jacob-it) dhe, pikërisht për këtë, autori e ka pasur të lehtë të ndërhyjë në zona të kompleksit njerëzor. Rrëfimi është i natyrës së ndjeshmërisë së lartë dhe shpaloset si shfaqje e dukshme moderniteti, edhe pse qëndrimet mbi veprat e asaj kohe kanë qenë nga më të ndryshmet. Studiuesi Trim Gjata ka dhënë mendimin e tij mbi novelën “Ata të dy dhe të tjerë”: “Dukej qartë, Olimpi monist ishte i zemëruar nga novela, akuza groteske të cilat dëshmojnë ndershmërinë artistike dhe etike të shkrimtarit”.³²

³⁰ Floresha Dado. *Teoria e veprës letrare-Poetika*, Tiranë 2002, f.171.

³¹ Alfred Uçi. *Pavarësia e veprës dhe përsendëzimi i artit*, botuar në suplementin “Drita”, 30 janar 1983.

³² Trim Gjata. *Diktatura dhe vepra letrare “thellësisht e gabuar”*. (Me rastin e botimit të novelës: “Ata të dy dhe të tjerë” të K. Kostës). Në: “Republika”, 12 janar 1995, f. 3.

Prandaj, ka shumë arsye të thuhet se vepra letrare e tij ekziston si plotësi, ku funksionon dhe modelohet qartas sistemi vetjak i stilit.

Kësisoj, një letërsi e mëvetësishme mund të kuptohet dhe duhet kuptuar vetëm si letërsi.

Në të vërtetë, aspekti narrativ është njëri prej aksesoreve më të fuqishëm në procesin e strukturimit të tregimeve dhe prozës së gjatë të këtij autori. “Tematikat që përmbajnë tregimet janë të larmishme, të gjitha i bashkon një ndjenjë e ngrohtë dashurie për njeriun e thjeshtë, për njeriun e punës”.³³

Në tërësinë e tyre shkrimet e këtij prozatori dëshmojnë për dhunti të gjalla narrative dhe për aftësinë e spikatur për të treguar ngjarje, për të karakterizuar dhe motivuar në mënyrë origjinale personazhet dhe veprimet e tyre, veçori të cilat e joshin studiuesin në punën e tyre. Jo vetëm stili dhe mjetet e ligjërimit, por edhe galeria e personazheve dhe karaktereve të novelave dhe tregimeve të tij i nënshtrohen një subjekti, me kalime të befasishme nga një realitet në tjetrin, me përshkrimin e ngjarjeve ku utopia për të ardhmen, lartësimi i njeriut, frymëzimi i ndjenjës, janë pikat kryesore në prozën e tij. Modelet e rrëfimit janë një shprehje e individualitetit të tij.

Ja disa nga pyetjet që na kanë lindur gjatë leximit të veprave të tij:

Ç’lloj narracioni ndërton K. Kosta?

Cilat janë mjetet, format dhe specifikat e artit rrëfyes?

Si organizohet struktura psikonarrative e personazheve?

A luan rol funksionaliteti i përshkrimit në skenën e përgjithshme narrative?

Në mendimin teorik letrar të kohës, si pasojë e konceptit klasik të ndarjes së veprës në dy pjesë: formë dhe përmbajtje, kemi një vlerësim empirik, jo vetëm për elementet narrative, por dhe për nocione të tjera të strukturës së veprës letrare.

Sipas këtij koncepti, “përmbajtja shpreh atë që në vepër është thënë, ndërsa forma nënkupton mënyrën në të cilën është thënë”.³⁴

Për pasojë, vepra letrare, domethënë strukturat përbërëse të saj, vlerësohen të shkëputura dhe në një ndarje formale, gjë që duket sikur e fut analizën e përgjithshme në qorrsoak, të cilit nuk i shpëtojnë as elementet e shtresës narrative si pjesë e të tërës letrare. Pas një leximi të vëmendshëm për të hetuar përdorimet dhe kuptimet e nocioneve narracion, narrator, përshkrim në analizat që u bëhen veprave në prozë, konkludojmë se: në studimet dhe në trajtesat teorike - kritike dhe historiko-letrare shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore e këtej, vështirë se gjenden punime dhe gjykime të posaçme tërësore për rrafshin narrativ të veprës letrare dhe problematikën e gjerë që rrok kjo shtresë e saj. Ky është fenomeni i cili shpjegohet me shumë faktorë, pasi dihet që ndonjë konstatim i këtij aspekti, shtrihet në analizën e përgjithshme të veprave dhe stimulohet prej elementeve dhe shikimeve filologjike letrare, për shembull, prirja për vizatim heroik dhe bardhë e zi të personazhit, lehtësia e kuptimit prej të gjithëve dhe për të gjithë, edukimi unik i lexuesve. Kjo ishte karakteristikë për “realizmin socialist” që i ka varfëruar dhe reduktuar veprat letrare, që ka sjellë si pasojë edhe një varfërim të kritikës në kohën e së ashtuquajturës, le ta themi, *diktaturë kritike*, e cila

³³ Petrit Ymeri. *Me dashuri për njeriun – Shënime për vëllimin me tregime “Era e Udhëve” të Koço Kostës*, botuar në “Zëri i Rinisë”, 24 prill 1982.

³⁴ Dilaver Dilaveri. *Nëpër faqet e prozës sonë*. “Naim Frashëri”, Tiranë 1977, f. 134, f. 66.

nuk preferon të ndalet në elementet e veçanta të formës, por veçse në strukturat e ideve dhe të konteksteve social-politike. Rrjedhimisht, edhe elementet e shtresës narrative nuk bëjnë përjashtim nga ky konceptim i përgjithshëm i veprës letrare (për të cilën flasin R. Wellek-u dhe A. Warren-i). Nisur nga kjo platformë konceptuale teorike kemi rastin e një editoriali të revistës “Nëntori”, në vitin 1986, ku refuzohet me indignatë fryma e novelës së shkrimtarit K. Kosta “Ata të dy dhe të tjerë”, si dhe minimizohen vlerat e saj në skajshmëri, vetëm në disa ngjyresa stilistike në skalitjen e personazheve. Prej këtij editoriali po citojmë një pasazh të shkurtër : “Dhe ka një inkoherencë të plotë në pasqyrimin e këtyre personazheve, që herë janë gati të neveritshëm, herë e “mallëngjejnë” rrëfimtarin K. Kosta.”³⁵

Është fjala për një identifikim nga ana e kritikës, midis rrëfimtarit dhe autorit. Në fakt, nuk del e qartë në këtë kritikë se ku qëndron “inkoherenca e plotë”: në qëndrimin emocional të rrëfimtarit barazuar me autorin, apo në logjikën e brendshme të karaktereve të pasqyruar.

Vepra e tij është shkruar në një ligjërim të shtruar, duke i vendosur karakteret dhe ngjarjet në sfonde situatash të larmishme. Rrëfimtari s’është përherë identik me autorin dhe vlerësimi emocional në disa raste është ambivalent.

Nga shqyrtimi i elementeve të shtresës narrative përgjatë analizës së veprave, del se objektiviteti shkencor në dallimin e qartë midis shkrimtarit dhe narratorit, si dhe vlerësimi real i elementeve të rrëfimit, janë pika me rëndësi. Kur arrijnë të jenë të informuar mirë teorikisht, atëherë studiuesit mund të jenë vërtet objektivë/racionalë në verifikimin dhe studimin e kësaj shtrese themelore të veprës letrare, duke pasur një vizion/konceptim të saktë në përkufizimet dhe vlerësimet rreth narratorit, sidomos në raportet e tij me zërat e tjerë që qarkullojnë në strukturën e asaj ose kësaj vepre.

Këto konceptime e aplikime analizash i hasim në një varg tekstesh kritike të disa studiuesve si Ali Aliu³⁶, Sabri Hamiti³⁷, Bajram Krasniqi³⁸, kushtuar p.sh. romaneve të Ismail Kadaresë apo Hivzi Sulejmanit, ku ndihet dhe shprehet objektiviteti shkencor, në dallimin e qartë midis shkrimtarit dhe narratorit, si dhe vlerësimi real i elementeve të rrëfimit brenda botës së romaneve apo një alternim këndvështrimesh dhe vokalizimesh. Një mori analizash, formulimesh dhe teorizimesh, ndihmojnë në analizën e plotë dhe të saktë, të mirëfilltë e shkencore, të strukturës narrative të veprës letrare.

Dihet se narratologjia përfaqëson sot një prej disiplinave të shkencës për letërsinë, e cila shqyrtton dhe analizon skemën e komunikimit narrativ, ndërlihdjen, ndikimin dhe bashkëveprimin midis elementeve të tilla, të cilat shfaqen dhe funksionojnë në mënyrë

³⁵ Revista “Nëntori”, Editorial, Tiranë, Maj 1986, f. 25

³⁶ Ali Aliu. *Kërkime (studime, kritika, ese)*, zgjedhur e përgatitur nga Iskra Thoma. “Naim Frashëri”, 1990.

Struktura dhe domethënia e një proze, f. 129-143.

Lehtësia e narracionit, f. 177-182.

Rrëfimi për mashtrimin, f. 247-250.

Mjeshtëria e rrëfimit, f. 363-369.

³⁷ Sabri Hamiti. *Studime dhe kritikë letrare*, (autorë kosovarë, të Maqedonisë dhe të Malit të zi), përgatitur nga Ramazan Vozga, Tiranë 1983, f. 421-440.

³⁸ Bajram Krasniqi, në: “*Studime dhe kritikë letrare*, autorë kosovarë. SH.B. “Naim Frashëri”, Tiranë 1983, f. 297”, në vend të termit narrator përdor “kallëzimtar”.

permanente, në çfarëdoq teksti që pranohet për letërsi në formën e prozës tregimtare. Marrëdhëniet shkrimtar – narrator kanë veçantinë e tyre edhe në krijimtarinë e K. Kostës, të përqendruara tek proza e shkurtër, e cila lindi në atmosferën letrare dhe ideologjike të kohës, në një letërsi të etiketuar si e “realizmit socialist”. Skema e përgjithshme narrative funksionon si e tillë, brenda skemës globale të funksionimit të veprës në relacion me lexuesin. Kjo narratologji përfaqëson domethënien dhe rolin e elementeve të lartpërmendura, të cilësuar si:

1. Autori/shkrimtari: Ai që prodhon veprën letrare
2. Narratori/rrëfyesi: Ai që tregon, ai që rrëfen
3. Narracioni: Të rrëfyerit, akti i rrëfimit
4. Lexuesi: Objekti imagjinar i narratorit ose Receptuesi dhe Përjetuesi i rrëfimit.

Sipas Ann Jeferson-it dhe David Roby-it: “Aftësia për të vlerësuar veprën letrare është, në të vërtetë, çështje e mënyrës se si ta njohësh atë”.³⁹

Këto elemente funksionojnë të veçuara dhe si tërësi, në relacion me njëra-tjetrën në çdo vepër letrare të prozës rrëfimtare. Relacioni midis narratorit dhe lexuesit, paraqitet reciprokisht në formë të dyzuar, ku përfshihet edhe autori/narrator, pra, ai është një narrator i imagjinuar dhe pastaj një narrator real për lexuesin. Theksojmë këtu, se disa pohime të disa shkrimtarëve të ndryshëm, të cilat vlerësohen nga studiuesit francezë, si për shembull J. M. Adam,⁴⁰ si përvojë shkencore dhe jo si përfundime intuitive (meqë ata janë autorë), mbështesin teorikisht dhe praktikisht aksiomën: “Shumë njerëz bëhen akoma edhe sot qesharakë, kur përpiqen të bëjnë një shkrimtar bashkëfajtor të ndjenjave që ai u vesh personazheve të tij dhe, në qoftë se ai përdor vetën e parë, pothuaj të gjithë janë të prirë ta ngatërrojnë me atë që rrëfen”.

Jo pa qëllim e morëm si shembull këtë thënie. Kemi parasysh që flitet edhe nga instanca e rrëfimit. Dijetarë, teoricienë, narratologë, qysh nga koha e Aristotelit e deri më sot, kanë bërë të mundur pranimin e formulimit aksiomatik se: “Autori nuk mund të identifikohet me narratorin dhe anasjelltas”.⁴¹

Megjithatë, edhe shkrimtari më objektiv, siç ka qenë, bie fjala, Floberi, i “gjykon” personazhet e veta jo aq përmes zërit të rrëfimitarit në dukje indiferent, por, përmes situatave dhe detajeve të zgjedhura. K. Kosta është nga ata shkrimtarë, që “stimulojnë” objektivitetin. Pra, ka dhe raste kur shkrimtari arrin në identifikim me personazhet, siç ndodh në novelën e guximshme “Ata të dy dhe të tjerë”. Dy personazhet kryesore të kësaj novele “Peshku i Kuq” dhe “Djaloshi i Pashëm”, sado të çuditshme dhe *sui generis* që të duken, kanë marrë si të thuash, transfuzion gjaku nga autori i tyre, i cili ka projektuar tek ata shqetësimet e veta për dramën e artit në diktaturë, pra këtu, objektiviteti në dukje në zërin e rrëfimitarit

³⁹ Ann Jeferson, David Roby. *Teoria letrare moderne*, (botimi i dytë), Albas, 2006. f.7

⁴⁰ J.M.Adam, *Le Recit*, Paris, P.U.F. *Que sais-je?*, f. 10, nr. 2149, 1984, f.10

⁴¹ Kjo çështje është pak a shumë analoge me raportin midis unit lirik dhe atij uni që hasim prej studiuesit dhe poetit Agim Vinca, në librin e tij “Orët e poezisë” (kemi parasysh kritikën letrare, 1990). Në librin e studiueses gjermane Kete Hamburger “Logjika e letërsisë” përmendet mes të tjerash se: “Nuk ka asnjë kriter ekzakt as logjik, as estetik, që do të mund të na sqaronte nëse mundemi ta identifikojmë subjektin rrëfyes” (cituar sipas studiuesit A. Vinca).

fsheh subjektivitetin. Shkrimtari sikur nuk e ka prerë “kordonin e kërthizës” me “fëmijët” e vet prej letre.

“Edhe pse përballë këtyre vështirësive, ky shkrimtar, gjatë gjithë jetës, në rrethana tepër të vështira mbeti besnik i idealeve, një meritë e madhe kjo, që shkrimtari e ruajti me aq fanatizëm dinjitetin e krijuesit dhe artistit”.⁴²

Pra, deri tani, kemi vënë re se në letërsinë tonë, varësisht nga qëndrimi që shkrimtarët kanë ndaj realitetit nga e njëjta strukturë, gradualisht zhvillohen disa tipare dalluese dhe elemente, të cilat i ofrojnë më shumë disa tregimeve dhe novelave që i bëjnë të dallohen nga veprat e tjera e që kanë veçori të ngjashme, d.m.th., kristalizohen elemente që përbëjnë strukturën e tipit, në kuadër të të cilit diferencohen pak a shumë forma, prirje dhe veçori që për poetikën janë margjinare, karakteristike kjo edhe për Koço Kostën.

Karakteristike për shumicën e tregimeve të vëllimit “Bisedë në mesnatë”, është se brenda tyre ndërtohen miniskena që konkretizojnë esencën e gjithë krijimit. Ky autor kërkon t’i japë shumë tregimit dhe romanit.

Edhe F. Malo ka shprehur mendimin e tij se: “Duke vazhduar të paraqesë e të zhvillojë vlerat morale dhe estetike të realitetit shqiptar, autori do të dijë edhe fenomenet ku zbërthehen këto vlera”.⁴³

Nga interesimi i dukshëm për personalitetin e personazhit, që vjen duke u theksuar gjithnjë e më shumë, nga vënia e fabulës në funksion të krijimit të personalitetit të personazhit, e jo të personazhit në funksion të ndërtimit të kësaj fabule, nis e konstituohet tipi i kësaj proze. Në fazën që përjeton sot, proza e këtij shkrimtari huazon ende modele të paraqitjes artistike të jetës. Trajtimi i së kaluarës, si totalitet i mbyllur historik, nuk është shprehje artistike e vetëdijes moderne e historike. Prandaj, nuk mund të kryejë funksionin estetik, rrjedhimisht dhe shoqëror, nëse nuk parashton të tashmen dhe të tashmen si histori. Shkrimtari Koço Kosta, duke njohur në gjerësi dhe në thellësi këtë traditë, por edhe atë të periudhës rilindëse, e përvetësoi me mjeshtëri prozën e ngjarjeve, në të cilën zotëron hapësira e shtrirjes së ideve dhe domethënieve, hapësirë që përbrenda kornizës e krijon dimensionin përcaktues apo elementin përvijues që ka të bëjë me realitetin.

Sipas kritikut D. Dilaveri “... në pikën tjetër të procedimit, shihet funksionalizimi i personazheve përbrenda tekstit narrativ, për të krijuar paralelizmin apo relacionin me tipin e prozës së karaktereve...”⁴⁴

Diapazoni i fuqishëm, krijues dhe intelektual, lidhet me tregimet dhe novelat ku i prodhon dhe i riprodhon në dy forma: në variante dhe në versione. Por edhe kundërvënia e disa prej personazheve, është një prej veçorive që e shquan prozën e këtij autori. Në këtë mënyrë, janë bërë sprova kritike që të hetohet kjo kundërvënie në rrafshe të ndryshme të pikëshikimit. Gjithsesi, në pikëpamje të procedimit dhe të zhvillimit artistik, vepra e K. Kostës shënon prirje të reja dhe veçon me modernitetin e rrëfimit letrar. Në aspektin

⁴² Koço Kosta. *Refleksion: Koço Kosta rrëfen vetveten: Diçka për vete dhe për romanin: “Ata të dy dhe të tjerë” –refleksione, shkrimtari rrëfen vetveten*, në: “Tema”, nr. 1641, 9 dhjetor 2005, f. 20-21.

⁴³ Fotaq Malo. *Biseda të ditës*, botuar në “Zëri i Rinisë”, 18 Mars, 1972.

⁴⁴ Dilaver Dilaveri. *Disa karakterizime të prozës së Koço Kostës*. Në librin: D. Dilaveri, “Në rrugën e zhvillimit të prozës sonë të shkurtër: studime dhe artikuj kritikë”. Tiranë 1982. f. 146.

ndërtimor, përpos çështjes së përcaktimit llojor dhe konvencionit të kohës, në prozën e këtij autori, shihet dhe prania e hipertekstit, retrospektiva e ngjarjes apo digresionit. Gjithnjë përbrenda këtij pikëshikimi kritik, edhe novelat me prirje historike, filozofike, bashkërisht mëtojnë të krijojnë modelet e veçanta të shikimit në letërsinë shqipe. Pra, në prozën rrëfimtare të Kostës, ka vazhdimësi me prozën e viteve tridhjetë. Koço Kosta ka shfaqur mendime interesante në letërsinë dhe kulturën shqipe. Kjo duket në faktin se, në shkrimet e shumta letrare dhe nëpër shkrime e intervista të ndryshme, ai zhvilloi prirjen e tij të natyrshme për të hetuar, kuptuar e pastaj realizuar domethënien, idetë, stilin, figuracionin e veprave letrare. Si pasojë e evolucionit historik, edhe letërsia shqipe përgjithësisht, dhe proza veçanërisht, ishte në rrugë të kërkimit të formave, sistemeve dhe strukturave të reja gjuhësore-artistike. Ndonjëherë, shkëputja e elementeve të veçanta, që përbëjnë sistemin e normës së një konvence të konsoliduar, si dhe prishjes së normës estetike, ndonjëherë të ndara veç e veç, ato elemente nuk i përcaktojnë kushtet e nevojshme, si dhe krijimin e vlerave estetike me perspektivë historike. Kjo përbën poetikën e tij teorike që ka një raport të caktuar me poetikën praktike. Mendimet e autorit në thelb i nënshtrohen një procesi që e kërkon tërësinë e kuptimit dhe krijimin e saj. Kërkesat që shtronte koha, përpjekjet e shkrimtarëve për njohjen më të gjerë e më të thellë të realitetit dhe për rritjen e mjeshtërisë artistike, sollën ndryshim të dukshëm të veprave, gjë që e pasuroi mjaft brendinë e tij. Autori, në qasjen e tij shtreson pikëpamje që kanë vlerë njohëse dhe afirmative, të cilat shquhen me vlerën kryesore të ligjëritimit. I veçantë në mendime dhe veprime, modern në koncepte dhe metodë, në thurjen dhe në zgjedhjen e kërkimeve, autor i rëndësishëm, ku kontributi i tij nuk lidhet me studime sintetike - por me përpjekjen për t'i afirmuar të arriturat në letërsinë shqipe. Me të drejtë, kritika letrare e kohës theksonte se: “Prozatorët tanë deri më sot janë marrë kryesisht me veprimtarinë e vullnetshme të njerëzve për transformimin e jetës, por janë marrë pak me ndikimin e jetës për transformimin e njerëzve”.⁴⁵

Kritiku, duke krijuar mendime me peshë letrare e shkencore, arrin t'i zhvillojë konceptet e tij teorike dhe letrare, me një terminologji të shkathët dhe funksionale.

Sipas studiuesit A. Vinca, “Bota e veprave letrare i ngjan një labirinti, në të mund të hyhet nëpërmjet rrugësh e shtigjesh të ndryshme, ajo kërkon lexuesin që ta kuptojë e ta përjetojë varësisht nga formimi, dija teorike për letërsinë, përvoja, karakteri”⁴⁶.

Librat, ashtu si dhe njerëzit, kanë historitë e tyre. Ato komunikojnë me kohën, me kohët. Libri s'thotë gjë atëherë kur s'ka vlerë artistike, pra nuk arrin formën e lartë, ku mesazhi shkrihet dhe bëhet një me formën. Kujtojmë novelën “Ata të dy dhe të tjerë”, e cila, në atë kohë është quajtur thellësisht e gabuar dhe është dëshmi jo vetëm e kohës për të cilën flet, por edhe e kohës kur u shkrua. Edhe pse e shkruar në një kohë ku shkrimtari nuk merrte frymë lirisht, nuk mund të mos admirohet dhe të mos çmohet guximi intelektual i autorit, pse të mos thuhet, se njëra ndër veprat më të guximshme të letërsisë shqipe, ishte novela që bëri bujë “Ata të dy dhe të tjerë”. Siç dihet, guximi në krijimtarinë letrare nuk përbën vlerë më vete, por kur guximi krijues është i veshur me petkun artistik, atëherë duhet të konsiderohet si përbërës që ia shton vlerën veprës artistike. Në fund të fundit, letërsia është edhe dokumenti

⁴⁵ R. Brahimi. *Në udhën e lulëzimit të mëtejshëm (Disa probleme të prozës sonë të sotme)*, Nëntori 1963, nr. 1, f. 147-148.

⁴⁶ Agim Vinca. *Fije të pakëputura*, Pro kultura, Shkup 2004, f. 5.

shpirtëror i një kohe dhe si e tillë, ajo lexohet dhe pranohet në kohëra të ndryshme, duke vënë lidhje ndërmjet kohës së shkrimit dhe kohës së leximit.

Nuk mund të mohohet fakti se, në krijimtarinë e Koço Kostës, ka vepra, vlera dëshmuese e të cilave rivalizon me vlerën artistike. Në fakt, novela “Ata të dy dhe të tjerë”, vendos në qendër personazhe që përjetojnë një “krizë identiteti” dhe autori ndërthur realizmin dhe modernizmin, duke arritur një realizim estetik. Autori, përveç rrethanave të përgjithshme, ka pasur parasysh edhe nivelin e përgjithshëm kulturor të lexuesit të kohës, ose më mirë të thuhet, traditën e leximit të një tipi të letërsisë. Kjo vetëdije e autorit ndonjëherë artikullohet drejtpërdrejt në veprë. E rëndësishme është se autori, qoftë kur flet drejtpërdrejt, qoftë figurativisht, flet fuqishëm dhe bukur. Për sa i përket nivelit të kritikës së atëhershme, mund të thuhet se, një veprë letrare befason ose edhe vë në sprovë, jo vetëm lexuesin, por edhe kritikën, atëherë mund të thuhet se ajo veprë hap një rrugë të re, meqenëse ajo thyen dyfish “horizontin e pritjes”, pra, themelon ose përfshihet në një “avangardë”.

Studiuesja Floresha Dado, shpreh mendimin e saj në lidhje me këtë çështje, duke pohuar: “Narratori nuk luan gjykatësin dhe as nuk mëson të gjykojë. Ai thjesht e përball lexuesin me faktin dhe fjala - tekst mund të mos përsëritet gjatë gjithë romanit”.⁴⁷

Përballë këtij dëshpërimi, lexuesi i Koço Kostës vazhdon të mendojë e të reflektojë për ato që sapo ka lexuar.

“Sado që veprat e tij kanë të njëjtën procedë realist, të njëjtën teknikë të formësimit artistik, sidomos në aspektin e pikëvështrimit të autorit apo narratorit, prapë mund të hasen dallime dhe ndryshime në trajtimin, në shtjellimin e tematikës, të ideve, të personazheve, të kompozicionit, të formës së shprehjes artistike, të ritmit dhe intonacionit që buron nga qenia e tyre artistike dhe mënyra e konstituimit të elementëve të strukturës”⁴⁸.

Kjo do të thotë se personazhi i veprës dhe prirja optimiste, nënkuptojnë njeriun dhe dukurinë e re, njeriun dhe dukurinë tipike. Kësaj letërsie të kohës, personazhi pozitiv dhe prirja optimiste i janë kërkuar për parimësi, që buronte prej metodës zyrtare.

Sipas Tz. Todorovit, “Thyerja e linearitetit të kohës subjektive, si kompozicion i jashtëm, dhe i ndërvënies së kohës mitike, si kompozicion i brendshëm, ndodh në procesin e ndërmjetësimit ndërmjet personazhit narrator dhe autorit”.⁴⁹

Sikundër ka vënë në dukje dhe studiuesi i njohur Bajram Krasniqi, “Letërsisë sonë të sotme iu desh të kompensojë forma dhe ndjeshmëri të stileve të ndryshme”.⁵⁰

K. Kosta, me veprën e tij, arriti të krijojë atë personazh të dilemës dhe kjo përfaqëson faktin që, galeria e personazheve e krijuar prej tij, është një galeri karakteresh letrare të gjallë, që mendojmë se mbijetojnë ndër kohëra dhe i bëjnë nder asaj letërsie. Është aftësia e shkrimtarit, i cili jep modelin e botës së veprës letrare; pra, që ka ditur të modelojë skena dhe momente në veprën e tij, që të mbesin përherë të ravijëzuara në kujtesë si objekt estetik. Si

⁴⁷ Floresha Dado. *Teoria e veprës letrare - Poetika*, Tiranë, Shblu, 2003, f.131.

⁴⁸ Kate Hamburger-i dhe Vejn But-i e identifikojnë pozicionin e gjithëdijshëm të rrëfimitarit me pikëvështrimin e autorit. Krahaso: Kate Hamburger. *Logika književnosti*, Beograd, 1976, f. 147 dhe Vejn But: *Retorika proze*, Nolit, Beograd 1976, f. 65.

⁴⁹ Tzvetan Todorov. *Poetika e prozës*, Panteon, Tiranë, f. 63.

⁵⁰ Bajram Krasniqi. *Poetika e romanit historik shqiptar*, Prishtinë 1985. f. 92.

veprim i vetëdijshëm, që mëton të paraqesë sa më shumë materie dhe që ka rëndësi njohëse, duhen kuptuar skena, episode që përsëriten e që janë shumë të ngjashme me njëra - tjetrën, ndërkaq të mos lëndohet vlera artistike e veprave të tij. Ndërtimi i tregimeve tregon për hapësirën e hulumtimit, ku vrojtohet një ambient i tejmbushur me ngjarje që “flasim” për ngjarjet, me kallëzime që “flasim për kallëzime”. Këtu shtresohet bota e ndjeshme e karaktereve dhe kërkohet doemos forma e veprimit.

Vështrimi i temave dhe i personazheve, rezulton në faktin se, proza e këtij shkrimtari, tregon/dëshmon ngjarje për ngjarjet e përjetuara në ambientet e ndryshme. Prandaj, edhe modelimi i karaktereve të prozës së Kutelit, së pari projektohet në interpretimin e asaj çka ndodh në jetën njerëzore.

Jo pa qëllim e bëme këtë përngjasim. Përshkrimi i jetës nëpër etapa të caktuara dhe kontrastet e shumta që shfaqen përbrenda saj, japin mundësinë e krijimit të një vizioni të qartë dhe me synime të përcaktuara, kur është fjala për tematikën dhe motivacionin psikologjik të personazhit. Pra, përshkrimet ambientale zënë pjesën kryesore të ngjarjeve që rrëfohen në veprat e këtij shkrimtari. “Itinerari jetësor” i autorit, ndoshta është më unikali dhe më i rralli, jo vetëm ndër bashkëkohësit e tij, por, pse jo, në gjithë autorët e letërsisë shqipe. Një shkrimtar, i cili kaloi një jetë të rëndomtë saqë na kujton “Atridët” e antikitetit grek (një familje që patën shumë vdekje të tmerrshme dhe që trashëgoheshin nga brezi në brez), e shohim të shprehur dukshëm, me trishtim, por, gjithsesi, me realizëm në situatat e tregimit.

Përmes një depërtimi në biografinë dhe veçanërisht në veprën e tij me këtë tematikë, mendojmë se dy janë rrugët e përfuturit dhe formulimit të këtyre subjekteve.

Burimi i pare, ka të bëjë me “Itinerarin jetësor” të tij.

Burimi i dytë, ka të bëjë me leximin.

Specifika e korrelacionit midis shkrimtarit dhe jetës, kohës dhe vendeve në të cilën ai veproi, jo vetëm sugjeron përherë “lëndën jetësore”, subjektet, por i materializon në veprë. Ky korrelacion ka determinuar plotësisht pozitën e tij si narrator në raport me narracionin dhe lexuesin si dëgjues, si perceptues të asaj që tregohet/rrëfëhet për të. Këto marrëdhënie, trajtohen gjerësisht në vazhdim,⁵¹ ku elementi i pandarë është rrëfimi, elementi themelor organizues i ndërtimit të veprës.

Pjesa më e madhe e tregimeve me subjekte dhe tema të përditshme rrëfohen në vetën e pare dhe rrëfimtari, tregimtari, identifikohet gjithmonë me heroin kryesor. Ai rrëfen vazhdimisht për ngjarje, fakte, për të cilat ruan lidhje të forta, si ndikues në rrethin e problematikave jetësore, kolektive dhe individuale. Edhe kur i rrëfen në mënyrë indirekte ngjarjet, zhvillimet dhe pasojat jepen në formën e retrospektivave të shkurtra, pasi ato kanë ndodhur. Në këto tregime, ligjëratat e narrativizuar është dominuese e shkrimit letrar, ku ka dhe rrëfime tipike, çdo element në këtë rast lidhet me një fiksim në një tekst, themeli i të cilave bazohet tek e vërteta, tek ngjarjet dhe mendimet e autorit.

Sipas studiuesit të njohur Umberto Eco, “Një sërë funksionesh ka letërsia, edhe për jetën vetjake, edhe për jetën shoqërore”.⁵²

Autoriali.

⁵¹ Floresha Dado. *Proza nëpër teknikat poetike*. - Tiranë: Toena, 1997, f. 100 .

⁵² Umberto Eco. *Për letërsinë*, Dituria, 2007, f. 146.

Këtu do të ndalemi disi në kontekste teorike, si një pasazh, i cili, ashtu si dhe për autorë të tjerë, krijon premisa për ta vlerësuar në mënyrë sa më të brendshme edhe prozën e autorit që është objekt i këtij studimi monografik, K. Kostës.

Studiuesja F. Dado shprehet se, “Bota e brendshme e veprave dhe koncepti i veçantë i një shkrimtari, lidhet me marrëdhënien artistike.”⁵³

Në kuadrin e përgjithshëm të skemës së komunikimit narrativ të autorit dhe prozës së tij rrëfimtare, inversionsi i situatave shndërrohet në një konvencë të ligjëritimit narrativ, e cila është shenja e stilit tregimtar. Gjatë narracionit, personazhet kryejnë vazhdimisht funksionin veprues dhe transformues, duke bërë të mundur krijimin e një rrëfimi me ndryshueshmëri të vazhdueshme situatash, të cilat shfaqen sipas rastit të përmbysura dhe të ndërruara me kuptimësi logjike dhe elegancë rrëfimi, duke dhënë gërshetimin e dy kohërave në vepër.

Edhe studiuesi Rifat Ismaili shprehet se, “Intenca e autorit ndërton elementet e kohës dhe i rishkruan në qëllim të së ardhmes”.⁵⁴

Janë këto situatat narrative që transformojnë, duke u vetëtransformuar, shfaqen pra si një teknikë e përsëritur, duke bërë kështu një parim dhe një ritual narrativ të tij.⁵⁵

Në vijim të këtij mendimi kritik, lind pyetja: Sa i ngjan arti së vërtetës?

Gjendemi përpara një arti që “gjeneron” të vërtetë, atij arti që reflekton përsiatje të thella, nëpërmjet të vërtetës artistike, në kufijtë e rreptë të strukturës artistike. E vërteta e artit qëndron në hapësirën e strukturës artistike të rrëfimit. Ajo që duhet të theksojmë, është se koha është një nga temat e mëdha të filozofisë e të letërsisë perëndimore të kohëve moderne.

Në të vërtetë “...krejt letërsia ka të bëjë me kohën”.⁵⁶

Mirëpo, pasi lexojmë krejt krijimtarinë e tij, dalim në përfundimin se secila vepër dëfton “sojin” e vet të veçantë. Por nuk mund të harrojmë se shkas për një vepër letrare, aq më tepër paralettrare, mund të japë një fakt ose episod plotësisht i rastit nga ana e autorit, i palidhur dhe i parëndësishëm.

Pra: “...lidhja diskurs – autor – biografi, thuajse e predestinon kërkimin apo analizën tekstuale në raport me përgjegjësinë që ka autori, në raport me formën e re dhe me shkrimin figurative të tij në të, fuqi që ia mundëson fronin e neutralitetit letrar kësaj veprë”.⁵⁷

Në horizontin e përndriçimit të problemeve që ndërlidhen me veprën e tij, shkrimtari, fillimisht i parashtron disa momente që kanë të bëjnë me shënimet bibliografike dhe pastaj me zgjerimin e aktit të inspirimit krijues, me vështrimin kritik për gjenezën, formën dhe kuptimin e prozës së tij. Pikëshikimi i tij u ngulit në “mendimet” dhe “gjakimet” e pseudofilologëve. Fjalja e tij ishte e prerë, e fuqishme, domethënëse. Në vargun e këtyre

⁵³ Floresha Dado. *Teoria e veprës letrare – Poetika*, Tiranë 2002, f. 236.

⁵⁴ Rifat Ismaili. *Aspekte të prozës sonë*, Rilindja, Prishtinë 1981, f.135.

⁵⁵ Po aty...

⁵⁶ J. Hillis Miller, *Time in literature*, in: *Daedalus*, spring 2003. (“Daedalus” është revistë e Akademisë Amerikane të Arteve dhe të Shkencave (American Academy of Arts and Sciences).

⁵⁷ Autori historik nënkupton subjektin që e ka krijuar një tekst historik që është artefakt i papërsëritshëm. Ky nocion nuk ka të bëjë asgjë me historinë si shkencë e argumentimeve reale. Për më tepër shih: Jorge J. E. Gracia: *A theory of the Author*, në “The Death and Resurrection of the Author”, (ed. William Irwin), Greenwood 2002, f. 161.

kërkimeve të ideve që bëhet me karakterizime të veçanta, lexuesi e kupton gjuhën e letërsisë shqipe.

Letërsia e sotme, - vëren studiuesi Robert Elsie, - ka hyrë në shtratin e kulturës bashkëkohëse perëndimore.⁵⁸

Konstatimet që iu bënë veprave të shkrimtarit, ishin konstatime funksionale dhe që kishin një koncept të qartë të analizës. Kuptohet, se veprat e tij kishin një vlerë letrare dhe autori diti t'i shfaqë bindshëm ato. Kësisoj, mprehtësia e gjykimit dhe aftësia e shqiptimit të esencës krijuese, janë disa nga tiparet që dallojnë prozën e autorit. Nisur nga kjo, nxjerrim konkluzionin se autori i kërkon idetë dhe i argumenton vlerat. Edhe atëherë kur kërkohet thelbi i qartë i veprës, elementi shqiptar i rrit fuqinë personalitetit të një autori. Nuk ka dyshim se mbizotëron mendimi i freskët që e bën të vlefshëm dhe modern thënien e autorit. Dinamizmi dhe energjia e tij është pjesa e vështrimit në të cilën gjen kuptim metoda e krijimit artistik. Ky shkrimtar i vlerëson duke i ndjekur së brendshmi proceset shoqërore, të cilat i strukturon përbrenda një zinxhiri ngjarjesh dhe i sintetizon ato deri në thellësi. Duket qartë se, në veprat e tij, shkrimtari insiston të nxjerrë temperamentin vullkanik në shkallën më të qartë të kuptimit. Kësisoj, mendimi bëhet i kapshëm, por jo në rrjedhë të cekët lineare, ideja është funksionale, por jo analitike. Këtë dimension e nënkupton vetë emërtimi, vështrimi panoramik, si dhe metoda e interpretimit. Vlen të theksojmë, se jeta receptive e veprës së autorit, ka kaluar në një rrugë plot zigzage, rënie dhe ngritje të mohimit të rëndësisë së tij letrare, në njërën anë, dhe zgjerimit të rolit të saj në historinë e letërsisë shqipe, nga ana tjetër. Nisur nga pikënisja e këndvështrimeve për veprat e tij, kjo është përcaktuese e cilësisë së gjykimeve, bashkë me përmbajtjen e interesimeve për këto vepra.

Sipas studiuesit Isak Shema, “Vlerësimi objektiv i letërsisë së sotme, do të ndikojë në zhvillimin cilësor dhe sasior të letërsisë shqipe”.⁵⁹

Shumë faktorë përcaktues ndikuan në zgjerimin e përmbajtjes së vetëdijes së rëndësisë letrare, por edhe në ndryshimet shoqërore dhe politike që ndodhën në jetën shqiptare. Në veprat e tij autori konstaton me forcë artistike dhe në mënyrë sugjестive, se përpjekjet e tij duhet të jenë të mëdha për të përmbushur synimet të cilat çojnë kah realizimit të idealeve të së ardhmes. Autori jep tablo të gjalla dhe të plota të kohës dhe të realitetit tonë, të fatit individual që depërton në esencën e gjërave, problemeve, të cilat janë tipike për këtë kohë. Shkrimtari duket qartazi se kërkon nga gjenerata e tij, në mesin e njerëzve që nëpër rrjedhën e kohës dhe të jetës kanë qëndruar me stoicizëm, për të lënë gjurmë prapa në rrugën e ekzistencës njerëzore. Në veprat e tij autori me një nëntekst implicit dhe sugjektiv, pasqyron rrugën e brezit të tij, shansin që e krijojnë historia-kohë, e cila mund të realizohet me angazhimin rreth kontekstit shoqëror.

Në vijim të këtij mendimi, mund të themi se “mënyra e organizimit të tekstit në nivelin narrativ, krijon atë tepriçë të rrëfimit, e cila del si mungesë që duhet plotësuar me një rrëfim të ri”⁶⁰.

Vepra e tij pasqyron një tablo të gjerë jo vetëm të kohës sonë, por në mënyrë sugjестive dhe retrospektive pasqyron ngjarjen. Edhe novelat janë të ngritura mbi subjekte të

⁵⁸ Robert Elsie. *Historia e letërsisë shqipe*, Pejë, Dukagjini, 1997, f. 367-478.

⁵⁹ Isak Shema. *Vlerësime të letërsisë shqiptare*. Prishtinë 1996, f. 49.

⁶⁰ *Teoria e novelës dhe tregimit*, Shkup, Flaka e vëllazërimit, 1995, f. 194.

pasura me ngjarje dhe episode, shumica e të cilave dëshmojnë se autori e njeh mirë realitetin për të cilin na flet.

Autori është i vetëdijshëm për angazhimin dhe sakrificën e brezave të shkuar, për veprat e tij që në rrethana të ekzistencës së vështirë, ecën nëpër shekuj, për të arritur me dinjitet të plotë dhe njerëzor në kohën tonë, në shekullin tonë. Mendimi intencional i autorit konsiston në faktin se, brezi i tij duhet të angazhohet me vetëdije dhe përgjegjësi të plotë që ta zërë hapin e nxituar të kohës, për ta kompensuar atë me shekujt që nuk e mundësuan. Brezat që takohen dhe ndahen në kohë, në histori, secili në mënyrën të vet, i qasen jetës, realitetit. Brezi i këtij shkrimtari e thellon më shumë dimensionin kreativ të kohës, botës së re që po ndërtohet, dimension ky, që dëshmon sipas tij nivelin e arritjes sonë.

Në rrugën shekullore të zhvillimit tonë si komb, pati ngecje, zvarritje, çaste krizash, sidomos në aspektin e ekzistencës dhe mbase këto rrethana kushtëzuan tiparet e karakterit të këtij njeriu. Nëpërmjet retrospektivës, koha shtron mendime të ndryshme, të cilat gjejnë shprehje edhe te Koço Kosta, kanë të bëjnë me jetën, me shoqërinë dhe realitetin në tërësi. Si vetëdije e thellë e një kohe dhe e një shoqërie, shkrimtari potencion çështjen e funksionit të artit, si përgjegjësi për efektin që duhet të ushtrojë në natyrën dhe edukimin e qenies njerëzore. Ky është strukturimi i përmbajtjes së vizionit artistik, si faktor ndërmjetësues ndërmjet shumëllojshmërisë së përmbajtjeve të jetës, të historisë, të traditës dhe artit, manifestohet fuqishëm dhe në mënyrë të shkallëzuar në gjithë lëndën e kësaj vepre.

Sipas Danko Gërliqit, “Nuk është vetëm primare se cilat ide dhe cilat vlera shtrohen, por fakti që çdo gjë reale të shtrohet sipas ideve, që bota të matet përgjithësisht sipas vlerave”.⁶¹

Kështu p.sh. në dy romanet e tij linja e personazheve, edhe pse shfaqet dhe është e pranishme në faqet e veprave të tij, kjo linjë ndjehet si prani sugjестive gjatë gjithë veprës. Ajo depërton si e tillë në vetëdijen e lexuesve, ngulitet fuqishëm gjatë tërë rrëfimit me praninë e rrjedhës së saj në heshtje. E fiksuar vetëm në fillim përmes vijave të fuqishme, linja në fjalë ndihet në faqet e veprave dhe imponohet krahas rrjedhave të përcjella gjatë tërë rrëfimit.

Përmes kësaj veçorie kryesore krijuese, mund të shihet sublimimi mjeshtëror i natyrës së realizmit bashkëkohor, ku shquhet dhe talenti i këtij shkrimtari të letërsisë shqipe. Krijimi i fizionomisë së këtij shkrimtari, lëvrimi i formave të saj, konsolidimi i mjeteve të shprehjes ndoqi rrugë të ndryshme dhe nuk ishte i barabartë për të gjitha individualitetet krijuese. Pjesë e pandarë e prozës, janë dialogu me monologun, të cilët, së bashku me përshkrimin ndërtojnë veprën. Ato shfaqen në situata të caktuara si një nga burimet e informacionit, me funksionin tipizues e individualizues.

Në ndryshim nga shkrimtarët e tjerë, “...ky shkrimtar kontribuoi për t’i hapur rrugë të gjerë dhe për ta konsoliduar realizmin në letërsinë tonë”.⁶²

Dihet se proza do të kalonte nëpër rrugë të mundimshme, por në tërësi, disa nga problemet shoqërore që ngriti shkrimtari si p.sh. krijimi i karaktereve të fuqishme dhe mjediseve të besueshme, e bëjnë prozën e tij më të pasur me atmosferë jetësore e karakteresh

⁶¹ Danko Gërliq. *Estetika. Historia e problemeve filozofike*, Rilindja, Prishtinë 1984, f. 36.

⁶² Koço Kosta. *Refleksion: Koço Kosta rrëfen vetveten: Diçka për vete dhe për romanin: “Ata të dy dhe të tjerë” –refleksione, shkrimtari rrëfen vetveten*, në: “Tema”, nr. 1641, 9 dhjetor 2005, f. 20-21.

e që kjo prozë, në tipologjinë e vet, t'i takojë letërsisë realiste. Aq më tepër, këtë mund ta themi për shkrimet e viteve të fundit të tij, që u ripunuan nga pozita e tij më e avancuar dhe me koncepte të reja ideo-artistike. Funkcioni është i gjithanshëm. Me anë të tij bëhet zbulimi i tipit dhe karakterit të personazheve. Sigurisht që rrëfimi varet në një shkallë të madhe nga ritmi i të treguarit. Padyshim që në këto lloj rrëfimesh krijohen raporte me lexuesin dhe se poetika e prozës së autorit nuk mund të kuptohet pa poetikën e kompozicionit të tregimit.

Në një shkrim të revistës “Nëntori” të asaj kohe artikulohej mendimi se, “Fryt i zhvendosje-sublimimeve që vazhduan gjatë periudhës së totalitarizmit, është novela “Ata të dy dhe të tjerë”.⁶³

“Krijuesi, - thekson Frojdi, - bën të njëjtën gjë si fëmija, ai krijon një botë të fantazuar, të cilën e merr shumë seriozisht, d.m.th., e trajton me pasion të madh duke e ndarë qartë nga realiteti”.⁶⁴

Emri i K. Kostës është ndër emrat e merituar të disidencës letraro-estetiko-artistike, emër që pati sukses jo vetëm me një vepër, por edhe me veprat e tjera të tij, vepra që përcollën drama të vërteta njerëzore, ku nuk mungonin asnjëherë humanizmi dhe besimi/optimizmi për të bukurën, për vlerat sipërore, që mund të mbuloheshin për pak çaste nga mjegullat ideologjike të kohës, por ato mbeteshin të pacenuara në brendësinë e tyre.

Këto e të tjera tipare/veçori stilistike e semantike do të gjenden në krejt krijimtarinë e autorit.

1.2 Dy periudhat në krijimtarinë e autorit. Evolucioni i brendshëm letrar.

Krijimtaria e Koço Kostës shtrihet në dy periudha: në atë të para dhe të pas viteve '90-të. Këto nuk janë periudha të një kronologjie të zakonshme vijuese. Për letërsinë shqipe, e jo vetëm për të, ato janë epoka specifike e mjaft të evidentuara në rrafshin kulturor, social e politik të botës shqiptare.

Pra, dallojmë dy faza në krijimtarinë e autorit. E para karakterizohet nga një realizëm kritik në caqet e natyralizmit që vishet me një mburojë të lehtë rregullash të “realizmit socialist”, në sajë të së cilës personazhet që luftojnë për të nuk identifikohen me “heroin pozitiv” apo “personazhin pozitiv” të realizmit socialist. Kësaj mburoje të lehtë i detyrohet në disa raste “fund i lumtur”, kur zgjidhja vjen nga “lart” nga zërat/mendjet supreme/të ndritura që “vendosin drejtësi”, duke dënuar komunistët e degjeneruar që janë shndërruar në “bejlerë të rinj” si: Buzhel Zherdi, Peposhi etj. Pavarësisht nga ky “fund i lumtur” i sforcuar, shpesh konflikti pasqyrohet në tërë ashpërsinë e vet nga autori. Pra, mund të thuhet se i ikën konformizmit e skematizmit, duke ndërtuar artistikisht realitete që strukturohen e funksionojnë përshtat ligjësive autentike të artit dhe jo nën ritmin monoton të doktrinës estetike zyrtare.

⁶³ Koço Kosta. *Ata të dy dhe të tjerë*, Revista “Nëntori”, Tiranë 1986.

⁶⁴ Zigmund Frojdi. *Mbi letërsinë dhe artet*, Shtëpia botuese “Fan Noli”, Tiranë, f. 94.

Në këtë periudhë autori shfaq në prozën e tij dhe teknika moderniste, të cilat arrijnë të vitalizojnë e të gjallërojnë narracionin, duke tentuar kështu të eksperimentojë apo provojë në fushë të formës, doemos sa ishte e mundur në ato rrethana.

Po në këtë periudhë, Koço Kosta arrin me romanin e tij “Buka e një stine me borë”, që të shprehë një tipar të romanit modernist, pikërisht theksimin e elementit lirik, si dhe kompozimin e episodeve në formë mozaiku apo kolazhi, duke krijuar kështu ndjesinë e një hapësire kronotopike, pra, të hapësirës dhe të kohës së ngjarjeve. Është interesante të vërehet që në këtë roman, rikthehen personazhet e shumë tregimeve dhe novelave, duke formuar një lloj galerie me “heronj” të njohur nga lexuesi, pra, të risjellë prej krijimeve të mëparshme, duke krijuar kështu dhe një makrostrukturë të tërë veprës së tij, konceptuar si njësi. Ky model letrar është i njohur në letërsi dhe tek autorë të ndryshëm evropianë, por nuk na rezulton aq i ndeshur në letërsinë shqipe dhe prandaj besojmë të vlerësohet si një risi në synimin për kompozimin unik të veprave pararendëse, duke i sjellë ato jo thjesht si kujtesë letrare, por duke i transformuar në një si të thuash *megavepër* letrare, sa të re, origjinale, aq edhe me lidhje e ndërkomunikime më të hershme, por që tashmë kanë rastin të rizgjohen me një forcë dhe emocion më të fuqishëm.

Romani ka një figurë qendrore, si Pelik Baduni, njeri i thjeshtë e i punës, po as ai nuk është individualizuar thellë, më tepër është skicuar me ca penelata gati të shpejta dhe që lidhen me situata e gjendje të ndryshme, mjaft dinamike. Kështu, në këtë vepër fillon të shfaqet një tipar modernist, pikërisht thërrmimi/copëtimi i karaktereve, që shkon paralel me thërrmimin e subjektit. Por gjithsesi, edhe në këtë roman, gjejmë në fund një skemë të “realizmit socialist”, personazhin antipatik dhe egoist Nase Ksenon, që është i njohur qysh në tregimin “Fshatari Doka”, personazh që identifikohet me “armikun e klasës”, i cili kërkon të sabotojë socializmin dhe në fund të romanit dënohet duke u arrestuar nga Sigurimi. Ai fund doemos që e zbeh forcën e realizmit të ndërthurur me elemente modernizmi të romanit dhe është i lidhur me *haraçin* estetik që edhe ky shkrimtar duhej t’i paguante kohës.

Më e realizuar nga mesazhi dhe nga forma, ku arrihet shkrirja e realizmit me elementet moderniste, besojmë se është novela “Ata të dy dhe të tjerë”, që vë në qendër personazhe të ndërlikuar, në dukje komikë, në thelb mjaft dramatikë si: Peshku i Kuq dhe Djaloshi i Pashëm. Kjo shpreh qartë dukuritë negative që e dallonin të “ashtuquajturën socializëm”, si varfërimin e ngadalshëm të masave, zbehjen e “artit të vërtetë”, fitoren e të paaftëve mbi të aftët. Në këtë novelë përdoren teknika moderniste, si liria e personazheve pa emër, një lloj dyzimi në personazhin e tyre, ku ekzistojnë tipare pozitive që e lidhin me “vëllezërit e tyre”, personazhe të krijimeve të tjera të Kostës në prozë.

Në periudhën e dytë të krijimtarisë së Koço Kostës, modernizmi i tij shfaqet në mënyrën më të lirë. Janë thelluar teknikat moderniste dhe shkrimtari përpiket të depërtojë në labirintet e nënvetëdijes së personazheve.

Një fryt i arrirë i kësaj periudhe, ku bën pjesë dhe romani “Absurdi”, është dhe “Nata e Sofie Kondilit”. Koha në këtë roman reduktohet në një natë e një mëngjes, një tipar modern ky, që relativizon kohën dhe është i lidhur me tre “unitetet e antikitetit”: përqendrimi i veprimit në një hapësirë njëzetë e katër orëshe (kjo lidhet me traditën, pasi dramat klasikiste tregonin ca rregulla të Aristotelit në Antikitet). Por kjo hapësirë tepër e rrudhur, zgjerohet: ajo përmban në vetvete të kaluarën e dy protagonistëve dhe madje një të ardhme potenciale që s’do të realizohet kurrë, meqenëse nata e tyre e parë e dashurisë, është njëkohësisht dhe

nata e fundit, ata jetojnë njëkohësisht kulmin e lumturisë dhe të fatkeqësisë. Dy personazhet e këtij romani spikasin për veçantinë e tyre në krijimtarinë e Koço Kostës dhe sjellin një kontribut në historinë e romanit shqiptar.

Romani “Nata e Sofie Kondilit” është një “roman personazhesh”, që ndërthur dy prirje, prirjen drejt erotizmit - ku thyhen tabutë tradicionale në letërsinë shqipe, dhe ku për një kohë të gjatë ka mbizotëruar puritanizmi, - dhe prirjen drejt “tmerreve” të një të ashtuquajturit “roman i zi”, që po zhvillohet në letërsinë shqipe, prirjen që shprehet në pushkatimin nga vetë shokët e vet të Kristofor Kutullës, këtij djaloshi në lulen e rinisë, krim ky, që përmban në embrion krimet e ardhshme të diktaturës jo ende të vendosur, po që do të vendoset nga këta luftëtarë që janë ende të bindur të luftojnë për një çështje të lartë. Personazhet e romanit janë të veçantë sepse përjetojnë një dashuri jashtë martese, pra “mëkatore”, sipas moralit tradicional dhe ndonëse një temë e tillë ishte mjaft e pranishme në romanet sentimentale dhe romantike të letërsisë evropiane, romani shqiptar i traditës e ka shmangur me kujdes. Tërë çiftet e personazheve dashurues në letërsinë shqipe të traditës dhe të realizmit socialist luftojnë për triumfin e dashurisë së tyre mbi paragjykimet, mbi kujtesën që ta ruajnë këtë dashuri të pastër shpirtërore, për sa kohë që s’e kanë ligjëruar me martesë. Gjinia e poezisë në këtë drejtim tregohet më e guximshme se romani: tek poema “Një pasqyrë e jetës njerëzore” e De Radës, kemi çiftin Bozdar – Olimpi dhe tek “Mrika në Shkangull” e Risto Siliqit gjejmë Mrikën dhe të dashurin e saj. Megjithatë, De Rada nënvizon “gabimin tragjik” të personazheve të vet dhe i dënon me një fund të tmerrshëm. R. Siliqi, ndonëse jep fundin tragjik të Mrikës, vajzë-nënë e ardhshme që vret veten bashkë me fëmijën, shpreh mëshirën tragjike ndaj saj dhe një lloj dënimi të shoqërisë, ndonëse jo të shprehur qartë.

Realizmi i shkrimtarit është quajtur edhe realizëm grotesk, ku sipas A. Uçit, një nga meritat më të rëndësishme të tij, është përdorimi gjerësisht i vlerave të shumta nga krijimtaria gojore popullore, tipari themelor i së cilës ishte gjuha e veçantë. Nëse kujtojmë novelën “Ata të dy dhe të tjerë”, shfaqet si proza më e harmonishme, dhe kjo bën që të jetë një prozë me ngarkesë emocionale të pazakonshme. Autori përshkrimin e veprës e ka futur në kornizën e disa faqeve. Vetvetishëm, në këtë prozë të ndjeshme, ka portretizuar nervin e jetës së kohës dhe ka vendosur në këtë rrafsh psikoemocional, veprimet jashtëzakonisht të motivueshme dhe të vrojtuar hollë, veprime që mbartin dramën e jetës, që ndryshuan gjithashtu ndjeshëm rrjedhën e ngjarjeve, duke dhënë sa fundin, aq dhe rrënimin moral të beut.

1.3 Kalimi nga fakti apo prototipi real, në personazhin apo situatën artistike

Shkrimtari ka intuitë dhe prirje të dukshme në vëzhgime të mprehta ndaj karaktereve dhe situatave jetësore. Këtu ka luajtur rolin e vet qoftë fëmijëria në fshatin e tij të lindjes, qoftë kontaktet gjatë përvojës si mësues me nxënës e që kjo sigurisht i ka dhënë mundësi të njohë mirë e nga afër psikologjinë fëmijërore dhe të vëzhgojë kështu karaktere në formim e sipër. Karakteret njerëzore nxjerrin në dritë sipas rastit më të mirën dhe më të keqen e tyre, etjen për dije, por dhe egoizmin, vetëpërmbytjen dhe rebelimin. Gjithashtu, gjatë përvojës së vet të gjatë si gazetar, shkrimtari ka njohur një shumicë njerëzish nga të gjitha shtresat dhe ata e kanë nxitur e frymëzuar që t’u japë pastaj jetë personazheve të caktuara. Por atij i është dashur të ndjekë një itinerar të kundërt nga ai që ndjek gazetari, i cili duhet të synojë

maksimumin e besnikërisë ndaj faktit dhe situatës reale dhe rindërtimit të karakterit që riprodhon, meqenëse është i orientuar tek e vërteta e jetës, ndërsa për të arritur tek e vërteta artistike në “fiction” (fakt letrar), duhet t’i largohesh sa më tepër gjithçkaje të rastësishme dhe *sui generis* në vizatimin e situatave dhe individëve të caktuar, madje në art shkrimtari mund të mos guxojë të riprodhojë një ngjarje të pabesueshme, ngaqë do t’i largohet parimit dhe vërtetësisë (natyrisht po të ishte fjala për vepra realiste dhe po të mos futësh fantastiken në to).

Tipa si Puravel Duka, fshatari Doke, Çumani, Ramniu, Burri i vogël që..., Dademadhja, Buzhel Zherdi, e kanë prototipin e tyre real, por Koço Kosta ka zgjedhur tek ata për t’i paraqitur tiparet më shprehëse, për të përcaktuar karakteret e tyre, si dhe ata që i përgjigjen thelbit të tyre shoqëror, domethënë kategorisë shoqërore që ata përfaqësojnë. Mandej, ka përdorur fantazinë për të shtuar imtësi të tjera individualizuese. Nëpërmjet këtij procesi tipizimi dhe individualizmi, personazhi është shndërruar nga prototip në tip dhe situata nga reale në artistike. Ka raste që autori e ka vendosur edhe veten si prototip, kështu që, ka marrë elemente autobiografike nga jeta e vet dhe i ka kumtuar lexuesit imtësinë nga bota e vet e brendshme, të cilat kanë vlerë përgjithësuese dhe njëkohësisht i japin mundësi këtij lexuesi, që ose të identifikohet me personazhin, ose të përfshihet emocionalisht në qëndrimin e shkrimtarit ndaj tij, të dashurojë ose të cenojë, siç bën edhe shkrimtari nën ndikimin e objektivitetit dhe distancimit nga personazhi.

Në fakt, lexuesi nuk mund të mos ndjejë simpatinë e autorit për Dademadhen, Puravel Dukën, Çumanin, fshatarin Doke, ose të mos marrë pjesë në urrejtjen dhe neverinë e kohës për Peposh Buzbatin dhe Buxhel Zherdin, shenjë kjo, që autori ka nxjerrë në dritë personazhe të gjallë.

Me sa kemi vërejtur, ka personazhe që shkrimtari i ka marrë nga jeta dhe i ka kthyer në tipa letrarë, si, për shembull, Puravel Duka. Novela “Ata të dy dhe të tjerë” do të mbetet në letërsinë shqipe si kufiri që shënon rënien e letërsisë dogmatike, skematike e shabllone, të nxitur nga parimet politike e ideologjike të “realizmit socialist”, për të kaluar gradualisht drejt një proze moderne, që ka në bazë të vet një lloj realizmi grotesk.

Sikundër e kemi theksuar, K. Kosta mund të përcaktohet si shkrimtari i fshatit, në kuptimin e prirjeve të tij tematike dhe të filozofisë e personazheve që projekton artistikisht. Fshati nuk është thjesht sfond i prozës së tij, nuk është një kornizë e jashtme; ai jeton dhe merr frymë nëpërmjet jetës së personazheve të tij, ndihet të jetë gati i identifikuar me sjelljet dhe mentalitetin e tyre. Shkrimtari e njeh fshatin shqiptar para së gjithash përmes figurave të tij, fshatarë realë me tërë pamjet e jetës që ata shfaqin e manifestojnë natyrshëm e jo bujshëm, të cilët rezultojnë se nuk janë pikturuar në mënyrë të sipërfaqshme dhe në vija të trasha. Krijuesi i tyre arrin tek ai ekuilibër i nevojshëm – mes identifikimit dhe distancimit të autorit ndaj personazheve që ia lejon krijimin e tipave. Personazhet e tij janë pikturuar ndryshe nga personazhet e M. Kutelit, që shkojnë nga konturet fluide të “rrëfenjave”, në vizat si me laps karboni të novelave, ndryshe edhe nga personazhet e J. Xoxës, që dashurohet në mënyrë të pasionuar me personazhet që mishërojnë idealin e tij, ndonëse nuk i idealizon në frymë romantike, por në mënyrë realiste, nëpërmjet “dialektikës së shpirtit” dhe i urren krijesat e tij negative, por çuditërisht, përsëri në frymë realiste, respekton thelbin dhe të vërtetën e tyre njerëzore. Koço Kosta nuk është natyrisht indiferent ndaj personazheve të vet, por i objektivizon më tepër ndjenjat e veta, është një autor që di të presë me mprehtësi “kordonin e

kërthizës” - që lidh krijuesin me krijesat e veta dhe jep qartësisht përshtypjen e “krijesave të gjalla”. Personazhet e tij janë të tipizuar në thellësi dhe me larmi, karakteri i tyre tipik është shkrirë në individualitetin e tyre, d.m.th., në figurat e këtyre personazheve ndeshim një shkrirje të harmonishme të thelbit social me thelbin individual. Personazhet e tij janë vizatuar në plotësi dhe në thellësi, madje shumë prej tyre janë bartës virtytesh të rralla njerëzore, që letërsia shqiptare e viteve të fundit ngurroi t’i pasqyrojë, duke iu përgjigjur atij ideologjizimi të karaktereve që e dallonte realizmin socialist dhe që buronte nga ajo romantikë e rreme që pretendonte të mishëronte “energjinë romantike” në këtë drejtim letrar. Por, pa dyshim, kjo prirje e re përfton një njëanshmëri të krahut të kundërt, duke zëvendësuar mekanikisht ngjyrën rozë me ngjyrën e zezë. Koço Kosta është një shkrimtar “psikolog”, ashtu si dhe Jakov Xoxa, por në mënyrën e vet dhe personazhet e tij nuk janë as simbole fluide, as marioneta në dorën e autorit, por njerëz të gjallë që formojnë një minigaleri në gjithësinë virtuale të krijuar prej tij, në veçoritë e papërsëritshme të karakterit, të temperamentit dhe të tipareve sociale dhe kombëtare.

Mund të citonim mendimin e Bjelinskut: “Një nga tiparet dalluese të origjinalitetit krijues dhe të krijimtarisë, është tipizimi, që është vula e autorit. Tek çdo talent i vërtetë, çdo personazh është një tip dhe çdo tip për lexuesin është një i panjohur i njohur”⁶⁵.

Duke shfrytëzuar psikanalizën e Frojdit, Moriaku (shkrimtar francez), në studimin “Shkrimtari dhe personazhet e vet” është i vetëdijshëm për një tipar të personazheve letrare, që lidhet me realizmin në thelbin e vet, por edhe me talentin e veçantë individual dhe të papërsëritshëm të shkrimtarëve, forcën e depërtimit të tyre në shpirtin njerëzor, ligjet e brendshme të botës shpirtërore, individuale, të projektuara në botën e artit, pavarësisht relative të krijesave, personazheve në marrëdhënie me krijuesin e vet, autorin, të cilit, në përputhje me dialektikën e mundshme të karakterit të vet, i shpëtojnë nga dora dhe nuk i binden. Një shembull i qartë është ai që Moriaku, fetar e katolik, nuk arrin ta çojë deri tek feja një nga krijesat e tij më interesante dhe kontradiktore, Terezën e romanit “Terezë Deshejru”. Një bukuri të tillë, shenjë e vitalitetit të personazheve, e gjejmë edhe në tërësinë letrare të tregimeve të K. Kostës, të personazheve të krijuar prej tij, si Puravel Duka, fshatari Doke, Dademadhja, që kanë një vitalitet dhe pavarësi të tillë nga autori i vet, sa që të japin përshtypjen e njerëzve të gjallë, të cilët i ke njohur dhe i ke takuar diku në jetë.

Në procesin e gjatë dhe të ndërlikuar që përjeton çdo autor në krijimin e personazheve të vet dhe që u ngjan marrëdhënieve të nënës me fëmijën, shkrimtari K. Kosta, ndonëse shtiret si rrëfimtari objektiv dhe përdor vetën e tretë në vizatimin e tyre, ka arritur të derdhë në to gjakun e vet, në “krijesat e veta prej letre”, të cilat nuk ngjajnë aspak prej letre, por prej mishi dhe gjaku. Është kjo mrekullia e çuditshme e krijimit. Në të vërtetë, pavarësisht nga teoritë moderne për zbehjen deri në zhdukje të personazhit, një vepër, qoftë ajo e prozës së shkurtër apo të gjatë, jeton nëpërmjet personazheve, karaktereve të krijuara që, krahas asaj që u quajt “dialektikë e shpirtit” (e cila u zbulua nga letërsia tipike realiste e shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe që zotëron të vërtetën e vet relative), filozofinë e vet ia imponon lexuesve dhe që, siç kemi vënë re, bën pjesë në magjinë e prozës. Prandaj, në letërsinë bashkëkohore botërore postmoderniste e realiste kemi një ringjallje të ngadalshme të personazhit, i cili për një farë kohe u quajt i ezauruar, i tejkaluar. Do të mund të flisnim edhe

⁶⁵ V.G.Bielinski. *Artikuj kritikë*, Tiranë 1977, f. 47.

për personazhet që në thelb janë realistë, për shembull të postmodernistit U. Eko, i cili ka mundur të krijojë në romanin e tij “Emri i trëndafilin” karaktere tepër interesante si Guljelmi (në përkthimin shqip Uiliam), pa harruar edhe personazhet e “realizmit magjik”. Shkrimtari krijoi personazhe, ku thelbi i tij i qëndronte besnik realizmit kritik shoqëror. Ai nuk arriti të zbërthejë në psikologjinë individuale e të zhvillojë plotësisht në letërsinë shqipe me tërë forcën tërheqëse të vet dhe do të vazhdonte të mbijetonte nën “korracën” e ngurtë të skematizmit të metodës a drejtimit letrar zyrtar, realizmit socialist, në veprat e veçanta të shkrimtarëve të talentuar që shfaqnin kështu disidencën e vet estetike.

Pra, skalitjen e personazheve shkrimtari Kosta e realizon (siç ka vënë re edhe studiuesi Bashkim Kuçuku) në dy mënyra: duke u përqendruar në një tipar dallues të karakterit të tyre apo në disa tipare.

Mënyra e parë lidhet me traditën realiste të shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe në veçanti me modelin balzakian. Pra, shkrimtari gjen prototipin në jetë dhe personazhin e krijon. Sipas prototipit Balzaku e mori koprracin e vet nga një prototip i personazhit në realitet.

Mënyra e dytë është kur personazhin e bën sintezë tek disa personazhe në jetë, për shembull, Balzaku për Grandenë u frymëzua nga një koprrac në jetë. Kjo mënyrë, në mënyrë figurative mund të krahasohet me mbledhjen e nektarit lule më lule nga bletët. Edhe disa nga personazhet e Koço Kostës janë krijuar sipas këtij procedimi, që është i afërt edhe me dramaturgjinë si gjini dhe me zhanrin e komedisë, meqenëse vështrimi me lente zmadhuese i një tipari kryesor është i lidhur ngushtë me patosin komik dhe satirik. Megjithatë, një pikturim i tillë i karaktereve nuk është i huaj as për patosin tragjik, siç e shohim te Balzaku, në qoftë se autori përqendrohet më tepër në botën e pasioneve sesa në sferën racionale. Vizatimi i një tipari krijues mund të jetë komik, kur lidhet me reduktimin e karaktereve në një lloj automatizmi të brendshëm të tij, gjithashtu edhe tragjik, nëse lidhet me një pasion të caktuar tepër të fuqishëm që e gllabëron personazhin e tij.

K. Kosta e përdor këtë mënyrë portretizimi në vizatimin e personazheve, duke theksuar me penën e vet një ngjyrë të vetme në karakterin e tyre, por një ngjyrë që nuk përmban në vetvete skematizmin apo reduktimin, por përkundrazi sintetizimin. Tek ky shkrimtar mund të vëmë re personazhe që i përkasin këtij lloji. Në përmbledhjen e tregimeve të tij “Bisedë në mesnatë”, konkretisht mund të përmendim personazhe të tilla që të mbeten në mendje si: *Burri i vogël që...Mjeku, Individit*, etj. Mjeshtëria e shkrimtarit shfaqet në mënyrë të veçantë tek dialogët e gjallë, të pasur me fraza karakteristike, me aromën e fortë të jetës, që përmbledhin në mënyrë sintetike filozofinë individuale të personazheve, e cila, ndryshe nga ç’ndodh në tregimet e Kutelit, shkapet nga mendësia kolektive. Do ta quanim këtë një veçori karakteristike shqiptare, meqenëse shqiptari në thelb, ndonëse në dukje është tepër i lidhur me mjedisin social dhe familjar, në të vërtetë ai është thellësisht individualist. Kjo veçori i kundërvihej lidhjes shpirtërore me kolektivin, tipar artificial i së ashtuquajturës “njeri i ri” që propagandohej në socializëm. Një veçori e tillë mund të lidhet me egoizmin dhe konkretisht lidhet me disa karaktere të Kostës në këtë tipar të përbashkët, por mund të fshehë në vetvete edhe origjinalitet, pavarësi shpirtërore ndaj mjedisit. Mund të themi pra, që autori është tepër i efektshëm në vizatimin e individëve, tek ai nuk e gjejmë tipizimin përmbledhës, shumat masive të turmës, të cilët i ndeshim në veprat e autorëve të tjerë që gjithashtu parapëlqejnë pikturimin e fshatit si Kuteli apo Sterjo Spasse. Pra, autorë të ndryshëm kanë

përvojat e tyre origjinale, të pangjashme, duke u dhënë veprave të tyre kualitete specifike/unike.

Autori u jep forcë personazheve të veta edhe nëpërmjet antitezave, ballafaqimit të karaktereve të kundërta. Duke vizatuar karaktere të kundërta, të cilët jepen paralelisht apo ndeshen njëri me tjetrin, i shmanget rrezikut të një paraqitjeje *bardh e zi* nga e cila u ndikuan shumë vepra të “realizmit socialist”, ku vihej re një ndarje e prerë midis së ashtuquajturve karaktere pozitive dhe atyre negative. Në botën shpirtërore të personazheve të krijuara nga shkrimtari K. Kosta, ka nuanca të tilla që shfaqin larminë e jetës, veçori e dukshme kjo e tij, i cili arrin të gjejë nuanca qoftë tek e bardha, qoftë tek e zeza, njeh edhe ngjyrën e hirtë të karaktereve që nuk arrijnë dot, as tek e mira, as tek e keqja, për shkak të dobësisë së vet. Karaktere të tilla kanë qenë tipike për letërsinë evropiane të shekullit të njëzetë, e cila kaloi nga ekzaltimi i individit me botë shpirtërore më të pasur se mjedisi, karakteristikë kjo edhe për realizmin, në dyshimin dhe skepticizmin për thelbin e njeriut. Në krijimin e tipit të “njeriut pa cilësi”, të tilla karaktere binin në kundërshtim të dukshëm me kërkimin nga ana e “realizmit socialist”. Në krijimin e karaktereve të këtij lloji K. Kosta mbetet prozatori sa realist aq dhe modernist.

Autori është realist sepse arrin të paraqesë larminë e jashtëzakonshme të karaktereve njerëzore, modernist sepse paraqet zbehjen e ngadalshme të individit, në një botë ku mbretëron pasiguria. Karaktere të tilla mediokre dhe të dobëta, janë tipike në atmosferën e diktaturave që shtypin “njeriun e vogël” dhe që zhvillojnë tek ai tiparin e frikës. Në rrafshin social, këto karaktere vihen re tek personazhe mikroborgjeze, por humbja e idealeve, i ka përgjithësuar në rrafsh më të gjerë. Por personazhe të tilla në prozën e K. Kostës qëndrojnë përballë karaktereve të kundërta, që shprehin tërë pasurinë shpirtërore të njeriut të popullit, të lidhur me punën dhe me natyrën. Kosta ka aftësinë të vizatojë me finesë artistike karaktere ku mbizotëron bota emocionale, sfera e pasioneve, veçanërisht e pasioneve të forta si dashuria dhe urrejtja. Kështu, shkrimtari ia arrin të zbulojë botën e pasur dhe të larmishme të njerëzve të punës, dashurinë e tyre për tokën, për natyrën, për të gjitha qeniet e gjalla, si bie fjala kuajt dhe qentë, këta “vëllezërit e vegjël” të njeriut.

Kjo s’është dashuri sentimentale, po e gjerë dhe njerëzore, shfaqje e një lidhjeje të thellë me natyrën që karakterizon njerëzit energjikë dhe praktikë, që dinë të jenë edhe të butë edhe të ndjeshëm. Dashuria për kafshët tek këta personazhe nuk i kundërvihet artificialisht dashurisë për njerëzit, por harmonizohet me të.

Në tregimin “Fshatari Doke”, në shpirtin e protagonistit dy dashuri i kundërvihen njëra-tjetrës, dashuria për punën dhe dashuria për një qenie të gjallë si qeni, dashuria për punën, që vështrohet po me atë dashuri që shihet fëmija, mbizotëron edhe sjell fundin dramatik, vrasjen e qenit nëpërmjet të cilit, drama shpirtërore e protagonistit që ka humbur njeriun nga dashuritë e jetës së tij, dyfishohet.

Filozofia që është vënë në bazë të tregimeve të Koço Kostës në periudhën e parë të krijimtarisë së tij, është një filozofi thellësisht popullore. Në tregimet e tij vëmë re dhe paragjykimet patriarkale të fshatit shqiptar, siç ndodh konkretisht në tregim, por janë edhe sot të gjalla nën një veshje tjetër. Në personazhin e Anikës autori vizaton etjen e natyrshme për dashuri dhe lumturi, që ndërthuret edhe me një lloj nënvleftësimi për veten, për thelbin e vetë njerëzve, me vështrimin e martesës jo të lidhur me ndjenjat e natyrshme të dashurisë dhe

dëshirës, si i vetmi realizim i mundshëm jetësor për gruan në një shoqëri patrirakale që e përbuz gruan pa burrë, të ashtuquajturën “vajzë të mbetur”.

Sipas studiuesit Tefik Çausi: “...me Anikën K. Kosta na jep një karakter kompleks, ku ndërthuren tiparet e shëndetshme të dashurisë për punë, dëlirësisë, thjeshtësisë me paragjykimet e thithura që fëmijë nga mjedisi”.

Citojmë: “U afra dhe Anika. Në xhade bëme gjysmë sahat. Pastaj arritëm në fund të qytetit. Fundrat e këmbëve na ishin lagur dhe tani që ndenjëm, kishim ftohtë. Unë iu afrova. U afra dhe Anika”.⁶⁶

Shkrimtari shpreh edhe aftësinë e vet për të krijuar karaktere reale dhe psikologjikisht të besueshëm. Ai di të harmonizojë bukurinë morale të fshehur në një karakter të thjeshtë e të zakonshëm, pa e idealizuar. Është edhe ky një rast ku autori ndriçon larminë e ngjyrave që përbëjnë atë që simbolikisht quhet ngjyra e bardhë e një karakteri, dukuri që mund të krahasohet me shkrirjen e disa ngjyrave që përbëjnë ngjyrën e bardhë të ditës, nga ato karaktere që përmendëm më lart.

Në krijimtarinë e K. Kostës, ndeshim tipa të tillë si Bashmeta, ku virtytet e larta shoqërohen në një farë mënyre nga naiviteti, që e bën personazhin në fillim të nis të luftojë të keqen dhe madje arrin fitoren. Ky është rasti i pasqyrimit të një karakteri në evolucion, i cili fiton pjekurinë shpirtërore nën ndikimin e rrethanave të jetës. Është folur për një mungesë harmonie midis pasqyrimit realist të thelbit shoqëror të personazhit dhe realizmit artistik të atij thelbi. (Kujtojmë një artikull të Zija Çelës, “Jetë që vjen në art”, botuar te “Drita”, 8 gusht, 1982, ku kritikohet teprimi i figurës dhe fluiditeti i tepruar).

Shkrimtari, me intuitën e krijuesit që e kupton krijuesin tjetër, vlerat dhe kufizimet e tij, e ka kuptuar që i ka rrëshqitur pena nga super simpatia për personazhin e vet dhe ka rënë në një farë idealizimi të tij. Citoj mendimin e Zija Çelës i cili e kupton në një çast të caktuar se: “Personazhi gjen vetveten dhe arrin pavarësinë nga autori”.⁶⁷

Ky shkrimtar me të drejtë e vlerëson ruajtjen e ekuilibrit estetik në marrëdhëniet autor-personazh në tregimin “Qebiri”, ku kalohet nga jeta reale në jetë artistike, dhe kjo është bërë me shkathtësi dhe finesë. Ka në këtë vëllim tregimesh, edhe raste ku fjala e autorit zëvendëson paraqitjen reale të personazhit dhe duket sikur Koço Kosta e gjykon personazhin e vet pa e pasqyruar, d.m.th., e paragjykon pa ia lënë vendin lexuesit, siç ndodh me tregimin “Në vjeshtën e dytë” me personazhet e tjerë.

Personazhi tek tregimi “Njeriu i punëve të mira” mishërohet në figurën e L. B, të lidhur me punën krijuese, i cili shoqërohet me modestinë e natyrshme të njeriut të thjeshtë, po me botë shpirtërore të madhe. Ky tregim është nga ato krijime në prozë, në të cilat K.Kosta përdor mënyrën e kontrastit, duke iu kundërvënë një njeriu të plogët dhe të patalentuar si mësuesi i vizatimit. Por, në krijimin e karakterit të këtij personazhi të fundit, ka kompleksitet. Është një figurë ku në ngjyrën e hirtë, po të përdorim këtë metaforë, ka dhe nuanca të bardha, ka figura, madhështia e thjeshtë e të cilave zbulohet nëpërmjet një situatë, një veprimi, siç është figura e atij personazhi, i cili nga dashuria për shokun arrin të djegë atë që kishte më të shtrenjtë, letrën e vet të dashurisë, dhe e bën këtë sakrificë të pakrahasueshme

⁶⁶ Shih *Dademadhja*, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1976, f.7.

⁶⁷ Shih: Zija Çela. *Jetë që vjen në art. (Vëllimi me tregime “Era e udhëve” i Koço Kostës)*. Në: “Drita”, 8 gusht 1982, f. 5 – 6.

në heshtje. Këtij njeriu të thjeshtë dhe të madhërishtëm i kundërvihet një personazh meskin dhe karrierist si Pepoch Buzëbati, i cili kur arrin synimet e veta karrieriste ka paturpësinë të flasë heshtur se në shkollë ai s'ecte në mësim. Tragjedia rrëqethëse individuale (mëma fshatare që ka shkalluar se i biri i vetëm u arratis), ngrihet deri tek lartësia e një tragjedie përtej individuale, pra kolektive, duke e bërë kështu edhe më rrëqethëse atë tragjedi njerëzore.

Sipas Trim Gjatës, “Kjo do të frenojë recidivet e shakave të rënda të vjetra o të “reja”⁶⁸

Ka figura si Maze Llakatura që jetojnë dramën e jetërsimit të tyre, e lidhjes shpirtërore të fshatarit që shkëputet nga diktatura, shtëpi në fshat pa një lopë e pa një viç, shtëpi pa dele, pa dhi.

*Shembull...Çuk! Çuk! Çuk... Me nder të dhashë shpirtin në dorë! Ma rrëmbeve, - pohon Maze Llakatura.*⁶⁹

Ka dhe figura thellësisht tragjike, që të sjellin ndërmend tragjeditë greke, figura e Mëmës së përmendur tek novela “Dhoma e dashurisë”. Kjo grua ka humbur edhe emrin e vet, u ngjan disa personazheve të romaneve moderniste. Ka humbur emrin e vet që e identifikon atë si individ. Por ajo quhet Mëma dhe i biri është arratisur në perëndim. Të dy janë viktima të diktaturës. I biri ka shfaqur edhe njëfarë egoizmi në këtë arratisje - në kërkim të një ëndrrë lirie, megjithatë dukej se atij i zihej fryma në ajrin shtypës të diktaturës komuniste. Mëma, jo vetëm që ka humbur të birin, por ka humbur edhe lidhjet në bashkësinë e vendlindjes që e përbuz, pra përjeton një vdekje civile. Autori e vizaton atë si një hije me një zë që vjen si nga fundi i botës, me duart e thara, gjoksin e rrëgjuar që vazhdimisht thërret “Kthehu biro, shpirt”! (Autori, duke folur në vetën e parë, thotë se nuk e dinte në ishte grua e asaj bote, e cila zgjaste përpara krahët e gjatë dhe luste dikë që t'i afrohej”.

Kuptimplotë ishte edhe thënia e një personazhi nga grupi që i ka zënë nata në mal. Thënia “E marrosën”, është thënie që e ndryshon vetën e parë shumë, duke pranuar përgjegjësinë kolektive: “E marrosën”. Ishte jetërsimi i njerëzve nga diktatura, që u zhdukte atyre çdo ndjenjë njerëzore, kështu që njerëzit, në vend që t'i ndodheshin pranë gruas së braktisur nga i biri, e dënuan atë për “gabimin” politik të djalit të saj. Edhe në këtë përmbledhje, ndihet dashuria mallëngjyese e njerëzve për qeniet e tjera të gjalla, si për shembull, tek tregimi: “Qeni i Maze Llakaturës”, ku njerëzit qëndronin pranë qenit besnik Zib, që ia ka nxjerrë jashtë të përbrendshmet derri i egër, të cilin e qepin dhe e ushqejnë me lugë si një pjesëtar të familjes së tyre.

Një figurë poetike është ajo e stomatologes në tregimin “Bukuria”, e cila nën sfondin e ujërave të pastra të bjeshkës, puthet me të dashurin nën rërë. Ky tregim liriko-poetik, qëndron si një ishull i veçantë poezie në përmbledhjen me ngjyrim dramatik “Paradite me shi”. Pra, në tregimet e K. Kostës me temën e fshatit shqiptar ndërthuret patosi heroik, romantik, dramatik dhe tragjik. Interesant është edhe mendimi i Jorgo Bllacit, i shprehur në një artikull të botuar te “Drita”, për personazhet e shkrimtarit, në mënyrë të veçantë për personazhet e fshatarëve: “Ndonëse veprojnë në situata reale, ato ngjajnë së tepërmi për nga

⁶⁸ Trim Gjata. *Që të mos ketë më “shaka të rënda” me jetën e fshatarësisë.* (Mbresa nga vëllimi: “Paradite me shi” i K.Kostës). Në: “Zëri i popullit”, 21 dhjetor 1991.

⁶⁹ Po aty, fq. 277

guximi dhe zgjuarsia me personazhet e legjendave dhe përrallave, gjë që dëshmon për mbështetjen e shkrimtarit në krijimtarinë e pasur të popullit dhe shkrirjen në të”.⁷⁰

Këtë tipar K. Kosta do ta kishte të afërt me Kutelin, megjithatë, siç vumë re, personazhet e Kostës janë shumë më konkrete dhe komplekse.

Shkrimtari përveç karaktereve di të vizatojë me mjeshtëri edhe mjedisin, duke dhënë tablo të gjalla e me kolorit të theksuar. Një veçori e individualitetit krijues të K. Kostës është se ai arrin të konsolidojë poetikën e vet në prozën e krijuar nëpër vite.

Në krahasim me romanin tregimi ka më pak hapësirë, por zotëron një koncentrim të tillë që i jep një forcë të veçantë shprehëse. Po ta vështrojmë nga aspekti historik, “...tregimi është një formë internacionale në të cilën kanë vepruar e janë gërshetuar ndikimet e sferës kulturore të Perëndimit e Lindjes”.⁷¹

Në letërsinë e Rilindjes, tregimi u shfaq më vonë dhe me nivel të zbehtë estetik, ai njohu një shpërthim krijues në letërsinë e viteve 30 me Migjenin, Kutelin dhe Koliqin. Në këtë kohë tregimi shqiptar do të ngjitej në nivelin e tregimit evropian, duke gërshetuar realizmin kritik me elemente të drejtimeve letrare moderniste, problematikën sociale me problematikën ekzistenciale.

Çuditërisht, edhe në letërsinë e realizmit socialist paraprin romani, por ishte pikërisht lloji i tregimit ku do të mbizotëronte një larmi individualitetesh të talentuar si: Naum Prifti, Sotir Andoni, Zija Çela, Nasi Lera etj. Dy të parët i kanë rrënjët në traditën popullore, dy të tjerët karakterizohen në thelb nga lirizmi. Shkrimtari K. Kosta bën pjesë në këtë yllësi prozatorësh, por edhe dallon prej tyre, pasi fryma popullore tek ai është sublimuar së tepërmi dhe lirizmi shkrihet me dramatizmin.

Studiuesi Isak Shema shpreh mendimin e tij në lidhje me këtë mendim: “Lëvizjet letrare, si term letrar, paraqesin procesin letrar, ashtu siç është zhvilluar në të vërtetë në letërsi, në jetën letrare apo në programet letrare”.⁷²

Kjo do të thotë se këta prozatorë janë në thelb realistë; ata, duke përfshirë edhe K. Kostën, krijuan ishuj realizmi në gjirin e letërsisë së realizmit socialist. Koço Kosta më vonë do të hedhë një hap më tej me novelën “Ata të dy dhe të tjerë”.

Ai e realizoi vetveten si tregimtar, duke pasuruar tregimin shqiptar. Në shkollën e tregimit ai mësoi/dëshmoi respektin ndaj fjalës, koncizitetin, shkathtësinë e dialogut, që më vonë do t’i shfrytëzonte edhe në llojet më të gjera të prozës, si novela “Ata të dy dhe të tjerë”, një novelë e mirëfilltë disidente kjo, qoftë nga problematika e guximshme, qoftë nga tiparet moderniste që u stigmatizuan nga censura e diktaturës, apo romanet “Buka e një stine me borë” dhe “Nata e Sofie Kondilit”.

⁷⁰ Jorgo Bllaci. *Një libër jashtë skemës*. (Koço Kosta, “Paradite me shi”). Në: “Drita”, 28 qershor 1992, 3-4.

⁷¹ Hysni Hoxha. *Teoria e tregimit dhe novelës*, botuar nga “Flaka e Vëllazërimit”, Shkup, 1995.

⁷² Isak Shema. *Studime letrare*. Prishtinë 2008, f. 63.

Kapitulli II

2 Koloriti i fshatit shqiptar në prozën e K. Kostës

2.1. Pikëtakime dhe risi në raport me traditën letrare

Letërsia shqipe qysh në fillimet e veta, në bazë të faktorëve historiko-shoqërore e pse jo dhe natyrore, si dhe të një faktori estetik (komunikimi/lidhja e përhershme me poezinë popullore), nga tematika/problematika dhe mjedisi letrar, ka qenë më tepër letërsi e arealit rural sesa e qytetit (letërsia urbane në Shqipëri është zhvilluar disi më vonë, mund të themi duke nisur nga vitet 20-30). Kjo dukuri bie në sy, qoftë në gjininë që ka sunduar më gjatë, në poezinë, qoftë në gjininë e prozës, në llojet e zhvilluara relativisht vonë të romanit dhe të novelës, që do ta kompensojnë vonesën me një djegie të furishme etapash, në vitet '30 e më pas.

Në fakt, romanet e para të kësaj letërsie që paraqesin edhe interes historik, ndonëse nuk arritën të ushtronin ndikim për rrethana vështirësish të komunikimit, ato të arbërshit Santori që lëkundën midis romantizmit dhe një realizmi fotografik - i afërt më natyralizmin, kanë vënë në qendër jetën e fshatit, konkretisht të fshatit arbëresh, ndonëse synimi i tyre ishte shkrirja e “dy Shqipërive, atdheut të të parëve dhe Arbërisë”, vendlindjes së karakterizuar nga thesari i këngëve, valleve, zakoneve të transplantuar në dhe të huaj.

Është për t'u vënë re, që autori arbëresh, kur përpiqet të vizatojë heronj aristokratë si Sofia dhe Ajdini, në romanin e tij “Sofia Kominatë”(roman i shkruar nga Santori arbërisht dhe italisht, i cili nuk u botua dot në kohën e vet), nuk godet në shenjë dhe nxjerr në dritë personazhe të zbehtë dhe fluidë, kurse personazhet e tij më të realizuar, janë personazhe fshatarë. Prirja për të parapëlqyer jetën e fshatit si burim arti, me tërë problemet dhe veçoritë e veta, vazhdoi në letërsinë e zhvilluar midis dy luftërave me tërë larminë e saj të individualiteteve dhe drejtimeve që shkonin nga trashëgimia romantike te elementet e para të drejtimeve moderne.

Kjo prirje u trashëguua dhe vazhdoi të jetonte e të lulëzonte edhe në letërsinë shqipe bashkëkohore, duke filluar nga gjysmëshekulli letrar, ku mbizotëronte drejtimi zyrtar i “realizmit socialist” dhe duke u shkrirë në letërsinë aktuale në kuptimin e ngushtë të fjalës. Ndër shkrimtarët që vendosën në qendër të vëmendjes tematikën dhe problematikën e fshatit, si dhe personazhet fshatarë, në rolin ose jo të protagonistit, mund të përmendim autorë të tjerë si: Mitrush Kuteli, Jakov Xoxa, Sterjo Spasse, Vath Koreshi, Sotir Andoni dhe Koço Kosta. Të gjithë këta shkrimtarë, duke pasur individualitetin e tyre krijues të spikatur (megjithëse vihet re një lloj ndryshimi në shkallën e talentit të tyre), e pasqyrojnë fshatin në mënyrën e tyre të veçantë, duke vizatuar me penën e vet krijuese tablo dhe portrete njerëzish që ndryshonin njëri nga tjetri, ndonëse kanë të përbashkët frymën shqiptare që shfaqet në tiparet e heronjve, të personazheve të niveleve të ndryshëm, në skenat masive, në veçoritë natyrore të peizazheve të pikturuara etj. Në këtë frymë bën pjesë një afërsi shpirtërore midis autorëve dhe personazheve, që nuk vihen re në letërsinë e disa kombeve të tjera evropiane, si francezët

ose italianët dhe ku, përkundrazi, dallohet një distancim, një lloj vështrimi nga lart i autorëve ndaj personazheve fshatarë, si në rastin e Alesandro Manxonit.

Edhe ndaj protagonistëve të romanit të vet “Të fejuarit”, ndaj Renxos dhe Luçies, autori italian, ndonëse i do, nuk identifikohet me ta.

Në rastin e Balzakut, me romanin e tij “Fshatarët”, ai me një realizëm të ashpër, në caqet e natyralizmit, i vizaton personazhet e vet, duke nënvizuar tiparet e tyre negative. Një dukuri e tillë përgjithësisht nuk vihet re ndër autorët shqiptarë. Ata e shkrijnë thelbin social dhe psikologjik të personazheve të tyre, guxojnë të depërtojnë në psikologjinë e njerëzve të thjeshtë të punës, tek të cilët nuk vihen re stërhollimet dhe kontradiktat e brendshme të personazheve intelektualë, por fshehin një pasuri dhe thellësi ndjenjash, e cila mund të mos dallohet në vështrim të parë për shkak të shpirtit praktik që i karakterizon apo të mendësisë patriarkale. Të gjithë këta personazhe kanë filozofinë e tyre, e cila nuk shfaqet në pikëpamje teorike, po në gjykimin për jetën nga ku mund të alternohen pikëpamje të shëndetshme optimiste dhe stoike për jetën, vdekjen dhe dashurinë, por edhe me besnikërinë ndaj zakoneve të prapambetura dhe filozofisë së pasivitetit e nënshtrimit. Te këta personazhe spikasin virtytet tradicionale shqiptare të mikpritjes, trimërisë, besës, të cilat nuk mund të humbasin nën ndikimin e varfërisë dhe të shtypjes.

Fshati dhe fshatarët e Kutelit jepen në dy përmasa: në atë të realizmit kritik, ku realja dhe rrethanat konkrete historike ballafaqohen me shtresat e ndryshme shoqërore, pa lënë mënjane individualitetin që jeton në disa tipa të caktuar, si dhe në përmasën e një lloji të veçantë realizmi, që i paraprin “realizmit magjik”, i cili do të shfaqet më vonë në letërsinë botërore. Në dritën e këtij realizmi, që qëndron në caqet e përrallës, fshati simbolizon “Shqipërinë e përjetshme” dhe personazhet të sjellin ndërmend personazhet popullore. Kuteli i ndërton shpesh tregimet dhe novelat e veta (që tipologjikisht ndahen në “rrëfenja”, të afërta me “skazet” e rusëve e tepër të veçanta në letërsinë shqipe, krijime që i kanë rusët, diçka midis përrallës dhe tregimit), në proza më të gjata që janë romane në miniature, ndërthur shpesh mbi ballafaqimin e karaktereve të kundërta, pra, në kundërshti që strukturojnë tërë krijimin si antiteza midis figurës negative të Xheladin Beut, ku ndërthuren detajet e neveritshme fizike të portretit të personazhit të evidentuar në mënyrë natyraliste, natyra e të folurit dhe mendimet e tij (të ndriçuar nëpërmjet monologut apo ligjëratës së lirë të zhdrejtë), dhe figurës së Maros ku ndërthuren: bukuria fizike, guximi moral, dashuria e pakufishme për të bijën dhe urrejtja për atë përbindësh që i kishte dhënë jetën asaj vajze vetëm biologjikisht dhe ishte gati të arrinte në inçest me të. Figura e parë është realizuar përmes patosit satirik, e dyta nëpërmjet patosit dramatik dhe tragjik. Në shpërthimin e saj, kur ajo ndodhet para atij xhelati që ia ka shkatërruar jetën dhe do t’ia shkatërrojë edhe së bijës së saj, shprehin dhe urrejtjen e tij të zjarrtë, demaskojnë antagonistin e saj me shprehje të tilla si “më ke ngrënë jetën, të hëngërt mortja, ngordhç në një përrua si një qen i zgjebosur, na shojte t’u shoftë e mira dhe të hëngërt kukuvajka në shtëpi, ku është parë e dëgjuar të ç’nderojë i ati të bijën...”

Në vizatimin e karaktereve të personazheve, Kuteli nuk e lë mënjane portretin fizik, që në të shumtën e herës harmonizohet me portretin moral, siç ndodh në rastin e cituar më sipër, por nënvizon edhe hollësi që ndriçojnë botën shpirtërore të krijesave të veta. Me një intuitë tepër fine dhe psikologjike, Kuteli arrin të depërtojë në botën, në dukje të thjeshtë, në të vërtetë tepër të ndërlikuar të fëmijës, dhe këtë lexuesi e percepton nëpërmjet vizatimit me penel tepër të hollë, duke përdorur vetërrëfimim të një personazhi në kohën e fëmijërisë së vet,

i cili shfaqet si konceptim gati magjik i realitetit që karakterizon fëmijët në përgjithësi dhe afërsinë me natyrën, që i dallon në veçanti fëmijët fshatarë, të cilët janë në kontakt të përditshëm me të dhe prapëseprapë janë në gjendje të zbulojnë anët poetike të saj: “Atje ujin e pinja me grusht ose shtrirë me gojë e hundë brenda dhe në ujë, një tjetër djalë si vetë Theofili i afrohej fytyrës sime. Shumë është ndryshuar bota ime që atyre mëngjeseve me djellë ku pata filluar të njoh se janë dy veta të ndryshme, ajo e rreme dhe ajo e së vërtetës...”.

Edhe besimi fetar i njeriut të thjeshtë që arrin çiltërsinë më të lartë tek fëmija (le të kujtojmë thënien e Krishtit: “Po të mos bëheni si fëmijë s’do të hyni në mbretërinë e perëndisë”), përthyeret përmes atij naiviteti fëmijëror që konkretizon të papërfytyrueshmen.

Citojmë nga Mitrush Kuteli: “Asohere, në kohën e foshnjërisë sime, perëndia ish një plak i lashtë, fort i plotë nga shtati, që rrinte diku atje lart këmbëkryq, e qepte me gjilpërë shajakun e bardhë për të veshur botën”⁷³

Edhe një personazh si Argjiri i Stefanit, që instiktivisht bën drejtësi, duke u nisur nga një dashuri e madhe, e plagosur për vdekje, dashuria për fëmijën dhe një urrejtje që s’ka fund, e shpreh thelbin e vet me fjalë të thjeshta si të ligjëratës së zakonshme, ku përballohet me kundërshtarin me një ironi therëse, “...më harrove, o bej ? Ne jemi miq, miq të vjetër, jam Argjiri i Stefanit që iku në kurbet. Ti më rrëmbeve çupën, çupa vdiq. Unë të dogja shtëpinë. Nxirr tashi dividin e bëj hesap. Në mos me dividi, bëje me dorë ndër zemër. Këtu, një çupë e vdekur e unë dy, aty një shtëpi e vdekur... Kadri bej, të them për emrin e zotit se kandari anon nga ana jote. Ja të bëjmë pat e pat”⁷⁴

Edhe tek shkrimtari Vath Koreshi, origjinaliteti i tij krijues realizohet edhe në mënyrën sesi e strukturon ngjarjen”.⁷⁵ Ai arrin një kulm sidomos tek novela “Dasma e Sakos”.

Kurse tek shkrimtari Sterjo Spasse, në krahasim me shkrimtarin K. Kosta, jepen më tepër skena të turmës sesa gërmon psikologjinë individuale, si, për shembull, në veprën “Ata nuk ishin vetëm”, ku ka skena të bukura kolektive.

Shembujt më lart na dëshmojnë se ballafaqohen dy konceptime të jetës: konceptimi i shëndetshëm, i natyrshëm, sipas të cilit dashuria më e lartë e njeriut është fëmija e tij, që simbolizon jetën dhe të ardhmen, me konceptimin e egër dhe egoist të njeriut, për të cilin, prona dhe pushteti janë gjithçka dhe në këtë optikë, prona shtrihet mbi njerëz të gjallë, sikundër vajza e fshatarit.

Koço Kosta i takon atyre shkrimtarëve, që vendosën në qendër të veprës së vet temën e fshatit duke iu kundërvënë edhe shkrimtarëve të tjerë që parapëlqejnë temën e qytetit.

Këtë temë ai e pati të përbashkët me shkrimtarë të tjerë që spikasin për një origjinalitet si Mitrush Kuteli dhe Jakov Xoxa. Por, autori dha më të mirën e talentit të vet në atmosferën relativisht të lirë dhe të ndezur letrare të viteve ’30, ndërsa Jakov Xoxa përpiqet

⁷³ Mitrush Kuteli. *Ago Jakupi e të tjera rrëfime*, Tiranë 1943, f. 47.

⁷⁴ Po aty (Tregimi i Kutelit).

⁷⁵ Adem Jakllari. *Referencat mitiko-biblike dhe rrëfimi jokronologjik në romanet e V. Koreshit*, kumtesë e mbajtur në seminarin ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, gusht 2007, 26/2, f. 359.

edhe ta rikrijojë atmosferën historike të viteve '30 tek romanet e njohur “Lumi i Vdekur” dhe “Lulja e Kripës”.

K. Kosta, u afirmua në një përleshje të heshtur me normativizmin e “realizmit socialist” dhe u dallua për veçantinë e tij. Ai e trajton temën e fshatit jo si romantik i vonuar, që u atribuon fshatarëve një mirësi të natyrshme, as nëpërmjet krijimit të ideologjizmit që shfaqet tek kjo kategori e popullsisë.

Ai zgjedh këtë temë, se ky është një realitet që njihet më mirë prej tij dhe ku ai vështron më qartë njeriun bashkëkohës. Për letërsinë shqipe, kjo temë bëhet më e natyrshme sesa për letërsinë, bie fjala, italiane. Fshati shqiptar kishte zënë mjaft vend në veprën e Kutelit që kishte depërtuar thellë në psikologjinë e fshatarëve dhe që dallohej për një lloj realizmi “magjik”, që kishte lindur në mënyrë spontane në letërsinë shqipe. Ky shkrimtar ishte ushqyer në thellësi të veprës së vet nga folklori, “rrëfime” që qëndrojnë midis tregimit dhe përrallës popullore dhe ku autori e sheh në natyrën e vet fshatin dhe njerëzit e fshatit.

Duke depërtuar në kohë dhe ambiente të caktuara sociale, duke përfutur kështu një atmosferë shqiptare plot ngjyra dhe variacione, autori është përpjekur të japë jetën e fshatit shqiptar dhe t’u japë përgjigje disa pyetjeve që shtronte momenti historik. Ai himnizon natyrën e vendlindjes dhe çiltërsinë e karakterit. Çdo gjë shqiptare autorit i ngjan e bukur. Ai e ka paraqitur pamjen e fshatit shqiptar, jetën baritore, si model ideal lidhur me fisnikërinë e zakoneve të veta. Ky përfytyrim poetik entuziast, u jep përfytyrimeve ngjyra romantike. Kjo lidhje e dyfishtë shpirtërore me fushat, me malet, lumenjtë dhe pyjet e Shqipërisë, është dhënë si një fuqi e rrallë ndikuese, që ka shërbyer e shërben si një ndjenjë e fuqishme. Kjo është një meritë e autorit, një veçori e rëndësishme e pasqyrimit realist, të cilin autori vazhdon ta thellojë në veprat e ardhshme. Fshati i K. Kostës nuk është një hapësirë e izoluar, prapa jetës dhe botës, por një qelizë e jetës sonë, ku sundon dhe ndihet gjaku i përgjithshëm i kësaj shoqërie, madje ngacmimet e shoqërisë, ndihen edhe atje, si kudo.

Motivet e përgjithshme janë shkrirë me përfytyrimet konkrete, natyra me punën, gjithësia me njeriun. Autori i jep ngjyrat fshatit shqiptar dhe kjo zgjon besim, shpresë, bukuri dhe begati. Vepra e autorit ruan vlerat e veta, vlerat demokratike, që e përshkon si një shpërthim lirik nga më të fuqishmit e më ekzaltuesit. Por në disa raste të tjera, autori jep tablo me theks të fortë satirik e realist nga jeta e fshatit. Këto figura vështrohen përmes optikës së rrëfimitarit, si plaku Martin i cili është edhe personazh. Edhe në këtë rrëfim, dy antagonistët takohen ballë për ballë dhe në një moment të caktuar, njeriu me pushtet të pakufishëm dridhet. Më vonë heroi do të mundet nga pabesia, por do të fitojë pavdekësinë morale.

Është interesante, që, po të kthehemi përsëri te Kuteli, edhe në një figurë të degjeneruar në shkallë të lartë, si ajo e Xheladin Beut, autori arrin të zbulojë një shkëndijë ndërjegjeje njerëzore, në sajë të së cilës inçensi i shmangur në çastin e fundit me të bijën e bën të çmendet.

Leximet e Kutelit, - sipas studiuesit Kujtim Shala, “...janë produkt i vetëdijes për veprën e hapur (U. Eko), produkt i teksteve të shkrueshme” (R. Bart).⁷⁶

⁷⁶ Kujtim Shala. *Kuteli i zbuluar*. Kumbësë e mbajtur në seminarin ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. Prishtinë, gusht 2007, 26/2.

Studiuesi Nasho Jorgaqi, vëren se dramaciteti i theksuar që u jepet ngjarjeve me çmendjen e beut, nuk përliqet plotësisht, po të kemi parasysh se Xheladin Beu është zhveshur nga çdo ndjenjë njerëzore. Kjo hiperbolë e subjektit ndoshta duhet kuptuar si shprehje e kompleksitetit të karakterit të njeriut, në të cilin ligësia s'mund të arrijë kurrë kulmin. Ndoshta një shkëndijë e tillë e vogël e ndërgjegjes mbijeton edhe tek njerëzit më të degjeneruar dhe shton errësinë e përgjithshme të karakterit të tyre. Xheladin Beun e ka degjeneruar lakmia dhe imoraliteti, që burojnë pikërisht nga pushteti që zotëron, i cili e bën atë ta vendosë veten mbi ligjet dhe moralin njerëzor. Në këtë vështrim, thelbi i tij social dhe thelbi psikologjik përputhen, por ky thelb mund të jetë më kompleks sesa e koncepton kritika sociologjike. Tek Kuteli ndërthuren këndvështrimi social dhe humanizmi i përgjithshëm njerëzor, tek figurat e kaçakëve vërehet që ata të vizatohen me simpati.

Pra, tema e fshatit shqiptar rezulton të jetë lëvruar nga shumë autorë, të traditës më të hershme dhe ata më të mëvonshmit, si Lumo Skëndo,⁷⁷Jakov Xoxa, Sotir Andoni, Dhimitër Shuteriqi, Teodor Laço Jakov Xoxa dhe Teodor Laço priren drejt një fshati më epik. Si shkrimtar i personazhit, Koço Kosta e shikon fshatin ndonjëherë në konflikt, pra është shkrimtar i personazhit dhe jo i panoramave të gjera, jo vetëm në sinkroni, por edhe në diakroni. Fshati tek Koço Kosta del i lidhur me qytetin në shumë raporte komunikimesh, interesash e pse jo edhe kundërshtish e keqkuptimesh të ndërsjella. Ky është një tipar i rëndësishëm që i bën krijimet e shkrimtarit më përgjithësuese, më me hapësirë jete dhe problematike. Ky është preokupimi i Koço Kostës për ta njohur e përcjellë thellë e gjerë jetën. Me plot fakte e me bindje mund të pohojmë se shkrimtari e pasuron shumëllojshmërinë e karaktereve dhe figurave, duke gërshetuar realitetin me fantazinë, duke krijuar profilin e vet rreth pasqyrimin të kësaj problematike. Shkrimtari shfaq prirjen e dukshme që i kushtohet skalitjes adekuate të dialogëve, skenave e situatave të ndryshme. Një paraqitje komplekse dhe origjinale e mjedisëve të fshatit, bën që proza e shkrimtarit të jetë e plotë. Gjithmonë për një prozator, shtrohet problemi jo vetëm i shumëllojshmërisë së karaktereve, por edhe i larmisë, i larmisë së mjedisit nëpërmjet së cilës kërkohet të jepet për shtat mesazhit, ideve të thella, problemeve etj. Kur ne i referohemi subjektit, na bën përshtypje fakti që ai zhvillohet në restorante apo kafene. Sigurisht, që ky është një përshkrim që ka dhe vendin e vet në letërsi, sepse restoranti apo kafeneja janë një konvencion për autorin.

Mitrush Kuteli shpalos jetën njerëzore dhe fatin e personazhit nëpërmjet pamjeve dhe vizioneve të renditura shkallë-shkallë njëra pas tjetrës, përmes formatit të jashtëm të një rrëfimi gojor, që përcillet e përjetohet tek lexuesi në një rrëfim letrar modern.

Sipas studiuesit N. Jorgaqi, gjithë morinë e motiveve të tij “Kuteli i paraqet në trajtën e rrëfenjave letrare, me një stil të veçantë shkrimi dhe me një varg temash e motivesh, të cilat mishërohen përbrenda përmbajtjes dhe ideve të prozës së tij”.⁷⁸

⁷⁷ Sipas profesor Ali Xhikut, jeta baritore vazhdonte të mbetej e dashur për poetin, sepse krijonte një cak paqeje, që kushtëzohej nga mungesa e të tjerëve. Shkëputur nga: “Letërsia shqipe si polifoni”, Dituria, Tiranë 2004, f. 139.

⁷⁸ “Duke vështruar thelbin e rrëfimeve të Mitrush Kutelit, - shkruante N.Jorgaqi,- do të vëmë re se autori është përpjekur për një konceptim realist të problemeve”. Në: *Rrëfimet e Mitrush Kutelit, Poetika e dokumentit*, Tiranë 1987, f. 110.

Natyrisht, kjo prirje realizohet si e tillë, në kuptimin e paraqitjes së ambientit, thurjes fabulative apo karakterizimit të personazhit, madje duke i sistemuar ngjarjet përbrenda indit të rrëfimit në mënyrë dramatike, me ndërprerjen e veprimit, përmes ndërhyrjeve të narratorit dhe funksionalizmit të digresionit lirik.

Pra, në kornizën fabulare të prozës së këtij autori, ky ambient (bota e fshatit shqiptar) paraqitet në të gjitha vijat kuptimore prej nga rrjedhin veprimet e personazheve. Nga ana tjetër, derisa evokimi i këtyre temave dhe motiveve, pothuajse bëhet parim krijues i autorit, shkalla e strukturimit dhe e paraqitjes së tyre në përgjithësi, ngrihet në nivelin e shqiptimit dhe të zhvillimit stilistik. Kuteli nuk e vështron fshatin në mënyrë himnizuese, por në ndërlidhjet shpirtërore me bëmat që ndodhin në këtë ambient të tejmbushur me histori të ndryshme njerëzore apo me “shfaqje” të qenieve të mbinatyrshme, që procedohen përbrenda një rrëfimi herë realist (tek fati i njeriut pogradecar), e herë fantastik (temat e vdekjes).

Duke analizuar përmbajtjen e kesaj proze, mund të pohohet se Kuteli i paraqet me gjeturi të shkathët poetike edhe tema të tjera, të cilat nuk ishin trajtuar në atë mënyrë deri atëherë në prozën shqipe. Kuptohet, një qasje e këtillë i përket frytdhënies së tij krijuese në evokimin dhe në përshkrimin e jetës në formë kallëzimi dhe rrëfenje. Tiparet esenciale që dalin në aspektin e ndërtimit tematik dhe motivor të këtyre rrëfenjave, shihen kudo në veprat e këtij autori. Pikërisht këto elemente ia japin mundësinë Kutelit që t’i paraqesë me gjeturi krijuese dhe shkathësi meditimi ngjarjet dhe të dhënat, situatat dhe veprimet, momentet dhe gjendjet e personazheve, nga arti i të fantazuarit në mënyrë mjaft magjepsëse. Praktika e këtillë shkrimore i përket formës së rrëfimit prapavështrues për ngjarjet: të rrëfehët e kaluara, heroizmi atdhetar, fenomeni i mërgimit, problemi i gjakmarrjeve. Prandaj përbrenda këtyre tipareve, hulumtohet arti i tij poetik, hulumtohet thurja e tregimeve, mënyra e procedimit të tyre, shqiptimi tërësor i ideve që dalin nga brendia e prozës. Mitrush Kuteli është shkrimtari i cili gjithnjë kërkon dialogun me lexuesin e vet, duke projektuar fillimin, mesin dhe fundin e ideve. Rrëfenjat e tij, të formësuara përmes strukturimit të ri letrar, e kërkojnë bashkëbiseduesin e tyre. Në këtë mënyrë, edhe nivelet e ndërtimit të kësaj proze, marrin kuptimësinë e ndjeshmërisë stilistike, duke kërkuar praninë e figurave, të cilat arrijnë të zbulojnë së brendshmi thelbin e rrëfimit. Problemet që shtrohen, janë kryesisht probleme të natyrës njerëzore, të idealeve dhe të botëkuptimeve, të cilat e sugjerojnë apo e përcaktojnë konfliktin shpirtëror, moral e fizik të shtresimeve të ndryshme shoqërore.

Thamë që fshati nuk është thjesht sfond i tregimeve të tij, nuk është kornizë, ai jeton dhe merr frymë nëpërmjet jetës së personazheve. Shkrimtari e njeh fshatin shqiptar nga figurat e fshatarëve të tij, të cilët nuk janë të pikturuar në mënyrë të sipërfaqshme e në vija të trasha. Përshtat profilit të vet krijues K.Kosta është shkrimtari që arrin natyrshëm tek ai ekuilibër midis identifikimit dhe distancimit të autorit ndaj personazheve, që i lejon mundësinë për krijimin e tipave/personazheve letrarë. Shkrimtarë të tjerë si J. Xoxa, S. Andoni, Dh. S. Shuteriqi, T. Laço japin pasqyrimin ekzotik të fshatit, duke u dhënë shpesh pas traditave të një fshati të hershëm, përgjithësisht të sjellë e të kujtuar prej së largu, si vendi ku ruhen të konservuara tradita, mentalitete e mënyra të caktuara jetese, duke u fokusuar më së shumti tek vështrimi i tij si bastion e si mishërim i qëndresës historike etnokulturore.

E bëme këtë përjasje dhe i hodhëm këto paralele, sado me penela të shpejta rreth traditës së pasqyrimin të fshatit në letrat shqipe, duke e cekur argumentin në disa autorë e në disa vepra të tyre më të spikatura, për ta kundruar/dalluar në këtë traditë profilin e K. Kostës,

vepra e të cilit nuk mund të jetë e izoluar, veçse e lidhur në shumë fije me këtë traditë, qoftë ajo më e hershme apo dhe ajo bashkëkohëse.

Mund të vazhdonim më tej në hetimin e këtyre paraleleve mes këtij autori dhe autorëve të tjerë, të cilat rezultojnë të vijnë prej rrethanash të njohura ndikimesh, apo dhe si produkt interesimesh të pavarura apo të varura në raport me pasqyrimin e temës së fshatit shqiptar.

Në novelën “I bukuri im” jepet bota e fshatarit, një psikologji e pastër e me interesa të gjera që dita-ditës ndryshon e përsoset. Autori e ka përqendruar vëmendjen, duke shkruar faqe lirike, konflikte të vërteta të jetës dhe figura personazhesh të gjalla, që e bëjnë për vete lexuesin e pritshëm. Trajtime të tilla nuk do të arriheshin, po të mos ishte shkrimi në një përvoja e shkrimtarit (kërkuese e njohëse) me vetë realitetin e tij, apo kërkesat e lexuesit. Kjo është një meritë tjetër e autorit, që i jep prozës ngjyrimin e kohës, jo vetëm nga pikëpamja e ruajtjes së besnikërisë realiste, por edhe për nga respektimi i shijeve reale të lexuesit. Edhe kur shkruan për të kaluarën, autori ka parasysh që ato duhet të kenë ura komunikimi me të sotmen.

Në kornizën fabulare të prozës së këtij autori, ambienti i fshatit, me tërë dekorin dhe rrjetin e lidhjeve njerëzore që funksionojnë atje, paraqitet në sintoni me të gjitha vijat kuptimore prej nga rrjedhin veprimet/sjelljet/botëvështrimet e personazheve. Nga ana tjetër, derisa evokimi i këtyre temave dhe motiveve pothuajse bëhet parim krijues i autorit, shkalla e strukturimit dhe e paraqitjes së tyre në përgjithësi ngrihet në nivelin e shqiptimit dhe të zhvillimit adekuat stilistik. E kaluara e fshatit shqiptar pasqyrohet në rrëfimet e tij, duke shprehur pakënaqësinë ndaj realitetit ose shqetësimin për fatin dhe dinjitetin e njeriut të thjeshtë e për vlerat shpirtërore të tij në kushtet e rendit feudal.

Duke analizuar tipologjinë e kësaj proze në kontekstin e letërsisë shqipe, mund të pohojmë se Kuteli i përcjell me gjeturi të shkathët poetike edhe tema të tjera, të cilat nuk ishin trajtuar në atë mënyrë deri asaj kohe në prozën shqipe. Kuptohet, një qasje e këtillë i përket frytdhënies së tij krijuese në evokimin dhe në përshkrimin e jetës në formë kallëzimi dhe rrëfenje, sikundër e kemi theksuar edhe më sipër. Tiparet esenciale, që dalin në aspektin e ndërtimit tematik dhe motivor të këtyre rrëfenjave, shihen kudo në veprat e këtij autori. Asnjë prozator shqiptar nuk është mbështetur kaq fort tek proza e pasur gojore e popullit, te balada e rapsodia si Mitrush Kuteli. Ky prozator i shquar vizaton gjithçka nga jeta në fshat, me skena dhe piktura nga më të larmishmet. Prandaj, brenda këtyre tipareve mund të hulumtohet veçoria e artit të tij poetik, e thurjes kompozicionale të tregimeve, e shqiptimit tërësor të ideve që dalin nga brendia e prozës. Mitrush Kuteli është shkrimtari, i cili gjithnjë kërkon dhe ia arrin ta mbajë ndezur dialogun me lexuesin e vet, duke i nxitur atij atë kërshtëri/magjepsje të pafund për t’i ndjekur rresht pas rreshti tërë elementet e narracionit të teksteve letrare.

Në vepra të tipit, “Lugetërit e fshatit tonë”, “Fshati im e pi rakinë”, është e vështirë të evidentohet raporti mimetik mes artit dhe botës historike.

“Kuteli është shkrimtar i një vokacioni të veçantë në letërsinë shqipe, shkrimtar i fshatit, atdheut, kurbetit”⁷⁹ etj.

⁷⁹ Për më tepër shih: Gazmend Muka. *Dy prova mbi Mitrush Kutelin. Fshati im e pi rakinë (rrëfenjë)* – *Xinxifillua (përrallë)*. “Përpjekja”, nr 4, shtator 1995, f. 48-56.

Ndryshe nga K. Kosta, Mitrush Kuteli në përshkrimin e tij i nënshtrohet ngjarjes dhe *fshihet* autorialisht për të theksuar ngjarjen e rrëfyer, apo në të kundërt, përfshin vetëm disa elemente të nevojshme për paraqitjen artistike. Në rrëfimin “Fshati im e pi rakinë”, e gjithë “koha dhe hapësira e rrëfimit të ngjarjes i shërben përvijimit të një hapësire të “rrëfyer” pa kohë, të një fshati në formën e një skene teatrore, ku jetohet vetëm e vetëm për atë “dirisë të kazanit” që të ëmbëlson pakëz në këtë jetë kaq të hidhur, që dot s’ia gjejmë fundin”.⁸⁰

Autori zbulon elementet karakterizuese të bashkëkohësisë shqiptare në rrjedhën e jetës.

Raportet me jetën i ka mjaft të dukshme dhe K. Kosta, ku aroma e thekshme e realiteteve të fshatit ndihet sidomos në tregimet dhe novelat më të arrira të tij, ashtu si dhe në romanin “Buka e një stine me borë”⁸¹.

Natyrisht, zbulimi i virtytit të njeriut të thjeshtë, kundërvënja ndaj shfaqjeve të psikologjisë mikroborgjeze, fokusimi i anëve të jetës së fshatit, problematika e gjerë ndaj punës, raportet shpesh dramatike mes fshatit e qytetit, kanë bërë që në vëllimet e tij me tregime, të mos ketë monotoni teme.

Në vëllimin: “Era e udhëve”, midis trembëdhjetë prozave të përfshira në vëllim, ka pika më të ndritshme dhe autori ka dhënë vlera më të spikatura ideoartistike.

Veçohen sidomos novelat “I bukuri im”, “Poemë për njeriun e bukur”, si dhe tregimet “Njeriu i punëve të mira” e “Qebiri”. Novela e parë, e organizuar mirë dhe me një subjekt tërësor, e ngritur mbi bazën e antitezës së tipave, që zbulohet nëpërmjet kundërvënies së shkallëzuar, e transmeton në mënyrë të sigurt idenë e vet. Bashmeta ngrihet dhe rreshtohet edhe me personazhe të tjerë. Novela përbën një vlerë origjinale si një veshje e subjektit me një material jetësor të freskët.

2.2 Raportet e kritikës me prozën e autorit

Kemi gjykuar të ndalemi në këtë syth më konkretisht tek raportet që ka pasur kritika letrare me prozën e K. Kostës. Do të rendisim disa nga qëndrimet, vlerësimet e tezave që kanë shfaqur kritikë të ndryshëm rreth kësaj krijimtarije, duke sjellë në vëmendje disa probleme që i dalin gjykimit mbi to. Para së gjithash, duhet pasur parasysh se ky autor, me gjithë afirmimin që kishte fituar në meset letrare të kohës, nuk e kishte fituar dot ndërkaq aq sa duhej vëmendjen e kritikës. Kjo lidhej me letërsinë e tij shpesh antikonformiste dhe *heretike* në raport me kanunet zyrtare, por dhe me ndëshkimet që e shoqëronin prej këtyre qëndrimeve të tij dhe për pasojë, kritika mbetej në pozita heshtjeje apo veçse kritikuese/denigruese për autorin.

⁸⁰ “Fshati im e pi rakinë” u fillua të shkruhet në dhjetor 1942. Frazologjia dhe episodet janë mbledhur në

Pogradec, duke dhënë, kuptohet, transfigurimin e artit. Rrëfimi bën pjesë nga një cikël më i gjerë.

⁸¹ Teodor. Laço. *Lëngu i jetës. (Shënime për romanin Buka e një stine me borë)*. Në: “Nëntori”, nr. 3, 1980, f. 31 - 41.

Në një renditje të opinioneve të kritikës, kemi formatuar pak a shumë edhe një antologji të saj mbi autorin, ku mund të vërehen qartazi se vlerësimet pozitive mbeten më të besueshme, pasi mbështeten në fakte letrare rreth krijimeve letrare të shqyrtuara, kurse vërejtjet apo rezervat, më së shumti kanë nxitje/shtypa jashtëletrare, që do të thotë se këto të fundit duhen perceptuar/kuptuar brenda formatit që lejonte koha e socrealizmit.

“Autori, si tregimtar i talentuar, në tregimin “Era e udhëve” sjell një formë të thjeshtë dhe një material jetësor të pasur e të freskët, duke dhënë një brendi ideore të fortë dhe aktuale. Është meritë e autorit, që ka arritur të pasqyrojë me bindje dhe vërtetësi, forcën dhe zhvillimin intelektual të fshatarësisë”.⁸²

Në diskutimin e tij në Lidhjen e Shkrimtarëve (1982), një shkrimtar vlerëson se, “Autori dallohet për freskinë dhe mprehtësinë e temave e problemeve që sjell realiteti bashkëkohor, për larminë e personazheve, tipave shoqërorë apo karaktereve dhe trajtimin gjerësisht të jetës të fshatit.”⁸³

“Vëllimi me tregime i Koço Kostës, - thekson në diskutimin e tij Dalan Shaplo, - është ndër shembujt e mirë të kohëve të fundit për trajtimin artistik të temës aktuale. Meritë kryesore është njohja e jetës së fshatit, apo bukuritë e peisazhit”.⁸⁴

Vihet në dukje se, duke kapur tema konkrete, autori afirmon me ngjyra më të dukshme tiparet jetësore të njeriut të mirë.

“Diskutimi krijues i vëllimit “Era e Udhëve”, - thekson midis të tjerash Adriatik Kallulli, është një dëshmi e thellimit realist përmes shtjellimit të temës aktuale të fshatit.”⁸⁵

Autori trajton probleme mjaft të rëndësishme të jetës aktuale, jep në tregime dhe i shtron dhe i zgjidh konfliktet me dramacitet e vërtetësi. Tek “Njeriu i ditëve tona” ai hyn në thellësi të proceseve jetësore, jep karaktere dhe individualitete, ku dhe trajton probleme të mëdha të jetës, që s’i takojnë vetëm fshatit, por shoqërisë në tërësi.⁸⁶

Sipas gjykimit të kritikut: “Fshati del i lidhur me qytetin, nga ana tjetër qyteti është i mbushur me problemet dhe ngjyrat e këtij fshati”.⁸⁷

Edhe tek novela: “Poemë për njeriun e bukur”, siç duket edhe nga titulli, autori në mënyrë të vetëdijshme i ka vënë vetes qëllim të poetizojë një pjesë të jetës së fshatit, apo jetën e barinjve të bjeshkës.

“Një problem që e preokupon fshatin e shkrimtarit është se, aty ndihet nevoja që veçanërisht të rinjtë të punojnë në sektorin e blegtorisë, por autori ka marrë një grup

⁸² Razi Brahim. *Tregime të zgjedhura. (Vëllim nga Koço Kosta)*. Në: “Drita”, 15 shtator 1985, f. 6, 12.

⁸³ *Era e Udhëve. (Tregime dhe novela)*. Tiranë: “Naim Frashëri”, 1981. *Trajtimi artistik i temës aktuale*. (Diskutim krijues i zhvilluar në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve për vëllimin me tregime dhe novela të Koço Kostës). Në Drita, 6 qershor 1982.

⁸⁴ Po aty...

⁸⁵ *Era e Udhëve. (Tregime dhe novela)*. Tiranë: “Naim Frashëri”, 1981: *Trajtimi artistik i temës aktuale*. (Diskutim Krijues i zhvilluar në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve për vëllimin me tregime dhe novela të Koço Kostës). Në: “Drita”, 6 qershor, 1982.

⁸⁶ Po aty

⁸⁷ Adriatik Kallulli. *Fshati ynë në një vëllim me tregime. (Mbi vëllimin “Dadmadhja” të Koço Kostës)*. Në: “Drita”, 8 maj 1977, f. 6-7.

personazhesh të cilët ngjallin para lexuesit dashuri për fshatin dhe i mprehin ndjenjën e natyrës. Janë portrete njerëzish që të emocionojnë dhe që meritojnë të vijnë kështu, plot dashuri dhe art. Kjo bën që shkrimtari të ndjekë ritmin e zhvillimit të jetës së fshatarësisë”.⁸⁸

Është e vërtetë se, në interpretimin e fenomeneve dhe dukurive të jetës fshatare, shkrimtari duhet të ngrihet mbi fakte, por në këtë interpretim duhet të ndihet forca e atij pushteti tepër të respektuar që ushtrojnë vetë faktet. Kontakti i drejtpërdrejtë me fshatarët, me mjedisin e punës, njohja nga afër e njeriut punëtor, përpjekjet për të zbuluar botën e madhe shpirtërore, i kanë dhënë dorë autorit (në realizimet më të mira), të pasqyrojë anë të ndryshme të mjedisit fshatar e të realitetit në përgjithësi. Shumanshmëria dhe pamjet e reja të jetës që ka sjellë ajo kohë, dashuria dhe krenaria e natyrshme për vendlindjen, ndjenjat njerëzore që burojnë nga kjo dashuri, anët më qenësore të realitetit në fshat, autori i lidh me fytyrën e re të fshatit, me tiparet që ai fiton nga kontaktet me botën përtej tij, që doemos ia tronditin ekuilibrat që ka vendosur prej shekujsh. Nuk janë këto ndryshime që inspirohen thjesht e vetëm nga shtypsa politike. Jo, është ai ndryshimi universal i fshatit e jo vetëm i atij shqiptar. Por që në çdo regjion do të ketë specifika e kushtëzime rrethanash etnokulturore.

Tek “Burri i vogël që...” ndoshta më shumë se në të tjerët, autori Koço Kosta vë theksin në zhvillimin e psikologjisë së njeriut (konkretisht të fshatarit), si rezultat i ndryshimeve të raporteve ndaj punës, ndaj mjedisit, familjes, shoqërisë, ndaj teknologjisë që po hyn dita ditës.

Nisur prej krijimeve të tij del se autori e rrok jetën në një shikim realist dhe koherent. “Ashtu si në realitetin tonë, kemi të bëjmë me një fshat ku gjallojnë një mori lidhjesh dhe pleksjesh me tërë jetën e vendit dhe epokën, një klasë fshatare që shumon fibrat e psikologjisë së klasës punëtore, që rrit në shtresën e inteligjencës popullore bijtë dhe bijat e veta, një fshat që s’jeton dot as edhe një grimë pa marrëdhëniet, ndikimet janë reciproke dhe lidhjet e thella me qytetin”.⁸⁹ “...një gazetar që hyn e del si bleta nëpër livadhet e jetës popullore, në një dhomë hoteli me një “babaxhan” tinëzar, ndeshet me të, duke qëndruar disa ditë bashkë. Një burrë me kokore shoqëron grupin e këngëtarëve popullorë të fshatit që do të incizojnë dhe i ruan se mos bëjnë gabime ideologjike”.⁹⁰

Fabula të thjeshta mbulojnë konflikte në pamje të parë të heshtura, por që janë gati për të shpërthyer.

Vetë kënga që incizojnë fshatarët përshfaqet si simbol i sakrificave dhe i vlerave të tyre shpirtërore. Fshatari vërtet paraqitet me një psikologji të re, por procesin e shndërrimeve duket se e përjeton si një kalvar vuajtjesh e sakrificash dramatike, duke mbetur kështu kjo krijimtari në kontekstin e një proze jo thjesht lineare apo afirmative, por me shtjellat e kundërshtitë që në fakt i ofron vetë realiteti. Këtu autori shfaq personalitetin dhe karakterin e tij emancipues dhe jo sistematikisht konformist, sikundër ishin kërkesat e kohës.

⁸⁸ Zija Çela. *Jetë që vjen në art. (Vëllimi me tregime “Era e udhëve” i Koço Kostës)*. Në: “Drita”, 8 gusht 1982, f. 5 - 6.

⁸⁹ Adriatik Kallulli. *Kërkime dhe gjetje të reja novatore. (Mbi vëllimin me tregime dhe novela) “Era e Udhëve” të Koço Kostës*. Në: “Nëntori”, nr. 6, qershor 1982, f. 17-30.

⁹⁰ Adriatik Kallulli. *Mbi vëllimin “Dademadhja” të Koço Kostës*. Në: “Drita”, 8 maj 1977, f. 133.

Një tipar i qëndrueshëm i artit të K. Kostës, është mbështetja e tij te krijimtaria orale, ku ai di të zbulojë/njohë e bëjë të vetat para së gjithash strukturën estetike të anonimatit, me vezullimën aq evidente magjepsëse të ideve dhe të imazheve e figurave stilistike. Drejt këtij burimi shkrimtarin e shtynin shumë faktorë, por mbi të gjitha me sa duket atje ai ndjente e asimilonte pushtetin e një arti të njëmendtë. Nga potencat e folkut ai merr atë filozofi optimiste me të cilin njeriu (shqiptari) kundron jetën, vdekjen dhe dashurinë. Ai merr pastaj pikëzimin e karaktereve me vija të shpeshta por edhe domethënëse, merr tipare të heronjve, thjeshtësinë e madhërisme të zhveshur nga artificiet, merr konkretësinë dhe plasticitetin me të cilat skicon dukuritë, koncizitetin e rrallë, hyrjet e befasishme në temë, merr ligjet dhe përvojën e gjithanshme në pasqyrimin e dallgëzimeve të situatave, të ndjenjave dhe mendimeve, merr së fundi begatinë e figurave që për të bëhet një burim i pashtershëm krijues.

Autori pasqyron ndjenjat më delikate dhe pasionet më të fuqishme. Ai i kushton vëmendje dhe sferës intelektuale të njeriut. Merr nga krijimtaria e tij personazhe, motive dhe mjete të ndryshme artistike. Kjo duket në faktin që portretet kanë plasticitet të veçantë, ndërsa peizazhet duket se i ngjajnë atyre të De Radës, kanë shumë origjinalitet dhe ngjyrim të theksuar ideo-emocional. Por ndjenja, afekti apo pasioni i dashurisë në raste të veçanta, duket mbase e çuditshme, si e pashpjegueshme dhe e fshehtë, si vetë hyjnia.

Tek poezia popullore mbështeten edhe shkrimtarë të tjerë, si poeti Lasgush Poradeci. Poezi të tilla si: “Kroi i fshatit tonë”, “Kush ta fali bukurinë”, “Del në porta” etj, janë poezi brilante dhe të thjeshta, ku bëhet fjalë për vendet dhe mënyrat e ndryshme të fillimeve të dashurisë, pengesat konservatore në rrugën e zhvillimit të saj dhe përshkrimin e koloritit shqiptar.

Porse shkrimtari K. Kosta synon më tepër për të krijuar një raport më të drejtpërdrejtë midis përshkrimit dhe interpretimit, tenton të shmangë rutinën vetjake që nganjëherë e kanë edhe artistët më të shquar, aq më tepër që ai e njuh jetën thellë, është i ngopur me jetë, dhe vetë jeta në art kërkon një shtrydhje më të mirë.

Sidoqoftë, ajo çka të bën më shumë përshtypje në rrëfimet e këtij shkrimtari, është dashuria e autorit për fshatin, të cilin ndoshta e njuh më mirë se cilido prej krijuesve të kohës. Kjo dashuri, e në përgjithësi ky raport i thellë konfidencial me fshatin, spikat qysh në tregimin e parë (që për patosin me të cilin e ka derdhur në letër, shkrimtari me të drejtë e ka quajtur “poemë”), dhe shpaloset pastaj në të gjitha faqet e tregimeve dhe novelave të librit. Mund të themi me plot gojën, se ky është tipari kryesor i personalitetit krijues të K.Kostës dhe autori në disa raste e ndien veten në rrethe studentore apo mjedise të ndryshme qyteti, sjell ndërmjet vetes dhe rretheve apo mjediseve një copë të gjallë fshati, duke i mbushur ato me blerim dhe kaltërsi. Me sa duket, edhe vetë autori është i vetëdijshëm për këto veçori të personalitetit të vet krijues, përderisa në fillim te librit ka vënë shprehjen e Bethovenit “Asnjëri mbi tokë nuk mund ta dojë fshatin sa unë”. Sa e vërtetë është kjo në rastin e K. Kostës, mjafton të kujtohet se me ç’forcë dhe ç’dashuri i përshkruan ai peizazhet e fshatit, me ç’ngrohtësi dhe shpirt i ndërton karakteret e fshatarëve. Autori mburret që është bir i fshatit, çdo gur i fshatit, çdo gjë e gjallë, duket sikur i flet, kurse personazhe si: Mëma, Gizdari, Xha Rapi, Shoshoja, Mazja e ndonjë tjetër, të bëhen tepër të afërt, dhe sikur të japin diçka nga çiltërsia dhe zgjuarsia e tyre dhe sa herë që ndodhet në mjediset e tij, ndjehet zot i vetes dhe i botës.

Shkrimtari vë në qendër fshatarin, mjedisin e punës të formimit të tij, një fshatar që ndjen brenda vetes trandjen e ripërtëritjes, që herë e pranon dhe po aq herë e refuzon, në një mëdyshje sfilitesë. Kujtojmë këtu tregimin “Anika”, që hap vëllimin “Dademadhja”, ku vihen në dukje ato rrethana shoqërore që i japin mundësi fshatarit të dalë nga dramati e rënda .

Tek tregimi “Pasi dëgjova këngën e një gruaje” autori përshkruan një grua që mund të kishite qenë viktimë e kanuneve. E ndodhur në rrethana jete normale, këndon dhe përshkruan një dramë të vjetër që mund të rizgjohet në ciklin e jetës.

“Natyren ne e ndiejmë dhe në qytet, por ambienti i preferuar i personazhit rrëfenjës është fshati⁹¹, burim i jetës në të gjitha shfaqjet e saj, qoftë edhe i fluturimeve kozmike”. Autori është aq i ndjeshëm ndaj natyrës, sa e humanizon atë dhe degët e thara të pemëve që përplasen në xhamat e një nate dimri, që shëmbëlajnë me gishtërinj, një dëshmi e dashurisë së gjallë kjo ndaj burimeve të jetës, një ndjenjë e cila zbërthehet dhe skalitet në disa ngjarje të vogla, sa mezi t’i sheh syri dhe t’i kap mendja. Kështu që shfaqet prap burimi i jetës së shoqërisë njerëzore. Pothuaj në të gjitha tregimet autori jep temën e fshatit. Kjo prirje, që ishte shfaqur edhe në tregimet më të mira të mëparshme, këtu e ka pikësynimin themelor. Prandaj tek tregimet e tij do të gjesh pas përshkrimit të jashtëm pasurinë e madhe shpirtërore. Në këtë vrojtim, autori gjen detaje kuptimplotë, zbulon përvojën e pasur të njerëzve të punës me burimet jetësore, ndeshet njeriu i thjeshtë që në thelb është i ndershëm e përparimtar.

Në tregimin “*Puravel Duka,*” jepet hallka për konflikte të vërteta, me domethënie të madhe klasore, ku autori mbetet përherë i natyrshëm në thurjen e krejt situatës.

Fshati ka njerëz me karakter jo të zakonit, të cilët e kanë frymëzuar autorin të ndërtojë figurën e njohur të Dademadhes.

Duket se autori vendos pozicione të ndryshme të këtij personazhi. Kujtojmë këtu personazhet e *Puravel Dukës*, *Niko Litit*, *Dademadhes*, *Çumanit*, ku këta dhe mjedisi që përshkruhen aty janë të harmonizuar dhe të japin një përftyrim realist të jetës së fshatit.

K. Kosta është padyshim krijuesi me ndjeshmërinë e thellë për fshatin e tij, për fatin e njeriut në jetë dhe për pozitën e tij në shoqëri, si dhe të shoqërisë në përgjithësi. Ai ndien në shpirtin e tij dhembjen njerëzore, vuajtjen e peshës së skamjes, peshës së pasigurisë së njeriut në jetë dhe rrënimin të dinjitetit njerëzor, të robërimit shpirtëror të tij, ndien mallin dhe jetën fshatareske, duke u angazhuar kështu në krijimtarinë e tij letrare, me një krijimtari që hedh dritë në shpirtin e këtyre njerëzve, pikërisht me optimizëm e guxim për perspektivat jetësore.

⁹¹ Mehmet Myftiu. “*Dashuria e burimeve të jetës*”. *Koço Kosta*, “*Paradite me shi*”. Në: “*Drita*”, 23 shkurt 1992, f. 6.

Kapitulli III

3 Profili kompleks i personazheve të Koço Kostës

Koço Kosta është një shkrimtar që arrin të derdhë në prozën e tij ngjarje e personazhe jo vetëm me pasuri jetësore, por edhe me nota të theksuara psikologjizmi. Siç e kemi vënë në dukje, është shkrimtari para së gjithash i pasqyrimin të botës së fshatit shqiptar dhe arrin tek ai ekuilibër mes identifikimit dhe distancimit të autorit ndaj personazheve të krijimeve të tij, duke krijuar një lloj bote sa reale, të prekshme e fort të njohur, aq dhe në *kufijtë e largët* të trillit artistik.

Personazhet e tij, duke ruajtur origjinalitetin autentik autorial, janë pikturuar ndryshe nga personazhet p.sh. të një autori tjetër që e ka aq të trajtuar e aq mjeshtërisht motivin e fshatit, sikundër është Kuteli. Personazhet e K. Kostës duket se shkojnë nga konturet fluide të “rrëfenjave” në vizat si me laps karboni të novelave, që në disa raste, hiperbolizohen nëpërmjet fantastikes dhe groteskut. Ato ndryshojnë edhe nga personazhet e një shkrimtari tjetër aq të njohur në pikturimin mjeshtëror të fshatit, Jakov Xoxës, i cili duket se dashurohet në mënyrë të pasionuar me personazhet që mishërojnë idealin e tij shoqëror-etik, ndonëse nuk i idealizon në frymë romantike, por në mënyrë realiste, nëpërmjet së ashtuquajturës “dialektikë e shpirtit”, dhe përfshihet qartazi në urrejtjen/mohimin e krijesave/personazheve të tij negative, por çuditërisht, prapë përshtfaq në frymë realiste respektin për thelbin dhe të vërtetën e tyre njerëzore. Shkrimtari K. Kosta, nuk është natyrisht indiferent ndaj personazheve të vet, por i objektivizon më tepër ndjenjat e veta, është një autor që di të presë me mprehtësi kordonin e kërthizës, që lidh krijuesin me krijesat e veta, dhe të japë qartësisht përshtypjen e “krijesave të gjalla”. Personazhet e tij janë të tipizuar në thellësi dhe me larmi, karakteri i tyre tipik është shkrirë në individualitetin e tyre, domethënë, në figurat e këtyre personazheve ndeshim një shkrirje të harmonishme të thelbit social me thelbin individual. Te ky autor nuk gjejmë atë rrudhje dhe zbehje të personazhit që dallon letërsinë moderniste të shekullit të njëzetë e që vazhdon të ndihet edhe më pas, që shpreh, sigurisht artistikisht, dhe krizën/kaosin dhe humbjen e vlerave.

Ky tipar është shfaqur sipas rastit edhe në vepra të caktuara të prirjes moderniste e postmoderniste të letërsisë shqipe, por K. Kosta mbetet në thelb shkrimtar i prirjes realiste, madje realiste kritike. Edhe në periudhën e parë të krijimtarisë, ai nuk e përqafon tërësisht realizmin socialist me skematizmin dhe ngurtësinë e rregullave të tij, porse arrin të derdhë lëng jete në dejtë e personazheve që krijon, lëng jete që i vjen nga njohja e thellë e realitetit të fshatit dhe karakteristikave të tij. Këto personazhe janë vizatuar në plotësi dhe në thellësi, madje shumë prej tyre janë bartës të virtyteve të rralla njerëzore, që letërsia shqiptare e viteve të fundit ngurron t’i pasqyrojë, duke iu trembur atij idealizimi të karaktereve që e dallonte realizmin socialist dhe buronte nga ajo romantikë e rreme që pretendonte ta mishëronte “energjinë romantike” në këtë drejtim letrar. Por pa dyshim, kjo prirje e re përfton një njëanshmëri të kahut të kundërt, duke zëvendësuar mekanikisht ngjyrën rozë me ngjyrën e zezë.

E veçanta e shkrimtarit, është fakti që u ka dhënë mjaft personazheve të veta psikologjinë e thjeshtë, por edhe të pasur të njeriut të popullit, filozofinë e tij të natyrshme

dhe të shëndetshme. Theksuam më lart se ai është një shkrimtar me prirje psikologjizmi si Jakov Xoxa, por këtë prirje psikologjizmi e shfaq në mënyrën e vet dhe kësaj personazhet e tij nuk janë as simbole fluide, as marioneta në dorën e autorit, po njerëz të gjallë, që shfaqen në galerinë e pasur të personazheve, në gjithësinë e karaktereve virtuale të krijuar prej tij, në veçantitë e papërsëritshme të karakterit, të temperamentit, të tipareve sociale dhe kombëtare.

Mund të sillnim ndërmend në këtë rast mendimin e shprehur nga Bjelinski se, tek çdo talent i vërtetë, çdo personazh është një tip dhe çdo tip për lexuesin është një i panjohur i njohur.⁹²

3.1 Personazhet e tregimeve dhe novelave

Një dukuri të tillë, shenjë e vitalitetit të personazheve, e gjejmë edhe në gjithësinë letrare të tregimeve të Kostës, të atyre personazheve të krijuar prej tij. Puravel Duka, fshatari Doke, Dademadhja, kanë një vitalitet dhe pavarësi të tillë prej autorit të tyre, aq sa të japin përshtypjen e njerëzve të gjallë që ke njohur dhe takuar. Kështu Dademadhja nuk merret konkretisht sit ë thuash prej dorës së autorit për t'i hapur asaj sytë, por në mënyrë bindëse e njeh vetë të vërtetën. Po kështu mund të gjykojmë dhe për fundin dramatik të tregimit që i kushtohet fshatarit Doke, i cili nuk është përcaktuar si efekt nga autori, po rrjedh nga logjika e brendshme e karakterit të personazhit. Anika në tregimin me të njëjtën emër, nuk proteston kundër martesës me mblesëri, sepse kjo nuk do të përputhej me brumosjen e saj.

K. Kosta, në procesin e krijimit artistik që përjeton çdo autor, kur nxjerr në dritë personazhet e vet dhe që u ngjan marrëdhënieve të kohës me fëmijën, ndonëse përcaktohet si rrëfimtar objektiv dhe përdor më tepër vetën e tretë në vizatimin e tyre (në disa raste vetën e parë), ka arritur të derdhë gjakun e vet në “krijesat e veta aspak prej letre”, por prej mishi dhe gjaku.

Në të vërtetë, pavarësisht nga teoritë moderne për zbehjen deri në zhdukje të personazhit (më saktë, ngaqë asgjësimi i personazhit është i pamundur në depersonalizimin e tij), një vepër, qoftë ajo e prozës së shkurtër apo të gjatë, jeton nëpërmjet personazheve e karaktereve të krijuara, që, krahas asaj që u quajt “dialektikë e shpirtit”, e zbuluar nga letërsia tipike realiste e shekullit të nëntëmbëdhjetë, zotëron të vërtetën e vet relative, filozofinë e vet që u imponohet lexuesve dhe që siç kemi vënë re, bën pjesë në magjinë e prozës. Realizmi socialist, duke pretenduar të gjente përgjigjen e të gjitha pyetjeve, duke i ndarë personazhet sipas skemës bardhë e zi, reduktonte larminë e pakufishme të ngjyrave të jetës dhe të individualitetit njerëzor, duke sterilizuar në shumë raste letërsinë e gjallë. Shkrimtarët e talentuar, ndonëse nuk mund ta hidhnin poshtë kaq hapur këtë drejtim letrar, u përpoqën ta “shartonin” në mënyra të kalkuluara me elemente të realizmit kritik dhe madje të modernizmit. Në mjaft raste, ky shartim që i suksesshëm dhe u dha jetë veprave të realizuara. Magjia e karakterit njerëzor të pasqyruar në letërsi, është e tillë sa në letërsinë bashkëkohore botërore postmoderniste dhe realiste gjen një ringjallje të ngadalshme të personazhit. Do të mund të flisnim për personazhe, që në thelb janë realistë në sfondin e romaneve postmoderniste, si personazhet e postmodernistit Umberto Eko, i cili ka mundur të krijojë në

⁹² N. G. Bjelinski. *Artikuj kritikë*. Tiranë, 1977, f. 47.

romanin e tij “Emri i trëndafililit” karaktere tepër interesante, si Guljelmi (në përkthimin shqip Uiliam), pa harruar edhe personazhet e “realizmit magjik” të Markezit dhe Aljendës. (Kujtojmë se këta ishin përfaqësues të realizmit magjik në Amerikën Latine, kemi parasysh që është shkruar edhe vepra “Njëqind vjet vetmi” apo “Shtëpia e Shpirtrave”).

K. Kosta në krijimin e personazheve të veta i qëndron në tërësinë e krijimtarisë së vet besnik realizmit kritik, që në fakt nuk arriti dot të zhvillohej plotësisht në letërsinë shqipe me tërë forcën tërheqëse të vet dhe vazhdonte të mbijetonte nën “koracën” e ngurtë të metodës a drejtimit letrar zyrtar të realizmit socialist, në veprat e veçanta të shkrimtarëve të talentuar, që do të shfaqnin edhe kështu disidencën e vet estetike. Pra, skalitjen e personazheve, shkrimtari Kosta e realizon, siç vë re edhe studiuesi Bashkim Kuçuku, duke u përqendruar në një tipar dallues të karakterit të tyre dhe jo në dy tipare. Mënyra e parë lidhet me traditën realiste të shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe në veçanti me modelin balzakian.

Realisti i madh francez thekson tek personazhet e vet një pasion themelor që arrin në skajshmëri si: kopracia (Grande), zilia (kushërira Betë), dashuria atërore (xha Gorio). Ky pasion përcakton një tipar themelor që është çelësi i tërë karakterit. Edhe disa nga personazhet e K. Kostës, janë krijuar sipas këtij procedimi, që është i afërt edhe me dramaturgjinë si gjini dhe me zhanrin e komedisë, meqenëse vështirimi me lente zmadhuese i një tipari kryesor është i lidhur ngushtë me patosin komik dhe satirik. Megjithatë, një pikurim i tillë i karaktereve nuk është i huaj, as për patosin tragjik, siç e shohim tek Balzaku, në qoftë se autori përqendrohet më tepër në botën e pasioneve se sa në sferën racionale. Vizatimi i një tipari kryesor mund të jetë komik, kur lidhet me reduktimin e karaktereve në një lloj automatizmi të brendshëm të tyre, gjithashtu edhe tragjik, nëse lidhet me një pasion të caktuar tepër të fuqishëm që gllabëron personazhin, i cili e ushqen.

Shkrimtari e përdor këtë mënyrë portretizimi në vizatimin e personazheve, duke theksuar me penën e vet një ngjyrë të vetme në karakterin e tyre, por një ngjyrë që nuk përmban në vetvete skematizmin apo reduktimin, por përkundrazi sintetizmin.

Përkundrazi, personazhi i Mëmës është tragjik. Tek figura e saj theksohet tipari i dashurisë amtare që i çuar në skajshmëri, e çon në çmenduri personazhin. Është fjala për një hiperbolë të subjektivit, nëpërmjet së cilës shkrimtari pasqyron tragjizmin e luftës së klasave që të çon në një fund tragjik, si djalin ashtu dhe Mëmën, e cila humbet të birin, por edhe veçohet nga njerëzit, dënohet për një faj jo të saj, pra, është një “fajtores pa faj”. Një pasion tepër i lartë, tepër fisnik, çuditërisht shkatërron personazhin në kushte të caktuara politike-shoqërore. Në këtë pasion të “Mëmës” nuk ka egoizëm, siç ndodh, bie fjala, me një nga krijesat e Fransua Moriakut nga romani “Genitriks” (është fjalë latine, ishte fjala për një nënë egoiste e cila urren nusen e djalit dhe e lë të vdesë se ajo kishte larguar infermierën), që, duke parë të birin si pronë të vet e largon nga e shoqja, shkakton vdekjen e parakohshme të saj, më në fund humbet edhe djalin edhe jetën. Ndofta dhe tek “Mëma” e Kostës gjejmë një përkushtim të tepruar ndaj djalit, por flasim jo për një përkushtim egoist, por për një altruizëm të skajshëm që përqendrohet tepër tek lumturia e të birit; “ajo gëzohej kur i biri luante...që e tëra mirësi ajo grua.”

Po këtu është fjala për një kalim të masës së një ndjenje që sjell efektin e kundërt, një dashuri jo egoiste, por që e ushqen egoizmin tek ai që është objekt i saj.

Zotësia e shkrimtarit shfaqet në mënyrë të veçantë tek dialogët e gjallë, të pasura me fraza karakteristike, me aromën e fortë të jetës, që përmbledhin në mënyrë sintetike filozofinë

individuale të personazheve, e cila ndryshe nga ç'ndodh në tregimet e Kutelit, shkëputet nga mendësia kolektive. Do ta quanim këtë një veçori karakteristike shqiptare, meqenëse shqiptari në thelb, ndonëse në një vështrim është tepër i lidhur me mjedisin social dhe familjar, mbetet një individualist. Kjo veçori i kundërvihej lidhjes shpirtërore me kolektivin, tipar artificial ky i të ashtuquajturit “njeri i ri”, që propagandohej në socializëm. Një veçori e tillë mund të lidhet me egoizmin dhe konkretisht lidhet me disa karaktere të K. Kostës dhe me këtë tipar po kolektiv mund të fshehë në vetvete edhe origjinalitet, pavarësi shpirtërore ndaj mjedisit. Mund të themi pra, që autori është tepër i efektshëm në vizatimin e individëve, tek ai nuk e gjejmë parimin e tipizimit përmbledhës, skenat masive të turmës, të cilat ndeshim në veprat e autorëve të tjerë.

Shkrimtari u jep forcë personazheve të vet edhe nëpërmjet antitezave, ballafaqimit të karaktereve të kundërta. Kështu, duke vizatuar karaktere të kundërta, që jepen paralelisht apo ndeshen me njëri-tjetrin, Kosta i shmanget rrezikut të një paraqitjeje bardhë e zi, nga e cila vuajnë shumë vepra të “realizmit socialist”, ku vihej re një ndarje e prerë midis të ashtuquajturave karaktere pozitive dhe atyre negative. Në botën shpirtërore të personazheve të krijuara nga shkrimtari ka nuanca të tilla që shfaqin larminë e jetës. Shkrimtari arrin të gjejë nuanca, qoftë tek e bardha, qoftë tek e errëta. Ai njih edhe ngjyrën e hirtë të atyre karaktereve që nuk arrijnë dot, as tek e mira/sublimja, as tek e keqja, për shkak të dobësisë/lëkundjes së vet.

Në krijimin e karaktereve të këtij modeli, K. Kosta është sa realist aq edhe modernist. Realist, se di të paraqesë larminë e jashtëzakonshme të karaktereve njerëzore, modernist sepse paraqet zbehjen e ngadalshme të individit, në një botë ku mbretëron pasiguria. Karaktere të tilla, mediokre dhe të dobëta, janë tipike në atmosferën e diktaturave që shtypin “njeriun e vogël” dhe zhvillojnë tek ai tiparin e frikës.

Në rrafshin social, këto karaktere mishërojnë personazhe mikroborgjeze, por humbja e idealeve i ka përgjithësuar në rrafsh më të gjerë. Por personazhe të tilla në prozën e Kostës qëndrojnë përballë karaktereve të kundërta, që shprehin tërë pasurinë shpirtërore të njeriut të popullit të lidhur me punën dhe me natyrën. Kosta ka aftësinë të vizatojë me zotësi karaktere ku mbizotëron bota emocionale, sfera e pasioneve, veçanërisht pasioneve të forta si: dashuria dhe urrejtja. Kështu, shkrimtari di të zbulojë botën shumë të pasur dhe të larmishme të njerëzve të punës, dashurinë e tyre për tokën, për natyrën, për të gjitha qeniet e gjalla.

Kështu, në tregimin “Fshatari Doke”, në shpirtin e protagonistit, dy dashuri i kundërvihen njëra-tjetrës, dashuria për pemën, fryt i punës, dhe dashuria për një qenie të gjallë si qeni. Dokja e do pemën si fëmijën e vet, por kjo dashuri shkatërrohet nga krijesa tjetër e dashur e tij, qeni, që luan në tregim rolin e personazhit, mbizotëron dhe sjell edhe fundin dramatik, vrasjen e qenit nëpërmjet së cilës drama shpirtërore e protagonistit që ka humbur njërin nga dashuritë kryesore të jetës së tij dyfishohet. Kjo i sjell lexuesit ndjenja ambivalente, ai nuk di nëse duhet ta mëshirojë apo ta dënojë protagonistin, i cili dënohet në një kuptim si i pamëshirshëm, megjithatë, kuptohet se egërsia e tij buron nga një dashuri që i është vrarë.

Në veprën “Vendin e parë njeriut të tokës”, kjo ndjenjë e hollë lirizmi gjen përshkrime të bukura në fshat dhe ndjen në mes tyre dashurinë për fshatin dhe njerëzit e tij.

Sipas studiuesit Bashkim Kuçuku: “Autori ka ditur të vërë në bazë të krijimtarisë e ta forcojë pareshtur njohjen konkrete, të shumanshme, të atyre njerëzve për të cilët merr përsipër përgjegjësinë e madhe të shkruaj⁹³.”

Është e vërtetë që shkrimtari ka punuar për të nxjerrë një larmi karakteresh, si më të zgjedhurit e zemrës. E realizuar është dhe figura e bujkut dhe shkrimtari nënvizon veti/tipare të tij, përmes dialogëve apo shakave që tregon dhe Puraveli.

Edhe në veprën “Fshatari Doka”, autori jo përherë dëshiron t’i qëndrojë besnik deri në fund zërit qendror dhe natyrës së vet krijuese. Digresionet dhe “plotësimet” e këtilla në këtë prozë, nuk shkrihen as në natyrën krijuese të autorit. Duket se rrëfimi i Koço Kostës flet ndonjëherë edhe nëpërmjet heshtjes, edhe pse nuk është vështirë të pikaset një dualizëm kuptimor. Fijet e lidhshmërisë së këtyre personazheve me botën janë aq intensive, sa që refleksi i tyre ndriçon në veçanti. Autori e vizaton bukur botën e brendshme të Dokes, i nxitur nga ndjenja e tij private. Përballë njeriut shpirtgjerë ndeshet në kontrast/kontrapunkt njeriu shpirtvogël.

Shkrimtari jo rrallë kalon nëpërmjet vështimit të gazetarit për të kaluar tek vështimi i shkrimtarit. Po nëse tek personazhet e skicuar si për shembull tek gazetari synimi është besnikëria më e lartë ndaj realitetit, tek shkrimtari synimi është largimi nga prototipi real për të arritur tek krijesa e fantazisë. Duhet përmendur se ka raste kur ky proces nuk çohet deri në fund. Zbulimi i tipareve në jetë është i mprehtë dhe origjinal, kjo zbulon dhe tipat shoqërorë. Shkrimtari i ndërton tregimet edhe mbi figurat me kundërkahje, pikërisht përmes skenave, dialogëve, situatave apo detajeve. Bota shpirtërore e njeriut të tokës është themelore dhe e fuqishme. Sintezë e virtytit popullor/njerëzor është dhe figura e Dademadhes dhe me këtë rast mund të pohojmë se do të duhej mbase një analizë e veçantë rreth mënyrave sesi i ndërton ky autor karakteret e tregimeve dhe novelave. Ato janë struktura tekstore karakteristike dhe që prandaj mund të themi se dallohen menjëherë që janë krijuar nga pena e Koço Kostës.

Dihet se karakterizimi është përcaktimi i veçantë i ndonjë fenomeni apo dukurie tek njeriu dhe bota rreth tij. Në rastin tonë, karakterizimi i personazhit në veprën letrare, arrihet me anën e të dhënave për origjinën, veprimtarinë, vullnetin, aftësitë, paraqitjen e jashtme, të cilat autori i tregon nëpërmjet sjelljeve dhe emocioneve të personazhit, për të cilat shkrimtari na vë në dijeni nëpërmjet fjalëve të autorit. Ky individualizim me anë të gjuhës, ose karakterizimi me anë të së folurit, përbën zbulimin e tipareve dhe veçorive dalluese të personazheve të veprave. Nuk mund të kemi veçim karakteresh pa u bazuar mbi realitetin, prandaj dhe karakteri i personazhit shpaloset në raport me punën e tij. Filozofia e shkrimtarit bazohet mbi vlerat e njeriut për të kryer më pas një portret të atij që mendojmë dhe lexojmë në veprat e këtij autori. K. Kosta është munduar të zbulojë personazhin gjatë rrugës së jetës, si, për shembull, agronomi Pelik Baduni është vënë në qendër të subjektit e të thurjes kompozicionale, sipas mënyrës së njohur në prozën e realizmit socialist, të vajtjes së një intelektualit në fshat. Siç shprehet edhe Puravel Duka, “...kanë qarë e kanë qarë për dy mijë vjet këta njerëzit tanë, pas dy mijë vjetësh s’qajnë më, këtë e dinë edhe fëmijët”.⁹⁴ Shkrimtari

⁹³ Bashkim. Kuçuku. *Vendin e parë njeriut të tokës*. (Koço Kosta, “Dademadhja”, Tiranë: “Naim Frashëri”, 1976). Në: “Nëntori”, nr. 8, gusht 1977, f. 144 – 154.

⁹⁴ Shih “Dademadhja”, Tiranë: “Naim Frashëri”, 1976, f. 125.

vlerëson rolin e popullit në vepër duke e quajtur atë një vlerë materiale dhe shpirtërore, gjë që shprehet bukur në konsideratat që ai shpreh.

Filozofia që është vënë në bazë të tregimeve të K. Kostës në periudhën e parë të krijimtarisë së tij, është një filozofi thellësisht popullore dhe ku spikat konceptimi i shëndetshëm i popullit për njeriun, për jetën, vdekjen, dashurinë, lumturinë. Autori shpreh në disa tregime të tij kultin e dashurisë, bukurisë dhe natyrës. Dashuria ka vendin e vet në tregimet e K. Kostës, si një ndjenjë thellësisht njerëzore, shpirtërore dhe fizike, burim jete dhe lumturie që poetizohet, por edhe pasqyrohet në mënyrë realiste për të krijuar këtë tregim.

Në krijimtarinë e K. Kostës ndeshim tipa të tillë si Bashmeta, në të cilën virtytet e larta shoqërohen me një farë naiviteti që e bën të mos e kuptojë të keqen, por personazhi arrin të luftojë kundër tij dhe kështu arrin fitoren. Në këtë mënyrë, shohim një karakter në evolucion, arritjen e pjekurisë shpirtërore nën ndikimin e rrethanave të jetës.

Në tregimin “Qebiri”, kalohet nga jeta reale në jetë artistike dhe kjo është bërë me shkathtësi dhe finesë. Shkrimtari me të drejtë e vlerëson mbajtjen e ekuilibrit estetik në marrëdhëniet autor – personazh. Një interpretim të shtrembëruar të miqësisë që i lidh dy protagonistët e novelës “Ata të dy dhe të tjerë”, duke gjetur në të shenja homoseksualiteti, e gjejmë në një kritikë të shkruar për këtë novelë në kohën e diktaturës, e cila synonte vetëm të rëndonte artificialisht “mëkatet” e autorit. Këtë keqkuptim tendencioz mund ta krahasojmë me një shtrembërim të ngjashëm në studimin “Komedia njerëzore”, që studiuesi me prirje të majta Andre Vurmser ka shkruar për “Komedinë Çnjerëzore”. Ky studiues gjatë analizës së personazheve të Balzakut, gjen elemente të homoseksualitetit që objektivisht në tekst nuk ka gjasa që të ekzistojnë. Është fjala për marrëdhëniet midis priftit të rremë (Votrenit) dhe (Lysjenit). Autori i ka menduar këto marrëdhënie, si marrëdhënie at – bir. Nuk ka në tekst të dhëna të tilla që ta sugjerojnë kalimin e caqeve të miqësisë. Prandaj kritikët duhet të tregohen të kujdesshëm në ndërtimin e tekstit. Ka raste që personazhet e Kostës analizohen përmes optikës së një personazhi tjetër. Në rastin e Anikës është halla, në rastin e babait është djali, në rastin e Ramniut është mësuesi dhe babai. Konçiziteti i veçantë, përdorimi i ajzbergut, mënyra e karakterizimit psikologjik të personazheve, paraqitja e fshatit janë tipare kryesore të prozës së shkrimtarit.

Në tregimin “Në vjeshtën e dytë” K. Kosta e gjykon personazhin e vet pa e paragjykuar, d.m.th., nuk e paragjykon por ia lë vendin lexuesit që të shprehë gjykimin e vet. Personazhin e Qebirit Koço Kosta e ka marrë nga një prototip real, të cilin e ka shndërruar në krijesë letrare.

Një personazh i goditur është “Njeriu i punëve të mira”, që mishërohet në figurën e L. B., një njeri i lidhur ngushtë me punën krijuese, e cila shoqërohet me modestinë e natyrshme të njeriut të thjeshtë, por me botë të madhe, duke ia kundërvënë njeriun e aftë dhe aktiv një njeriu të plogët dhe të talentuar si mësuesi i vizatimit. Ky tregim është nga ato krijime në prozë në të cilën Koço Kosta përdor mënyrën e kontrastit, në këtë rast figura merr dritë nga kontrasti me ngjyrën e kundërt. Por edhe në krijimin e këtij personazhi të fundit ka kompleksitet. Po të përdorim këtë metaforë, është një figurë ku në ngjyrën e hirtë, ka dhe nuanca të bardha. Për një autor modern, respekti për lexuesin është veçori tipike që nuk ia jep të gatshëm publikut/lexuesit ushqimin artistik dhe nuk i mban personazhet e vet vetëm me ngjyrën bardhë e zi.

Ky është realizimi më i veçantë i autorit ku dhe gjejmë rrëfime në formë personazhesh. Madhështia e thjeshtë e këtyre njerëzve zbulohet nëpërmjet një situatë, një veprimi. Në tregimet e Kostës ka dhe figura të tilla, në dukje të zakonshme, që nuk dallohen nga asgjë prej njerëzve të tjerë, duke mos shkëlqyer me mençuri a talent të jashtëzakonshëm, as duke kryer heroizma të bujshme që pranohen nga të gjithë, megjithatë, në thelb, dallohen për veti të larta. E tillë është figura e atij njeriu, i cili nga dashuria për shokun, arrin të djegë atë që kishte më të shtrenjtë, letrën e vet të dashurisë, dhe e bën këtë sakrificë të pakrahasueshme në heshtje.

Një figurë të tillë e gjejmë në një tregim të përmbledhjes “Paradite me shi”. Këtij njeriu të thjeshtë por të lartësuar në vlera morale, i kundërvihet një personazh meskin dhe karrierist si Peposh Buzëbati, i cili, kur arrin synimet e veta karrieriste, ka paturpësinë të ndjellë thashetheme të ulëta për shokun e vet të dikurshëm të shkollës.

Nëse i rikthehemi figurës së Mëmës të “Dhoma e Dashurisë” ajo është një figurë thellësisht tragjike, që të sjell ndërmend tragjeditë greke. Ajo përjeton një tragjedi që ua kalon atyre tragjedive të cilat kishin në bazë të vet problemet ekzistenciale si dashuria ose vdekja, ose, në rast se trajtonin një problematikë qytetare, ishin më pak të ndërlikuara, prandaj u ngjan disa personazheve të romaneve moderniste. Kjo grua ka humbur edhe emrin e vet që e identifikon si individ. I biri është munduar të arratiset në perëndim, por është kapur dhe është vlarë nga sigurimi, i cili e mban të fshehtë vdekjen e tij, për t’ia torturuar shpirtin kësaj nëne tragjike.⁹⁵

Kuptimplotë është edhe ajo çka shpreh një personazh nga grupi që i ka zënë nata në mal. Thënia “E marrosëm”, është thënia që e ndryshon vetën e tretë shumë, duke e kthyer në vetë të parë dhe duke pranuar përgjegjësinë kolektive, një pikë (nevrallgji) kjo, në kohën e diktaturës. Është jetërisimi i njerëzve nga diktatura, që u zhdukte atyre çdo ndjenjë njerëzore, kështu që njerëzit në vend që t’i ndodheshin pranë gruas së braktisur nga i biri, e dënuan atë për “krimin” politik të djalit të saj. Mëma është njeri i gjallë që përjeton një tragjedi.

Një figurë e ngjashme me Mëmën është Maze Llakatura, që jeton dramën e jetërisimit të fshatarëve nga diktatura, e këputjes brutale të lidhjes së tyre me tokën dhe me kafshët. Ai gjendet në një shtëpi tashmë pa dele, pa dhi, pa një lopë, pa një viç. Personazhi jeton një moment të vështirë të përcaktuar nga politika e gabuar/mbrapshtë e partisë për tufëzimin, që pati pasoja të rënda/rrënuese ekonomike. Po autori e sheh atë në rrafsh kryesisht shpirtëror, më parë se ekonomik. Prozatori ka krijuar një personazh të tillë në sajë të objektivitetit të tij ndaj kontradiktave të realitetit, si, për shembull, “Çuk! Çuk ! Çuk! Me nder ta dhashë shpirtin në dorë! Ma rrëmbeve”, - pohon Maze Llakatura.

Autori arrin të ndalet bindshëm në ndjenjat e bukura njerëzore që e karakterizojnë njeriun e thjeshtë, ku as varfëria, as shtypja e partisë-shtet, s’kanë mundur t’i çrënjosin dot karakterin. Një figurë tërheqëse është ajo e stomatologes në tregimin “Bukuria”, e cila, nën sfondin e ujërave të pastra të bjeshkës puthet me të dashurin në rërë. Ky tregim liriko-poetik, qëndron si një ishull i veçantë poezie në përmbledhjen me ngjyrim dramatik “Paradite me shi”. Dashuria mallëngjyese e njerëzve për qeniet e tjera të gjalla spikat te tregimi “Qeni i Maze Llakaturës”, ku njerëzit i qëndrojnë pranë qenit besnik Zib, të cilit ia ka nxjerrë jashtë të përbrendshmet derri i egër, e qepin dhe e ushqejnë me lugë si një pjesëtar të familjes së

⁹⁵ Koço Kosta. “Paradite me shi”. Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1991, f 144.

tyre. Pra, në tregimet e K. Kostës, me temën e fshatit ndërthuren patosi heroik, romantik, tragjik dhe dramatik. Personazhet, më tepër se tipa realë me mish e me kocka, kanë valencë simbolike. Në fakt, ata shprehin krizën e identitetit të njeriut, pasqyrojnë personazhin në diktaturë dhe aspiratën e një realizmi magjik.

Këtu mund të kujtojmë një vlerësim që lidhet me këto tipare që shpalosin këto figura: “Ndonëse veprojnë në situata reale, ato ngjajnë së tepërmi për nga guximi dhe zgjuarsia me personazhet e legjendave dhe përrallave, gjë që dëshmon mbështetjen e shkrimtarit në krijimtarinë e pasur të popullit dhe shkrirjen në të”.⁹⁶

Këtë tipar Koço Kosta do ta kishte të afërt me Kutelin, megjithatë, sikundër kemi vënë re, personazhet e Kostës janë të formatuar në mënyrë më konkrete dhe më komplekse. Shkrimtari, përveç karaktereve, arrin të vizatojë me mjeshtëri edhe mjedisin, duke e funksionalizuar atë në raport me sjelljet e figurave të personazheve. Arrin të zbulojë gjithashtu poetiken, filozofiken në të thjeshtën, të zakonshmen.

Në personazhin e Anikës, në një nga tregimet, vizatohet etja për dashuri dhe lumturi, e cila ndeshet me paragjykimet patriarkale të kohës, atëherë shumë të forta, por që edhe sot vazhdojnë të ndihen, por sigurisht nën një veshje moderne. Etja e natyrshme e vajzës për jetën, si ndjenjë që përcillet me simpati nga shkrimtari, ndërthuret edhe me një lloj pranimi të heshtur të paragjykimeve që e shtypin personalitetin e saj dhe që e ndalojnë të kërkojë vetë lumturinë përmes një martese me dashuri dhe të zgjedhë vetë shokun e jetës. Koherenca mes veprimeve të personazhit dhe identitetit të tij, është kushti kryesor i programit narrativ që përvijohet në vepër. Protagonistja ka në vetvete shumë çiltërsi, mirësi e thjeshtësi, po asaj i kërkohet të mishërojë idealin patriarkal “të vajzës së mirë”, që pret me nënshtrim t’ia gjejë fatin familja, dëshira e saj e natyrshme dhe jetësore, familje dhe amësi, ndërthuret me një lloj nënvleftësimi për veten, për thelbin e vet njerëzor, me vështrimin e martesës jo të lidhur, me ndjenjat e natyrshme të dashurisë dhe të dëshirës, por si i vetmi realizim i mundshëm jetësor për gruan. Ajo i trembet fatit të gruas pa burrë të së ashtuquajturave “vajza të mbetura”. Kjo është dhe nevoja që e shtyn personazhin e K. Kostës të veprojë dhe të kushtëzohet nga mjedisi, të veprojë në mënyrë koherente me botën që e rrethon. Pra, me Anikën Koço Kosta na jep një karakter kompleks, ku ndërthuren tiparet e shëndetshme të dashurisë për punë, dëlirësisë, thjeshtësisë me paragjykimet e thithura që fëmijë nga mjedisi. Shkrimtari shpreh aftësinë e vet për të krijuar karaktere reale dhe psikologjikisht të besueshëm dhe këtu shkëputet nga koncepti i pranuar në atmosferën e kohës, që e vë shoqëroren mbi individualen dhe i rrafshon karakteret duke iu përmbajtur këtij portretizimi.

Kështu, Anika e tregimit hyn përmes dialogut dhe portretizimit fizik dhe figura e saj ravijëzohet nëpërmjet optikës së hallës së saj. Bëhet fjalë për një shoqëri patriarkale që i përbuz vajzat që nuk martohen. Fizikisht Anika përshkruhet si jo aq e bukur, e paktë në trup, e gjatë dhe e hollë, si një thekër e egër, me sy të përhimët, një vajzë e thjeshtë që s’bie në sy, jo e përkëdhelur nga natyra, që ka vetëm diçka të bukur, “flokët” që i dridhen supeve, por nga ana shpirtërore përkufizohet me një epitete shprehës “gojëmjaltë” dhe me një krahasim të tillë “si engjëll”. Nëpërmjet dialogut del në dritë sinqeriteti i saj që nuk pranon as shtirjen më të

⁹⁶ Jorgo Bllaci. *Një libër jashtë skemës*. (Koço Kosta, “Paradite me shi”). Në: “Drita”, 28 qershor 1992, 3-4.

vogël në frazat e shkurtra kuptimplote, “s’më pëlqen”, “nuk dua as..” (ajo donte të thoshte: “Nuk dua as burrë”), që shpreh neverinë e saj për të dalë “si në pazar të kafshëve”, për të gjetur me mblesëri “fatin” e saj. Ajo ndjen neveri edhe nga sjellja dinake dhe naive e hallës së saj, që i vesh gjashtë palë çorape që të duket më e bukur, me “këmbët e mbushura”, meqenëse kësaj gruas thashemexhie ia kanë sharë këmbët e holla dhe më vonë i heq çorapet e mbuluara në mënyrë që kunata e dhëndrit, “dhelpër”, të mos e zbulojë dredhinë.

Në fakt, sipas mendësisë patriarkale bukuria e gruas duhej parë në aspektin e saj fizik, jo në atë shpirtëror. Por dhëndëri i ardhshëm me të cilin shkëmbejnë më pak fraza, duket se e ndjen instiktivisht bukurinë shpirtërore të vajzës, ndonëse ajo flet fare pak dhe nuk guxon të shprehë simpatinë ndaj tij, duhet t’i përgjigjet hapur pyetjes së tij se a e do. Ajo e shpreh pranimin e vet në një frazë lirshëm: “Si të thuash ti”, ku shpreh nënshtrimin e vet ndaj farefisit, por dhe ëndrrën e saj naive dhe të thjeshtë për të krijuar familje. Bota e gjerë shpirtërore e Anikës, duket edhe në qëndrimin e saj ndaj komunitetit të njerëzve me ngjyrë, jevgjve, për të cilët thotë: “Gjynah, moj hallë, janë të mirë, pse t’u themi jevgj?”ose, në pyetjen naive për kunatën e dhëndrit: “Pse të jetë dhelpër?”⁹⁷

Çiltërsia e saj është e tillë sa ajo nuk thotë as edhe një gënjeshtër naive, si të thoshte duke u përkëdhelur që s’kishte ftohtë. Gëzimi i saj për krijimin e familjes së ardhshme, shprehet vetëm përmes një detaji: “mu lagën sytë”.

Dademadhja është mishërimi i filozofisë popullore me dashurinë për jetën dhe njerëzit, një zemër rinore që mbijeton edhe në moshë të viteve nëntëdhjetë e ca vjeçe. Ky personazh portretizohet nëpërmjet dialogut dhe monologut, në monologët e saj zbulohet bota e saj e brendshme, e bukur dhe e thellë, ku dashuria për punë është bërë një me shpirtin e saj, e cila lufton me moshën e madhe. Citojmë: “Atëherë kishte shumë kohë që më thërrisnin Dademadhe. Vetëm djali më fliste Mëmë. Kur ne flisnim Dademadhe, unë mërzhitesha, sikur të më thoshin që të mos dilja në punë, sikur të më thoshin që të rrija pranë vatrës dhe të piqja misra për nipçet. Unë vërtet ecja përkulur, por e bëja punën dhe natën, bëja gjumë të mirë. Katër net, një pas një, nuk më lajmëruan për punë dhe unë i thashë nuses se doja të shkoja në punë. Ajo më tha se tani duhet të çlodhesha në shtëpi, ndërsa djali foli prerë: Jo mëmë, rri në shtëpi. Por unë dola mbrëmjen tjetër dhe prita derisa erdhi në mëhallë. E kërkova nga fanella dhe ajo qeshi dhe tha: “Të veja të prashisja qepë. Në mëngjes zbrita në fushë”.⁹⁸

E pra, vitaliteti i këtij personazhi shfaqet edhe në episodin e pazakonshëm të veshjes së saj si nuse në moshë të madhe. “Më veshën nuse, po unë isha aq e moshuar, sa shpina më ishte thyer dhe zbukurimet e nusërisë shikonin në truall. Edhe herën e fundit e pata vështirë me babanë.”⁹⁹

Veçse pastërtia shpirtërore e Dademadhes shoqërohet me një paaftësi të çuditshme për ta kuptuar të keqen, një naivitet që e bën atë të besojë Buzhel Zherdin, që do ta manipulojë në kohën kur ai është në rrezik të demaskohet. Dademadhja i vlerëson lidhjet familjare, andaj e pranon si nip këtë djalë kushëriri dhe meqenëse e njeh nga fëmijëria nuk mund ta pranojë shpërftyrimin e tij, beson me naivitet se ai është i pafajshëm dhe duan ta dënojë padrejtësisht, kështu që, me ndjenjën e saj të drejtësisë, pranon të flasë në mbledhje për ta

⁹⁷ Koço Kosta. *Dademadhja*, Naim Frashëri, Tiranë, 1976, f. 187.

⁹⁸ Po aty, f.190.

⁹⁹ Po aty. f.73.

mbrojtur. Këtu, na del një veçori e K. Kostës, pasqyrimi dialektik i karakterit të personazhit, pasqyrimi i tij në evolucion. Veçse, kur i hapen sytë dhe zbulon të vërtetën për dallaveret e tij, ajo vepron me guxim në mënyrë të kundërt, duke e befasuar atë që donte ta manipulonte dhe farefisnin. Dademadhja karakterizohet edhe nëpërmjet fjalëve së autorit, domethënë rrëfimtari tradicional të gjithëdijshëm. “Ishte ngritur midis tyre figura e dashur dhe e shtrenjtë e nënës, ishte krijesa e pashoqe, mëma më e rëndësishmja, nga gjithë ç’ishin zhdukur e jetonin. Ajo tani s’ishte vetëm një kujtim. Ishte një pus i thellë dhembshurie e dashurie dhe duke qenë aty midis tyre, u kujtonte se ishte, se merrte frymë dhe kollitej nga të ftohtat e hershme, se do të ishte dhe s’do ta gënjenin kurrë”.

Janë dy momente që shprehin thelbin e kësaj figure aq tërheqëse dhe paradoksale prej nëne fshatare shqiptare: momenti paradoksal kur një fëmijë pohon për të se është “dymijë vjet” dhe çasti kur ajo nis të thithë ajër të pastër me tërë mushkëritë dhe “në sytë e gjallë” të saj veson një “mëngjes fshatar”.

Karakteristikë është vegimi i saj kur i shfaqet vigani legjendar Guva, që dhe pohon: “Dua të bluaj Buxhel Zherdin”.

Një personazh po ashtu tërheqës popullor është Puravel Duka, një njeri që “s’plaket kurrë”, i lidhur me punën, natyrën dhe kafshët, i guximshëm dhe me një ndjenjë të natyrshme humori, që kur e pyesin “Si flet kështu ti”, - të përgjigjet natyrshëm, - “ashtu si këndon zogu”.

Autori vizaton edhe portretin e tij fizik, “...kishte fytyrë të butë dhe ballë të lartë si poçe. Sytë i kishte të vegjël dhe me rrudha, hundë të shtypur dhe mbi buzën e sipërme mustaqet i ngjanin si një njollë me bojë zmalto gri. Kishte buzë të trasha tallëse dhe qafë si të kaut. Ndërsa barku i tij ishte i madh e i rrumbullakët sa një fuçi”.¹⁰⁰

Ka detaje që shprehin qëndrimin e tij ndaj realitetit dhe ndjenjën e tij të humorit, që bëjnë pjesë në optimizmin e tij realist. Ky personazh portretizohet në tërë plotësinë e vet, në thelbin e vet individual psikologjik, që përputhet me thelbin e tij shpirtëror, si fshatar që e ka kaluar jetën e vet në varfëri dhe ka luftuar me guxim në këtë jetë.

“Sado që ta ushqesh ujkun, ai i kthen sytë nga mali... sikur nata është bërë që të jetojnë lulet, drurët, që të flasin sendet, ditët lëvizin me njerëzit, tha se do më sillte dy kalema hardhie. I solli. Ishin kalema të shëndoshë. I shartova. Njëri është zgjatur nja gjashtë metra, tjetri ka mbetur i hollë, i dobët si fëmijë i paarrirë. Kur hyn ai yll atje, më vyshket syri”.¹⁰¹

Në gjuhën e Puravel Dukës shprehet edhe një poezi e natyrshme, sado naive të duket në strukturat e saj figurative, por që janë të befta dhe tërheqëse për lexuesin. Humori i Puravel Dukës shprehet qartë në ballafaqimin e tij me ajrin e fshatit, kur ai bën sikur i është kapur veshi i prishur dhe pohon: “Me një vesh dhe s’i dëgjoj dot tërë këto të zeza, jo më të hapet edhe tjetri”. Filozofia optimiste e Puravelit shkrepiti edhe në pohimin e tij. “Njëllor janë pleqtë, nuk bëhen më të urtë, por më të matur. Unë jam akoma i ri. S’dua të plakem”.¹⁰²

Koço Kosta e njeht mirë psikologjinë e rinisë, por ai di të vizatojë edhe portrete fëmijësh dhe adoleshentësh me natyrshmërinë e çiltërsinë e tyre, por edhe me emocionet e thella që herë ndrydhen e herë shpërthejnë.

¹⁰⁰ Po aty, f. 125-127.

¹⁰¹ Po aty.

¹⁰² Po aty.

Një figurë e goditur fëmije është ajo e Ramniut, djali i vogël fjalëpakë e që mendohet thellë, që shpesh merr dhjetë kur të gjithë të tjerët janë të papërgatitur, turpërohet kur merr nota mesatare apo të ulëta, ashtu si një personazh tjetër, vajza e përkëdhelur me sedër të sëmure, Luljeta Krasniqi, nuk qan, veç po kontrollon çdo gjë në libër dhe e shfaq dashurinë e vet për mësuesin me një gjest delikat dhe të pazakonshëm, dhurimin e një luleje. Ky djalë nuk pranon që një kryetar burokrat t'ia kufizojë ëndrrat dhe pyet me sinqeritet të atin: “Pse më tha Shemshua ashtu? Edhe një vit dhe do të vish këtu ndër dhen; do të bëhesh çoban, bari? Pse nuk më tha: “Edhe një vit dhe të shkosh në shkollë të mësosh për delet”?”¹⁰³

Karakteristike është dashuria e tij për kafshët dhe bimët, që shprehet në episodin e qenit të keqtrajtuar, të cilin mundohet më kot ta shpëtojë, madje sëmuret nga dhimbja për të. Për vizatimin e këtij personazhi, Koço Kosta përdor teknikën e dy këndvështrimeve të ndryshme, portretizimin e tij nga mësuesi dhe nga vetë i ati (Po ti si thua?).¹⁰⁴

Një portret tjetër fëmije e gjejmë te tregimi “Babai”,¹⁰⁵ ku nëpërmjet rrëfimit të djalit, portretizohen njëkohësisht atë e bir, shumë të lidhur njëri me tjetrin, por me një dashuri burrërore jo sentimentale.

Disi i veçantë është fëmija i novelës “Pasi dëgjova këngën e një gruaje”,¹⁰⁶ i cili në fillim mishëron një viktimë të luftës së klasave të cilit nuk i japin nuse dhe e quan të pamëshirshme nënën e vet që nuk ia qan hallin djalit të hallës, i shoqi i së cilës nuk e do kooperativën, po më vonë ai magjepset pas nuses së bukur që i japin Vasos me mblesëri dhe e kupton dramën e kësaj vajze të martuar pa dashuri.

“Doja patjetër të ulërija me tërë fuqinë e zërit për ta shpëtuar nusen, sepse atë do ta rrëmbenin krijesat e zeza. Ata po turrehin dhe tani ishin mbledhur nëpër strehët e trarit të shtëpisë dhe diç kërkonin. Ndërsa nusja e bukur, e njomë, e thjeshtë, e afërt dhe e përmbajtur, me siguri shikonte ëndrra dhe buzëqeshte me pafajësinë e saj të madhe. Tani gjumi nuk më zinte dhe sytë nuk i mbyllja”.¹⁰⁷

Ky personazh jepet në dy momente të jetës së tij, si i mitur dhe si fëmijë. Por në fakt ne e njohim atë kryesisht nëpërmjet retrospektivës, me psikologjinë e tij si fëmijë.

Një tjetër tip interesant fëmije është protagonistin e tregimit “Unë shkula një kryq”. Këtë fëmijë e karakterizon dashuria e mallëngjyeshme për motrën, e cila vdes para kohe në mënyrë tragjike dhe revolta kundër klerit të korruptuar që shfrytëzon popullin. Në atmosferën e diktaturës, ky tregim mund të përfshihej në demonizimin e klerit dhe të fesë, megjithatë aty ka edhe diçka reale, dënimi i asaj pjese të klerit që pasurohej në kurriz të popullit, duke u tallur me dhimbjen e tij njerëzore. Elementet ndërtuese të veprës, të karakterizuar nga domethënia njohëse dhe logjike, përpunojnë atë sistem të pasur letrar si produkt sintetik i arsyes dhe kontribut i pavarur i njohjes së botës së personazheve. Protagonisti fëmijë me naivitetin e tij pret një “mrekulli”, që mund ta shpëtojë motrën, por nuk e pret atë mrekulli nga mjekësia apo shkenca. Veçse, kur sheh t'i shembet iluzioni i shpresuar nga vdekja e

¹⁰³ Po aty.

¹⁰⁴ Koço Kosta. *Tregime të zgjedhura*. “Naim Frashëri”, Tiranë, f.62.

¹⁰⁵ Po aty, f. 73.

¹⁰⁶ Po aty.

¹⁰⁷ Po aty, f. 183.

motrës dhe cinizmi i priftit, i jep një shpjegim tjetër kërcitjes së kryqit. Në tregimet e K. Kostës gjejmë edhe një galeri personazhesh, valenca e të cilëve është negative, po jo vetëm kaq, ajo përforcohet nga hipokrizia e cila na dyfishon ligësinë. Këto personazhe përshkruhen nga K. Kosta kryesisht me ngjyra satirike, janë njerëz me shpirt të vdekur, që shtiren si bartës virtytesh të cilat nuk i kanë, ato përbëjnë një galeri për të cilat autori nuk ka asnjë mirëkuptim, asnjë mishërim. Këto personazhe vizatohen përmes një patosi satirik.

I tillë është Peposhi i përmendur më lart me mosmirënjohjen e tij ndaj shokut të dikurshëm. Tërë karakteri i tij zbulohet në frazat e nënvleftësimit me të cilat përkufizon shokun. I tillë është Buzhel Zherdi, një bej i ri, i rritur në atmosferën e të ashtuquajturit socializëm, i cili shtiret si filantrop, si dashamirës i fshatit, të cilin e ka mbuluar, siç thotë, me të mira. Atë e përkufizon në mënyrë simbolike bariu i ri: “Në barkun e madh të Buzhel Zherdit blegërijnë delet tona, më-meeee...”.

Autori e ballafaqon këtë pohim që shpreh thelbin e personazhit me fjalët hipokrite me të cilat e përshkruajnë njerëzit e familjes së tij. E shoqja thotë për të: “U bë ëndërr nga të pagjumët... Mbeti luftërave, mbeti mes përgjegjësirave zyrave...Për këta përpiqet, që të rrojnë si njerëz. Kush e bëri fshatin kështu qytet?”¹⁰⁸

Motra e tij e vogël thotë: “Po bredh poshtë e lart. I iku mendja për këtë fshat. Puno natë e ditë e puno ditë e natë...doni shtëpi të re ? Na shtëpi. Doni shkollë? Na shkollë. Doni dritë elektrike ? Na radio, na dhe televizor. Na, na, na”...¹⁰⁹

Po këtyre fjalëve të mëdha e të fryra, autori ua kundërvë luksin e shtëpisë “sixhadetë me origjinë orientale”, të cilat e mbushin dhomën me personazhe të çuditshme, orenditë që nuk mbusheshin i çonin në fshat tabakaja, gotat dhe pjatat e vogla me llokume, të gjitha shumë të bukura, televizori, frigoriferi etj.

Mes vlerës njohëse dhe edukuese të artit të qëllimtë shkrimtari fuqizon strukturën organike të veprës edhe në rrafshin e shprehjes edhe në rrafshin e përmbajtjes. Këtu autori nuk e ngarkon lexuesin me narracion, por shumë momente i lihen që t’i mbushë me imagjinatë. Shkrimtari zgjedh edhe një detaj të vogël simbolik, detajin e allçisë, luanin të tërë me allçi mbi televizor, i madh, i verdhë dhe agresiv, që shikonte drejt sikur do të turrej. Ai e vizaton personazhin e vet në kohën kur rrezikon t’i humbasë të gjitha përpjekjet dhe e ka zënë frika, prandaj shfaqet si i trishtuar në qepallat e njomura dhe fytyrën e zbehtë, përpiqet të manipulojë gruan e thjeshtë e me zemër të madhe, kushërirën e vet “Dademadhen”, e përkëdhel në faqe, e puth në faqet e fishkura dhe synon t’i mbushë mendjen që ajo ta mbrojë në mbledhje, duke dalë si zëdhënëse e brezit të vjetër.

Kryesore është heroi, për të cilën shkrimtari ka derdhur frymëzimin e vet. Kjo zgjeron gamën problematike, shton larminë, sepse ndjehet nevoja për më shumë hapësirë dhe tregimtari futet në aksion, ka dialogë të shkathët e plot nerv, gjë që është mjaft pozitive se tek ndonjë autor, mania e dialogëve të vazhdueshëm e të zgjatur. Dialogu rrit shkathtësinë dhe dinamikën e tregimit dhe fjali fuqiplote si: “Në mëngjes hapa sytë, u kujtova se pashë një ëndërr të bukur”.

Të realizosh dhe të nxjerrësh në dritë disa prej elementeve mistike dhe t’i paraqesësh ato me elemente realiste është paksa e vështirë në atë mori personazhesh, karakteresh, stilesh,

¹⁰⁸ Po aty.

¹⁰⁹ Po aty.

mendimesh etj. Në tregimet e tij, autori nuk realizon një hetim të imët për gjithçka që ndodh mes personazheve, por thellohet në problemet shoqërore e morale të ditës, duke i dhënë përparësi studimit të karaktereve në kushtet e reja që shtron epoka moderne. Temat që preken mbeten aktuale, sepse dëshpërimi është pjesë e natyrës njerëzore. Temat e mëdha si: dashuria, jeta, vdekja, autori i sjell nëpërmjet një pështjellimi të ri ideo-emocional,¹¹⁰ ku simboli padyshim luan rolin e një çelësi *çudibërës* me të cilin autori shpalos fuqishëm njëmijë e një portat e librit.

Në tregimet e vëllimit “Bisedë në mesnatë”, si “Djaloshi që donte kuajt”, “Lule bore përmbi ta”, “Unë theva një kryq” planimetria e lëvizjes së personazhit u nënshtrohet ligjeve të brendshme artistike dhe kjo ka bërë që fati i personazhit të kundrohët deri në imtësi.¹¹¹

3.2 A mund ta quajmë prozë të karaktereve kundërvënëse prozën e Koço Kostës?

Dihet se jeta/proza e personazhit shëtit nëpër shpirtin e shkrimtarit, i cili, duke kërkuar vizionin e arsyes personale, i shtreson ndjenjat dhe veprimet. Kjo ka të bëjë me pozicionin e personazhit i cili përsëritet si refren, brenda novelës që i përmbahet kornizës reale. Novela, duke e zbërthyer moralin njerëzor, doemos e projektoi pozicionin e karaktereve kur shqipton kodin e shtresimeve shoqërore, raportin e dëshirës dhe arsyes. Këto situata janë ballafaqese në ambientin e zgjedhur dhe në karakteret tipike. Novela e përcakton vetëdijen e personazhit, duke spikatur natyrën dhe virtytet shpirtërore të tij. Mbase, pikërisht për këtë qëllim, zbulohet edhe prapavija e veprimeve për karakteret e tjera që gjenden në pozicionin e figurantit. Në këtë vepër, shkrimtari rrëfen nga perspektiva e personazhit narrator, por që nuk e fsheh edhe prezencën e perceptimit nga këndi i kohës kur rrëfëhet ngjarja, apo dhe nga këndi i së tanishmes autoriale. Vetë fazat e rrëfimit të ngjarjes lidhen me detajet që dëshmojnë ndërhyrjen, por jo si zhvendosje e rrjedhës së rrëfimit. Ruajtja e ecurisë së natyrshme, përputhja me rrjedhën kohore dhe aftësitë perceptuese në këto vepra, mund të ilustron me detaje të bollshme. Një detaj i tillë është dhe shpalim-komunikimi i botës së brendshme të personazheve. Kjo do të thotë se autori vrojton, percepton dhe rrëfen në përputhje me këtë ecuri kohore, përkatësisht vetëdijesore. Çastet e rrëfyera që rrjedhin në procesin gjatë leximit, nuk na përvetësojnë për përshtypjen e fuqishme të ngjarjes, por për atmosferën e krijuar, për gjallërinë dhe lehtësinë e konceptit të kësaj atmosfere. Kuptohet, se sa më e thjeshtë të jetë fabula, aq më mirë është.

Nëse flasim për tregimin, do të thoshim se ai shënoi një ngritje të vrullshme të vlerave ideoartistike. Prodhimi letrar i periudhës në fjalë shquhet për rritje cilësore.

Sikundër dhe është shprehur në studime, “Tregimin e dallon shumëllojshmëria e mënyrave që tregimtarët vështrojnë jetën, thellësinë dhe individualitetin e tyre artistik”.

¹¹⁰ Mehmet Myftiu. *Dashuria e burimeve të jetës*. Në: M. Myftiu, “Ese, poezi, dokumenta të letërsisë”. Tiranë: Marin Barleti, 1998, f. 85 - 89.

¹¹¹ Koço Kosta. *Bisedë në mesnatë*, “Naim Frashëri”, Tiranë 1971.

3.3 Determinimi i personazheve nga syzheu (Tipizimi dhe individualizimi)

Koço Kosta i krijon personazhet e veta nëpërmjet një procesi të gjatë tipizimi, duke pasur një prirje për t'u mbështetur në prototipa realë dhe duke u munduar t'u fshijë atyre tiparet e rastësishme për të kaluar natyrshëm/bindshëm në tiparet karakteristike për tipin shoqëror që pasqyron dhe për t'i riformuar ata, duke u dhënë tipare të veçanta. Këtu mund të përmendim thelbin e një pohimi të njohur të Umberto Eco-s se: "Nëse personazhi nuk është konkretisht individual në çdo veprim të tij, atëherë nuk është një personazh artistikisht i arrirë".¹¹²

Mënyra e trajtimit dhe strukturimit të elementeve artistike, konstituimi i poetikës në përgjithësi është shumë i afërt dhe i ngjashëm edhe me romane të tjerë që ne na kanë rënë në dorë. Kujtojmë këtu, romanet e Sterjo Spasses, Fatmir Gjatës, Ali Abdihoxhës, Nazmi Rrahmanit etj. Padyshim që bazë e ndërtimit të tyre është fabulacioni, ndërthurja e të ndodhurave si konvencë letrare dhe që ka për qëllim një gjendje në një kohë dhe hapësirë të caktuar. Në dimensionin e kohës mbetet dhe zhvillimi i kompozicionit, ku ndërthuren dhe linjat problemore të konflikteve. Personazhet determinohen nga ky zhvillim dhe i shërbejnë paraqitjes së gjendjes së brendshme.

Dihet se kompozicioni nuk është asociativ dhe nuk konstruktohet paraprakisht nga një vetëdije qendrore autoriale, pasi ai ngjizet, rrjedh e formatohet në procesin e krijimit, ku idetë e gatshme autoriale mund të zbehen apo edhe të humbasin për t'u shfaqur të tjera, mbase dhe fare të paparashikuara. Prandaj dhe fatet e personazheve nuk janë bosht i strukturës, por u nënshtrohen të ndodhurave, ku ata kanë për pasojë zhvillimet e veta progresive apo regresive, sipas rastit. Kjo mënyrë e paraqitjes, sigurisht që nuk mund të kuptohet e shkëputur nga perspektiva e vetëdijshme e narratorit, edhe pse personazhi është element dominues i strukturës dhe që mund të përcaktohet ose projektohet sikur *ecën në qejf të vet*, nëpër rrjedhë të ngjarjeve të rrëfyera. Personazhet iu nënshtrohen të ndodhurave të përgjithshme dhe shërbejnë si një lidhje për të ndërtuar situatën e tërësishme. Narratori nuk është konceptuar në botën e tij subjektive apo në analizën e brendshme dhe konkrete. Ka personazhe që janë dhënë të zbehtë, por ka personazhe që në mënyrë dinamike shfaqin bazën e konfliktit shoqëror. Koço Kosta, jo pa qëllim, ka pasur për synim të trajtojë një atmosferë të mirëpërcaktuar shoqërore, sikundër është bota e fshatit. Një dominim i tillë, bën që edhe personazhi të jetë pjesë natyrale e këtij areali socio-letrar, duke mbartur tërë ato elemente që e bëjnë pjesë integrale të tij dhe sidomos e bëjnë të jetë i besueshëm në tërë specifikat që mbart si figurë letrare.

Në veprat e tij bëhen përpjekje që të shtjellohen shumë probleme që duket sikur në pamje të parë kanë vetëm portretizim bardhë e zi të ngjarjeve dhe personazheve. Lufta në mes dritës dhe errësirës, duket sikur është e përhershme; në aspektin ideor dhe social ky motiv në veper konstituohet gradualisht në zhvillimin e vetëdijes së personazheve dhe kjo vetëdije e personazheve rezulton të jetë tërësisht e motivuar.

¹¹² Umberto Eco. *L'uso pratico del personaggio*. Apocalittici e integrati, Bompiani, Milano 1990, f.191.

Tek libri “Bisedë në mesnatë” autori ka tërhequr vëmendjen e lexuesit për tematikën e larmishme dhe grishëse e provokuese të krijimeve të tij, kryesisht nga jeta e fshatit, për problemet e mprehta që ngre dhe freskinë e materialit jetësor. Pra, në tërësinë e vet, “Autori ka ditur të vërë në bazë të krijimtarisë e ta forcojë pareshtur, njohjen konkrete, të shumanshme, të atyre njerëzve për të cilat merr përsipër barrën e përgjegjësisë për të shkruar”.¹¹³

Vlen për të theksuar se edhe në romanet e tij autori është treguar i fuqishëm për sa i përket individualizimit dhe tipizimit të personazheve, saqë ndonjëherë në veprat e tij, ashtu siç ndodh jo rrallë në veprat e autorëve të tjerë, një ndërthurje e zhvillim zinxhir në situatat midis personazheve, apo një degëzim i shumëfishtë i fabulës, si një tendencë e paraqitjes së gjerë të skenave dhe lëvizjeve të personazhit, dominon në këto vepra. Nëse i referohemi novelës “Ata të dy dhe të tjerë”, mungesa e prezantimit metaforik dhe asociativ, është kompensuar me përshkrime konkrete dhe paraqitje që krijojnë parafytyrime të qarta. Vetë mënyra e trajtimit është adekuate dhe kjo është në përputhje me kohën, ambientin dhe hapësirën. Këtë veçori e kemi vënë re edhe në veprat e shkrimtarëve të tjerë. Një mënyrë e ngjashme e strukturimit të elementëve, duke përshkruar gjendjen me mjete të narracionit dhe në ndërtimin e personazhit asisoj si bartës kryesor të ngjarjeve, situatave dhe figurave lëvizëse, ku gërshetohen planet e strukturës apo linja e subjektit, ndodh edhe në këtë roman, i ndërtuar me një strukturë të qëlluar.

Sqarojmë se, që në fillim të romanit, përmes një deduksioni përshkruet jepen situatat e personazheve. Secili element i strukturës është konstituuar në atë mënyrë që të mos e cenojë harmoninë e tërësishme të veprës. Kjo do të thotë që dhe distanca e narratorit, fabula, syzheu apo kompozicioni, kanë një rrjedhë dhe zhvillim të njëtrajtshëm përkundrejt gjerësisë së paraqitjes së këtyre personazheve, të cilat shkrimtari i tipizon dhe i individualizon me sukses.

Ka pjesë ku në vepër rikrijohet situata nga autori-narrator në bazë të bisedave me personazhin.

Atmosfera e jashtëzakonshme në të cilën ndodhen personazhet, jepet me situata nga më të ndryshmet, ku, falë mënyrës së rrëfimit, kalon edhe tek lexuesi. Ndodh që rrëfimtari e karakterizon personazhin, por personazhi edhe vetëkarakterizohet. Kështu, bisedat e personazhit narratori i jep përmes dialogut, që herë i thotë vetë, herë personazhi ua kumton të tjerëve. Rrëfimi nuk karakterizohet nga tensioni apo ritmi, ku dhe dinamizmi është shumë i shpejtë.

Në vijim të mendimeve më lart, theksojmë se tematika e prozës së tij është e një rëndësie të veçantë. Edhe pse tema në vetvete nuk përcakton vlerën artistike të një vepre, ajo është përbërës gjithsesi shumë i rëndësishëm. Jo pa qëllim, duke trajtuar tema të tilla, autori dëshmon se nuk mund të qëndrojë mospërfillës ndaj ngjarjeve që kishin ndodhur në të kaluarën e afërt, por që dhe në kohën e shkrimit të veprave kthehen në ngjarje që autori e shtrin në të tanishmen. Shkrimtari i vë personazhet në pozita të ndryshme tregimtare, sepse dimë fare mirë që në disa prej tregimeve të tij personazhet nuk i krijojnë situatat, por ndodhen në situata të caktuara, situata të cilat shpërfaqin në mënyrë të plotë personazhin. Parë nga ky

¹¹³ Bashkim Kuçuku. *Vendin e parë njeriut të tokës*. (Koço Kosta, “Dademadhja”, Tiranë: “Naim Frashëri”, 1976). Në: “Nëntori”, nr. 8, gusht 1977, f. 144-154.

këndvështrim, autori u shmanget situatave që mund të tingëllojnë “të stisura” artificialisht, situata që i krijojnë personazhet në mënyrë që të vetëdëshmohen.

Mjafton të kujtojmë vëllimin “Paradite me shi”. Nëse në ditët e atëhershme disa personazhe tingëllonin si krijesa artificiale të stisura, e vërteta është që ky vëllim paraqitet i freskët dhe me vitalitet. Kritika e ideologjizuar e asaj kohe, e kishte humbur nuhatjen për të dalluar freskinë e jetës nga artificialiteti i skemës.

Sipas Trim Gjatës: “Ajka artistike e vëllimit janë: “Gizdar Lloguri”, “Bukuria” dhe veçanërisht “O vendi im”, që është një perlë e vërtetë dhe ku zbulohet nektari i jetës fshatare”.¹¹⁴

Të mos harrojmë se botëpërjetimi dhe botëkuptimi i veprave nuk varet nga autori, edhe pse nuk duhet të harrojmë se disa prej tyre përfaqësojnë idetë e autorit, lexuesi i interpreton veprat me syrin e tij.

Prej llojeve të prozës romani i personazhit është tipi që është standardizuar dhe stabilizuar në letërsinë tonë. Kronologjia, si parim kompozicional, e strukturon organicitetin e fabulës. Autori dhe lexuesi i kanë plotësisht të qarta funksionet e personazheve, kurse ndarja kategorike në bardh e zi të tyre vjen si rrjedhojë e natyrshme e modelit didaktik-iluminist të letërsisë, e cila ka për qëllim që veprimet e figurave t’ua sjellë lexuesve të vet si shembuj të gatshme e klishe të veprimeve, të sjelljeve, të gjesteve pa marrë parasysh se ato kanë vepruar në rrethana të ndryshme. Përmes krijimit të paradigmave të sjelljes dhe të veprimit, vetë letërsia ka për objekt dhe ideal të vetin përsosmërinë dhe lartësimin e ndërgjegjes së personazhit. Vetë konceptimi i këtyre personazheve (një konceptim artistik ky), është shprehje e konceptit dhe qëndrimit glorifikues, në mënyrë që personazhet të shfaqin ngjarje sa më të ndritshme, të zhveshura pothuaj nga të gjitha të metat dhe veset e ndryshme të njerëzve, thua sikur ata të jenë manekinë të parafabrikuar në laboratorin krijues të autorit dhe jo figura të gjalla, duke u prezantuar të besueshëm e ndikues tek lexuesi.

Po të shikojmë fillimet e veprës, përmes një deduksioni përshkruar jepen situatat e personazheve. Kjo situatë që intensifikohet me të ndodhurat e reja të jashtme të veprës, vjen e koncentrohet në shqetësimin që përmbush çdo personazh. Kuptohet se futja e elementeve të tjera, lidhet me përjetimet e kësaj figure. Rrjedha e fabulës shfaq linjat që kapërthehen ndërveti, duke sajuar episode që nxjerrin në shesh fatin e personazheve. Gjendjet e personazheve përplotësohen me kolizionin dhe nga situatat midis personazheve të shumta e të ndryshëm dhe kjo bën që fabula të degëzohet në një varg situatash që trajtohen përmes skenave dhe tablove të ndryshme. Bota e personazhit formësohet në relief dhe ku vëmendja është e përqendruar në fatin individual të personazheve kryesorë. E gjithë atmosfera në vepër është dhënë me mjete autentike të stilit dhe poetikës. Mund të sjellim mjaft shembuj ilustrues, apo të perifrazohen momente të ndryshme rreth faktit se autori, përkatësisht me situatat, episodet, pamjet, tablotë apo detajet, me disponimin dhe gjendjen e personazheve, ka gjetur edhe shprehjen, edhe figurën e goditur. Pamjet, skenat, figurat, përfaqësojnë lëndësinë e trajtuar, të cilat përgjithësohen artistikisht. Ndonjëherë tregimet dhe novelat e shkrimtarit, veças ato me temën e fshatit, kapin natyrën e dyzuar në trajtimin e realitetit.

¹¹⁴ Trim Gjata. *Që të mos ketë më “shaka të rënda” me jetën e fshatarësisë.* (Mbresa nga vëllimi: “Paradite me shi” i K. Kostës). Në: “Zëri i popullit”, 21 dhjetor 1991.

Diku theksohet "...unë e di mirë, - thotë heroi i romanit "Buka e një stine me borë", - se, që të shkruhet një libër për këtë realitet, duhet mençuri, guxim dhe vullnet i vërtetë. Këtu ka heroizëm, ka dramë gjithashtu. Ti thua, a do t'i tregoja në këtë libër këto vështirësi? Patjetër... Nuk e shikon ç'kohë të mëdha po jetojmë?"¹¹⁵

Në karakterizimin e Pelik Badunit, të Pandi Gaxhonit ("Buka e një stine me borë"), autori ka dhënë bukur tipin e njeriut të thjeshtë që vihet në krye të punës. Pelik Baduni, ndonëse i përmbahet skemës së "kthimit në fshat", është një figurë e gjallë, një tip shoqëror dhe një personazh i individualizuar, që spikat dukshëm në roman. Na jepet në mënyrë mjaft bindëse ky personazh, si njeriu që nuk njeh lodhje, që është sa agronom aq edhe poet në shpirtin e tij.

Po t'i rikthehemi kapitullit të nëntëmbëdhjetë, autori na kujton ditët kur ai ishte kryetar. Citojmë: "Ata të dy ishin ulur në kuzhinë pranë sobës dhe gjer vonë në mëngjes, kur kishte kënduar kokoshi i vetëm ilegal i lagjes, ai i betohej asaj se do të punonte mirë dhe me ndershmeri. Ai e tha shumë herë atë premtim. Aq herë në jetën e tij s'kishte përsëritur gjë tjetër. Pastaj ajo filloi të trembej për detyrën e re që i kishte ngarkuar të shoqit. Dhe shikoi perdet. Errësira e natës që përgjonte te parvazët".¹¹⁶

Edhe Mëmëlalja e kuptoi të vërtetën e jetës së sotme, kur mendon: "Çudi e madhe e ç'gaz gjen ky njeriu ynë"...¹¹⁷

Këtu kemi shkrirjen e reales me imagjinaren dhe synimi kryesor dhe i paanshëm i shkrimtarit është pasqyrimi i figurave për të krijuar një mori të tërë portretesh dhe karakteresh me një teksturë të pasur me tone realiste. Me nota realiste ndeshim të pasqyruara mjedise pune, si dhe një mori ambientesh të tjera nga jeta sociale dhe personale e njerëzve.

Ja si vlerësohet përmbledhja e librit "Paradite me shi" për pasqyrimet me rrokje gjithëpërfshirëse të botës së njeriut: "Këtë libër e lexova shumë vonë. Ka dalë në fillim të viteve '90. Midis kryedetajit dhe kryeepisodit të librit, lëviz krejt rruzullimi shqiptar. Shkrimtari nuk ka kohë të vdesë. Shkrimtari, i mallkuari i të gjitha kohëve, ka thënë dikush..."¹¹⁸

Duket se autori mundohet të realizojë figurën komplekse të njeriut të thjeshtë, që lufton me kthetrat e egra të jetës për të tentuar të mos humbasë. Një "luftë" e tillë mund të shkaktojë gjithçka, prandaj është pikërisht ky lloj karakteri¹¹⁹ që mbizotëron pothuaj në të gjitha prozat e këtij autori.

Karakteristikë e veçantë e shkrimtarit për të karakterizuar portretin e personazhit janë dhe pasionet që i kalojnë skajet e arsyes, ndjenjat që nuk pyesin për logjikë, që në tërësi iu referohen brezave të tërë lexuesish. Gjuha e personazhit të veprës nuk përfaqëson në vetvete riprodhimin direkt dhe fjalë për fjalë të gjuhës së këtyre apo atyre personave të jetës.

¹¹⁵ Razi Brahimi. *Vlagë jete, romani "Buka e një stine me borë" i K. Kostës*. 3 shkurt, 1980, botuar në gazetën "Drita".

¹¹⁶ Koço Kosta. *Ata te dy dhe të tjerë*, Tiranë, 1994.

¹¹⁷ Po aty.

¹¹⁸ Mehmet Elezi. *Shkrimtari nuk ka kohë të vdesë: (Paradite me shi)*. Në: "Drita", 16 shkurt 1997, f. 14.

¹¹⁹ Quhet karakter në veprën letrare, figura letrare e njeriut me tipare individuale të shprehura qartë, të përshkruara në mënyrë të plotë dhe të përcaktuar.

Duke qenë se vizioni subjektiv i autorit ka funksion formativ, modelues në strukturimin kompleks të botës, vizioni dhe ndjeshmëria e autorit është më e madhe. Peposh Buzati është një figurë më se reale, e qëmtuar me mjeshhtërinë e autorit deri në hollësi, është pjellë e shoqërisë shqiptare që nuk kishte jetuar njeriun e ri, pra krijimin e njeriut të ri, fabrikimin e Peposhëve, të cilët për shumë vjet mbizotëruan mbi fatet e shokëve të tyre.

Në gjithë jetën për shkrimtarin kronikohet e shkuara e jetës së tij. Ajo që na bën më shumë përshtypje është fakti se vepra në fjalë jep të qartë një peizazh ku përshkruhet me hollësi se deri ku shkon ky lloj absurditeti - duke shkuar konkretisht deri tek personazhi i Shoshosë, i cili, i penduar dhe i vrarë shpirtërisht, i vetëvrarë psikologjikisht dhe fizikisht, është mishërim i cenimit të rëndë moral e njerëzor përgjithësisht.

Kurse në anën tjetër, del personazhi i Gavrililit, me sandalet e tij të varura në një pemë, një simbolikë kjo, tepër e bukur dhe e dhënë me detaje të goditura bukur nga autori. Padyshim, këtu dëshmohet sërish fakti se shkrimtari është mjaft i drejtpërdrejtë në ato që shkruan, i thjeshtë dhe i qartë në ide, apo në mënyrën se si i servir ato.

Për nga ndërtimi, tregimet nuk kanë fabul të ndërlikuar. Autori nisat nga jeta, nga episode apo karaktere që ngjajnë vërtet si të ndodhura apo të takuara në jetë. Kjo ka anën e saj me vlerë sepse i bën ato afërta me lexuesin, por mund të sjellin dhe përshtypjen e një riprodhimi fotografik të realitetit, pa kaluar sa duhet në filtrin autorial. Me të drejtë është vërtetuar se ky autor i harmonizon mjaft mirë realen dhe imagjinaren dhe kësaj fare natyrshëm: “Frymëzimi apo vëzhgimi i jetës dhe mendimit, derdhen në shtratin e tyre”.¹²⁰

3.4 A mund të jetë personazhi determinim i aksionit?

Nuk ka personazh pa aksion dhe as që ka aksion pa praninë e personazhit. Sado që lidhja midis personazheve të shkrimtarit është e parrënueshme, personazhet janë pararendës të aksionit. Më saktësisht, i paraprijnë karakteret, përkatësisht psikologjia. Si tipar të karakterit, shkrimtari nuk ka dhënë vetëm shkakun e aksionit apo thjesht pasojën e tij. Analiza që shkrimtari i bën veprës nuk orienton kah një prejardhje të hershme të pandryshueshme, që është dhe kuptimi dhe ligji i tablove pasuese. Personazhi nuk përcakton gjithëherë aksionin, ashtu sikundër dhe çdo tregim që nuk konstituon në përshkrimin e karaktereve. Herë-herë gjendemi në mbretërinë e njerëzve-rrëfime. Ky fakt depërton thellë në strukturën e veprave; mjafton të kujtojmë këtu romanin “Buka e një stine me borë”.

Shkrimtari jep rrënjën dhe tabanin e çdo vlere shpirtërore të personazheve, me gatishmërinë, ndershmërinë dhe mençurinë e personazheve që mishërojnë njerëz të thjeshtë të punës, me një sens të arrirë artistik të urtësisë, të humorit dhe mënyrës popullore të kuptimit dhe të manifestimit të sjelljeve jetësore. Në qoftë se asnjë nga personazhet nuk pushon së

¹²⁰ Zija Çela. *Jetë që vjen në art. (Vëllimi me tregime “Era e udhëve” i Koço Kostës)*. Në: “Drita”, 8 gusht 1982, f. 5 - 6.

rrëfyeri, kjo do të thotë se ky akt ka marrë përkushtim kulmor: të rrëfesh është baras me të jetosh, një situatë e cila përsëritet pareshtur përbrenda rrëfimit.

Boshtin e novelës “Ata të dy dhe të tjerë” e përbën përshkrimi i dy protagonistëve e konkretisht “Djaloshit të bukur” dhe “Peshkut të kuq”.

Duket se ngjall kënaqësi/interes të veçantë mjeshtëria e autorit në zbërthimin/zbulimin e thelbit të karakterit të të dyve. Në pamje të parë, të dy personazhet të duken me doza komizmi/grotesku. Por gradualisht, me strukturat narrative, i jepet mundësia lexuesit që të thellohet në karakterin e tyre, duke zbuluar gradualisht se “këta të dy” janë njerëz fare të thjeshtë dhe secili prej tyre zotëron një natyrë artistike të mirëfilltë. Sipas shkrimtarit, drama e tyre e vërtetë është fakti që autoritetet e atëhershme nuk çanin kryet për talentet e njerëzve të thjeshtë. Protagonistët e kësaj novele janë edhe të afërt edhe të kundërt me personazhet e tregimeve të tjerë.

Padyshim që novela zotëron tipare më të arrira të prozës së mëparshme të shkrimtarit: realizmin, origjinalitetin, frymën poetike dhe mjeshtërinë e përdorimit të detajeve shprehëse, të cilat zbulojnë karakterin e vërtetë të personazheve. Këtu ndeshemi me veçoritë e karakterit, që krijojnë dinamizmin e aksionit. Në përputhje me kohën, hapësirën, ambientin dhe të ndodhurat që konstituohen në vepër edhe mënyra e trajtimit është adekuate; figura e personazhit kryesor shkrihet me veprimet, me lëvizjet dhe vetëdijen e masave, në gjithë ndërthurjen e veprës ai është fokus në të cilin gërshetohen planet e strukturës, e veçmas linja e subjektit e vështruar në këndin e gjithëdijshëm të narratorit dhe e karakterizuar në mënyrë deduktive përmes përshkrimit dhe komentimit të pikëpamjeve. Kjo nuk mbetet vetëm në planin horizontal, por kompletet edhe me elementin e fuqishëm emocional në raport me gjendjen e përgjithshme.

3.5 Figura-personazh në strukturën artistike të veprës së autorit.

Figurat njerëzore në veprat letrare janë një prej mjeteve kryesore me anën e të cilave shkrimtarët arrijnë të mishërojnë realitetin dhe të shprehin ndjenjat, idetë dhe idealin e tyre estetik, apo dhe të ideshmërive që ata besojnë e ndjekin. Për Koço Kostën, personazhi pozitiv është ai që përfaqëson energjinë më pozitive dhe më emancipuese dhe kështu ai është në harmoni me idealin e shkrimtarit. Vënia në qendër e “heroit pozitiv” dhe letërsisë pararendëse të realizmit socialist, tani është zëvendësuar me një lloj alergjie ndaj “heroit ideal”, luftëtarit për progres dhe për të mirë. Në letërsinë bashkëkohore shqipe jo pak shfaqet dhe tipi i “njeriut pa cilësi”, si dhe figurat e personazheve negative.

Ky tipar i letërsisë bashkëkohore dëshmon për një skajshmëri tjetër, e cila ka një bazë reale, krizën e individit, krizën e identitetit, që lidhen me kërkimet ekzistenciale sot në botë, pikërisht në këto kohë kur janë bërë të njohura, kanë kryer funksionin e tyre, apo janë ezauruar shumë doktrina filozofike, morale e politike dhe priten jo pa ankth e jo pa dyshime të mëdha pistat e reja ku do të shkojnë shoqëritë e ndryshme dhe njerëzimi në përgjithësi. Këto udhëkryqe apo dhe projekte, gjithësesi të mjegullta sociale, sigurisht që janë ushqim i lakmuar për artin në përgjithësi e doemos edhe për letërsinë.

Në veprën e Koço Kostës që i përket periudhës së parë të krijimtarisë, vend të veçantë kanë njerëzit e thjeshtë me botë të madhe shpirtërore dhe heroizëm të heshtur, që si tipa shoqërorë vijnë shpesh nga radhët e fshatarëve, por që i gjejmë sipas rasteve edhe në mesin e intelektualëve.

Në të vërtetë, edhe në novelën që shënoi kalimin e shkrimtarit drejt modernizmit dhe tërhoqi drejt tij rrufetë e kritikës së kohës figurat e protagonistëve, ndonëse aspak të idealizuar, nuk janë egocentrikë dhe shpirtvegjël dhe aspak perverse, siç i ka perceptuar/cilësuar kritika e kohës. Në thelb ato kanë respekt për artin e vërtetë dhe për rolin shoqëror që duhet të luajë artisti, kanë respekt për bukurinë, ndonëse ky respekt merr edhe forma narciste në dukje, si tek fjalët e Djaloshit të Pashëm për bukurinë e vet. Në thelb, ky kult i së bukurës bie në kundërshtim me nënvleftësimin e saj që vihej re në poetikën e ngurtë dhe monotone të “realizmit socialist”.

E ritheksojmë sërish se kjo kritikë e ka deformuar edhe miqësinë e singertë dhe të bukur që lidh dy protagonistët, duke parë në të shenja të perversitetit, të homoseksualizmit. Në fakt, teksti i Koço Kostës nuk të jep material për një konceptim të tillë. Ky vlerësim i kritikës së atëhershme, na sjell ndërmend sikundër e kemi përmendur edhe në një kapitull të mësipërm, një pohim të studiuesit marksist Andre Vurmsër, i cili gjen gjurma homoseksualiteti në personazhet e Balzakut si për shembull, në veprën e tij “Komedia njerëzore”. Ky studim interpreton në veprën e Balzakut miqësinë midis Voltrenit dhe Lysjenit tek “Shkëlqimi e mjerimi i Kurtizanëve”, ose miqësinë midis Betës dhe Valeries tek “Kushërira Betë” si marrëdhënie homoseksuale/lesbikë. Në të vërtetë, në tekstin e Balzakut mungojnë detajet që do ta përligjinin një supozim të tillë, ndonëse një interpretim i këtij lloji nuk mund të përjashtohet plotësisht. Në rastin e kritikës zyrtare shqiptare, është i qartë synimi për ta rënduar edhe më tej akoma autorin dhe personazhet/heronj të tij. Personazhet e Kostës, që luftojnë për të mirën në fazën e tij të parë të krijimtarisë, kanë një gjallëri dhe dinamizëm që e kapërcen cakun biologjik të moshës. Bashmeta që shkon në fshat për të kaluar pensionin vazhdon të jetë aktiv për të ndikuar mbi realitetin dhe për të eliminuar të keqen. Edhe Dademadhja, synon të luftojë të keqen (në fillim duke zgjedhur me naivitet drejtimin e gabuar, më vonë duke iu kundërvënë hapur bartësve të së keqes).

Kujtojmë edhe personazhin e Sitkiut, si karakter i njeriut tepër të cekët, tepër të pazoti, tepër artificial, por me pozitën e tij sociale ai kërkon t’i kompensojë ato me përfitim privilegjesh.

Artistikisht, portretizimi i këtij tipi në tregim është arritur bukur nëpërmjet një sërë detajesh, të renditura dhe të vendosura me shumë efekt (kujtojmë pasazhin e kapjes së mizës apo të njohurive që ka Sitkiu për letërsinë dhe gjuhën italiane). Në këto tregime autori është marrë kryesisht me portretizim tipash të ndryshëm, që përfaqësojnë elemente me pak ose shumë shtrirje shoqërore në shoqërinë tonë. Por edhe pse tregime-portret, aty shfaqen konfliktet e kohës, sepse pikërisht këta tipa, këto portrete, mbartin anë të caktuara të këtyre konflikteve në të cilat ndeshet shoqëria.

Të mos harrojmë, se personazhi është kryefjala e kësaj lënde dhe kjo duket edhe në faktin se mes temave të shumta të trajtuara nga autori, vendin e parë e zënë temat që kanë të bëjnë me normat etike dhe morale, me lirinë e individit në shoqëri. Tregimi i Koço Kostës nuk është tregim rreth ngjarjeve, por rreth personazheve. Tregimi më i realizuar është tregimi “Burri i vogël që...”. Të rrëmben vërtetësia e tregimit dhe forca e përshkrimit artistik. Duke u

futur thellë në psikologjinë e fëmijëve, autori ka mundur të na japë krejt jetën shoqërore, apo individët që manifestojnë shenja të moralit të kohës.

Boshti i saj rrotullues është njeriu. Si e tillë, tematika e kësaj proze njih disa tipa procedimesh që i shkojnë përshtat pothuaj gjithë tregimtarisë së tij. Strukturën tematike të kësaj proze të shkurtër, do ta paraqesim në këtë formë:

Gjykim (Kemi të bëjmë me një gjykim të personazhit rrëfyes për personazhin e rrëfyer, gjykim ky i ngritur mbi bazën e një keqkuptimi apo keqinformimi dhe paragjykimi).

Përballje (Këtu të dy personazhet janë të vendosur përballë njëri-tjetrit).

Rivlerësim (Si pasojë e disa zhvillimeve, personazhi rrëfyes rivlerëson personazhin e rrëfyer).

Reflektim + Rinisje (Këtu kemi personazhin rrëfyes përballë vetes dhe personazhit të rrëfyer, kuptohet, jo vetëm me një qëndrim tashmë të ndryshuar, por edhe të vlerësuar).

Tek të dy tregimet në fjalë, autori vë në plan të parë botën e brendshme të dy personazheve, i jep për detyrë vetes të depërtojë dhe pastaj të shpalosë botën e tyre të pasur dhe të nuancuar. Sipas shkrimtarit, populli është rrënja dhe tabani i çdo vlere materiale dhe shpirtërore, gjë që shprehet bukur, në gatishmërinë, mençurinë e ndershmërinë e personazheve, që i mishërojnë njerëzit e thjeshtë të punës.

Në vijim të këtij mendimi vlen të theksojmë mendimin e Tefik Çaushtit: “Autori përdor sensin e mirë artistik, të urtësisë, frazeologjisë, humorit dhe mënyrës popullore të kuptimit të proceseve jetësore.”¹²¹ Në këtë aspekt autori dallohet për:

- 1) portretizim shpirtëror të personazheve;
- 2) projekcion psikologjik të zhvillimit të karaktereve;
- 3) skicim të shkathët të konfliktit;
- 4) topos/hapësirë të pasur përshkrimesh.

Personazhet në veprimet e autorit na paraqiten gjithnjë në luftë kundër të vjetrës, në kërkim dhe në veprim për realizimin e kësaj kauze. Mund të pohojmë se K. Kosta ka punuar me bindje, me vetëdije e këmbëngulje për ta pasuruar shumëllojshmërinë e karaktereve, të figurave, ndër të cilat të zgjedhurit e zemrës janë bartësit e tipareve të këtij morali. Shohim më tej një fenomen tjetër në lidhje me personazhet e K. Kostës. Brendapërbrenda rrëfimit ndryshon në një farë mënyre pozicioni i autorit. Ai herë flet nga pozita e personazhit, herë sikur distancohet për t’i rrëfyer lexuesit. Kjo ndërthurje krijohet nga prirja për thellimin e psikologjizmit, për të zbuluar atë tallaz ndjenjash e mendimesh që përjeton personazhi. Vështrimi i rrëfimitarit depërton thellë në botën e personazhit.

Kujtojmë këtu Bastriun e tregimit “Djaloshi që donte kuajt”, ku krahas burrërisë ai ka luhatjet e botës së një fëmije, krahas pjekurisë dhe idealit të lartë të kohës ka naivitetin e moshës së njomë. Prandaj, sipas autorit, për të realizuar këtë qëllim, atij do t’i duhej medoemos të krijonte personazhe që kishin një biografi, një portret fizik, një mënyrë të sjelluri dhe të foluri që i dallon ndërmjet tyre. Kësaj letërsie do t’i duhej të bënte përshtypjen e objektivitetit, prandaj autori duhej t’i rrëfente ndodhitë pa marrë pjesë në to.

¹²¹ Tefik Çaushtit. *Vesa e qerpikëve*. (Anika) Koço Kosta: Anika, tregim në vëllimin “Dademadhja”, (1976). Në librin “Klubi i personazheve” (Shënime për personazhe të shquara të letërsisë shqipe). Tiranë, Dajti 2000, f. 151-157.

Nëse shohim ndërtimin e figurës së personazhit tek libri “Bisedë në mesnatë”, brenda kontradiktave të kohës janë kontradiktat e dorës së “dytë” ato që vulosin shpesh atmosferën emocionale dhe bukurinë e botës shpirtërore, duke fituar sfond e relief brenda kontradiktës kryesore. Autori operon dendur me anën e hoveve të fantazisë. Gjithçka në tregim vihet në shërbim të psikologjisë së personazheve. Si shumë fëmijë të kësaj kohe, ai dëshiron të bëhet partizan. Kemi një sërë situatash dhe argumentesh artistikë që risjellin një ngjashmëri e koherencë dhe në mjetet e formës e në rezultatën ideoartistike.

Shembull: “Ne ishim ngjitur lart dhe po linim pas shtretërit e përrenjve që vareshin malit, lugjeve të gjelbra dhe pllajave të vogla. Pastaj shkelëm në fragmente kalldrëmsh të një fshati të hershëm. Shikuam mure të lashta, që ngriheshin si krahë të djegur, shikuam edhe dylbe e xhami, të cilat ngjanin si dhëmballë të vjetra të ngrëna. Këtu kishte qenë dikur fshati. Ndërsa atje poshtë, në fund të malit, rridhnin ujëra të bollshme dhe kishte një mulli. Edhe ujërat, edhe mullirin fshatarët i ruanin që lart nga faqja e malit. Po kohët sollën luftëra e luftërat i rrënuan ato troje. Mandej, fshatarët ngritën gjurmë të reja në gjunjët e malit tek ato ujëra”.¹²²

“Bariu heshti, pastaj belbëzoi: E ke për detyrë!

Dëgjo, këtu, iu lut gazetari i radios

Bariu e shikoi drejt

Dëgjo dhe bëj si të thotë, - i tha kryetari

Po mirë, po deshe?!

Dëgjo, dëgjo atë.

Ehe, mirë.

Gazetari i radios filloi ta inçizonte.

Xha Merqezi shikoi i çuditur nga ne dhe tha:

U ç’llafoset kështu ky, mo Dule! Po mirë jam, si jam”!¹²³

Figurat janë të pranishme që në fillim të veprës.

Në krijimet e sotme letrare preken të gjitha problemet njerëzore. Vetë ambienti në të cilin do të zhvillohen ngjarjet e personazheve përmbledh dimensionet e kohëve në një.

Edhe romani “Buka e një stine me borë” synon të sjellë para lexuesit disa nga dukuritë kryesore të jetës së fshatit. Në vepër kemi intelektualin e ri që e vë talentin dhe zotësinë e vet në shërbim të fshatit (Peliku). Gama e problemeve është shumë e gjerë por filli që i bashkon është i qartë. Problemet dhe shqetësimet e personazheve janë të ndryshëm, si për shembull, shqetësimi i fshatarit që të prodhojë sa më shumë mish, qumësht, drithë për popullin, për Shqipërinë. Kujtojmë këtu episodin e grindjes që pëlçet midis blegtorëve të fshatit me blegtorët e ndërmarrjes blegtorale. Të tjera dukuri e konflikte shfaqen për fshatin.

Figura e Pelo Qordukës, Sile Bërdëllimës, Niko Lilit, nënë Vusheja, Kristina, Guçe Gërbi, Maçiku janë figura realiste e shumëngjyrëshe. Këto personazhe shfaqin një dashuri të veçantë për fshatin, arën, livadhin, për kuajt e lopët.

Veprat e autorit dallohen për funksionalizmin e plotë të marrëdhënieve të personazheve, njësimin e tyre me rrethanat në të cilat veprojnë, të ndodhive me mjedisin, sidomos me anë të fabulës/historisë së rrëfyer, të përqendruar nga fillimi në fund.

¹²² Koço Kosta. *Bisedë në mesnatë*. Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, f. 89.

¹²³ Po aty, f. 135.

Rrëfimi dhe përshkrimi janë dy mënyrat sendërtuese që paraqiten harmonishëm në prozën e shkrimtarit. Koncepti për personazhin, veçanërisht në modernizimin bashkëkohor, është më i gjerë se ai që e kufizon vetëm tek shëmbëlltyra e drejtpërdrejtë njerëzore.

Është pikërisht ky dialog që nxjerr në pah karakterin e personazhit.

Citojmë: “Përfytyrova fshatin. Në pushimet e kohës studentore ndodhte që, natën, në pranverë apo në vjeshtën e yjeve të mëdha, të ulesha e të rrija në ndonjë shteg nga ku ngjiteshin për në fshat. Kundroja fshehëtitrat e botës natyrë dhe meditoja për jetën. Pikërisht në net të tilla përballësha me Gizdar Llogurin. Ai ngjitej nga fusha nëpër tragën e tij të fshehur.

Ti Gizdar, je? - i thosha. Ai lëshonte vandakun me gjethe apo jonxhë dhe, kur ulej, unë e ndieja sesi godiste në truall bishti i sëpatës së varur përbrenda xhaketës, atje tek bën kënd bërryli.

Po shpie jonxhë në shtëpi, - i thosha.

Po shpie qumësht në shtëpi, më thoshte. Ndjeva se më kërcitën dhëmbët.”¹²⁴

Kjo është një figurë e thjeshtë, e zakonshme, por me nëntekst.

Libri “Unë dhe komiti”, një përmbledhje me tregime, si dhe libri “Krishtë midis gurgullimash”, flet për hapat e rritjes artistike të këtij autori.¹²⁵

Në tregimin “Si etërit” trajtohet tema e ndihmës që jepnin fëmijët në punët e fshatit.

Këta heronj janë marrë nga jeta e fshatit. Kurse në qendër të tregimeve “Ai njeri”, “Zvarrisja” dhe “Këtë shteg e zë unë” jepet tabloja e personazheve, të cilët shfaqen për ngjarjet interesante që tregohen aty, për stilin e rrjedhshëm, për skalitjen e personazheve dhe praktikisht për punimin e tokës dhe ngjall tek fëmijët dashurinë për punën. Kuptohet se, jo vetëm në këto tregime, por edhe në tregime të tjera, të gjitha veprimet autori i ka parë me syrin fëmijëror. Bota shpirtërore dhe mendore e heroit kryesor të tregimit përshkruhet me ngjyra të gjalla. Këto tregime janë shkruar me stil të rrjedhshëm, tërheqës për fëmijët, me një gjuhë të pastër e të pasur, që i përshtatet moshës për të cilën është shkruar.

3.6 Personazhet e novelës “Ata të dy dhe të tjerë”

Në atë kohë novela “Ata të dy dhe të tjerë” nuk u quajt disidente, fjala disidente nuk ishte fort në përdorim, për të mos thënë se mund të merrte një konotacion tejet negativ dhe keqkuptues. Boshtin e novelës e përbëjnë “Peshku i Kuq” dhe “Djaloshi i Pashëm”, të cilët, të dy zotërojnë një natyrë artistike. Kjo mund të përcaktohet si një novelë, e cila zotëron tiparet më të mira të prozës së këtij autori; realizmin, por dhe guximin sfidues për të dalë përtej koracës së skemave estetike të kohës. Ndaj kësaj vepre sigurisht që pati jo pak konsekuenca por në fund të fundit ajo i bëri ballë kohës dhe u rilexua ndryshe pas rënies së diktaturës.

Suksesin dhe jetëgjatësinë veprës ia ka garantuar vlera artistike, mjeshtëria dhe novatorizmi që përcillte për kohën. Novela është e ndërtuar sipas një modeli të atillë, që ka shumë episode të shkëputura (që ndihmojnë të japin një galeri portretesh psikologjike e tërheqëse për lexuesin). Koço Kosta është mjeshtër i përdorimit të detajeve shprehëse.

¹²⁴ Koço Kosta. *Paradite me shi*, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1991, f. 112.

¹²⁵ Koço Kosta. *Krishtë midis gurgullimash*, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1989.

Fantazia e tij nxitet, frymëzohet sidomos kur në të futen me shumicë detajet reale, shprehëse dhe të përpunuara. Tek mjeshtërit realistë e romantikë, kjo procedurë njohjeje e zbërthimit të shpirtit jepet nëpërmjet detajeve shprehëse. Episodi i bisedës së Djaloshit të Pashëm me rrëfyesin, flet me një dashuri e dhembshuri mbresëlënëse për Peshkun e Kuq dhe zbulon disa të dhëna prekëse për jetën ku dhe shfaq dhe karakterin humanist.

Mendime nga më të ndryshmet, po kryesisht negative, janë thënë në atë kohë në lidhje me novelën, pasi imazhi i veprës në atë kohë perceptohej i deformuar. Kujtojmë vlerësime të tilla ku aludohet qartazi se novela ka mangësi të dukshme që nuk mund ta shpëtojnë dot disa vlera në rrafshin e formës, sado të arrira të ishin ato: "...Kjo novelë dëshmon për cilësinë artistike, na ndodh që harrojmë cilësinë ideologjike duke harruar kështu, se sigurisht nuk ka përmbajtje, sado e drejtë dhe e rëndësishme të jetë, që ta shpëtojë një vepër të dobët artistikisht ashtu si nuk ka formë artistike, sado e "sofistikuar" të jetë, që mund ta shpëtojë një vepër me përmbajtje të gabuar".¹²⁶

Dhe si për ta përforcuar këtë mendim, citohen pjesë nga kjo novelë: "Djaloshi i Pashëm u bë i menduar. Ai vuri një skedë të bardhë përpara dhe me krenarinë dhe "dashurinë" e Djaloshit të Pashëm për vetveten. Këtu duhet të kemi të qartë se personazhi në fjalë nuk thirret me emër nga autori."¹²⁷

Ky pohim është bazuar mbi konceptin se përmbajtja është primare, duke nënvleftësuar formën, pavarësisht se në dukje ngjan se ato dy elemente barazohen. Sociologjizmi i metodës në kohën e "socializmit" anashkalonte në fakt formën, i jepte rol dytësor, madje dhe më tej se atë, po të kemi parasysh se ka pasur raste kur janë vlerësuar nga ato vepra që kanë përcjellë vetëm ideshmëri të zbrazët, pa veshjen e duhur formal-artistike. Por vepra dëshmonte se forma dhe mesazhi i saj e thyenin/kapërcenin horizontin e pritjes së kohës, drejt një horizonti tjetër, në perspektivë.

Edhe pse imazhi perceptohej i deformuar, novela kish rëndësinë e saj.

Vlerësimet për këtë vepër nuk mungojnë, sigurisht, shpesh e vështruar ajo në një kënd retrospektiv, pasi në kohën kur ajo u botua dhe u kritikua/refuzua, u bë i pamundur vlerësimi i saj korrekt e me objektivitet. "Novela jo vetëm që është shkruar me dorë mjeshtëri, por dhe të çudit me kurajon që kishte treguar autori! Më kishte habitur pjesa e parë. Vitet kalonin. Emri i Koço Kostës nuk përmendej më. Por kjo nuk do të thosh se ai qe harruar. Ai vërtetë nuk botonte, por atë sa kish bërë, kish qenë e mjaftë, që të mbetej i gjallë imazhi se ai merrte pjesë aktive në jetën letrare të vendit".¹²⁸

Citojmë nga vepra: "Me lehtësi vizatoi me karbon bustin e një vajze, e hoqi atë pastaj nga tavolina, bile e copëtoi pa pikë dhimbjeje. Pfu! Ka të ngjarë që ai jeton edhe me ca vegime të çuditshme, të cilat i mban dhe i zhvillon në trurin e tij të ndezur, mbase"...¹²⁹

¹²⁶ Mbi novelën thellësisht të gabuar *Ata të dy e të tjerë* (autor Koço Kosta). (Autokritika e redaksisë së revistës pas anulimit të botimit dhe asgjësimit të pjesës së botuar të novelës në numrin e mëparshëm). Në: "Nëntori", nr. 5, maj 1986, f. 20-28.

¹²⁷ Është karakteristikë e shkrimit letrar të K. Kostës që shumë nga personazhet e veprave të tij, t'i paraqesë në mënyrë të tillë, jo me emra por me nofka apo pseudonime, si shenjë spikatje të individualizmit të tyre.

¹²⁸ Shpend Topallaj. *Koço Kosta, shkrimtari që foli atë trimërisht*. Botuar në gazetën "55", 7 shkurt 2003.

¹²⁹ Koço Kosta. *Ata të dy dhe të tjerë*. Tiranë 1994.

“...u habitën gratë e mëhallës kur më lindi mamaja, - tha Djaloshi i Pashëm, - u habitën nga bukuria ime. Megjithëse kur linda, s’merrija frymë. Një xhaxheshë më fryu me buzët e saj. Dhe ajo më solli në këtë botë. Peshku i Kuq iku me urgjencë. Djaloshi shikonte thellë në vetvete”.¹³⁰

Analizë të veçantë meriton mënyra se si i ndërton ky autor karakteret e novelës. Ata janë të karakterizuar në kufijtë mund të themi të figurave karizmatike dhe për tiparet që shfaqin, dallohen menjëherë që janë krijuar nga pena e Koço Kostës.

“Novela u botua pjesërisht, në nr. 4 të revistës “Nëntori”, në vitin 1986. Pjesa e dytë e novelës, siç dëshmojnë faktet, nuk u lejua të publikohej, sepse sipas kritikës zyrtare të kohës, kjo novelë cilësohej thellësisht e gabuar, me të meta të theksuara ideore, aq më tepër që kjo pjesë ishte më e keqe nga pjesa e parë”.¹³¹

Është më tej akoma dhe një pasazh nga shënimi i redaksisë së revistës “Nëntori”, ku kryqëzohet personazhi kryesor, Djaloshi i Pashëm, pasazh të cilin po e citojmë në vijim:

“Djaloshi i Pashëm është një njeri që nuk lufton për asgjë e vetëm ëndërron me “afsh”. Ai vuan nga narcizmi, gratë e mëhallës qenkëshin habitur nga bukuria e tij kur e lindi mamaja. Vetë autori na e thotë në novelë, se Djaloshi i Pashëm nuk ngopej me komplimente”.

“Struktura karakterologjike e Djaloshit të Pashëm dhe relacionet e narratorit me të, të gjitha pikëvështrimet e mundshme, vërtetojnë më së miri, se ai vuan nga kompleksi i narcizmit”.¹³²

Megjithëse nuk është ky qëllimi kryesor i veprës dhe i personazhit, lexuesi është i shtyrë drejt një përjetimi të tillë, ai na shpie drejt një gjykimi të Todorovit në një kontekst të caktuar: “Një sintagmë, një përemër vetor, një sintagmë emërore me vlerë anaforike duke u kthyer në një aktor antropomorf, mjaftojnë për të formuar një personazh”.¹³³

Pra, tendenca e autorit për ta thirrur qysh në hyrje të rrëfimit këtë personazh, Djaloshin e Pashëm, përbën hapin e parë formal të qëllimit që ai ka për ta vizatuar e veshur me petkun e Narcisit dhe narcizmit. Kjo prirje vërtetohet nga të dhënat e njëpasnjëshme që rrjedhin deri në fund.¹³⁴

Ky tipar që mund të lidhej me egoizmin, lidhet në fakt me vetërrëfimin. Është një kundërshtim me nivelimin tipik të “realizmit socialist”, që e nënvleftëson bukurinë. Pra, tipari i personazhit është ambivalent: ai është i vetëdijshëm për bukurinë e vet fizike, i gëzohet asaj dhe e shpreh. Këtu ka natyrisht narcizëm, por edhe vlerësim të bukurisë si dhunti e natyrës, si pjesë e bukurisë së jetës dhe natyrës.

¹³⁰ Po aty, f. 26-27.

¹³¹ Revista “Nëntori”, shënim i redaksisë: “Mbi novelën thellësisht të gabuar”, Nr 5, Tiranë, 1986.

¹³² Roland Zisi. *Miti i narcisit në letërsinë shqipe*. Shtëpia botuese “Alb Paper”, Tiranë 2013.

¹³³ C. Todorov, *Poetika e prozës*. Panteon, Tiranë, 2000, fq. 172.

¹³⁴ Në hyrje të novelës fillimisht autori e prezanton lexuesin me Peshkun e Kuq i cili kurrë nuk sulej vetëm.

Qëndronte atje me një djalosh tjetër që vishej me shije e elegancë.

Hapësira e personazhit.

Me qëllim që aventura, si element i strukturës kompozicionale të kësaj vepre, të rrumbullakoset deri në etapën e ekzaltimit të protagonistëve, autori shfrytëzon një hapësirë të gjerë gjeografike. Hapësira në të cilën zhvillohen ngjarjet nuk është një kategori, në këtë rast operuese në punë të procedimit klasifikues, ngjarjeve, rrënjët e së cilës mund t'i gjejmë në tipin e romanit.

Vlerësimi karakterologjik. Kjo është njëra prej fazave që ndërmerr autori. Vlen të përmendet edhe zbulimi i thelbit karakterial të personazheve, përmes veprimeve, detajeve dhe “huqeve të tyre”. Shkrimtarit nuk i pëlqen të meditojë fuqishëm dhe intelektualisht rreth botës së brendshme të personazheve të veprave. Kemi skenën kur personazhi piktor i novelës “Ata të dy dhe të tjerë” nxjerr dhe vizaton në mënyrë “blic” portretin e një vajze. Citojmë: “Pas pak minutash, me të njëjtën shpejtësi që e vizatoi, e grisi dhe e “copëtoi pa pikë dhimbjeje”.¹³⁵

Autori i kushton vëmendje të veçantë botës së brendshme të personazheve, duke trajtuar aspektet e veçanta të karaktereve të tyre, shfaqja e dukjes së të cilave është rrjedhojë e faktorëve të jashtëm shoqërorë. Tek novela e K. Kostës, vihen re tipare të tilla tek Djaloshi si: mërzia, inati dhe mllef i antifemëror, jo përmes monologut të brendshëm, as nëpërmjet rrethanave, por përmes një veprimi. Nisur nga këndvështrimi i autorit me detaje dhe domethënie të këtij veprimi, duke qenë se ishte dëshmitar okular, me të drejtë shkrimtari mbërrin në një përfundim logjik dhe të justifikuar. Citojmë: “Ka të ngjarë se ai jetonte edhe me ca vegime të çuditshme, të cilat i mbante dhe i zhvillonte në trurin e tij të ndezur, mbase...”.¹³⁶

Veprimi i djaloshit është pasqyrim i një drame të brendshme dhe e intrigon lexuesin. Lind pyetja: A është fjala për një dashuri fatkeqe të personazhit apo për një qëndrim që të kujton heroin e romanit “Pse”, Gjon Zaverin?

Këtu ka ambiguitet dhe mundësi për disa interpretime. Mos vallë Djaloshi i Pashëm, i dashuruar me vetveten, s’është i aftë për dashuri të tjera?

Duket se shkrimtari e shpalos dukshëm këtu dashurinë për veprën e vet.

Ja si shprehet autori: “Do të shkoj tek shtëpia botuese Gutenberg dhe që tani përfytyroj një zotëri të qeshur i cili më pret. Në njërën dorë do të ketë në gjuhën greke “Ata të dy dhe të tjerë”, të botuar me aq kujdes. Nderime dhe mirënjohje për ju që bëtë të njohur dhe të mundur që një vepër e imja të flasë në gjuhën e lakmuar të grekut dhe që bën që personazhet e mi të kenë jo pak rëndësi”¹³⁷

Një model kritik i botëperceptimit të realitetit jetësor, shpërfaqet në tërësinë e tij edhe në novelën “Gjaku” dhe në tregimin “Tregtar flamujsh”, si ndër krijimet më të arrira artistikisht të prozës tregimtare të Koliqit. Jo pa qëllim e bëjmë këtë përngjasim, sepse lexuesi

¹³⁵ K.Kosta. Vepër e cituar, f.19.

¹³⁶ Po aty, f.19.

¹³⁷ Koço Kosta. *Refleksion: Koço Kosta rrëfen Vetveten: Diçka për veten dhe për veprën: “Ata të dy dhe të tjerë”*: Refleksione, Shkrimtari rrëfen vetveten. Në: “Tema”, nr. 1641, 9 dhjetor 2005, f. 20-21.

i kujdesshëm mbetet shtang; se si ky prozator (Koliqi), qysh në nisje të tregimit apo në të parat fjali gjen dhe fillin e mbarë dhe tonin e saktë.

Edhe Koliqi ashtu si K. Kosta ndodhet midis traditës dhe modernitetit.

“Novela e Koliqit është imazh i jetës reale dhe i sjelljeve, imazh i kohës në të cilën është shkruar, është tipi i prozës tradicionale me gjithë elementet konstitutive”.¹³⁸

Le t’i rikthehemi novelës së Kostës dhe ndikimit të modelit të Narcistit. Ndryshe nga Peshku i Kuq që është njeri i veprimit, Djaloshi i Pashëm, njëlloj si Narcisti, është njeri i meditimit dhe i dyshimit.

“Bashkëshoqërimi formal dhe kuptimor i këtyre dy figurave jep ballafaqimin mes Djaloshit të Pashëm me Narcistin. Djaloshi i Pashëm është personazh i llojit psiko-sociologjik i një kohe. Nuk përmendet emri i Narcistit, por paradigma e tij mitologjike është e pranishme kudo: në frymë, në shembuj, në meditime, në portret, në heshtje”.¹³⁹

Personazhi i K. Kostës është një Narcist i kohës së socializmit.

Kjo na lë të kuptojmë se Miti i Narcistit e frymëzoi prozën poetike të Koliqit në “Shtatë pasqyrat e Narcizit”, në mënyrë të qartë. Ky mit rikthehet te Kosta në formë të nënkuptuar. Sigurisht, një motiv i tillë, i bukurisë fizike dhe i egocentrizmit binte ndesh me poetikën e “realizmit socialist”.

Me të drejtë Isuf Berisha dhe Shkëlzen Maliqi kanë shprehur mendimin e tyre në lidhje me këtë novelë, e cila bëri jo pak bujë për atë kohë: “Koço Kosta qysh me shkrimet e para u imponua me talentin e individualitetin e vet krijues, dhe si i tillë, u mirëprit dhe u çmua lart nga kritika letrare. Këto vlerësime, ishin vlerësime të mëpasshme, të favorshme për veprën e Koço Kostës. Ndalimi i botimit të novelës së Koço Kostës dhe kritikën që iu bënë autorit, nuk kishin ndikim vendimtar për fatin e këtij shkrimtari, i cili për mendjen tonë hyn në radhën e prozatorëve më të mirë të gjeneratës së vet”.¹⁴⁰

Në shembullin e lartshënuar rrëfimi vjen pas maksimës, me të cilën paraprakisht në një farë mënyre, paralajmërohet qëllimshmëria e rrëfimit të personazhit narrator. Por ashtu siç ndodh që maksima i paraprin rrëfimit, në nivelin e organizimit narrative, na paraqitet dukuria inverse. Në raport me tipin e lidhjes sipas logjikës së suksesivitetit kohor, veprimet e personazheve shfaqin pasojën e dominimit të lidhjes së gjymtyrëve narrative sipas logjikës shkak-pasojë.

Bota subjektive e personazhit narrator në veprën e K. Kostës, shpaloset nëpërmjet procedeut eseistik dhe zhbërja e fabulës si përbërës i konvencës letrare zëvendësohet me zbatimin e teknikës rrëfimtare të ndërlidhjes së asociacioneve. Përdorimi i një procedimi të tillë vihet në funksion të shpalosjes së botës meditative të personazhit narrator. Vizatimi i fytyrës së Djaloshit të Pashëm bëhet me pasionin dhe kujdesin e një piktori, nëpërmjet një enumeracioni zbritës të elementeve anatomike: flokë, ballë, sy, hundë, buzë, mollëza (i shoqëruar me cilësime sipërore absolute si: të admirueshëm, të veçantë, të bukur, të hijshme, shprehëse etj), të cilat formojnë një fytyrë të bukur, të përsosur.

¹³⁸ Arben Hoxha. *Poetika e prozës së Ernest Koliqit*. Prishtinë 2005, f.139.

¹³⁹ Roland Zisi. *Miti i Narcizit në letërsinë shqipe*. Shtëpia botuese “Alb Paper”, Tiranë 2013.

¹⁴⁰ Isuf Berisha –Shkëlzen Maliqi. *Novela e thyer*. Në: “Fjala”, Prishtinë, nr 1, Janar 1987, f. 12. Mbi prozën e Koço Kostës: “Ata të dy dhe të tjerë”.

Citojmë nga vepra: “Sytë e tij u bënë pëllg

Ai po qante.

Lotët duhet të thoshin diçka.”¹⁴¹

Novela “Ata të dy dhe të tjerë” shfaq fenomene nga më të ndryshme edhe pse është cilësuar si një vepër që shpreh konceptin idealist mbi rolin vendimtar të individit, një vepër që vë në pedestal të artit rolin e artistit në shoqëri. Kjo vepër pasqyron dramën e artistit në diktaturë, dilemën e tij, konformizëm apo edhe rebelim “heretik”.

Citojmë: “Kishte flokë me të vërtetë të admirueshëm, në ngjyrën e gështenjës, fytyrë shprehëse, veçanërisht sy shprehës dhe mollëza të kërcyera që s’ulërinin, por që e bënë më të hijshme fytyrën e tij me hundën e drejtë dhe buzët e trasha. Fytyra e tij e bukur është rekomanduese, e heshtur. Kjo figurë kuqalashë, edhe mund të zbutet.”¹⁴²

Shohim që narratori është i nënkuptuar dhe rrëfen në vetën e tretë. Herë-herë ndodh kombinimi i zërit të rrëfimitarit autor me zërin e rrëfimitarit personazh.

“Ajo Fytyrë më rekomandonte dikë: pikërisht atë

E copëtoi pa pikë dhembjeje”¹⁴³

Në krijimin e këtij personazhi, autori vështirë se mund të jetë motivuar nga literatura psikanalitike e cila jep shpjegime të gjera për personalitetin e personit patologjik. Ky personazh nuk është gjë tjetër, veçse një modalitet dhe burim kulturor që i lejon autorit të shpalosë dhe të prezantojë synimet estetike e letrare. Fshehja e të vërtetave të mëdha të regjimit komunist në jetën e përditshme dhe në art solli tjetërsimin e individit.

Sipas përcaktimit të një studiuesi: “Novela zotëron tiparet më të mira të prozës së mëparshme të K. Kostës, realizmin, origjinalitetin, frymën poetike, mjeshhtërinë e përdorimit të detajeve shprehëse, të cilat ndryshojnë thelbin e karakterit njerëzor. Kritikë të shumtë e mbrojtën novelën me etikë intelektuale dhe kompetencë profesionale”.¹⁴⁴

Po ashtu, theksojmë se “Ndalimi i botimit të novelës së K. Kostës dhe kritikën që iu bënë autorit me këtë rast, nuk patën ndikim vendimtar për fatin e këtij shkrimtari, i cili për mendjen tonë hyn në radhën e prozatorëve më të mirë të gjeneratës së vet. Pas shumë përpjekjeve të shumta kundër shkrimtarit, ky i fundit vazhdoi rrugën e vet”.¹⁴⁵

Si përfundim, kjo novelë shënon një moment vendimtar në prozën e tij, jo vetëm një kulm, por edhe një fillim të ri ku autori i zbulon ngjarjet me vërtetësi, një realitet më të gjerë kohor dhe historik. Ky ishte projekti më i madh artistik dhe letrar i autorit, cikli i tregimeve dhe novelave, që tematikisht lidhen me epokën e ngjarjeve të asaj kohe, dhe strukturalisht qëndrojnë në raporte të ndërsjella me njëri-tjetrin, njëkohësisht secili prej tyre qëndron si vepër më vete. Sakrificat, vuajtja, lumturia, fatkeqësia në një kohë të caktuar shfaqin veprimin njerëzor i cili në një çast merr fund, dhe pikërisht aty rifillon nga e para, sipas modelit

¹⁴¹ Po aty, f.76.

¹⁴² Po aty, f.20.

¹⁴³ Po aty.

¹⁴⁴ Trim Gjata. *Diktatura dhe vepra letrare “thelësisht e gabuar”*. (Me rastin e botimit të novelës: “Ata të dy dhe të tjerë” e K.Kostës). Në: “Republika”, 12 janar 1995, f. 3.

¹⁴⁵ *Vështrim panoramik i një konference imagjinare apo jo imagjinare për artet dhe letërsinë në qytetin e Fierit*.

Botuar në “Koha Jonë”, Tetor, 1994.

sizifian. Këtë model dhe koncept të aksionit njerëzor shkrimtari e ka aplikuar me mjeshtëri të plotë. Për ilustrim, mund të sjellim shembuj plot për konceptin e ringritjes individuale shpirtërore dhe ringritjes kombëtare dhe shoqërore. Reagimi i fuqishëm negativ i kritikës ndaj kësaj novele, që si një letër lakmushi që nxori në dritë vlerën e një ideologjie dhe estetike, tashmë të vënë dukshëm në dyshim. Në fakt, këtu shohim realitetin shqiptar në aspektet e veta negative pa asnjë vel idealizimi, pra një pasqyrim të fuqishëm demaskues realist, po edhe një “copëzim të individit”, në frymë moderniste. Realizimi estetik është arritur në vizatimin e portreteve të protagonistëve dhe në kornizën e realitetit që i rrethon, domethënë në tablotë e këtij realiteti. Këtu gjejmë pikësynimin modernist të riprodhimit të ndjenjave individuale të papërsëritshme (prandaj personazhet janë aq “të veçantë”). Personazhet janë edhe individë, edhe simbole, ato dalin nga caqet e realizmit.

3.7 Personazhet e dy periudhave të krijimtarisë së autorit

Është shprehur mendimi se “Novela “I Bukuri im” në tërësinë e vet nuk i ka përmbushur të gjitha kërkesat kryesore të llojit, mungon një ngjarje bazë, që të përbënte trunqun ku të montoheshin pjesët e tjera të mozaikut”.¹⁴⁶

Mund të mos jemi dakord me këtë mendim, sepse ajo ngjarje bazë ekziston. Është fjala për demaskimin e Teberit kur Bashmeta punon si bari, ndonëse është pensionist. Novela në fakt është ndërtuar mbi ballafaqimin e dy karaktereve të kundërta, mbi evolucionin e Bashmetës, që çlirohet nga naiviteti të cilin, çuditërisht, e ka ruajtur deri në moshë të thyer.

Një vlerë tjetër e tregimeve dhe novelave të K. Kostës janë dhe detajet e holla të vjela nga jeta. Shkrimtari ka një sy të hollë vëzhgues.

“Autori di të zbulojë imtësi që të futura me mjeshtëri dhe në funksion të ideve dhe personazheve, e bëjnë krijimtarinë shprehëse dhe të pëlqyeshme”.¹⁴⁷

Krejt natyrshëm kupton se problemet që shtrohen e zgjidhen në to janë probleme të rëndësishme. Shkrimtari thellon realizmin, duke i qëndruar besnik individualitetit të vet. Lëvizja e jetës është dhe prirja më e përhershme e autorit për të na dhënë adaptimet që marrin dukuritë e vjetra dhe mbeturinat e tjera. Sipas kritikut Adriatik Kallulli, “Këtë tendencë shkrimtari e dha në qëndrimin e asaj shoqërie”.¹⁴⁸

Në vijim vjen edhe mendimi tjetër se për një shkrimtar nuk janë vetëm rrethanat sociale ato që përcaktojnë në mënyrë të padiskutueshme vlerat e veprave të tij, pasi “Historia na jep shembuj të shumtë, se edhe me diktaturën më të egër, dolën intelektualë e shkrimtarë që s’ua bëri tërr syri dhe ç’patën për të thënë e thanë”.¹⁴⁹

¹⁴⁶ Zija Çela. *Jetë që vjen në art. (Vëllimi me tregime “Era e udhëve” i Koço Kostës)*. Në: “Drita”, 8 gusht 1982, f. 5 - 6.

¹⁴⁷ Ibrahim Braho. *Era e udhëve, një vëllim i bukur*. Në: “Nëntori”, nr. 7, korrik 1982, f. 70 - 72.

¹⁴⁸ Adriatik Kallulli. *Kërkime dhe gjetje të reja novatore. (Mbi vëllimin me tregime e novela “Era e udhëve” të Koço Kostës)*. Në: “Nëntori”, nr. 6, qershor 1982, f. 17-30.

¹⁴⁹ Shpend Topallaj. *Tersiti i letërsisë së realizmit socialist: rreth novelës “Ata të dy dhe të tjerë” të shkrimtarit Koço Kosta*. Në: Sh.Topallaj, “Paqja –virtut i civilizimit: kritika letrare”-Tiranë, Globus R, 2003, f. 15-28.

Novela ka një bosht të një natyre socio-etike që vlerëson çdo tipar të portretit fizik të Djaloshit të Pashëm, si për t'u justifikuar tek lexuesi, për nofkën me të cilën autori i propozon personazhit të tij.

“Fati i novelës mbetet i çuditshëm. Harrohet me të njëjtën forcë që kujtohet, gati 20 vjet pas ndalimit botohet në greqisht, edhe pse novela s’e mori atë që meritonte as në kohën e duhur”.¹⁵⁰

Evidentimi i bukurisë fizike të personazhit është ndofta një shprehje e kultit të bukurisë në traditën letrare klasike, së cilës dekadentët i kundërvinin kultin e shëmtimit.

Edhe pse në veprën e shkrimtarit, na duket se shfaqet në mënyrë të pashmangshme një kontradiktë botëkuptimore, qëndrimet kritike ndaj shumë anëve të jetës të kohës, duke rënë ndesh me mosbesimin, hera-herës mjaft të hapët ndaj çështjes së krijimit të një bote më të mirë, duket sikur zbehen e hyjnë në një udhë pa krye. Duket se dëshpërimi i kohës, ku trajtohet realiteti i tendosur dhe ambienti i tejmbushur, bëhet specifikë narrative që bashkë me largesën tematike të perceptimit të ideve vizionohet edhe atëherë kur mbizotëron një trazim shpirtëror i valëvitur paradoksalisht gjatë përshkrimit të një jete njerëzore dhe një klase shoqërore. Ja si shprehej shkrimtari në ato vite: “As unë nuk përulem. S’ndodhem i rrënuar. Dhe s’do të arrini të ma deformoni shpirtin dhe pavarësinë artistike. Të dy personazhet e librit më qëndronin pranë: Djaloshi i Pashëm dhe Peshku i Kuq, prej kohësh më qëndronin pranë. I vështroja, madje i prekja dhe i dëgjoja. Dhe isha ulur të bëja për ta një studim njerëzor. Janë tejet njerëzorë”.¹⁵¹

Disa nga veçoritë kryesore të personazheve të kësaj periudhe krijimtarie të prozës së autorit mund të ishin:

- Ndryshimet e duhura shpirtërore që kalojnë nëpër situata të skajshme. Këto personazhe nuk përfaqësojnë thjesht vetveten, por janë persona që kanë forcë përgjithësuese, si edhe individualitete që reagojnë mendërisht dhe emocionalisht në bazë të karakterit të tyre ndaj situatave në të cilat ndodhen disa personazhe të tjerë.

- Në vlerën artistike të prozës të Koço Kostës ndikon mënyra e ndërtimit të personazheve dhe vendosja e tyre në situata të cilat padyshim ofrojnë mundësi që vënë në dukje unin e tyre.

- Për sa i përket rrëfimit, autori e afron rrëfimin me lexuesin, e konsideron lexuesin si bashkëbisedues dhe lexuesi nuk e ndien bezdinë apo monotoninë që do ta bënin prozën të huaj për të, por zbulon forcën tërheqëse të fshehur në të zakonshmen.

- Përmbajtjes dhe situatave të personazhit i përgjigjet toni, ritmi dhe atmosfera, përbërës këta të rëndësishëm që kontribuojnë në vlerën artistike të prozës. Funkzioni primar është plotësimi i rrëfimit.

¹⁵⁰ Elsa Demo. *Duhen 200 palë sy që ta shohin qind për qind: (Koço Kosta, “Ata të dy dhe të tjerë”)*. Në: “Shekulli”, nr 329, 28 nëntor 2005, f. 18.

¹⁵¹ Koço Kosta. *Refleksion: Koço Kosta rrëfen vetveten: Diçka për vete dhe për romanin: “Ata të dy dhe të tjerë”* – refleksione, shkrimtari rrëfen vetveten, në: “Tema”. nr. 1641, 9 dhjetor 2005, f. 20-21.

Kujtojmë mendimin e studiuesit Agim Vinca, i cili nënvizon: “Personazhet në një vepër më shumë se karaktere të gjalla të tipit realist, janë mishërim i ideve shoqërore, politike dhe intelektuale”.¹⁵²

Në fakt, personazhet e Koço Kostës kanë vitalitetin e tyre të brendshëm, logjikën e brendshme që riprodhon logjikën e karaktereve në realitet.

Duke pikasur veset në jetën shqiptare, ai njëkohësisht, është në anën e së vërtetës. Mjafton të kujtojmë vëllimin me tregime dhe novela “Paradite me shi” dhe të kuptojmë se shkrimtari ka një stil rrëfimi mjaft të kursyer, por dhe mjaft komunikues.

Vlen të përmendim edhe mendimin e Jorgo Bllacit, se “Shkrimtari zbulon plagë shoqërore dhe në funksion të këtyre plagëve që zbulon ai vë edhe inkoherenca të shpeshta dhe të qëllimshme, i përzemërt dhe lirik ndaj frazave. Karakteret janë një galeri e tërë tipash që nga njerëzit e thjeshtë e deri te ai me post të lartë shoqëror”.¹⁵³

Nisur nga kjo, dalim në përfundimin se shkrimtari ka mundësi të jashtëzakonshme, analizuese e përgjithësuese, për faktin se përcjell mesazhin kuptimplotë. “Shkrimtari duhet ta njohë realitetin në mënyrë të drejtpërdrejtë. Këtë realitet e vëmë re edhe në tregimet e këtij vëllimi të Koço Kostës i titulluar “Unë dhe komiti”, ku përshkruhet me ngjyra të gjalla bota shpirtërore dhe mendore e heroit kryesor, një djali të vogël që shkon në mënyrë bindëse pas të atit, i cili kulloste bagëtitë e të pasurve”.¹⁵⁴

Në kuadër të kategorisë së rastësisë individuale të personazheve merr pjesë elementi i parimit kompozicional të veprës. Citojmë në këtë rast mendimin e N. Frajit, i cili shprehet se “Forma e plotë është *kërkimi*, i cili realizohet në tre etapa: etapën e udhëtimit, betejën kyç dhe ekzaltimin e heroit”.¹⁵⁵

Personazhi kryesor, nëpërmjet gjuhës që ka zgjedhur autori në portretizimin/individualizimin e tij, është i sinqertë në vete derisa thyen kufijtë e dyshimit brenda vetvetes. Vlen të theksojmë se, një vend të rëndësishëm zë edhe nëna e Gavrilit, e cila bën një thirrje para pemës ku vareshin sandalet e birit të saj të zhdukur nga peposhët. Ajo, brenda marrosjes së saj, akuzon me britma ngjethëse prej një nëne të plagosur në shpirt: “Ju të goditur dhe unë e marrë”! Dhe thërret përsëri: “Jo sot e marrosur, joo”!¹⁵⁶

Shembujt e mësipërm dhe të tjerë që gjallojnë nëpër krijime të ndryshme në prozë të këtij autori luajnë një rol specifik përshtat strukturës unike të rrëfimit. Autoriali i këtij tregimi dëfton origjinën e fakteve letrare, burimet jetësore të letërsisë, d.m.th., rrugët e përfitimit dhe formulimit fillestar të subjekteve, të cilat nevojiten për ndërtimin e veprës. Në mënyrë të thjeshtë dhe diskrete, nga ngjarjet e njerëzve, të rrugëve dhe të botës që njeh, autori kalon në një përgjithësim të natyrshëm për botën dhe njerëzimin.

¹⁵² Agim Vinca. *Letërsia bashkëkohore shqipe* (grup autorësh), Libri Shkollor, Tiranë, 2004, f. 368.

¹⁵³ Jorgo Bllaci. *Një libër jashtë skemës*. (Koço Kosta, “Paradite me shi”). Në: “Drita”, 28 qershor, 1992, f. 3-4.

¹⁵⁴ Astrit Bishqemi. *Unë dhe komiti* (1969). Në A. Bishqemi, “Histori e letërsisë shqiptare për fëmijë e të rinj”. Botimi i tretë i plotësuar dhe i përmirësuar. Tiranë.; *Dy lindje dhe dy Perëndime*: Universiteti “A.Xhuvani”-Elbasan. Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë, 2008, f. 375.

¹⁵⁵ N. Fraj. *Anatomia e kritikës*, Rilindja, Prishtinë 1990, f. 255.

¹⁵⁶ Koço Kosta. *Absurdi*, Shtëpia botuese “Dudaj”, Tiranë 2009.

Edhe romani “Nata e Sofie Kondilit” do të shkrihej në vazhden e saj, aty ndiqen jo pak teknika moderniste, sidomos reduktimi apo presimi i kohës. Edhe protagonistja e këtij romani, Sofia, është portret/karakter individual, në kuptimin e mirë të fjalës, lufton për realizimin e lumturisë së vet, të mishëruar tek dashuria.

Lidhur me funksionet e motiveve dhe personazheve, që variojnë në krijimtari, por që mbeten pjesë/hallkë e atij zinxhiri të krijimeve në tërësi, mund të kujtojmë pikëpamjen e një teoricieni të njohur, i cili arsyeton se: “Ashtu si përralla, edhe tregimi artistik mund t’i shfrytëzojë të njëjtat personazhe dhe të njëjtat motive, por funksionet e tyre brenda sistemeve në përjetimin e botës përbëjnë dallimin thelbësor”.¹⁵⁷ Një karakteristikë të tillë e vëmë re edhe në krijimtarinë e shkrimtarit.

Planimetria e lëvizjes së personazhit u nënshtrohet ligjeve të brendshme artistike dhe kjo ka bërë që fati i personazhit të kundrohët deri në imtësi.

Jo vetëm në këtë roman, por edhe tek romani “Absurdi”, ndihet të respektohet një konceptim i tillë.

Citojmë një vlerësim kuptimplotë: “Ekzistojnë një kategori njerëzish, që, ndonëse e kanë jetuar kështu, apo edhe më keq, mohojnë ekzistencën e këtij “Absurdi” kaq të egër dhe mizor, që shkatërroi mijëra jetë, që vrau Gavrilët me shokë, që bëri që nënat e tyre të enden të marrosura në kërkim të sandaleve të varura të bijve të tyre, që me mijëra të tjerë, të degjenerohen deri në atë shkallë sa të spiunojë vëllai - vëllanë, gruaja të shoqin dhe mbi të gjitha, këto t’i ngrenë në pedestal, atë që autori thotë me forcë: krijimin e njeriut të ri, fabrikimin e Peposhëve, të cilët për shumë vjet fabrikuan mbi fatet e shokëve të tyre.”¹⁵⁸

Përpjekjet për të depërtuar në thelbin e ngjarjeve të rëndësishme të jetës aktuale (në romanin “Buka e një stine me borë”), për të zbuluar në mënyrë më të thellë botën shpirtërore dhe emocionale të njerëzve të kohës, jetën dhe punën e tyre, të cilat sollën me vete pasurimin e veprave me elemente të shprehjes artistike, vërehen edhe në lëmin e subjektit e të kompozicionit, në mënyrën e rrëfimit, në mjetet e karakterizimit të personazheve etj. Subjekti shikohet si pasqyrim i ngjarjeve në rendin kronologjik, ku për paraqitjen e karakterit të personazheve, vijon të përdoren mundësitë që ky subjekt jep.

Zhvillimi i ngjarjeve është i ndërvarur sipas parimit shkak-pasojë dhe shpalimi i historisë së marrëdhënieve të personazheve ndihmon të zhvillohet fizionomia e tyre shpirtërore, aspiratat dhe synimet që kanë në jetë.

Kritika e kohës e ka vërejtur këtë harmoni në vepra: “Shkrimtari i përligj masat energjike që ndërmerr Peliku për të zhdukur të metat”. Duke iu përgjigjur pyetjes se cilat ishin arsytet e fitores, autori vë në dukje se Peliku është i matur dhe fjalëpakët e këto cilësi e rrethojnë atë me një respekt dhe dashuri të veçantë. Veçoria e talentit të autorit është se u jep mundësi konflikteve dhe karaktereve që zbulohen natyrshëm, pra ai nuk ndërhyrë arbitrarisht në ecurinë e ngjarjeve dhe të veprimeve të personazheve.¹⁵⁹

¹⁵⁷ Shih Milivoj Solar. *Novela dhe përralla*, në librin “Teoria e Novelës dhe e tregimit”, Flaka e Vllazërimit, Shkup, 1995.

¹⁵⁸ *Shënime mbi romanin: “Absurdi” i autorit K. Kosta*. Në: “Shqip”, 26 mars 2009. (Njëlloj me librin).

¹⁵⁹ Koço Bihiku. *Jeta bashkëshortore në romanin shqiptar të realizmit socialist të viteve 70*. Në: Studime filologjike. nr 3, 1980, f. 83-86.

Një konceptim i tillë i personazhit të këtij shkrimtari, është shprehje e konceptit se njeriu është produkt i marrëdhënieve të caktuara shoqërore, ndërsa shëmbëlltyrat janë “zëdhënës” të ideve të reja të momentit, dëshirave dhe aspiratave. Për këtë arsye, shkrimtari ka përshkruar në mënyrë të gjerë dhe të hollësishme jetën e këtyre personazheve si shprehje e traditës, moralit dhe virtyteve etnopsikologjike. Jo vetëm për të individualizuar personazhet e ndryshme, por edhe për të stolitur frazën gjuhësore, shkrimtari zgjedh dhe riaktivizon fjalë dhe frazeologji të ndryshme. Duke gërshetuar në mënyrë të ndërvarur faktin me fikcionin, shkrimtari e mbështet sistemin e motivacionit në historinë individuale të personazhit, e cila përbën hallkën kompozicionale të veprës, në funksion të së cilës janë vënë të gjitha kolizionet e tjera. Shikimi i së kaluarës, ka ndikuar në aktivizimin e formave, të mjeteve dhe formateve/mjeteve të ndryshme letrare. Vepra e këtij shkrimtari jo në të tëra rastet shfaq një harmoni mes funksionit estetik dhe atij ndikues, që mund ta themi dhe edukues apo didaktik. E themi këtë për vetë faktin se jo në të gjitha veprat, sidomos te tregimet, dalin në spikamë/dukje funksionet njohëse, edukative dhe ideore. Ndodh që në mënyrë të njëanshme disa tregime i takojnë modelit didaktik dhe janë shembull i funksionalizimit të historisë, i vënies së veprës letrare artistike në shërbim të ideve aktuale të autorit. Figurën dhe idetë e autorit i vërejmë lehtë në komentet ndonjëherë deklarative në të folurit e autorit-narrator, por edhe në ligjëratën e personazheve të ndryshme, që iluzionisht nuk mund të përfaqësojnë autorin, në dashurinë dhe urrejtjen e hapur ndaj shëmbëlltyrave të ndryshme, në këndin e caktuar të shikimit të ngjarjeve, në orientimin dhe kontrollimin e kërkësisë dhe gjykimit të lexuesve për orientime/anësi të ndryshme semantike.

Padyshim, që shkrimtari e ndjek personazhin dhe ka përshkruar me mjaft hollësi ngjarje dhe akte të njohura të kësaj lëvizje në tërësi. Është mjeshtëria e tij që nuk i lë lexuesit për të vetëkuptuar dhe për të gjykuar për arsyeshmërinë dhe motivin e sjelljeve, gjesteve dhe veprimet të personazheve që të nxjerrë përfundime të pavarura për kohën, për të drejtën dhe të padrejtën. Sigurisht që fabulën e përbëjnë shumë hallka së bashku dhe shkrimtari këtë ka dashur, që ideali pozitiv i njeriut të jetë: liria, humaniteti dhe zhvillimi i mendimit të lirë. Kur mbyll faqen e fundit të librit, lexuesi hap faqen e parë të mendimeve e meditimeve të veta, për atë që e ka gjetur në libër, dhe për atë që do të dëshironte ta gjente. Këto ngrihen mbi shtratin e jetës së sotme dhe arrijnë nivelin e duhur artistik të letërsisë.

Syri i një vëzhguesi të vëmendshëm kërkon të hyjë tek thelbi i dukurive që është prezent në ngjarjet e ditës. Ndjeshmëria e tokës, bimëve, bagëti dhe staneve, ndihet tej e ndanë faqeve të tij, e thërrmuar në përjetimin lirik të autorit, që vjen në pjesën narrative dhe në botën shpirtërore, plot ngrohtësi e ndjeshmëri të Pelikut, në gjerësinë e ndjenjave dhe humorin zhurmëmadh të Puravelit, në meditimet e Kristinës e të disa personazheve të tjerë, që në mënyrë të përbashkët krijojnë tablonë e fshatit apo të njerëzve të tjerë, me punët, problemet, ndjenjat, pasionet, kontradiktat dhe zgjidhjet e tyre. Mentaliteti i pronarit, aq i stërholluar dhe i pangopur për të siguruar fitime e mirëqenie më shumë sesa kolektivi, veprimet apo përvetësimet e hapura marrin një gjerësi të madhe. Vepra e autorit merr vlera të veçanta si nënvizim i një dukurie të re dhe si një zgjidhje e saj që afirmon psikologjinë e personazhit, i cili nuk trajtohet vetvetiu, po në procesin e zgjidhjes së disa kontraditave si: konceptet e Buxhelit, të së shoqes dhe Ndone Tromarës, i mohon mbesa Lili, vajza qytetare që bashkon fatin me fshatarin Mako Dushi. Personaliteti i ndrydhur i Belës nis të zgjohet. Në

vepër kemi gërmadhat e Buxhel Zherdit nga “Dademadhja”. Buxheli është topitur, rri në hije, fati i tij nënkuptohet, ai s’ka më peshë, ndihet vetëm fjala e së shoqes.

Kapitulli IV

4 Veçori të prozës rrëfimore të Koço Kostës

Prozën rrëfimore të Koço Kostës, po të përqendrohemi tek struktura e saj pararomanore, domethënë tek tregimet dhe novelat, ku shfaqet më tepër origjinaliteti i individualitetit të tij krijues dhe që spikat krahas tregimtarëve të tjerë bashkëkohës, si Naum Prifti, Vath Koreshi, Zija Çela, Nasi Lera, Sotir Andoni etj. do të mund ta përkufizonim nëpërmjet disa tipareve të caktuara.

Disa nga këto tipare që e bëjnë aq të veçantë mund të ishin:

1. Aplikimi/zbatimi i të ashtuquajturit parimi i “ajsbergut” përgjatë strukturave narrative, ku janë pjesët e shfaqura, por ku ndihen përmes nënteksteve, asociacioneve dhe kapërximeve të ngjarjeve, që së toku krijojnë ndjesinë e një vëllimi tekstor më të gjerë se ai që është i shfaqur imediatisht.

2. Dinamizmi i stilit, që shprehet nëpërmjet frazës së shkurtër, domethënëse dhe jo pak shprehjeve çelës (fjalë dhe fjali që përsëriten, frekvente).

3. Roli i nëntekstit si një rrymë e fuqishme e brendshme, që rrjedh së brendshmi dhe gufon herë pas here së jashtmi.

4. Dramatizmi nën vellon e së zakonshmes, së përditshmes. Në këtë pikë gazetari e ka mësuar shkrimtarin, i ka dhënë lëndën e parë si argjilë nga realiteti, për t'i dhënë pastaj formën e duhur në një material tjetër, atë letrar.

5. Kontrasti midis karaktereve të kundërta, një trashëgimi kjo, nga tradita romantike e që shprehet në trajtat e realizmit.

6. Shumëllojshmëria në dhënien e figurës së rrëfimitarit, që herë di më shumë se personazhet (pra, identifikohet me autorin si rrëfimtari tradicional i gjithëdijshëm, që depërton në thellësi të botës së personazheve duke drejtuar “kamerën” e vet, qoftë së jashtmi në portretin e tyre fizik dhe në veprimet, qoftë së brendshmi, në botën e tyre shpirtërore, në vetëdije dhe nënvetëdije), herë di po aq sa ato apo më pak se ato personazhe.

7. Thërrmimi i subjektit, një tipar ky dukshëm modern.

8. Mungesa e një subjekti të jashtëzakonshëm, që e habit dhe e trondit lexuesin me suspansa dhe befasi, me shpejtim dhe vonesa në rrjedhën e ngjarjeve. Por prania e tyre, në dukje fare e munguar, jepet nga K. Kosta nëpërmjet një fakti dhe subjekti, në dukje krejt të zakonshëm. Ky autor nuk synon të befasojë lexuesin nëpërmjet “gjetjeve” sensacionale.

Në lidhje me tiparin e parë të prozës së K. Kostës, mund të themi se ai lë në hije shumë gjëra nga parahistoria e personazhit ose nga labirintet e vetëdijes dhe nënvetëdijes së tij dhe përdor një teknikë pothuajse teatrore/dramaturgjike në vizatimin e tyre, duke u përqendruar tek dialogët, që shpesh kufizohen me disa fraza domethënëse dhe tek veprimi që rrjedh i shpejtë dhe dinamik.

Mund të ndalemi tek tregimin “Anika”, një tregim me një subjekt në dukje fare të zakonshëm, faza e dytë e evolucionit në zakonet e martesës në fshatin shqiptar, që ka evoluar në krahasim me traditën, kur të porsamartuarit lejoheshin të shiheshin për herë të parë vetëm natën e martesës. Zakoni i lejonte dy të porsamartuarit të shihen për pak çaste, aq sa të lejojnë formën e një ideje për pamjen e jashtme të tyre dhe të shkëmbejnë midis tyre dy fjalë. Frazat e zakonshme mbulojnë një dramë të tërë: dramën e një vajze të heshtur, por plot virtyte, së cilës i mungojnë disa vlera që çmoheshin në martesën tradicionale si origjina e familjes së saj dhe bukuria fizike, por që është e thjeshtë, e çiltër dhe e aftë për një dashuri të thellë dhe besnike. Ajo ka ëndërruar në heshtje për shokun e jetës, por njëkohësisht do të kënaqë prindërit që shqetësohen për fatin e saj, meqenëse ka arritur në prag të një moshe që quhet si e vonë për martesë, por që njëkohësisht ndjen neveri për atë “paradë” për të cilën e shtrëngojnë të afërmit, për ndonjë hile që synon t’ia rrisë vlerën, sado e pafajshme të jetë. Ajo vajzë më tepër hesht se flet, po pas asaj heshtjeje nuk fshihet zbrazëtia shpirtërore, por përkundrazi, thesare të fshehura mençurie dhe mirësie, dashurie për jetë dhe vlerësim të familjes, dashurie njerëzore për të tjerët, për të cilët refuzon të mendojë keq dhe të pranojë dinakërinë e tyre, e zhveshur nga çdo lloj racizmi, siç del dhe nga shprehja e saj: “Gjynah moj hallë, janë të mirë, pse t’u themi jevgj?”¹⁶⁰

Kjo vajzë nuk është një luftëtare që të luftojë në mënyrë të ndërgjegjshme për fatin e saj, por në mënyrë instiktive ngre krye kundër çdo shtirjeje, çdo hileje. Ajo ka një pafajësi të tillë që e bën të paaftë për të konceptuar të keqen, madje e shpreh këtë në frazën e pafajshme lidhur me kunatën, “...pse të jetë dhelpra?” që pasohet nga komenti i autorit që dukej se i vinte keq që në këtë botë kishte edhe dhelpra.

¹⁶⁰ Koço Kosta. *Dademadhja*. Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1976, f. 13.

Pra, ky personazh, e përjeton me dhimbje dhe shqetësim një çast që mund të ishte i gëzuar për të, çasti i njohjes së shokut të ardhshëm të jetës; mungesa e zgjedhjes së lirë dhe të ndërgjegjshme e bën të vështirë atë çast; vajza ka vetëm të drejtën e diskutueshme që të thotë “jo”. Autori sikur e lë qëllimisht në hije atë çast aq të pritur kur dy të rinjtë mbeten vetëm, njëri përballë tjetrit dhe lexuesi e percepton atë nëpërmjet ritregimit me shumë ndrojtje nga ana e vajzës, por nënkuptohet se ka ndodhur diçka me rëndësi: dy njerëz të mirë, të ndershëm, të thjeshtë, kanë kuptuar instiktivisht thelbin e njëri-tjetrit, e kanë kuptuar përmes frazave të pakta, madje edhe heshtjes. Djali flet qartë, shkurt e prerë: “Më do mua?” “Unë të dua, po ti?” Vajza nguron të shprehë pranimin e saj, e shpreh atë vetëm përmes kodit tradicional “Thuaja ti hallë.”, “Si të thuash ti.”

Këto fraza të thjeshta e të zhveshura shprehin pranimin e një fati, ndërtimin e një familjeje, perspektivën për të dashur një njeri tjetër, për t’i qëndruar besnike dhe për të lindur bashkë me të fëmijë.

Në zhvillimin e ngjarjeve luan rol një “hile” e gjetur nga halla e vajzës për t’i përmirësuar asaj paraqitjen e jashtme: veshja e gjashtë palë çorapeve për t’i “maskuar” këmbët e holla që janë bërë objekt thashethemesh nga një njeri keqdashës dhe mandej ndërrimi i tyre fshehtas vetëm me një pale, për t’i dalë përpara zbulimit të mundshëm të “hiles” nga ana e kumatës dinake “dhelpër”. Vajza e neverit këtë hile, e pranon vetëm nga dëshira për t’i kënaqur të afërmit, po rrjedha e ngjarjeve e bën të pavlefshme këtë “hile”, kur dy të rinjtë ballafaqohen me njëri-tjetrin dhe djali si me një vetëtimë, me intuitë percepton bukurinë e brendshme të Anikës në kundërshtim me bukurinë e jashtme që pothuajse mungon. Në tregim ka “suspansë” nga ana e lexuesit se si do të komunikojnë dy të rinjtë me njëri-tjetrin, ndonëse dihet se ata do të martohen, meqenëse ngjarjet jepen në retrospektivë: nuk dihet vetëm nëse ata do të ndiejnë simpati për njëri-tjetrin, përveç detyrimit për të krijuar familje që shpreh pjesëmarrjen, madje ndërhyrjen e bashkësisë në fatin e individit në fshatin shqiptar. Por ajo vetëtimë simpatie shpërthen: ata e perceptojnë njëri-tjetrin si “të mirë”, përtej pamjes së jashtme; dihet tashmë se Anika nuk ka ndonjë bukuri të veçantë, përveç flokëve që një personazh tjetër i quan “të bukur”, ndërsa djali duket shtatmadh. Ai përkufizohet “si një lis i rritur në tokë të majme”, po këtij përkufizimi që hedh dritë mbi pamjen e tij fizike i shtohet një përkufizim që ndriçon botën e tij shpirtërore, “i butë dhe i afërt”.

Dramatizmi i situatës ndihet në disa çaste edhe në disa fraza plot reticensë të Anikës, e cila me çiltërsinë e saj të jashtëzakonshme nuk do të duket më e mirë nga ç’është, edhe nëse luhet me fatin e saj: “S’më pëlqen”...dhe “Nuk dua as...” që autori e plotëson “Nuk dua as burrë”. Pason një frazë kuptimplote nga ana e rrëfimtares që identifikohet me personazhin, hallën e vajzës: “Asaj iu lagën qerpikët. Iu lagën sikur të kish rënë vesë. Autori nuk e thotë qartë fjalën “lot”, por përdor metaforën “vesë”, për të pasqyruar dritën e çiltërsisë fëmijërore të vajzës, që është si një hile në kuptimin e bukurisë shpirtërore, si një lule e fshehur midis barit”.

Edhe heshtja e saj është një heshtje që “flet”. Më vonë vjen kthesa që ndodh në botën shpirtërore të saj, kur bindet se shoku i ardhshëm i jetës është një njeri i mirë dhe mund ta dojë. Djali në fakt përdor shprehjen “të dua”. Megjithatë, nuk është fjala për “goditjen e rrufesë” në frymë romantike, për dashurinë me një të parë që lidhet me pasionet romantike dhe kultin e ndjenjës. Është fjala për një tërheqje të heshtur shpirtërore, jo fizike, por për një

simpati. Rrëfimtaria (pas së cilës natyrisht fshihet autori), gjen një detaj tjetër, tepër fin, për të dhënë kthesën që ndodh në shpirtin e Anikës: “Anika bëri një lule atje te këndi i buzës.” Është një buzëqeshje e fshehur. Mandej përsëritet detaji i lotëve që kësaj radhe janë lot gëzimi.

Është interesante që personazhi i Anikës jepet përmes perceptimit të një personazhi tjetër, hallës, e cila, duke qenë e afërt me të, mund ta idealizonte, por kjo nuk ndodh. Vetëm se ajo i transmeton lexuesit virtytet e fshehura të Anikës. Në këtë tregim edhe rrëfimtaria - personazh që merr pjesë në zhvillimin e ngjarjeve gjatë tregimit të ngjarjeve portretizohet mjaft bindshëm. Si njeri i brezit të vjetër, ajo mund të mos e kuptonte dramën e heshtur të Anikës, por të mjaftohej me shqetësimin për fatin e saj, me paragjykimin se ajo mos ngelet si “vajzë e mbetur” dhe madje t’i dukeshin si trille mospranimet e saj për t’i zbukuruar gjërat. Në fakt, nuk ndodh ashtu. Ajo merr pjesë në mendimet dhe ndjenjat e vajzës me një shqetësim, dashuri dhe intuitë prej nëne. Ajo bën disa vërejtje që tregojnë logjikën e shëndoshë të saj dhe njohjen e realitetit. Ajo e zbulon menjëherë thelbin e karakterit të kunatës, mendjengushtësinë dhe dinakërinë e saj. Ajo trillon atë “hile” të pafajshme që mund të ndikojë dhe në fakt ndikon në përcaktimin e fatit të Anikës, të paktën në pranimin e saj nga familja e dhëndrit të ardhshëm, meqenëse ata vlerësojnë në radhë të parë tradicionalisht bukurinë e nuses, ndërsa dhëndri është në fakt më mendjehapur, por halla këtë ende nuk e di. Ajo është e vetëdijshme për kufizimet e zakonit. Ajo është psikologe e mirë siç tregon pohimi: “Mua më pëlqen, por Anikës nuk i thashë asgjë, se s’dihej si vinte puna”. Po të ndikonte keq djaloshi, do ta shaja. Ajo në fakt do ta “shante” kundër vetë bindjes së saj djalin, për ta ngushëlluar vajzën për dështimin e marrëveshjes nga e cila varej vetë jeta e saj. Më vonë, ky personazh miraton zakonet e ri të martesave me dashuri, ngaqë është e vetëdijshme se zakonet e vjetra mund edhe ta shkatërrojnë fatin e vajzave, se ndonëse rasti për të cilën ajo flet pati fund të lumtur, ky fund i lumtur nuk vinte gjithmonë, se rreziku ishte i madh”.

Një teknikë rrëfimtare të ngjashme përdoret në tregimin “Babai”, ku i ati portretizohet përmes rrëfimit të të birit, i cili e vlerëson, madje e adhuron, por megjithatë e përkufizon si “të çuditshëm”, se nuk arrin të kuptojë plotësisht. Brenda kuadrit të familjes pasionet janë të forta, dashuria dhe mllefi shkojnë pranë e pranë, madje shpesh shkrihen në një ndjenjë ambivalente. Në këtë rast, i biri e përshkruan të atin me dashuri, duke nënvizuar cilësitë e tij që mbizotërojnë mbi të metat dhe kufizimet e tij, megjithatë, vihet re edhe një frymë kritike që lidhet me ndryshimet e mendësisë midis brezave. Rezultati i këtyre ndjenjave relativisht të kundërta është një portret në thelb objektiv. Ky tregim nuk ka në fakt pothuajse subjekt, aty vizatohet një portret përmes përshkrimit të ndjenjave të rrëfimitarit dhe tablove të fëmijërisë së tij (është për t’u vënë re se Koço Kosta e njeh psikologjinë e fëmijës, prandaj arrin t’i pasqyrojë ngjarjet dhe personazhet nëpërmjet optikës së tij). Babai i rrëfimitarit është një njeri që ka luftuar, por nuk përshkohet me ngjyra retorike, por nëpërmjet tregimit të një fakti të thjeshtë, një episodi kur partizanët e uritur në një shtëpi i presin me mikpritjen shqiptare. Rrëfimtari në këtë tregim edhe përshkruan, edhe tregon. Ai bën dhe vërejtje si ajo “Të moshuarit jetojnë shumë me të kaluarën”, vërejtje që mund të duket e zakonshme, por në këtë rast babai i rrëfimitarit kujton ngjarje të rëndësishme që lidhen me heroizmin e tij të heshtur dhe me mirënjohjen. I biri me intuitë i kupton ndjenjat e të atit, shqetësimin e tij, që nuk e kishte sa duhet të qartë në fëmijëri, se i biri ishte tepër i butë, ndërsa jeta kërkonte burrëri.”

Kuptimplotë është vizatimi i portretit të babait si “tepër i madh” që “shtëpia mezi e merret”. Nënkuptohej se s’është fjala për madhësi fizike, por për madhësi shpirtërore. Hija e babait mbizotëron në familje. Edhe frazat që i vihen në gojë janë kuptimplotë. Ai thotë: “Pse s’mëson?” dhe kjo mund të ngjajë si paradoks, meqenëse babai e gjen të birin të përkulur mbi libra. Por i biri e vret mendjen për kuptimin e vërtetë të fjalëve të të atit. Ai e përshkruan të atin në çaste gëzimi kur këndonte shumë këngë njëra pas tjetrës dhe pinte raki. Pra, ishte një njeri që i donte gëzimet e jetës dhe i ndiqte zakonet shqiptare. Por në marrëdhëniet e tij me të birin ka diçka të veçantë, ai e shikon të birin shtrembër dhe i pasigurt dhe “shfryn si dem i tërbuar”, kur i biri që s’dinte të këndonte dhe s’pinte raki, largohet nga gostia.

Djali flet për një lloj qëndrimi përbuzës të të atit ndaj tij. Pikërisht këtu, rrëfimtari dhe autori që fshihet prapa tij, lë disa zona të errëta. Nuk flet për dhimbjen e heshtur që personazhi duhet të ketë provuar, as për ndjenja rebelimi ndaj të atit, as për përpjekje për të aluduar për mungesë mirëkuptimi me babanë për botën shpirtërore të atij vetë, as për një zili të mundshme që mund të provonte i biri ndaj epërsisë së të atit ndaj tij në disa fusha, të forcës fizike, të zotësisë në të shtënë, të zotësisë në të kënduar, në të pirë.

Qëndrimi përbuzës i të atit mund t’i kishte frymëzuar të birin një mllef që të shndërrohej në një urrejtje të fshehtë (ashpërsimi i konfliktit midis brezave), ose për një ndjenjë inferioriteti. Por nënkuptohet se djali e ka pranuar të atin si ai ishte, se respekti dhe dashuria ndaj tij ishin më të forta se çdo pakënaqësi dhe ndonëse nganjëherë e sheh si “të çuditshëm”, e vlerëson traditën që mishëron ai dhe veçantësinë e tij si individ. Kontradikta ndaj prirjes së të birin për botën e letërsisë, pra, për një botë ideale, “virtuale” dhe prirjes së të atit për jetë praktike, nuk shndërrohet në konflikt, madje babai bën një përpjekje për të depërtuar në fshehtësinë e botës së të birin, siç dëshmon ky dialog midis protagonistëve:

“- Po ai amerikani si e ka emrin?

-Witman-thashë unë.

Emër i ngatërruar

-Ka qënë partizan, domethënë...

-Si tha mësuesi për këtë amerikanin?

-I madh, - tha, - donte lirinë, donte demokracinë

-Ka luftuar?

Patjetër që ka luftuar.”¹⁶¹

Babai përpiqet ta kuptojë të birin dhe shkrimtarët që do ai dhe po në mënyrë naive ai përshat psikologjisë së vet. Një njeri që do lirinë, patjetër që edhe lufton për të. Ai nuk e përftyron dot një njeri liridashës që lufton vetëm me fjalë, siç ka qënë rasti për Witmanin. Nuk e kupton forcën e fjalës. Autori depërton thellë në shpirtin e personazhit dhe në atë perceptim të gjërave që ngjan si naiv tek ai. Koço Kosta pasqyron edhe shpirtin kritik të personazhit, i cili është në gjendje të vlerësojë me intuitë dhe artin, bie fjala, një këngë. “Ja ashtu, ato fjalët...

-me shat e me kazma

Ato fjalët nuk duhen, nuk duhen
Ai që ka një mall të atillë
e gërmon me thonj varrin.
Dua të them, nuk duhen ato fjalë.
Jo, ti nisu nga populli”.¹⁶²

Populli nuk e thotë atë, se nuk duket se ai është i tepërt, siç është mangut një njeri që s’di këngët e vendit të tij.

Pra, ai ka një ndjenjë instiktive se ç’është konciziteti, si duhen mënjanuar fjalët e tepërta, mandej rrëfimtari, duke pikturuar portretin me fjalë të të atit, përpiqet që t’i shtojë një tipar, i cili, në atë kohë perceptohej si pozitiv, ndjenja klasore, të cilin i biri e ndan me të. Është i deklasuar, ka qenë në burg për veprimtari kundër pushtetit, - thotë djali dhe i ati ia kthen: “Tani po mësojnë të duken të mirë, të buzëqeshin”.

Është një tipar që vendos vulën e kohës, i natyrshëm për një djalë që merr në shkollë “dukuri revolucionare” dhe për një ish partizan. Autori e jep këtë me objektivizëm që në kohë përkufizohej si vigjilencë dhe tani (kësaj kohe të mëvonshme) mund të shihet si rreptësi e tepruar dhe mungesë humanizmi.

Teknikën e vizatimit të personazheve, nëpërmjet optikës së personazheve të tjerë, K. Kosta e përdor edhe në tregimin, “Po ti si thua”?, ku heroi i vogël Ramniu jepet përmes perceptimit të dy personazheve, mësuesit dhe të atit të tij. Teknikën e autorit në këtë rast do të mund ta përkufizonim si përdorim të dy “zërave” të ndryshëm, teknikë moderne kjo, që mund të kombinojë subjektiven dhe objektiven, sepse subjektivizmi i dy personazheve të ndryshëm që plotësojnë njëri-tjetrin do të mund të japë një përfytyrim objektiv për personazhin që vizatohet.

Personazhi mësues, vëren diçka interesante: “Qëllonte shpesh që merrte notën dhjetë, pikërisht kur të gjithë ata që pyeteshin ishin të papërgatitur, një gjë e tillë më pëlqente, por kishte edhe raste kur unë ndieja një revoltë të brendshme pikërisht nga kjo gjë”.

Rrëfimtari nuk e shpjegon atë “revoltë të brendshme”, disi e çuditshme për një mësues që mund të shpjegohej lehtë, përkundrazi, nga ana e shokëve që mund të ndienin zili. Nuk e shpjegon, por mund të lidhet me dyshimin se mos Ramniu kërkon të shkëlqejë mbi të tjerët. Ka dhe një rast që mësuesi i vë një notë më të ulët Ramniut dhe vëren reagimin e tij (ai përplasi njëherë qerpikët e pakët) dhe çuditërisht iu kujtua një shoqe shkolle e llastuar që qante kur merrte nota të dobëta. Megjithatë, Ramniu e mban veten dhe nuk i shfaq ndjenjat e veta në mënyrë të papërmbajtur, por me mençuri kontrollon saktësinë e përgjigjes së vet në libër, pra, ka një ndjenjë të natyrshme të drejtësisë dhe jo sedër të sëmurë. Edhe në rastin kur papritur ai merr notën pakaluese, ai kontrollon përgjigjen e vet. Por Ramniu s’ ishte vetëm një nxënës i heshtur dhe studioz, ishte gjithashtu edhe i mençur. Ai është edhe i dashur, në atë mënyrën e vet të heshtur dhe pa bujë. Ai gjen një lule kur duhet të ndahet me mësuesin, një gjest shumë delikat nga ana e tij, që nuk kuptohet dhe aq nga nxënësit e tjerë, të cilët u habitën sesi mund të dhuroheshin edhe lule kur largohej një mësues. Gjithashtu, rrëfimtari shton një detaj: “në atë stinë lulet ishin të rralla dhe vështirë t’i gjeje mësues”, pra Ramniut i është dashur ta kërkojë. Mësuesi e falënderon me një përqaftim që ndiqet me një farë zilie nga nxënësit e tjerë.

¹⁶² Po aty, f.71.

Në këtë rrëfim të parë, Ramniut nuk shqipton asnjë fjalë. Ashtu nënvizohet natyra e tij e heshtur. Është një heshtje thjeshtësie e jo mendjemadhësie. Përkundrazi, në rrëfimin e të atit, Ramniut flet. Ai zbulohet në këtë rrëfim në dashurinë e tij për tërë qeniet e gjalla. Kur sëmuret shelegia, fshatarët mundohen ta shërojnë në mënyrën e vjetër popullore, por s'ia arrijnë qëllimit. Ramniut atëherë i bën të atit një pyetje të mençur "Pse s'erdhi veterineri?" Babai i Ramniut shton një episod kuptimplotë. Ramniut kërkon dhe gjen qenin që kishte zburar e ëma dhe e kishte lënë pa bukë dhe e ushqen, por kur qeni ngordh, sëmuret nga hidhërimi. Në këtë rrëfim theksohet edhe dashuria për studim e Ramniut, përmes ndjenjës ambivalente të të atit që e sheh se vazhdimisht lexon dhe e qorton, por në të vërtetë i vjen mirë, madje, siç thotë vetë "ndien kënaqësi të jashtëzakonshme" edhe për lulet, për të cilat i vjen keq kur të tjerët ia shkelin. Madje ai interesohet edhe për zogj, që mund të konsiderohen të shëmtuar, si kukumjaçkat. Gjithashtu, Ramniut revoltohet kundër atyre që duan t'ia kufizojnë ëndrrat në sajë të mendjemadhësisë së tyre, si kryetari Shemsho. Ai hesht para fjalëve prej mendjemadhi të kryetarit, por i bluan këto fjalë në vetvete dhe nuk fle gjersa gjen rast t'i hapet të atit dhe t'i drejtojë pyetjen e mençur: "Pse nuk më tha?"

Ai pra, dëshiron të ndjekë studimet e larta, ndërsa kryetari mendon se ai është i aftë vetëm të bëhet bari si i ati. Kur ia hap zemrën të atit, ai nënvizon: "unë i dua dhentë", pra, edhe bari mund të bëhet, por ai dëshiron të thellohet më shumë, të marrë më tepër dituri. Shohim pra, tiparet kryesore të Ramniut nëpërmjet dy optikash të ndryshme. Pasionin për studim mësuesi ia vlerëson, por ka edhe frikë se mos ai do të dalë mbi shokët dhe të bëhet mendjemadh. Në një çast i duket sikur Ramniut e gjykon dhe e kritikon pa zë. Në fund ai e kupton plotësisht zemrën bujare të Ramniut. Këtu del edhe dashuria e Ramniut që përkulet të shkrihet me dashurinë e tij për mësuesin. I ati krenohet me pasionin për studim të Ramniut, e vlerëson dashurinë e tij për të gjitha qeniet e gjalla, që përkundrazi, e ëma, me një mendësi të kufizuar dhe shpirtthatësi s'ia vlerëson. Gjithashtu, përmes këtij rrëfimi, shohim ëndrrat e Ramniut për të ardhmen që e çojnë larg dhe që kundërshtohen nga ndjenja e superioritetit të kryetarit, që i përbuz njerëzit e thjeshtë dhe e ndan në mënyrë të prerë botën e intelektualëve nga ajo e fshatarëve. Figurën e Ramniut nuk e shohim me vokalizim të brendshëm nëpërmjet rrëfimit në vetë të parë, as nëpërmjet monologëve të brendshëm. Kjo figurë vizatohet me një lloj teknike teatrore, nëpërmjet frazave kuptimplote, shumica e të cilave janë pyetje që shprehin një kërkim, gjykim, a kritikë. Është me interes fakti që këtë fëmijë të mençur dhe të guximshëm, nuk e vlerësojnë tipa si drejtori i shkollës ose kryetari Shemsho, tipa intelektualësh narcistë, tipa shefash të vetëkënaqur, që nuk mund të kuptojnë mençurinë e vërtetë popullore, bukurinë e thjeshtësisë, por që gjithnjë mençurinë e të tjerëve e vështrojnë si kërcënim, pra, këtu gërshetohet një tipar tjetër i prozës së Koço Kostës, ballafaqimi i karaktereve të kundërta, që në këtë rast e përforcon evidentimin e tipareve pozitive të djalit, kuptohet, tipare pozitive në formim e sipër, meqenëse është ende fëmijë. Kurse një nga personazhet më interesante nga ana social-psikologjike, fshatari Doke, vizatohet nga këndvështrimi i një rrëfimtari të gjithëdijshëm, që përpiqet të jetë sa më objektiv dhe Koço Kosta përdor në këtë tregim ligjëratën e zhdrejtë të lirë. Në këtë tregim vihet re një motiv që rikthehet, motivi i shkatërrimit, hakmarrja e sofistikuar duke prerë pemët e kundërshtarit apo duke bërë që ato të fshihen. Ky motiv përsëritet në dy forma, nëpërmjet konfliktit të fshatarit Doke me Nase Ksenon, kur priten gjashtë hardhi dhe një ulli, dhe më vonë, nëpërmjet "konfliktit" të njeriut, domethënë Dokes, dhe qenit.

Fshatarin Doke e karakterizojnë tipare të kundërta, si dashuria për tokën, kafshët dhe punën, punë që konceptohet në mënyrë krijuese. Dhe një lloj egoizmi i tij, që ngre krye dhe është më i fortë se dashuria e tij për qenin, bëhet shkak që ai të shndërrohet në zemërgur dhe t'ia vrasë qenit Pirkë gjashtë këlyshët që ka lindur. Në këtë çast ngjet e papritura. Qenit Pirkë, të bindur dhe të përkushtuar ndaj të zotit, i zgjohet egërsia. Kafsha antropomorfizohet, s'është më kafshë, po një nënë që i kanë vrarë fëmijët dhe hakmerret për to. Dhe hakmarrja e saj instinktive ngjan si e antropomorfizuar, gati njerëzore, ajo rrjep lëkurën e portokallit që e ka mbjellë me aq dashuri i zoti në mënyrë që ai të fshihet. Drama midis dy qenieve jepet nga autori me disa fraza lakonike: “Ai shikoi trungun e portokallit dhe u drodh. Ajo ishte një dridhje e tmerrshme. Atij iu kontraktuan tërë eshtrat dhe e kapi një inat i verbër. Goja i thirri me një ulërimë të thekshme, sikur ta kishte goditur dikush befas prapa kokës. Pirka u tërhoq dhe e shikonte drejt e me armiqësi. Pirka është hakmarrë egër për fëmijët e vrarë. Por kjo hakmarrje nuk e bën Dokon të reflektojë për gabimin e vet dhe të pendohet, si nuk e kishin bërë të pendohet për qortimet e gruas dhe të fëmijëve, përkundrazi, kjo e bën të duket edhe më zemërgur. Hakmarrja zgjon hakmarrjen. Ai tani nuk ndjen më dashuri ndaj qenit që e kishte dashur aq shumë dhe që e kishte lënduar në dashurinë tjetër të tij. Për të shprehur këtë shndërrim të dashurisë në urrejtje, autori rrëfimtari shprehet në dy fraza kuptimplote: “Ajo tani nuk mund të ishte Pirkë, atje më tej ishte qeni. Ai nuk donte që të kujtonte se ajo e kishte emrin Pirkë.”¹⁶³

Autori vizaton edhe metamorfozën e frikshme të qenit: “Qeni mblodhi qafën, hapi fort gojën dhe burri shikonte drejt tridhjetë e dy dhëmbë të bardhë të pacenuar. Goja ishte krejt e kuqe sikur të ishte ndezur me zjarr”. Dy ngjyrat: e bardha dhe e kuqja, këtu perceptohen si të llahtarshme, e bardha dhe e kuqja e zjarrit në kuptimin shkatërrues. Frazat ndjekin njëra-tjetrën në një shkallëzim drejt fundit dramatik, vrasjes së qenit, që jepet në tërë mizorinë e saj. Por autori rrëfimtari nënvizon se, duke vrarë qenin Dokja vret edhe një pjesë të vetvetes. Kjo shprehet nëpërmjet një metamorfoze paralele me metamorfozën e Pirkës (ai shndërrohet në një të vdekur të gjallë, fytyra e fshatarit Doke u hutua krejt, u bë e zbrazur nga çdo mendim. Ajo u nxi e u zgjat si koka e mushkës. Dhe, befas, me një shpejtësi të jashtëzakonshme, ai njeri u sulmua nga rrudhat. Sikur u zbardh përnjëherësh, sikur u shndërrua në gërmadhë).¹⁶⁴

Pason në vepër ringjallja shpirtërore e tij që jepet nga autori rrëfimtari me një frazë. Citojmë: “Atë e ringjalli pasioni për punën dhe për drurët dhe në fund jepet një lloj sentence si koment disi moralizues në frymën e kohës. Privatja është e keqe, privatja të shkatërron, të shkatërron shpirtin”.¹⁶⁵

Autori rrëfimtari jep dhe mendimin e vet për personazhin në këto rreshta: “Ai nuk i është falur perëndisë, as si njeri dhe as si qengj. Tërë jetën ai i është falur vetëm punës.” Këtu jepet thelbi pozitiv i personazhit, që ndonëse është tepër plak dhe jeton në moshën biblike

¹⁶³ *Era e udhëve*, Tiranë 1981, f. 148.

¹⁶⁴ Po aty, f. 150.

¹⁶⁵ Po aty, f. 153.

(këtu rrethohet si nga një aureolë legjende), “lëviz dorën e djathtë poshtë e lart, sikur punon me kazmë: punë, punë.”¹⁶⁶

Fraza e mbylljes është kuptimplote: “Sipër qielli kishte një kaltërsi të pasosur, të qartë e të shëndetshme”, - frazë që të jep idenë e pafundësisë dhe të dritës, që i tejkalojnë përpjekjet e njerëzve, pra, një dramë në miniaturë. Autori nuk përdor teknikat e monologut të brendshëm, apo të “përroit të ndërgjegjes”, ai jep gjithçka nëpërmjet përshkrimit dhe veprimit, me pak dialogë shprehës. Por ndihet të shihet personazhi si i gjallë.

4.1 Parimi i ajzbergut si veçori kryesore

Te “Fshatari Doke” pika kulminante e veprimit, ku dashuria midis dy qenieve, kafshës dhe njeriut, qenit dhe të zotit, shndërrohet në urrejtje, jepet përmes disa frazave në dukje të thjeshta.

Mjafton të kujtojmë fjalinë “Ajo tani s’mund të ishte Pirkë, atje më tej ishte qeni.”, dhe të kuptojmë se fshatari pushoi së thirruri qenin me emrin që i ka vënë dhe që për të tingëllon përkëdhelës. Tashmë e sheh si “qen” (nënkuptohet si kafshë, si egërsirë).

“Atij iu drodh fytyra, iu tundën nofullat dhe i lëvizën rrudhat e barkut tek kërthiza”.¹⁶⁷
(Drama shpirtërore jepet përmes imtësish fizike).

Mandej, në portretin fizik të Dokes shfaqet një detaj i ri, që shpreh kulmin e zemërimit të tij: “në thellësi të atyre syve të hidhur të fshatarit shkrep gjaku”.¹⁶⁸

Portretin e ndryshuar fizik të personazhit, autori e shoqëron me një epitete që shpreh qëndrimin e vet ideo-emocional (syve të hidhur).

Epiteti ka dy valenca të mundshme:

1) të dhimbshëm

2) të zemëruar ose të dhimbshëm dhe të zemëruar njëkohësisht.

Qëndrimi i autorit është në dukje objektiv, megjithatë, ndihet dhimbja e tij për personazhin që edhe e mëshiron, edhe e dënon.

Siç vërehet, personazhi nuk e këput zinxhirin e hakmarrjes me anë të faljes. Ai mund të kuptonte e të falte reagimin e hidhur të qenit, por kjo nuk do të përputhej me karakterin e tij, me ligjet e brendshme të këtij karakteri. Një krijesë e tij është zhdukur, ai harron dashurinë për krijesën tjetër që i përket dhe ndaj së cilës kishte qenë i padrejtë. Ndjen vetëm zemërim, vetëm urrejtje, vetëm dëshirë për shpagim. Autori e kupton dhe e përshkruan drejt atë proces psikologjik që zhvillohet në pak minuta. (Në fakt, para pak minutave ai kishte ndjerë dhembshuri për qenin: “Fshatarit iu dhimbs dhe i foli në emër, pastaj uli mesin dhe zgjati dorën që ta përkëdhelte”¹⁶⁹).

Në pak minuta ka ndodhur kthesa psikologjike, dashuria është bërë urrejtje. (Pse? Mos vallë se në atë dashuri kishte edhe egoizëm?) Personazhi në ato çaste vetëm ndjen, nuk mediton, nuk vetanalizon; më vonë, pas shumë kohe ndërgjegjësohet dhe e shpreh përmes një fraze: “Privatja është e keqe”, që plotësohet nga dy të tjera: “Privatja të shkatërron, të

¹⁶⁶ Po aty, f. 153-154.

¹⁶⁷ Po aty, f. 148.

¹⁶⁸ Po aty.

¹⁶⁹ Po aty, f. 147.

shkatërron shpirtin”, që lidhen në atë egoizëm të pashmangshëm që sjell ndjenja e pronës e që i përgjigjen mendësisë së kohës. Personazhi mund të kishte shkuar më tutje dhe të ishte ndërgjegjësuar që gabimi i tij qëndronte në atë, se ajo e kishte parë si send të vetin një qenie të gjallë që kishte ndjenja, ndonëse s’ ishte qenie njerëzore. Po formimi i tij nuk e lejon të shkojë aq thellë dhe autori është i vetëdijshëm për këtë.

Pak fraza pikturojnë dyluftimin midis këtyre dy qenieve.

Edhe qeni është shpërfytyruar. Shpërfytyrimi i tij shpreh shndërrimin e brendshëm: edhe tek ai dashuria dhe besnikëria ndaj të zotit janë shndërruar në urrejtje; tek ai është prekur një ndjenjë më e lashtë, më instiktive, dashuria prej nëne. (“Sytë e tij ishin të trazuar e të përhumur në një përzierje të verdhë e të gjelbër dhe në skaje kishte sklepa. Ata ngjanin sikur të ishin plakur krejt në një natë...Goja ishte krejt e kuqe sikur të ishte me zjarr”).¹⁷⁰

Autori nënvizon dy elemente të portretit të krijesës: sytë që shprehin ndjenjat, gojën që shpreh agresivitetin dhe tërbimin.

Gjatë dyluftimit përsëritet fraza kuptimplotë: “Ai nuk donte që të kujtonte se ajo e kishte emrin Pirkë”(domethënë, nuk donte të kujtonte që dikur e kishte dashur).

Me pak fraza jepet shndërrimi i mëtejshëm i personazhit tani që ka humbur dy dashuri të rëndësishme të jetës së vet: qenin dhe drurin e portokallin.

“Pas ca ditësh fytyra e fshatarit Doke u hutua krejt, u bë e zbrasur nga çdo mendim dhe befas, me një shpejtësi të jashtëzakonshme, e sulmuan rrudhat.”¹⁷¹

Rilindjen e tij shpirtërore autori nuk e jep së brendshmi, por nëpërmjet frazash si të zhveshura dhe objektive. “Nisi të sillte fidanë të rinj portokalli, dy rrënjë ulliri, hardhi dhe hurma nga të Jemonit, ulej mbi një shkëmb në livadhin e vogël dhe shikonte gjithçka. Atë nuk e punonte askush. Atij i kishte shkuar ndër mend se pikërisht aty nuk mund të mbilleshin agrume”.¹⁷²

Lufta e tij për të kthyer skepticizmin e bashkëfshatarëve, shprehet vetëm me një frazë: “Nuk bëhen o Doke, jo, nuk bëhen portokallet këtu.”¹⁷³

Fitorja e Dokes mbi natyrën dhe skepticizmin e të tjerëve, shprehet përmes një fraze të vetme, koncize:

“Katër vjet më vonë portokalli rriti kokrra.”¹⁷⁴

Pra, ai e ringjalli njëri nga dashuritë e jetës së vet, pemën e portokallit, nëpërmjet një pune disavjeçare ngulmuese dhe krijuese. Portokalli i vetmuar i dikurshëm i kopshtit të tij është shndërruar në një “plantacion agrumesh”.

Autori shton dy fraza kuptimplotë për të nënvizuar lidhjen shpirtërore të Dokes me frytin e punës së vet: “Atij i ngjan sikur është një me drurët e portokalleve. Kur një dru pëson goditje, ai e ndien goditjen në trupin e vet”.¹⁷⁵

Vetëm një gjest i tij në fund të tregimit, kur protagonistin është plakur, po e ndjen veten të ri përmes punës, shpreh kuptimin e jetës së tij: ai lëviz dorën e djathtë poshtë e lart, sikur

¹⁷⁰ Po aty.

¹⁷¹ Po aty, f.150.

¹⁷² Po aty, f. 151.

¹⁷³ Po aty.

¹⁷⁴ Po aty.

¹⁷⁵ Po aty.

punon me kazmë: punë, punë. Vetëm një gjest tek ai zëvendëson fjalët. Ai nuk di ta shprehë thellësinë e ndjenjës, as të mendimit. Autori për të thotë: “Nuk di të mbajë ligjërata për agrumet dhe pemët e tjera” (pra as për diçka shumë të shtrenjtë për të).

Pra, Dokja është një njeri tipik i popullit, fjalëpak e punëshumë. Një frazë kuptimplotë të lë ta marrësh me mend që ai s’e ka harruar qenin Pirkë, të cilin e ka dashur aq shumë dhe e ka vrarë me dorën e vet: “Ai shikoi diku në thellësi të vetvetes dhe thithi duhan i qetë dhe i butë, si Sokrati kur donte të pinte helmin.”¹⁷⁶ Çfarë ndjen ai? Mall, dhimbje dhe pendim? Autori s’e thotë, mjaftohet me atë shprehje të personazhit: “Privatja është e keqe”.¹⁷⁷

Pra, duhej një tronditje e fortë që ai të lidhej me bashkësinë e njerëzve në vend që të mbyllej në vetvete?

Edhe kjo është e fshehur në nëntekst. Me pak fraza autori zëvendëson shumë përshkrime apo monologë të brendshëm.

Edhe në tregimin “Puravel Duka”, nënteksti ka vendin e vet. Këtu personazhi punon, po edhe di të flasë bukur, me një frazeologji të pasur popullore. Personazhi zbulohet në disa mënyra: përmes optikës së rrëfimitarit, përmes optikës së nënës së tij plakë dhe nëpërmjet vetërrëfimit të tij, ku spikasin frazeologjia dhe filozofia popullore, çiltërsia, aty-këtu një vetëmburrje naive. Disa fraza çelës vizatojnë portretin e tij shpirtëror. Ai thotë për veten e tij që flet “ashtu si buron zogu”, pra, natyrshëm, pa i kërkuar fjalët, por duke i gjetur instiktivisht. Personazhi shqipton edhe disa fraza që ngjajnë jo si prej njeriu të popullit, por prej poeti “Sikur nata është bërë që të jetojnë këto, drurët, që të flasin sendet”.¹⁷⁸ Kjo frazë perceptohet me habi nga mysafirët e tij, personazhit rrëfimitar që është një alter-ego i autorit dhe i së shoqes, të cilët çuditen me atë thellësi të papritur mendimi. (Vetë personazhi, njeriu i thjeshtë, s’është i vetëdijshëm për atë thellësi. Për atë, dashuria për natyrën është diçka e lindur. Ai e ndjen veten si pjesë të saj. Kjo çudi nuk shprehet me fjalë, por vetëm me një vështrim të gruas: “Gruaja ime ndali dhe e shikoi në sy me habi dhe me një lëvizje të kokës së burrit”. Unë lëvizja kokën”.¹⁷⁹

Më vonë, personazhi shqipton një frazë tjetër që i lë pa mend bashkëbiseduesit e tij dhe që tregon dashurinë e tij të pakufishme për natyrën, shfaqet po kësaj radhe me një shprehje frazeologjike popullore: “Kur hyn ai yll atje, më vyshket syri”.¹⁸⁰

Kësaj radhe bashkëbiseduesi reagon me një pyetje të heshtur “Si?”¹⁸¹

Dikur me një frazë të mençur Puravel Duka ishte ndeshur me aganë. Pra, disa fraza çelës për të hyrë në botën shpirtërore të personazhit, për të kuptuar humorin e tij popullor, herë-herë të hidhur, shkrirjen e çiltër me botën e natyrës dhe për të vizatuar kështu me pak viza një portret. Po ai parim i “ajsbergut” ndiqet edhe në tregimin “Çumani”, ku personazhi qëndror zbulohet dalëngadalë përmes optikës së rrëfimitarit dhe vetëzbulimit. Në fillim

¹⁷⁶ Po aty.

¹⁷⁷ Po aty.

¹⁷⁸ Koço Kosta. *Dademadhja*. Tiranë 1976.

¹⁷⁹ Po aty.

¹⁸⁰ Po aty.

¹⁸¹ Po aty.

ndeshim një detaj komik të portretit, nëpërmjet perceptimit të një personazhi tjetër, - “shiko sa të madhe e ka dorën, - nuk ia nxë xhepi”.¹⁸²

Më vonë shohim një detaj tjetër, shkathhtësinë e tij praktike në të hapurit me dorë të shisheve të birrës, që koncentrohet nga gazetari si e çuditshme. Mandej, djali shikon “pjerrtas” një vajzë që i kujton atë që dashuron, një detaj i thjeshtë ky, por kuptimplotë. Më vonë e shohim atë të menduar duke pirë cigare: “Fjollat e trasha të tymit i ngjiteshin nëpër fytyrë me ngadalë, siç ngjitet mjegulla shpatit të malit në një ditë vjeshte”.¹⁸³

Pra, personazhi mendohet. Për kë? Për vajzën që do? Për punën e tij në fshat?

Tërë këto informacione (ka qenë bari, ka vajtur ushtar, i do shumë librat), na jepen nga rrëfimtari, por lexuesi nuk di ende të interpretojë “përhumbjen” apo “ngrysjen e personazhit” (edhe këto epitete shtohen nga rrëfimtari). Epitetet në fjalë nuk janë ende çelësa për të zbuluar shpirtin e tij, as për të shpjeguar se përse mendohet apo ëndërron ai. Rrëfimtari shton detajet, rrëfen sesi Çumani dikur e pyeste për librat dhe çuditej pas rrëfimeve të shokut me zbulimin e fjalëve të reja, ai çuditet me emrin e perëndeshës ilire dhe njëkohësisht çuditet me këngën e bilbilave që “sikur tregojnë përralla”. Ai i do librat e shkruara, por dhe librin e madh të natyrës. E ka ndjenjën e çudisë si një fëmijë që u gëzohet zbulimeve të vazhdueshme, dëshmi kjo për freski shpirtërore. Personazhi i Çumanit merr dritë edhe nga kontrasti me gazetarin e burokratizuar, që s’di të mbajë veçse shënime (deformim profesional) përpara gjërave që zbulon nga bota dhe nga njerëzit dhe e ka humbur kaq ndjenjën e humorit sa i duket “i çuditshëm” fshatari, i cili pohon se e ka lidhur “çadrën pa bisht” prapa shpatullave “që të mos i laget logjika” dhe e shënon në bllok thënien e tij.

Më vonë e dëgjojmë personazhin si flet për vete, që ka filluar të ndjekë duke vazhduar njëkohësisht punën si traktorist, flet për të dashurën që e ka pagëzuar me shaka me atë emrin e çuditshëm ilir dhe e përkufizon si të “urtë”, virtyt që e vlerëson me mendësinë e fshatarit. Së fundi, arrijmë në zbulimin e heroizmit të heshtur të këtij djali, i cili, me pak orë gjumë, duke mos u çlodhur mirë nga puna dhe nga shkolla që ndjek natën, vendos të kthehet në fshat, që traktori “të mos mbetet qoftë edhe një orë pa punë”. Rrëfimtari vëren se fjalët e Çumanit për të ikur, - (po të ishte ndonjë tjetër, do t’ia merrja për shaka), nuk ndahen nga veprimi. Ai vetë mjaftohet duke thënë: “Ka njerëz që mendojnë se edhe vetëmohimi ka një kufi”. Ndërsa Çumani ia kthen me një modesti të jashtëzakonshme, aspak të shtirur, për t’i treguar se këtu nuk ka vetëmohim: “Edhe ti, po të ishe në vendin tim, kështu do të veproje”.¹⁸⁴

Lexuesi ndahet nga personazhi dhe frazat e kursyera të autorit e kanë portretizuar në mënyrë të goditur. Lidhur me këtë personazh, të lind pyetja: mos e mishëron ai “heroin pozitiv” të “realizmit socialist”?

Kritika e kohës do ta ketë perceptuar si të tillë, por në fakt ai është një njeri i thjeshtë, me dashuri të madhe për punën dhe për njerëzit, virtyte këto të njeriut të thjeshtë të popullit bashkë me modestinë. Ndihet se autori do të jetë frymëzuar në krijimin e tij në ndonjë prototip të marrë nga realiteti, që e ka frymëzuar dhe e ka riprodhuar e plotësuar me fantazinë e vet krijuese.

¹⁸² Po aty.

¹⁸³ Po aty.

¹⁸⁴ Po aty, f.68.

Në tregimin “Era e udhëve”, personazhi zbulohet gradualisht. Në fillim jepen pak viza të portretit fizik të tij. (Fytyra e tij e madhe me hundën e kthyer kishte pamje, të madhërishtme, por me një shprehje përbuzëse, ngjyra e asaj fytyre m’u duk si ngjyra e eshkës së zier dhe gjithë pamja e tij m’u duk e fishkur, m’u duk e shëmtuar).¹⁸⁵

Mandej, vetëm me një frazë (tre fjalë), fillon të çuditë rrëfimtarin në vetë të parë dhe të zbulojë një njeri krejt tjetër nga ç’ e kishte përfytyruar rrëfimtari personazh.

Personazhi ka njohur tek bashkëbiseduesi një shkrimtar. Ai mban mend hollësisht nga takimi i tyre i rastit. Vetë personazhi – rrëfimtari, një alter-ego e autorit, e ka harruar këtë takim të rastit dhe fizionominë e bashkëbiseduesit; personazhi shofer, një njeri i thjeshtë, i do librat, e do letërsinë. Pak fraza të tjera zbulojnë se ai në mënyrën e vet e të thjeshtë zotëron gjykim kritik, pra, është një lexues i vëmendshëm që thellohet më tej (“kërkoj të dinte se pse e kisha shtuar hyrjen, më parë e kemi botuar në gazetën “Zëri i Rinisë” dhe atëherë s’ ishte hyrja. Më vonë, nëpërmjet çelësit së dashurisë së tij për librat, nis të hapet shpirti i tij dhe ai i tregon bashkëbiseduesit diçka për të kaluarën e vet, për lidhjen e thellë shpirtërore me të atin).

Së fundi, zbulohet dashuria e personazhit për fshatin, tek i cili ai e kërkon të kthehet dhe të lërë punën si shofer në qytet (tha se ndoshta ishte radha e fundit që ngiste atë timon). Kjo frazë e intrigon bashkëbiseduesin. Më vonë, në fund të tregimit, ajo gjen shpjegimin e vet: - “do të iki, do të shkoj në fshat”.

Plot nënkuptim është edhe fraza që personazhi shqiptar e përsërit dy herë: “Shkrimtarët kanë punë delikate”. Kjo frazë e thjeshtë shpreh respektin që personazhi ka për shkrimtarët si njerëz që shkruajnë libra, pa zilinë apo moskuptimin e një njeriu të punës fizike ndaj njerëzve të punës intelektuale, që, sipas një paragjykimi të përhapur, quhen të privilegjuar. Ai, nëpërmjet dashurisë që ka për librin, zbulon instinktivisht vështirësitë e punës krijuese. Dinamizmi i stilit të Koço Kostës shprehet në frazat e shkurtra që arrijnë në një koncizitet të tillë, sa të përbëhen prej dy fjalësh apo prej një fjale të vetme.

Mbizotërojnë frazat pohore, çka dëshmon për një stil të qetë dhe të shtruar. Frazat pyetëse dhe thirrrore janë të rralla. Kjo ushton domethënien se Koço Kosta është konciz, ritmi i stilit është i shpejtë. Ky ritëm ndjek tablotë që dallohen njëra pas tjetrës si në fillim, por ndjek edhe pauzat në zhvillimin e rrëfimit.

Koço Kosta e përdor procedimin e vonesës që mban në ankth lexuesin, kështu që demaskimi i Teberit vjen me vonesë, meqenëse protagonistin është verbuar nga besimi i tij i thellë tek njeriu dhe nuk e kupton thelbin lakmitar dhe egoist të atij që e quan mik dhe tek i cili sheh anët e mira (duke shikuar me sytë e mendjes Teberin, flokët e tij të valëzuar, fytyrën e shëndetshme me pllanga të kuqe, gazin e bukur që i çelte fytyrën dhe mollëzat e ngritura, e tërë fytyra e tij, i tërë shtati ishin shenjë begatie. Begatia është edhe bukuri...).

Në të vërtetë, autori e vonon çastin e zbulimit të hipokrizisë së personazhit Teber dhe në këtë çast aq të thjeshtë dhe aq dramatik, përdor fraza thirrrore që vijnë si shpërthim: “Hënëza të vogla! Bereqet! Be-re-qet”!

Këto fraza e ndjekin njëra-tjetrën si në një shkallëzim: në fillim metafora “hënëza të vogla”, mandej, emërtimi i saktë që jepet duke u përmendur tri herë me radhë, herën e fundit të ndarë në rrokje për ta nënvizuar, më vonë një frazë thirrrore që i drejtohet protagonistit me

¹⁸⁵ Koço Kosta. *Era e udhëve*, Tiranë 1981, f.172-173.

qortimin për mungesën e syçeltësisë nga ana e tij: “Ah, Bashmetëëë ...”, pra një vetëqortim, më i efektshëm se një kritikë nga ana e të tjerëve.

Edhe tek “Fshatari Doke”, një frazë thirrrore “Qeni”, shënon kulmin e intrigës.

Te “Dadmadhja”, fraza e përsëritur me vetëm dy fjalë: “vij vetë”, shpreh dëshirën për pavarësi të protagonistes me gjithë moshën e madhe. Më vonë, kjo frazë plotësohet me një lloj thënie të urtë “Një njeri që s’vjen dot vetëm, nuk jeton”.

Nënteksti ka vendin e vet në prozën e Kostës. Në mes të rreshtave ndihet pesha e fjalëve dhe e frazave të pathëna, e mendimeve dhe ndjenjave të nënkuptuara, hapësira e bardhë/munguar, që i sugjeron lexuesit ta mbushë atë me interpretimet e veta, duke bashkëpunuar me shkrimtarin. Autori nuk kërkon asnjëherë situata të jashtëzakonshme, as personazhe të jashtëzakonshëm. Ai e kërkon dramatizmin, madje tragjizmin, aty ku ai nuk duket.

Lind Pyetja: A s’është tregimi “Anika” një dramë e fshehur, një dramë e heshtur e një vajze që ekspozohet si mall për t’u shitur?

Një dramë që mund të kthehej në tragjedi nëse dhëndri i ardhshëm, dhëndri i supozuar nuk do ta pëlqente vajzën dhe ajo do të mbetej në shtëpi, plagë e hapur për njerëzit e saj. “Fundi i lumtur” është i rastit, djali dhe vajza e simpatizojnë njëri-tjetrin, por të drejtën e zgjedhjes e ka vetëm djali, vajza ka të drejtën e pranimit apo refuzimit. Ajo pranon, megjithatë liria e saj është e kufizuar, ajo e pranon më tepër për të gëzuar të afërmit e saj dhe e nxitur nga besimi që ka te njerëzit, në bazë të së cilit dhëndri i ardhshëm duket si njeri i mirë.

Por ajo nuk e mendon dashurinë si mundësi, aq më pak si bazë për familjen e ardhshme. Fabula e “Fshatarit Doke” është e thjeshtë: një njeri i punës është veçanërisht i lidhur me bimët dhe me kafshët, konkretisht me një bimë portokalli, duke treguar dashuri e kujdes për qenin. Në fakt, nuk mendon për ndjenjat e kafshës, e sheh atë si një qenie që duhet t’i shërbejë. Ai ndjek një praktikë mizore, po që në atë kohë quhej si e zakonshme: I vret këlyshët e qenit. Por qeni ngre krye, ia bren drurin e portokallit në mënyrë që ai të vyshket. Dhe fshatari e vret atë krijesë që dikur kishte dashur, një mikrodramë që ngjan si e zakonshme, e përditshme. Por kafsha humbet jetën, druri i portokallit shkatërrohet, njeriu (fshatari) për pak zhytet në dëshpërim edhe pse ai i gjen forcat për ta kapërcyer këtë dramë.

Tek “I bukuri im”, idili i fillimit shndërrohet në dramë. Protagonisti Bashmeta, kthehet në vendlindje për të kaluar vitet e pensionit, pra, në gjirin e natyrës, të një natyre të bukur. Por edhe në mes të asaj natyre idilike fshihet fara e së keqes. Dhe protagonistin e zbulon dhe i duhet të ndërrojë mendim për dikë që e kishte quajtur mik dhe njeri të mirë. Ai nuk mund të shtiret indiferent sikur nuk ka parë asgjë, kështu që i vë zemrës gur dhe e demaskon mikun e dikurshëm hapur. Ai e bën këtë me dhimbje, por edhe qorton veten për mungesën e syçeltësisë.

Edhe kjo është një dramë që ishte fshehur nën petkun e zë zakonshmes. Njerëzit e njihnin të keqen, por nuk guxonin të vepronin hapur ndaj saj. Protagonisti Bashmeta ia hoqi koren plagës me guxim. Në tregimet dhe novelat e Kostës vëmë re një shumëllojshmëri në llojet e rrëfimitarit që komunikon me lexuesin. Ndeshim shpesh rrëfimitarin në vetë të parë, që është edhe personazh, pra, që nuk di më shumë se personazhet e tjerë. Ndeshim dy lloje rrëfimitarësh me optikë të ndryshme, ndeshim një rrëfimitar në vetë të tretë, por që ka asimiluar optikën e një personazhi siç ndodh me personazhin e Bashmetës tek “I bukuri im”.

Rrëfimtari është njësuar me personazhin në mënyrë që edhe lexuesi bashkë me të në fillim mund të gabohet për Teberin. Veçse disa detaje objektive e zbulojnë pjesërisht këtë personazh hipokrit: mënyra e veshjes së tij, shtëpia dhe kafshët e tij. “Monologu i brendshëm” dhe “Ligjërata e tërthortë e lirë” plotësojnë boshllëqet në atë që rrëfimtari nuk e di.

Edhe tek “Dademadhja”, ndonëse përdoret veta e tretë, që të jep iluzionin e objektivitetit, ka një vokalizim të brendshëm. Tek personazhi i Dademadhes lexuesi e vështron realitetin me sytë e saj. Ka dhe raste që rrëfimi në vetë të tretë shpreh më tepër paanësi si tek “Djaloshi që donte kuajt”.

Një objektivitet të tillë e karakterizon edhe rrëfimtarin tek romani: “Buka e një stine me borë”, por atë e plotësojnë monologët e brendshëm të personazheve. Kontrasti midis karaktereve të kundërta është një procedim që ndiqet më shumë në tregimet e K. Kostës. Kështu, tek “Dademadhja” gjejmë karakteret e kundërta të Dademadhes, mishërim të virtyteve popullore, plot vitalitet dhe në moshë të thyer, plot dashuri për të mirën dhe e gatshme të luftojë deri në fund, ndonëse ka naivitetin e njerëzve shpirtpastër; të Buzhel Zherdit, lakmitar dhe hipokrit që fshihet nën një tis fjalësh të bukura, por vetëdemaskohet nëpërmjet portretit fizik (...të kujtohet ai sy i skuqur që të kujton ujkun?).

4.2 Proza e shkurtër si strukturë pararomanore

Proza e shkurtër në krijimtarinë e Koço Kostës ka veçanësinë dhe autonominë e vet. Megjithatë, struktura e tregimeve dhe novelave mund të quhet edhe si një bërthamë, që përmban në embrion strukturën e romaneve të ardhshme.

Shumë tregime dallohen për intensitetin e veprimit, që të kujton ritmet e dramës dhe vizat e shpejta në të cilat pikturohen personazhet në këtë zhanër skenik, që ka kornizat e veta kohore dhe hapësinore.

Por ka dhe tregime të gjata dhe novela, ku ndihet të përdoret me kujdes procedimi i vonesës, si “I bukuri im” ose “Dademadhja”. Në ndërtimin e tregimeve dhe novelave ndiqet rendi kronologjik, herë përdoret me sukses retrospektiva, si, bie fjala, tek tregimi “Anika”. Në tregimin “Fshatari Doke” ndjekja e rendit kronologjik të lejon të shohësh zhvillimin e konfliktit, i cili shtjellohet në heshtje gjersa arrin pikën kulminante.

Tek “Buka e një stine me borë” ndiqet rendi kronologjik i ngjarjeve. Peliku është figurë që shfaqet në proces gradual në rrjedhë të ngjarjeve e situatave. Në atë kohë personazhi futej në kallëpin/skemat e heroit pozitiv. Këta ishin njerëz të thjeshtë që pastaj rrinin me shpresë të një bote të re por që nuk u ndërtua dot kurrë. Është ky një roman plot kolorit jetësor prej fshatit të kohës e ngjarjesh interesante, por që mbetet gjithsesi edhe fragmentar, mbase dhe nga prirja autoriale për ta kompozuar atë në një strukturë prej mozaiku.

Kurse tek “Nata e Sofie Kondilit” përdoret gjerësisht edhe retrospektiva. Autori artikulon disa modele/lloje rrëfimtarësh, shfrytëzohet monologu i brendshëm, por edhe ligjërata e zhdrejtë e lirë. Në tregimet dhe novelat e tij ka një tendosje të skajshme të konfliktit, një evidentim të nëntekstit dhe një teknikë teatrore. Megjithatë, janë këto tipare karakteristike për prozën e shkurtër ku ndihet edhe një prirje e fshehtë për lloje më të mëdha. Në këto tregime ka personazhe që dallohen për tipare më të theksuara dhe botë më të pasur

shpirtërore, si dhe konflikte që mund të arrinin zhvillimin e veprës më të plotë në roman. Madje dhe lirizmi dhe prirja drejt nëntekstit, që janë të përshtatshme për prozën e shkurtër, janë tipare që do të bëhen karakteristike për romanin modern, ku është bërë i zakonshëm copëzimi i subjektit. Në fakt, në romanet e Kostës vëmë re një rikthim të personazheve më tipike dhe më të individualizuara, si Fshatari Doke, Puravel Duka, Peposh Buzbati, Buzhel Zherdi, Mëma dhe i biri i saj, Nase Kseno etj. Veçse tek “Buka e një stine me bore” autori ka mundur vetëm t’i rigrupojë personazhet, pa u shtuar asgjë tipareve të tyre, madje duke i bërë të humbasin në sfondin e gjerë. Figura e Nase Ksenos, ideologjizohet së tepërmi, duke e kthyer në armik të klasës.

Tek romani “Absurdi”, figura e Mëmës, të birit të saj që aty emërtohet Gavril, kanë një zhvillim, veçanërisht tek ky personazh i fundit. Tiparet negative të Peposh Buzhatit gjithashtu thellohen, kurse personazhi i Betës, dikur i parë në rrafshin lirik, njih një evolucion të çuditshëm në prirje negativizmi.

Tek “Nata e Sofie Kondilit” protagonistët janë krejt të një lloji të ri, megjithatë Kristofor Kotulla ka diçka nga tiparet e personazheve simpatikë të tregimeve dhe novelave, si guximi moral, përkushtimi ndaj një ideali, aftësia për një dashuri të thellë. Ndërsa Sofia ka diçka nga pasioni i heshtur i shumë figurave femërore të tregimeve dhe novelave dhe aftësinë për një dashuri amshore që mbetet potenciale. Meqenëse drama e saj qëndron në pamundësinë për t’u realizuar si grua e si nënë, Sofia është figura themelore më e guximshme dhe më e ndërlikuar që ka konceptuar fantazia e Kostës, që na duket se mund të qëndrojë pranë figurës tragjike të Mëmës.

Pra, në prozën e shkurtër të Kostës, mund të gjejmë disa tipare, të cilat mund t’i përcaktonim si shenja të një strukture panoramike. Kjo lidhet me intensitetin dhe potencën që ato kanë, duke sjellë për pasojë gjatë leximit të tyre ndjesinë e kufijve të kapërcyer të zhanrit të tregimit – drejt atyre të novelës apo dhe romanit. Ky është një tipar i kësaj proze të shkurtër, që e bën autorin të shfaqet dukshëm si një zë me regjistër origjinal në prozën e shkurtër shqipe.

4.3 “Nata e Sofie Kondilit” si kulmi i fazës së dytë të krijimtarisë së shkrimtarit

Me këtë roman autori shënon një moment të rëndësishëm, jo vetëm brenda krijimtarisë së tij; ajo vepër vjen si kontribut me vlerë edhe në kontekstin e romanit të ri shqiptar. Sigurisht, që ai roman është shkruar në një rrethanë krejt ndryshe në raport me veprat e tjera të autorit, ato para viteve ’90-të dhe, për rrjedhojë, doemos që do të konceptohet e përcillet si një vepër e çliruar prej varësive jashtëletrare, pra, vjen si zëri autentik i autorit të saj, i cili tashmë udhëhiqet veçse nga referenca estetike.

Përmes kësaj vepre përcillet përshkrimi i një realiteti që vret një krijesë të brishtë, një femër pa mbrojtje, e rrethuar sistematikisht nga një realitet i vrazhdë.

Lënda e romanit mbarështrahet dhe lidhet në mënyrë organike. Duket se autori i përmbahet kronologjisë së ngjarjeve, duke bërë që romanit të mos i mungojnë skenat dhe situatat që i kapërcejnë caqet e paraqitjes lineare. Shkrimtari sjell risi në strukturën dhe në narracionin e romanit.

E tërë vepra është një zbërthim psikologjik i gjendjes nëpër të cilën kalon Sofia Kondili. Shkrimtari përshkruan me tërë oshilacionet gjendjen nëpër të cilën kalon shpirti i kësaj vajze. Gjithçka duket se vështrohet në një rrafsh ekzistencial, sidomos në raportin e përballjes së vlerave me të keqen, e cila merr forma të ndryshme, duke krijuar dhe një mori situatash të vështira e shpesh dhe molisëse për mjedisin, ku marrin kuptimin e tyre dhe ironia e grotesku, me synimin për t'a bërë më tronditës ambientin e përshkruar.

Struktura unazore e romanit është karakteristike e veçantë e Koço Kostës. Me nota realizmi përshkruhet fati i njerëzve, i lakuar në situata të rënda jetësore, që bëhet njëkohësisht temë obsesive e autorit. Në roman ndiqen në unitet të brendshëm, të harmonizuara, tërë linjat e subjektit. Përshkrimet e skenave të dashurisë autori arrin t'i përcjellë me një fjalor të skalitur/përzgjedhur artistik dhe plot finesë. Kjo e bën atë që të dallohet prej veprave të tjera. Figurat e radhitura për të transmetuar gjendjen e rënduar/traumatizuar e gati të pavetëdijshme të personazheve, gërshetuar me një zinxhir asociacionesh shpesh të befta/të paparashikuara, krijojnë natyrshëm tërë atmosferën ku veprojnë personazhet. Gjuha është e përzgjedhur, lakonike dhe me shtresa dalluese, për ta dhënë kështu në mënyrë sa më gjegjëse profilin e secilit personazh, në bazë të kulturës, të formimit e temperamentit që ai përfaqëson.

Risite që sjell shkrimtari në këtë roman janë të lidhura me strukturën kompakte kompozicionale, por sidomos me këndvështrimin ndaj sjelljes së personazheve. Sofia Kondili dhe Kristofor Kutulla janë personazhe që vënë pasionin mbi atë "detyrë morale" që u ka imponuar shoqëria dhe në të cilën Sofia nuk beson më, ndërsa Kristofori lëkundet. Sofia e shikon lidhjen me Kristoforin jo si mëkat por si të shenjtë, sidomos përpara ligjit të egër dhe formal që s'ka kërkuar pëlqimin e saj dhe për më tepër ka vulosur një martesë në fakt të paqenë, madje dhe para Zotit, të cilit ajo i beson. Madje ajo mendon se ka qenë Providenca hyjnore dhe jo rasti që e solli këtë djalë të ri tek ajo.

Të shenjtë, se është një bashkim real dy qeniesh të reja dhe të bukura, se i jep mundësi të vërë në jetë ëndrrën gjer atëherë të porealizueshme për t'u bërë nënë, se është një afrim midis dy qeniesh që kanë lidhje shpirtërore. Ajo admiron virtytet e djalit që e sheh si luftëtar, pra, trim, e njeh si të çiltër e të dashur, për më tepër ajo është dëshmitare e luftës së tij të dëshpëruar për t'u përmbajtur, që ishte shumë e vështirë për t'u përballur me një të ri me pasionet e rinisë dhe para një gruaje me bukuri të rrallë, e joshur prej tij dhe me dëshirë që ta joshë. Kjo luftë midis pasionit dhe ndjenjës së detyrës karakterizohet nga një gjest fizik, kafshimit të gishtit për të mos "mëkatuar", siç pohon ai. Këtu të kujtohet At Sergei i Tolstoit (bëhet fjalë për një murg i cili tundohet nga një grua që vjen ta provokojë), duke pasur parasysh distancën midis këtyre personazheve: njëri murg dhe mistik, tjetri luftëtar. Por që të dy i shqetëson vetëdija e mëkati, se në fakt Kristofori, në dallim nga gruaja, e shikon lidhjen e mundshme me të si mëkat të trefishtë: shkelje kurore, shkelje e mikpritjes shqiptare, pra, prerje në besë, shkelje e disiplinës partizane, pra, shohim se këtu, ashtu si në folklorin shqiptar luan rol numri tre. Ky konkluzion nuk jepet hapur nga shkrimtari, rrëfimtari heterodiegetik, por që rrok herë-herë optikën e të dy personazheve që janë të ndryshëm, por ngjajnë njëri me tjetrin dhe plotësojnë njëri-tjetrin, të dy të rinj tepër të bukur dhe të etur për jetë dhe gëzimet e saj, të dy të aftë për një dashuri të vërtetë, të cilin Kristofori në fakt e ka gjetur tek e fejuara, Lenica, dhe ka projektuar tek ajo ëndrrat e veta rinore. Dy personazhet dallojnë nga njëri-tjetri. Tek Kristofori sfera racionale, meditimi, mbizotëron mbi botën e pasioneve, ndërsa Sofia është më afër me natyrën, pra, me botën e pasioneve dhe të

instinkteve dhe nënvetëdija e saj është një magmë e zjarrtë vullkanike, që së fundi shpërthen, duke u derdhur në vrullet e një pasioni që vërtet është fizik, vërtet ka një bazë fiziologjike, por nuk është pasion i prirjes perverse, përkundrazi, është i bukur në lakuriqësinë e tij të pafajshme, ashtu siç e pikturon autori, një dashuri e lidhur me tërë botën e natyrës që e rrethon, me botën bimore dhe shtazore, që i bindet ligjit të shenjtë të përtëritjes së llojeve, të vazhdimësisë së brezave, që autori e nënvizon jo pa tendencë dhe në funksion të këtij mesazhi disa herë nëpër kapitujt e romanit.

Kujtojmë episodin e kalit që bashkohet me pelën dhe fraza kuptimplotë “Sa i bukur është bërë kali”, ose episodi i mëshqerrës që lind viç dhe jepet përmes monologut të brendshëm të Sofisë. Kjo është një nga teknikat moderniste të romanit që hodhën dritë më të thellë mbi të, një dritë që buron paralelisht nga errësira e nënvetëdijes: Citojmë: “U përpiva e tëra duke vështruar atë. Shihja e etur sesi ajo mëshqerrë, pas ca, do të bëhej mëmë. Do të lindte një fëmijë, prandaj ajo vazhdonte të mendohej edhe më shumë, lëkundej e tundej me dhembje, gjithmonë me një lloj kujdesi, vështirësie e ngushtësie, nga mundimet e lindjes e shkreta! Shtriu prapa akoma kokën dhe gushën e gjatë, një çikë e nga një çikë atje, prapa tek të lermët që ishte hapur i kullonin lëngje, u shfaqën dy shenja si doçka, si dy zogj të bardhë që më ngjethën dhe s’ngopesha frymë. Mëshqerra shtërmënej, përdridhej dhe veçanërisht jepte e jepte të shtrëngohej akoma, dhe ato dy doçkat e njomështa u zgjatën më, dhe dielli u rrinte atje, dhe ngrohja e tij i ndillte që ato të dilnin përjashta. Pas ca, doli midis dy doçkave të zgjatura, që kishin vënë përçark dy thundra gati të tejdukshme, pra pak më tej dy thundrave të qelqta ku u shfaq fytyra, turiri i viçit të vogël, ajo e lëpinte, viçi u përpoq që të ngrihej dhe dridhej. Unë isha harruar e shtrirë tek ai copë vend dhe thosha me trembje se, - ja tani do të rrëzohet; tani do të rrëzohet: shpirti! Po ai! Se kush i jepte forca dhe përmblihte veten, dhe dielli e lyente dhe i frynte me avull të padukshëm diellor...”¹⁸⁶

Tabloja e mëshqerrës që lind, i ngjan tablosë së një lindjeje njerëzore: aty imtësitë e sakta, gati natyraliste ndërthuren me fjalë të buta, përkëdhelëse si “doçka” dhe imazhe delikate si: “zogj të bardhë”, emrat njerëzorë përzihen me emrat e kafshëve (fytyra, turiri, djali, viçi dhe qenia që lind quhet mëma e re, pa dallim nga një mëmë njerëzore dhe dielli sikur merr pjesë në atë lindje dhe në hapat e parë të krijesës së vogël).

Sofia është një personazh që në këtë skenë është edhe spektatore, por edhe identifikohet me mëshqerrën-mëmë dhe tërë dëshira e saj e pavetëdijshme për amësi del në sipërfaqe. Mandej pason takimin kuptimplotë me Daden e lashtë, që ndjen dhimbje për fatin e Sofisë, për bukurinë e saj po që mbetet shterpë dhe i lutet një qenieje të mbinatyreshme për fatin e saj. Por lexuesi e sheh edhe Sofinë të lutet, t’i lutet zotit pagan, Diellit, por edhe Perëndisë së të krishterëve, edhe figurave kristiane, si Krishti dhe Shën Maria. Pra, së fundi, bashkimi i saj me Kristoforin ngjan si përgjigja e atyre lutjeve, jo mëkat, por një lidhje e shenjtëruar nga natyra dhe Perëndia.

Edhe Kristofori, nën ndikimin e Sofisë, më vonë sheh bukurinë e lidhjes që i bashkon (kuptimplotë është antiteza midis natës së zezë dhe Sofisë së bardhë). Sofia është e bardhë se është e bukur, e bardhë dhe e bukur është dashuria midis dy të rinjve, dashuri fizike që shndërrohet në shpirtërore (jo më kot autori thotë se Sofia dëshironte të besonte tek ky partizan), ajo i jep jo vetëm trupin por edhe shpirtin. Kristofor Kotulla e vlerëson këtë dhuratë

¹⁸⁶ Koço Kosta. *Nata e Sofie Kondilit*, Botimet “Dudaj”, Tiranë 2007, f. 250-251.

të dyfishtë, ndonëse ndihet fajtor ndaj vajzës që dashuroi me gjithë shpirt, Lenicës, para se të njihte këtë grua.

Edhe Sofia, me bujarinë e shpirtit të vet është gati të pranojë martesën e të dashurit të saj të një nate, të atij që e bëri grua dhe ndoshta nënë, duke e ditur se lidhja e tyre s'mund të ligjërohet dhe i rrezikon të dy. Dhurata që ajo i bën më vonë, një send simbolik, një kësulë nuseje (meqenëse ajo e ndjen veten më shumë si nuse sesa si dashnore të tij, ndonëse ligjërisht ishte nusja e një tjetri, i cili nuk kishte mundur dhe ditur të mbillte farë jete tek ajo, por vetëm dhunë e vuajtje), është shprehje dashurie e mirënjohjeje, por shndërrohet në të kobshme dhe i çon në vdekje të dy. (Fitorja e Tanatosit mbi Erosin ishte fitorja e kobshme e vdekjes mbi jetën, e megjithatë romani mbyllet edhe me një fitore morale se dy të rinjtë gëzuan orë të magjishme lumturie, që askush s'mund t'ua rrëmbente më). Ato dy qenie të bukura dhe të reja sikur i flijohen jo një perëndie, por një demoni dhe ky ishte demoni i paragjykimëve të vjetra, por edhe i diktaturës së ardhshme (një demon shumëformësh). Dy personazhet e romanit janë të afërt edhe me një grup tjetër personazhesh, ata që kanë bërë sipas logjikës së luftës partizane, një gabim tragjik. Një dukuri të tillë e vëmë re tek "Doktor Andrea" i Dalan Shapllos (një personazh i cili tregohet i pakujdesshëm në shumë veprime).

"Partizani Tare" i romanit "Kronikë në gur" të Ismail Kadaresë (u gjykua një partizan i cili vrau një spiun të fashizmit ku pranë tij ishte dhe e bija që donte të mbronte të atin, e dënuan për pakujdesi, momente këto, që janë shkrirë edhe në romanet moderne).

Azemi tek "Komisari Memo" i Dritëro Agollit (kujtojmë personazhin që donte të ngacmonte një nga vajzat).

Heroina e "Ëngjëjve të armatosur" të D. Çulit, ku shfaqen luftëtarë që gabojnë nga pakujdesia apo një pasion i fortë dashurie erotike dhe urrejtja ndaj armikut. Të gjithë këto, në sajë të disiplinës së luftës, gjykohen nga shokët e tyre dhe dënohen me vdekje (bën përjashtim rasti i doktor Andresë të D. Shapllos ku dënimi nuk zbatohet, meqenëse mbizotëron dashuria dhe vlerësimi ndaj shokut, i cili po bëhej gati të vdiste me dinjitet. Nuk del e qartë nëse kjo është skema e "fundit të lumtur" të realizmit socialist, apo një zgjidhje që buron nga logjika e karaktereve). Në të gjitha këto raste, ndonëse personazhet ndryshojnë njëri nga tjetri, qëndrimi i autorëve është ambivalent ndaj personazheve dhe atyre që i gjykojnë, meqenëse bëhet fjalë për vepra të "realizmit socialist" në të cilat disiplina e luftës quhet si e shenjtë.

Edhe Kristofor Kutulla përfshihet në galerinë e këtyre personazheve që gabojnë dhe dënohen me rreptësi. Në roman nuk ka ambivalencë, ndonëse figura e komandantit gjykatës është komplekse dhe jo krejt negative, qëndrimi ideo-emocional i Kostës është i hapur, nëpërmjet tablosë kolektive të qëndrimit të popullit që do të shmangë dënimin, autori mbështet personazhin dhe dënon gjyqin partizan me në krye komandantin.

Figura e komandantit partizan është disi e ndërlikuar: ai është njeri në thelb i drejtë dhe trim, por që si ushtarak u bindet urdhrave nga lart: ai beson në çështjen për të cilën lufton, ai s'do të donte të jepte një dënim aq të rreptë, ai shpreson që i akuzuari të mund të mbrohet dhe këtë e shohim në disa momente: "Sytë e komandantit u pikën në dhimbje. I tha: -Po ç'ke marrë në atë shtëpi? Vetullat e rënda të komandantit e humbën përtesën, u ndjenë të çlodhura dhe nisën të lëviznin me ngut poshtë e lart, bloi nofullat dhe përtypte me zemëratë...

- Ka vjedhur! - mërmëriti ulët me psherëtimë. Po pse o vëlla, pse, lëngoi përbrenda me vete ai...Nuk vodha, - pëshpëriti partizani Kristofor Kotulla. Pse s'thërret, - foli komandanti me vete. Thirr! Aman thirr, de! Nuk vodha!

- Ka fytyrë të njomë, shejtani, mendoj komandanti. Po nejse, e shpëtuam, më duket! Komandanti ndihej i gëzuar. Iu ngroh gjaku).¹⁸⁷

Autori përdor këtu me zotësi procedimin, sikur do ta vonojë fundin tragjik. Kur komandanti nis të shpresojë, lexuesi shpreson bashkë me të, por fundi megjithatë vjen. Komandanti e jep atë urdhër që donte ta shmangte. Pastaj lexuesi njeh nga kujtimet e komandantit dhe monologun e tij të brendshëm, një krim që ai e ka kryer sipas urdhrave, vrasjen pa gjyq të një partizaneje për një imoralitet të supozuar:

Citojmë: "Partizania Bedene...më pëshpëriti me zë të dridhur:

- Ç'pate?!

- Për imoralitet, - i thashë.

- Po ku, ku imoraliteti! Kur u bë ky imoralitet.

- Për imoralitet, - i thashë prapë, dhe desha të bërtisja që të qëlloja malin matanë përtej lumit.

- Ajo për imoralitet?! Dhe...pa gjyq?!

Heshta dhe s'di në ia shqiptova:

- Urdhër!

....Ajo qe një vrasje me urdhër dhe lufta ka të vetat".¹⁸⁸

Komandanti nuk dëshiron të kujtojë britmën e fundit të vajzës së vrarë me pabesi nga shoku i luftës dhe më vonë komandanti partizan, - thotë autori. Ngjante i tëri si një rrënojë që nuk mund të riparohej. Gjithashtu, edhe komandantit të rreptë partizan, i bëri përshtypje bukuria e Sofisë. Pastaj atij i shfaqet vegimi i partizanit të vrarë që e pyet:

"Pse?"

Tani i ndërruan rolet, i vdekuri shndërrohet në gjykatës dhe komandanti në fajtor, madje autori e quan fukara të botës.

- Dhe pastaj ai mendon: "Nderi im vate, u bë plak dhe sikur vdiqëm ne të pafajshmit. Befas u shfaq tërë ngazëllim plot zburime gazmore kostumi i nusërisë i krahinës së tyre."¹⁸⁹

Autori e vë t'i bëjë gjithnjë gjyqin vetes. Ndërgjegjja është më e fortë, sikur thuhet, se logjika e luftës. Partizani Kristofor Kotulla ishte "fajtor pa faj".

Edhe Komisari, ndonëse i brumosur me idetë komuniste, e ndjen veten fajtor për vrasjen e Kristofor Kotullës, se është në thelb njeri i sinqertë dhe i drejtë dhe nuk është i bindur në thellësi të ndërgjegjes së ligjit të luftës, e cila po e pushtonte dhe ajo magjia e shpirtit të njeriut.

Shkrimtari nuk mbetet në pozita skematike, ndaj dhe nuk e sheh komisarin komunist si negativ, por si personazhin e dilemës. Një personazh interesant është dhe partizani Ashtus, njeri i thjeshtë dhe me moral të rreptë, por që dhe e ndien dhimbjen njerëzore. E ndjen se vrasja e Kristoforit qe krim dhe dënim jo i ligjshëm. Në fund të romanit Sofia, ajo krijesë

¹⁸⁷ Po aty.

¹⁸⁸ Po aty.

¹⁸⁹ Po aty, f. 62-72.

“fajtores pa faj” dhe viktimë njëkohësisht, quhet nga autori “Martire e shenjtë”, Martire jo e ndonjë ideali abstrakt, por e dashurisë. Fundi tragjik merr ngjyra heroike dhe lirike për personazhet, vdekja tragjike u jep pavdekësi. Autori është i vetëdijshëm se me këtë libër ka bërë “Iliadën e Dashurisë”.

Në zhvillimin e fabulës të këtij romani vihen re ngarkesat psiko-erotike, që shfaqin edhe karakterin, edhe formimin e personazhit. Padyshim që dilemat që operojnë në roman janë të shumëllojta, duke e bërë prozën sa të imët, aq dhe komplekse për nga grafiku mjaft dinamik i gjendjeve mjaft të kompleksuara të personazheve. Romani ngërthen klasiken dhe modernen, një lëndë të pasur dhe të gjerë, duke bërë kështu që të zgjerohet dimensiononi i prozës moderne shqipe. Mirëpo të mos harrojmë se letërsia ka dimension universal, por është edhe zgjedhje personale.

Romani i veprimit ka mjaft veçori të përbashkëta kompozicionale. Shkrimtari, duke treguar hapur dashurinë dhe qëndrimin e tij personal, aktivizon mjetet retorike të ligjëratës gjuhësore, duke bërë kështu, që të krijojë tek lexuesi strukturën e vet ideo-emocionale. Edhe në veprat e tjera të shkrimtarit, hasim elemente të tilla të metodës realiste. Peshën kryesore në formësimin e portretit të brendshëm dhe në thellimin e elementit vertikal, e përmban struktura e veprës, ose më saktë, struktura e kohës. Veçori e poetikës së romanit është përdorimi i figurës-sintezë, që shënon dukurinë, situatën, gjendjen, mënyrën e meditimit të personazhit. Kjo hetohet që tek Sofia Kondili, por përforcohet me përjetimet e personazhit, me shqetësimet dhe me veprimet e Kristofor Kutullës.

Studiuesi Italian Franko Moreti, tek vepra e tij “Atlas i romanit europian 1800-1900”, hedh hipotezën origjinale dhe interesante se gjeografia është një aspekt vendimtar i zbulimit dhe trillimit letrar dhe do të argumentojë sesi gjeografia arrin të gjenerojë romanin e Europës moderne.¹⁹⁰

Kurse tek romani “Nata e Sofie Kondilit”, brenda subjektit të veprës dhe strukturës shumështrësore të saj, dominante janë dy linja rrëfimi:

- a. Marrëdhëniet e vjetra shoqërore;
- b. Linja e transformimit të vetëdijes, shkëputjes së tyre nga paragjykimet, mentaliteti dhe psikologjia e krijuar nëpër shekuj.

Vetë rrëfimi i autorit thuret nga një varg njësisish meditative, të cilat e motivojnë qëndrimin dhe gjendjen shpirtërore të autorit. Autori trajton çështje dhe motive të cilat dalin nga thellësia e kohës dhe reflektohen nëpër ndërjegjen e njeriut që ballafaqohet në të njëjtën kohë me dramën individuale dhe atë kombëtare. Të mos harrojmë se vepra e shkrimtarit fikson të vërtetën, se realiteti në zhvillim modelon dhe diferencon edhe karaktere të ndryshme, ku disa prej tyre ecin me ritëm të caktuar, ndërsa të tjerët zvarriten. Brenda mentalitetit të ndrydhur, disa lirohen botëkuptimisht nga paragjykimet e vjetra, të tjerët i mbartin këto, në shpirt, tërë jetën dhe në kthesat e historisë.

Objektivi i autorit është i drejtuar rreth fatit të personazhit, ku dhe shpaloset bota e tij e brendshme, aspiratat, ankthet, dhe se e gjithë fabula vihet në shërbim të shpalosjes së veçorive psikologjike të personazhit kryesor, kështu që, tipologjikisht veprën “Nata e Sofie

¹⁹⁰ Shih : Sergio Pautasso. *Aventure letterarie di un lettore dilettante*. *Lingua e literature*, 19, 30-31, 98, f. 45.

Kondilit” mund ta klasifikojmë si prozë të personazhit, që i kundërvihet atij lloji ku dominojnë ngjarjet, pra, një roman i personazhit, por jo, një roman i ngjarjeve.

Siç shprehet dhe Mehmet Myftiu, “Romani është në natyrën e poemës së Witmanit, ku lexuesi gozhdohet me një fuqi artistike të madhe, një vështrim me kujdes dhe me zemër në dorë i realitetit modern”.¹⁹¹

Edhe një kritik tjetër vëren se shkrimtari është mjeshtër në dhënien e elementeve tabu të socrealizmit pasi ka dhënë elementet psiko-erotike të Sofisë, të burimit floreal, lezbik, pastoral dhe elemente të paraardhësve.¹⁹²

Siç ndodh edhe në romanet e shkrimtarëve të tjerë, edhe këtu Sofie Kondili është personazh idealesh dhe dashurish, ku utopizmi (mbirealiteti i ndjenjave) është veçori e njerëzve me botë të pasur. Një vlerësim interesant është edhe ai ku vepra shihet e ndërthurur mes një realiteti jetësor konkret dhe një mbirealiteti ndjenjash.¹⁹³

Romani “Nata e Sofie Kondilit” është arti i motivimit bindës, motivet dhe motivimet përbëjnë kryesoren në vepër. Nata e Sofie Kondilit përqendrohet si një tragjedi greke në hapësirën e një nate, e një mëngjesi, ku ndërthuren Erosi dhe dhimbja erotike. Protagonistja bën një zgjedhje të guximshme që i siguron pak çaste lumturie, të cilat shndërrohen më pas në tragjedi, si në një lloj kalimi aristotelian nga lumturia në fatkeqësi. Pa një fuqi artistike superiore të personazheve, nuk mund të gozhdohet lexuesi në ato faqe, në përshkrimin e një nate të vetme dhe në rrjedhimin e saj në mëngjesin e ditës së nesërme. Pushkatimi i partizanit, qëndrimi i Sofie Kondilit para çetës dhe sakrifikimi i jetës së saj në gjirin e natyrës, janë tingujt e fundit funebër ndaj kësaj tragjedie që prodhoi shoqëria në një fazë të caktuar të zhvillimit të saj. Ndonëse thyhen disa tabu, si tabuja e erotizmit të anashkaluar nga puritanizmi hipokrit komunist, ngjyrimi erotik i romanit nuk është qëllim në vetvete. Dashuria, e parë në aspektin fizik, shihet si forcë e madhe jetësore. Dy protagonistët, Sofia dhe Kristofori, shkelin ca norma (Sofia - kurorën e martesës, Kristofori - disiplinën partizane), por ata i binden një ligji më të lartë, atij të dashurisë që bashkon qeniet njerëzore dhe siguron vazhdimësinë e jetës. Mjedisi nuk e pranon këtë si ligjin më të lartë: (së këndejmi vjen dhe fundi tragjik i protagonistëve). Kësisoj, përmes rrugës jetësore të personazheve shkrimtari jep fizionominë e personazhit me fatin e tij, me shqetësimet, brengat, përjetimet që ata provojnë. Autori i paraqet personazhet në veprim apo në mjediset e punës, ata shfaqen në rrjedhën e mendimeve të thella e të begatshme, tregojnë sesi ecin me rritjen e tyre shpirtërore, sesi marrin pjesë aktivisht në këtë proces, është i pranishëm në monologjet për të forcuar mendimet, duke i dhënë kështu ligjërimin një patos të veçantë dhe një karakter të ngritur emocional. Edhe Sofie Kondili, personazhi kryesor i romanit “Nata e Sofie Kondilit”, dëshmon psikologjinë estetike të dashurisë femërore. Është një përzierje afshi dhe dëshire,

¹⁹¹ Mehmet, Myftiu. *Letër Koço Kostës për romanin "Nata e Sofie Kondilit"*. Në: “Ndryshe” (“Drita Ndryshe”, suplement). nr. 16, 24 shkurt 2008, f. 17.

¹⁹² Nuri Plaku. *Elementet psiko-erotike dhe morale të Sofie Kondilit*. Botuar në: “Metropol”, 25 janar 2009.

¹⁹³ Bashkim Kuçuku. *Pas eklipsit letrar, Letërsi Shqipe Bashkëkohore I*. Botimet Toena, Tiranë 2014, f. 25.

Utopizmi është mendim politik e shoqëror që përfytyron një shoqëri ideale. Fjala utopizëm vjen nga vepra “Utopia e Tomas Morit”, përshkrimi i një mbretërie imagjinare që zbatonte një komunizëm të krishterë (“The New Encyclopaedia Britannica”, Micropaedia, Volumi X, 1963, faqe 316).

një nevojë e transformuar dëshpërimi, e shfaqur në cakun e një lamtumire rinore jo të natyrshme, kërcënuar nga burgu i mureve të shtëpisë, e dhunuar barbarisht nga i shoqi. Sofie Kondili gjen forcë që natën e fundit të saj të realizojë ëndrrën e jetës: të flejë me një mashkull të vërtetë. Por, për ta realizuar këtë, nusja nuk e ka aspak të lehtë të luftojë me vetveten. Ajo kalon përmes një kalvari të gjatë kujtimesh lënguese, nëpërmjet të cilave lexuesi njeh karakterin e saj, të drejtën mbi vendimin e marrë, arsyt e dëshirave epshore dhe mbi të gjitha prezantohet me potencën e saj femërore, një sakrificë kjo, jashtë çdo lloj skllavërie të fshehtë trupore. Një nga personazhet e romanit, Babazoti dhe njëkohësisht gjyshi i Sofisë, i referohet gjithashtu natyrës, në përligje të dashurisë...

“Dhe tërë lulet ç’ të përhapin këtë aromë!

Që të afrojnë insektet, që t’u japin lëng.

Edhe ato të bëjnë dashuri, Sheleget, Lulet”

Romani dallon nga veprat e tjera të letërsisë shqipe, edhe për shkak të tematikës, e cila ndoshta duket e shpeshtë në romane të shkrimtarëve të tjerë. Përcaktimi i kohës dhe i vendit është e veçanta e shkrimtarit dhe kjo vë në dukje faktin, që proza e shkrimtarit ka një frymë realiste në sprovën për të depërtuar apo hulumtuar anët më të panjohura të shpirtit njerëzor. Bisedat, qëndrimet e hapura të personazheve, japin edhe karakterizimin e atmosferës së kohës dhe situatës, të ambientit dhe fatit të personazheve.

Personazhet episodike janë në lidhje funksionale për të dhënë dinamizmin e ngjarjeve në vepër dhe ndërtohen përmes digresionit dhe janë paraqitur përmes kompleksitetit të karakterit që përfaqësojnë.

Nga pikëpamja e arkitekturës së karakterit, madje edhe nga pikëpamja e një niveli më të përgjithshëm strukturor, kryesisht parashtrimin dhe perspektivës narrative, teksti përbën një rast tipik të “paparashikueshmërisë”, ku siç thotë dhe Lotmani, “Në funksion të një teksti të karakterit, bëhen zgjedhje strukturore dhe ligjërimore të përshtatshme”¹⁹⁴.

Përderisa vepra e autorit neutralitetin letrar dhe modern e arrin me hipertekstualitetin, ky është procesi esencial i të resë që buron nga tradita nacionale, por, mos harrojmë se kemi edhe autorë e letërsi, që neutralitetin e tyre e arrijnë duke shkelur tepër pak, ose aspak mbi terrenin e kohës reale.

Po të flasim duke u mbështetur në teorinë e Jungut, do të thoshim se autori është zëri i shoqërisë që jeton tek ne, një shkrimtar që komunikon me elegancë me bashkëkohësinë, duke sjellë prej këtej një polifoni detajesh në harmoni me njëra-tjetrën, e duke bërë kështu, që romani të ruajë dhe të konsolidojë ndofta dhe nivelin më të lartë të prozës së tij. Kjo vjen edhe si përpjekje për të ndërtuar një ligjërim artistik, ku në bazë të saj qëndron modifikimi për kodin e shkrimit. Shprehur thjesht, e mundshmeja me të pamundshmen japin “Realen”. Citojmë: “Nga një fshat i largët në një vend të tillë të harruar nga zoti zbret një nuse ngarkuar me një bukuri të rrallë, Sofie Kondili. Bashkë me kostumin e nusërisë ajo ka hedhur edhe gëzofin e zi, të një fati tragjik nga më të vështirët në jetën e një femre, një nuse e cila përjeton ankthin e dëshirave të vrara. Kjo dhuratë është shkak i tragjedisë, një fshat i cili terrorizohet nga ky akt makabër i një tjetërsimi të arratisë surreal”.¹⁹⁵

¹⁹⁴ Umberto Eko. *Struktura e papranishme – kërkimi semiotik dhe metoda strukturore*. Nbgj, Dukagjini, Pejë, 1996.

¹⁹⁵ Po aty.

Duket se shkrimtari dëshmon psikologjinë e dashurisë femërore. Sofie Kondili kërkon të realizojë një ëndërr: Të flejë me një mashkull të vërtetë: Jepet zgjidhja konfliktuale që varet nga edukimi psikologjik, forca morale, lufta dhe sakrifica. Detaje dhe skena të tëra intime gjenden në roman. Pamje të tilla të erotizmit e mbushin botën me eksperiencë të ndryshme, duke e nxitur botën për përjetime të çuditshme. Psikologjia e këtij personazhi e bën ndërgjegjen e tij më të pasur. Por, duke pasur parasysh që jeta është e mbushur me ligjet natyrale të riprodhimit të saj, na bën të mendojmë se eksperiencë e Sofie Kondilit përbën një formë të çuditshme dhe të veçantë njëkohësisht. Kësisoj, kompozicioni i romanit e ndjek procedurën shkallëzore të ngjarjeve, duke e funksionalizuar përshkrimin letrar. Romani, temën e bën fakt artistik dhe dëshmia jetësore i përplotëson kërkesat për t'i shtresuar ngjarjet kryesore.

Kujtojmë këtu se: “Në letërsinë shqipe janë të shumtë emrat e shkrimtarëve që në rrethana të ndryshme historike implikohen dukshëm në veprimtari të natyrës monarkiste, ideologjike apo politike”.¹⁹⁶

Shkrimtari u bëri ballë këtyre situatave. Analiza e mirëfilltë dhe e gjithanshme e veprës letrare mundëson interpretimin shkencor dhe të mirëfilltë të veprës artistike. Përjetimi artistik është formë e kontemplacionit të veprës, sidomos me rastin e vlerësimit estetik dhe të vlerësimit të fenomenit letrar. Ndërtimi i personazhit të Sofie Kondili bëhet me mjeshtëri artistike. E vërteta jetësore, kundërthënia, e ndodhura, kuptohen në shfaqjet e brendshme të rrafshit artistik. Ky përshkrim i botëkuptimit, flet për karakterin dhe mentalitetin e njeriut që zhytet në një mentalitet shqiptar. Forma letrare e dëshmon realitetin e dhënë të personazhit. Kësisoj, interpretimi i tekstit narrativ nuk aktivizohet vetëm në rrafshin përmbajtësor, kështu që pozicioni dhe perspektiva e personazhit i funksionalizon kodet e gjuhës poetike.

Struktura rrëfimore përshkon një frymë dëftuese dhe gjen maksimalisht me hollësi rrjedhën e shpejtë dhe të kondensuar, duke karakterizuar një roman modern. Kjo shpreh dhe faktin që, me këtë roman, shkrimtari Koço Kosta u paraqit me një profil të veçantë, qoftë në pikëpamje të rrëfimit, qoftë në anën e trajtimit të gjuhës.

Hulumtimi i vazhdueshëm është pjesë e pandashme e procesit krijues. Duhet të themi me bindje, se lënda e romanit është një lëndë jo e rëndomtë qysh në rreshtat e parë e deri në fund. Është për t'u vënë re, se proza e sidomos romanet e tij, depërtojnë në anët më të panjohura të shpirtit njerëzor, ashtu si rrëfenjat e Mitrush Kutelit, të cilat shkrihen dhe funksionalizohen natyrshëm, duke i dhënë një vlerë të lakmueshme rrëfimit. Shkrimtari ka ditur të ruajë saktësisht autenticitetin. Koço Kosta është shkrimtar që ka të shtresuar në veprat e tij kultin e gjuhës dhe kultin e peizazhit mjedisor, dy elemente themelore këto, të cilat realizohen përmes formave të ndryshme rrëfimore dhe artistike.

Romani “Nata e Sofie Kondilit” është një simfoni himn për thelbin e burimit njerëzor, si pjesë e pandarë e instiktit të jetës. Për temën që trajton, romani mbetet unik dhe i përshkruar tejprtej nga një lirizëm i pafund.

Ja si shprehet Mehmet Myftiu në një letër drejtuar Koço Kostës: “Ti ke thyer me guxim të pashoqë njerëzor çdo tabu, duke përshkruar shfaqjet seksuale me imtësi dhe

¹⁹⁶ Për aspektin qëllimor të letërsisë sonë, shih pjesën “Modelet e shkrimit” në veprën “Letërsia filobiblike, Letërsia romantike”. Sabri Hamiti. “Faik Konica”, Prishtinë 2002, f. 22-82; ose për më shumë, shih studimin monografik të studiuesit Sh. Sinani me titull “Letërsia në totalitarizëm”.

vërtetësi, duke i zhveshur nga turpi ndaj një fenomeni që gjithë jetën njeriu e ka në mendje dhe në veprim. Dhe organet seksuale i ke quajtur me emrin e tyre të vërtetë, jo në formën e një lapërdhie. Duke i përshkruar realisht fenomenet e seksit njerëzor, duke e zhveshur në thelbin e tyre nga velloja formale, artificiale, duke e bërë atë copë e çikë, ke treguar vërtetësinë dhe bukurinë e tyre.”¹⁹⁷

Shkrimtari në të vërtetë thyen tabutë me guxim, por respekton cakun midis letërsisë erotike dhe asaj pornografike dhe që shprehet përmes katarsit estetik që sublimon erotizmin.

Kjo na shpie drejt një konstatimi në letërsi, ku çdo gjë është relative dhe mund të përsoset. Personazhet kryesorë paraqesin referencën tematike dhe artistike njëkohësisht, realitetin dhe fiksionin, të cilat ndërthuren si koncept krijues nga ana e autorit. Prandaj, edhe rrëfimi merr karakter të veçantë brenda romanit dhe i nënshtrohet një dinamike të theksuar në të gjitha shtresat e tij. Gjuha është fine, nuancat dhe referencat janë tipizuese, të cilat e bëjnë tekstin jashtëzakonisht të pasur dhe të gjallë, të kapshëm dhe dinamik, duke i dhënë atij forcën e vërtetë të artit. Sigurisht që dhe paradokset reflektojnë atë morfologji shpirtërore dhe fizike të njeriut, përballë një mjedisi shoqëror, të atij mjedisi të çoroditur nga zbatimi i ligjësisë dhe veprimeve absurde. Me mjeshtëri artistike autori zbret në thellësinë e kësaj jete dhe nga brendia e paradoksit të madh totalitar arrin të zbulojë gjithçka që ndien për një kohë të gjatë. Kjo dëshmon, se veprat në fjalë, vijnë para lexuesit me një ndjeshmëri të thellë lirike, si pasqyrë e dhimbshme, thua se je në një zbulim të paradoksit dhe ku realiteti prodhon vetëm vuajtje, pikëllim, dëshpërim. Romani të ngjan si një film që sjell imazhe nga një botë e ngrirë. Ëndrrat, lutjet, frika, emocionet, kanë një fuqi përgjithësuese, një personazh që ëndërron duke ruajtur shpresën dhe fuqinë për të dashuruar. Gjithsesi, personazhi arrin të ëndërrojë dhe shkrimtari me një gjuhë të pasur, realist në çka thotë, dëshmon edhe njëherë mjeshtërinë e rrëfimit të tij.

Romani trajton temën e vijëzuar në ndërdijen e individit, që në të vërtetë kalon nëpër procesin e reales dhe ireales. Vetë nyjëtimet jetësore të njeriut kalojnë nëpër këtë rrjedhë. Një shtrirje shumëdimensionale duket se ka simbolika për një jetë më të mirë në roman. Padyshim që rrjedha e këtyre elementeve, simbolika e tyre dhe shumëdimensionaliteti, kanë shtrirje të thella dhe rrjedhin misterishëm në faqet e romanit. Vetë simbolika e domethënies së ëndrrës për një jetë më të mire, shpërfaq dhe ndonjë element të kohës, që përkon me kohën e mbylljes së Shqipërisë diktatoriale përtej atij horizonti të paracaktuar. Gjatë analizës së nocionit të kohës, në këtë vepër na përvijohet mendimi se koha nuk mund të përjetohet. Jeta dhe dhimbja janë dy rrafshet që lidhen pikërisht me kohën dhe si të atilla shtrihen në gjithë romanin. Këto janë dy rrafshet e perceptimit të kohës që veprës i japin një tingëllimë përtej tingëllimës letrare dhe ku lexuesi ndjek rrugët drejt zgjerimit të horizonteve të dijes. Vetë autori nëpërmjet kryepersonazhit jep mendimet e tij rreth asaj që po shkruan, duke shprehur dyshimin se mos e ka zgjatur shumë rrëfimin ose duke komentuar ndonjë figurë letrare që i duket posaçërisht përshtypjëlënëse. Shkrimtari, duke dialoguar me personazhet, jep shpjegime në stil autorial për rolin dhe rëndësinë e tyre. Autori dhe personazhi kryesor janë marrë vesh: flet për jetën, flet për romanin, ku siç shprehet dhe studiuesi Rexhep Qosja, “Romani bashkëkohor është mrekullia letrare e kohës sonë dhe ku gërshetohet poezia,

¹⁹⁷ Mehmet Myftiu. *Letër Koço Kostës për romanin “Nata e Sofie Kondilit”*. Botuar në suplementin “Ndryshe”.

filozofia dhe shkenca”.¹⁹⁸ Të realizuara këndshëm janë dhe sistemet figurative dhe të strukturave, secila në përputhje me llojin dhe stilin përkatës. Me një rrëfim të thjeshtë dhe të natyrshëm, ironizohen dukuri negative.

Romani zbulon filozofinë e kësaj jete. Veprimi është i përcaktuar mirë në kohë dhe në hapësirë përmes morisë së personazheve. Autori nuk e ka lënë pas dore ambientin, atmosferën, sfondin, madje ka gjetur elementet për t’i dhënë fuqi rrëfimit dhe nota vlerësimi së resë.

Në parametrat strukturorë dhe narrativë, romani ruan kontinuitetin e rrëfimit. Fijet e fabulës janë të shumta. Kjo është rruga e përpjekjeve të rënda dhe të pafundme të këtyre personazheve, të vendosur në dilemën çka janë dhe ç’duhet të jenë. Ngjarjet kanë rrjedhshmëri, po herë pas here ato marrin kthesa të papritura, duke rritur karakterin dramatik. Me afinitetin krijues, shkrimtari i mundëson përsiatjen e duhur një realiteti jetësor, i skicuar në horizont, i vështirë deri diku për nga kompleksiteti i ngjarjes. Kjo ishte vorbulla e jetës së asaj kohe nëpërmjet fabulës ciklike ajo kohë jepet me tërë pamjet e veta sociale dhe individuale. Proza e këtij autori na ngjan se përvijon në letërsinë shqipe një sagë të dhimbshme dashurie, e cila fillon si një klithmë fati e përmbysur dhe përfundon deri në marrëzi.

Ky roman sjell prurje të re në letërsinë shqipe. Në këtë letërsi konflikti i kurorës ka qenë gjithmonë i lidhur me moralin, duke bërë që dhe personazhi të jetë i komplikuar. Padyshim që ky është roman që sjell një konflikt midis moraleve, një dramë kjo e thellë njerëzore, e cila shkon përtej natës të mbushur me kujtime. Interesant janë dhe marrëdhëniet e njeriut me kafshët, tregimet e Ritës dhe marrëdhëniet e motrës me të fejuarin, skemat e intimiteteve të prindërve, nevoja e mëmësisë dhe mosgjenerimi i jetës, rrëfimet aventureske të babazotit, ngarkesat psiko-erotike, fryma e shenjtë e bashkimit të femrës me mashkullin, duke dhënë edhe luftën midis ndjenjës dhe mendimit.

Citojmë: “Nata i zë në një fshat që në atë kohë njihej si një fshat që përkrahte një formacion tjetër politik, ballin Kombëtar. Mirëpo, partizanët janë të detyruar të kalojnë natën në këtë fshat. Në shtëpinë e re të Sofie Kondilit, hyjnë Kristofor Kutulla dhe partizani”.¹⁹⁹

Të duket sikur romani përmban temën e një dashurie të ndërlikuar, madje shpesh nuk dallojmë se cila është e vërtetë apo e rremë. Ngjarjet vendosen në kornizën kohore dhe përdoren si mënyrë e përgjithësimit artistik të realitetit, madje përmbajnë një mënyrë ekulibri midis dy kohëve paralele në rrëfim: kohës së shkuar dhe kohës aktuale; e para, ka të bëjë me pozitën dhe perspektivën e personazhit. Shikuar në kërkimin e ideve letrare, funksionalizohen dy raporte të përjetimit estetik: në përjetimin e drejtpërdrejtë të ndodhisë, që paraqitet ose refuzohet gjatë konkretizimit të idesë qendrore, dhe me ndryshimin e “distancës kohore” prej nga përcaktohet dhe narracioni.

Vetë koha në roman është figura e formës së shprehjes artistike të veprës. Nisur nga aspekti i substancës apo nga aspekti i shprehjes gjuhësore, lënda letrare e romanit është një risi e frytshme dhe jo *kufomë e mekanizmit kirurgjikal* të narratologjisë.

Sofie Kondili rrëmbushet e tëra nga kujtimet dhe përballë provës më të vështirë të jetës së saj, përballë një mashkulli që ajo e kishte ëndërruar deri në masakër. Ankthi i jetësisë,

¹⁹⁸ Rexhep Qosja. *Nata është dita jonë*. Toena, Tiranë 2003, f. 121.

¹⁹⁹ Po aty.

i riprodhimit dhe i vazhdimit të jetës, duket se e mundon në të gjitha përshkrimet autorin. Gjithë kjo botë ka në themel përdëllimin hyjnor dhe njerëzor të kënaqësisë, që e ka dënuar Sofie Kondilin me mungesë. Skena e çetës që mbledhet në qendër të fshatit, fshati i tërë që e përçmon Kristofor Kotullën dhe gjyqi që i bëhet atij, janë nga faqet më të bukura, ku vihet në peshore faji dhe kënaqësia, mëkati dhe jeta. Konceptimi i këtij personazhi është shprehje e botëkuptimit filozofik, se njeriu është produkt i marrëdhënieve shoqërore, ndërsa shembëlltyrat e tyre janë zëdhënese të ideve të reja, të dëshirave dhe aspiratave të secilit. Për këtë arsye, shkrimtari ka përshkruar në mënyrë të hollë e të gjerë jetën e personazhit. “Nata e Sofie Kondilit” përbën një vlerë të madhe artistike për letërsinë tonë. E shkruar në formën e një autotregimi, ai bie mjeshtërisht përmes rrëfimit, gjithçka të ndodhur në një kohë dhe në vende të caktuara, por që me gjuhën e artit fitojnë vlera e adresime përtej tyre, pra, universale.

4.4 Pasuria gjuhësore

K. Kosta bën pjesë ndër ata krijues që shfaq në veprat e tij edhe një vetëdije të lartë gjuhësore. Që do të thotë, se e kërkon fjalën shqipe në të gjitha nivelet e saj: historike, krahinore, frazeologjike, duke i kombinuar ato të lidhura fort me statusin e narratorit, apo edhe të personazheve që enden në toposin letrar të kësaj vepre. Mund të thuhet se këtu ndeshim një fjalës të pasur të një shqipeje sa të standardit, aq edhe të selitur me derdhje prej sociolekteve e dialekteve të ndryshme, të cilat janë në harmoni me vetë frymën mjaft jetësore e dinamike të kësaj vepre.

Pra, kësisoj, veprat e këtij autori veçohen në prozën shqipe edhe për pasurinë e madhe gjuhësore. Shkrimtari përpiqet t’i japë rëndësi gjuhës gjatë rrëfimit, jo vetëm si fjalë a njësi frazeologjike, por edhe si strukturë gjuhësore. Dihet se rrëfimi nuk është i plotë, në qoftë se nuk i përmbahet parametrave ose siç mund të themi ndryshe, nëse ka një shpërfillje gjuhësore (moskujdesje gjuhësore). Një shkrimtar i talentuar doemos që ka brenda vetes aftësinë/magjinë që të *zbulojë* gjuhën brenda vetë gjuhës. Larmia e stileve, konceptimeve dhe operimeve të veçanta në rrafshin poetik, e bëjnë prozën e Koço Kostës më të besueshme dhe njëherazi me rrezatim vlerash për tek receptuesi i saj. Në ndërtimin e fabulës, autori i kushton kujdes jo vetëm anës strukturore, por edhe përzgjedhjes së emrave të personazheve, të cilët, edhe me emër e bartin porosinë/synimin e autorit. Vepra letrare e tij përfaqëson vlera të mirëfillta artistike dhe zë një vend të merituar si dëshmi artistike e kohës dhe si vlerë e qëndrueshme letrare e gjuhësore. Niveli përgjithësisht i arrirë artistik, figuracioni i dendur, ndjenja e stërholluar artistike, shfrytëzimi në kapacitet i të gjitha niveleve të rrafshit semantikostilistik, të gjitha këto bëjnë që ato të derdhen/transformohen/virtualizohen në pamje të larmishme të realitetit dhe në sekuenca narrative me përmbajtje të thellë filozofike.

Shkrimtari i vendos fjalët në lidhje të befta/spontane e i vë në rrethana të atilla ligjërimore, duke ua zgjeruar edhe më tej rrethin e kuptimeve dhe të ngjyimeve stilistike. Pa mëtuar të bëjmë shpjegimin dhe vlerësimin artistik të figurave letrare të ndërtuara në to, po theksojmë se ky grup është pika kryesore e lidhjeve të fjalëve me vlera adekuate artistike. Në tekstin letrar, fjalët, lidhjet e tyre, rrafshi i kuptimeve, hyjnë në vepër ku dhe fitojnë vlera

stilitike. Fjalëkrijimi këtu realizohet me një strukturë përgjithësisht të organizuar dhe kjo prirje gjuhësore në të shumtën e herës është funksionale dhe e shumanshme.

Simbolika e përdorur është shprehje e përvojës njerëzore, që lidhet me fusha të ndryshme si me folklorin, ashtu edhe me kulturën fshatare. Përmes emrave simbolikë të personazheve, autori shfaq shëmbëlltyrën reale të kohës, të shoqërisë së atyre viteve, duke dhënë kështu nuancat kuptimore që, sipas logjikës simbolike, sjellin risi në prozën shqipe të kohës. Merita në prozë nuk qëndron tek tradita popullore për të rrëmbyer prej andej simbole, por në përdorimin e tyre me mjeshtëri, në funksion të fabulës që shtjellon. Nga fusha leksikore e mjedisit, krijoi simbolikën në kontekste të caktuara, si njohës i thellë i jetës së fshatarëve, duke i funksionalizuar këto detaje në tablotë e pasqyruara me atmosferë dhe me lëng jete. Sikundër e përcaktojnë gjuhëtarët, fjala, si njësi më e vogël gjuhësore, që ka kuptim leksikor tërësor e të mëvetësishëm, konsiderohet si njësi leksikore dhe si e tillë trajtohet/vlerësohet edhe në këtë punim.²⁰⁰

Krijimtaria letrare e Koço Kostës është një pasuri vlerash, të cilat ajo i qëmton e i sjell prej kulturës, traditave etnografike, folklorit dhe të folmeve të krahinave të jugut dhe veçanërisht të qytetit të Gjirokastrës. Jo rastësisht nëpër vepra, krahas frymës dhe perceptimeve e gjedheve leksikore prej këtyre hapësirave etno-psikolinguistike, kemi jo pak edhe fragmente prej lirikave apo baladave popullore.

*Mbi leshrat e tua,
Një fole bilbili.
Si do t'ia shkonj vetëm,
Këtë natë prilli.*

Krahinorizmat edhe një pjesë e profesionalizmave bujqësore, krijojnë ngjyresën e njëmendtë të vendit të ngjarjeve, d.m.th. ngjyresën krahinore të toposit letrar.

*Hapu moj zemër e shkretë;
Hapu, bënu fletë;
Nxirri jasht marazetë,
Sa të kalbet gjoksi i shkretë!*

Frazeologjizmat zënë një vend të dukshëm në vepër dhe krijojnë premisa për t'i skalitur në format më të spikatura personazhet dhe situatat në të cilat ata janë afishuar, brenda logjikës së organizimit letrar/artistik. Citojmë: “Kakua fshiu sytë me cepin e mandiles së zezë të ç'ngjyrosur dhe gërmonte midis qepëve me bishtin e shtrembër të rrëzuar përsipër. Ajo seç kishte veshur një kavadhe shumë të vjetëruar, që dikur duhej të kishte qenë e zbukuruar tek

²⁰⁰ Jani Thomai. “Teksti dhe gjuha”, Tiranë, 1992, f. 40.

fundi, tek mëngët dhe tek gjoksi. Dhe një biçim flokate apo sharkel me një gajtan të pambuktë”.²⁰¹

Autori zbulon dhe një tipar etnografik të rasteve të mortit në këto krahina, atë të goditjes së dheut me grushte dhe të çjerrjes në fytyrë të burrave dhe grave që vajtojnë: “... e bënë devrën duke qarë e u çjerrë, duke folur e gjakosur. Ajo qante me lemeri, dhe goditëte dheun me grushte”.

Shumë dëshmuere për etnografinë e të folurit në krahinën e Lunxhërisë (ambienti ku enden mjaft episode të kësaj veprë), është dhe fustani i nusërisë, i cili është një element i trashëguar nëpër breza prej traditave të lashta të zonës, të cilin shkrintari e ka përshkruar deri në detaje.

“Dhe befas para saj u shfaq tërë ngazëllim dhe plot zbukurime gazmore një Kostum Nusërie i krahinës së tyre. Kostumi ishte plot nënfunde dantellash, i qëndisur me fije ari dhe gajtanë jeshilë. Me mantelin e qëndisur me argjend dhe që në krahinën e tyre e quanin fermele. Në krye të kostumit ishte Kësula me plotë fije mëndafshi ngjyrë portokalli. Ato fije ishin këlloshat. Kësula kishte monedhën e madhe të floririt në mes të ballit. Dhe pesë monedha të tjera floriri mbi të. Dhe katër të tjera nga e djathta përmbi ato të pestat, dhe katër monedha të tjera, dhe treflorinj të mëdhenj dhe tre të vegjël..... Dhe gjer në krye të kësulës florinj. Dhe karapeshi i gjatë i kësulës. Dhe xhufka me llambro në njërën anë”.²⁰²

Bile, duke u distancuar së jashtmi, autori rrëfen dhe përshkruan në natyrën e mjeteve tipike të gjuhës e rrëfimit popullor, pa u bërë rob i tyre, larg çdo natyralizmi.

*Tatëpjet bregut vije,
Jelekverdha veshur-o,
Me mëngë përveshur-o...*

*Ti veje tek keshe punë,
Ika zëmëruar-o*

4.4.1 Leksiku si bërthamë e etnoligjërimit

Lexon veprën e Koço Kostës dhe të mbeten në mendje episodet e gjalla jetësore, larmia e personazheve tejet karakteriale, por mbi të gjitha leksiku i përdorur në të.

Autori përdor fjalë të thjeshta në dukje të parë, por që fitojnë valencë në rolin karakterizues në raport me sjelljet dhe qëndrimet e personazheve qarkullues: bushtër, thëngjill, bandill, kokonë, dajko, hamall, bandill, xhikë, dhjak, bullë etj.

Kjo mënyrë e karakterizimit të personazhit e bën secilin prej tyre më me karizmë, duke u dhënë kështu një regjistër ligjërimit sa më origjinal e të dalluar mes tyre.

P.sh : “*Dhe jelekun e kuq ia tund era. Ke parë ti, Leçe! Thuaj vetë motërzë, thuaj. Ai imi ishte trim. Të paça. S’më zuri kurrë në gojë nga ato kuturbirat, radiot. As nga këto...*

²⁰¹ Po aty.

²⁰² Po aty.

Hiqe këtë të ligë, Leçe, hiqe xanxën e kunadheve. S'është për ty kjo! Edhe të tallurat që bën, hiqi. Ose... po... .”²⁰³

Ai ka shfrytëzuar me mjeshtëri poliseminë e fjalës shqipe, duke e vendosur në raporte të reja, të cilat e zgjerojnë sferën e saj kuptimore edhe përmes togfjalëshit, duke përfshirë këtu edhe gjymtyrët e një krahasimi, por edhe përmes sistemit kompleks të opozicioneve leksikore e sintaksore.

Të kërkoi në mëndje, o bir! Ëhë, më kujtohet, tha Mëmlalja. – Vuanim e këndonim. Perëndi! Tas Petani e shikonte në gropat e syve.²⁰⁴

Pasurinë gjuhësore autori e qëmton mjeshtërisht nga *bota floreale*, apo dhe nga *kolonitë e kafshëve dhe shpendëve*. Kjo shkon në harmoni dhe me interesimin specifik të tij ndaj ambienteve rurale, ku dihet se këto gjallesa janë mjaft të pranishme dhe të lidhura fort me njeriun e atyre mjediseve. Njeriu krijon një raport të veçantë me to dhe rreth këtyre marrëdhënieve letërsia e të gjitha kohëve ka treguar interes të posaçëm. Në ato lidhje shpesh tejkalohej raportet e interesave dhe ato imediate, duke u humanizuar në skajshmëri, madje u ngritur në raporte më të epërme, universale, apo dhe qiellore/mistiko-religjioze.

Dihet se natyrën, pemët, barin, fluturat, kafshët, çdo veprim, shkrimtari e poetizon. Personazhet e Koço Kostës janë shumë të lidhur me bimësinë, e cila gjallon në një kontekstualitet dhe lidhshmëri organike me strukturat semantike dhe stilistike të teksteve të tij narrativë..

-Agronom,- thirri ajo,- si quhet kjo lule?

-Perikliu lëvizi dhe u kthye brinjas.

-Hë, si quhet lulja ime?

-Fikus, tha ai

-Dhe?

-Dhe e ka prejardhjen nga Azia dhe jeton më shumë se njëzet e pesë vjet.

-Ky fikus është dy vjeç. Atëherë ti do të jesh pesëdhjetë e tre vjeç.

Shkrimtari na paraqet një tablo, ku buron dashuria e zjarrtë ndaj atyre, të cilat ai vetë i quan burime të jetës.

*“Diku këndonte ende zogu i mëngjesit. Ende s'ishte shuar cicëritja gazmore e shpesëve. Dëgjoheshin hingëllima kuajsh dhe një e pallur gomari, gërhitje derrash dhe buluritje lopësh”.*²⁰⁵

²⁰³ Po aty

²⁰⁴ Po aty

²⁰⁵ Po aty

Përfundime

Koço Kosta është një prozator i veçantë në letërsinë shqipe, me një talent dhe individualitet të spikatur krijues, i cili parapëlqen prozën e shkurtër dhe në këtë zhanër shfaqet si mjeshtër i tregimit për freskinë e temave dhe të situatave, për konfliktet e fuqishme, për larminë e personazheve, për ndërthurjen e tipareve të realizmit me ato të modernizmit, tipare që në periudhën e parë të krijimtarisë fshihen pas mburojës zyrtare të “realizmit socialist”, duke krijuar iluzionin e respektimit kanonik të parimeve të “realizmit socialist”, me vëmendjen që u kushtohet personazheve dhe heronjve “pozitivë” apo “fundin e lumtur optimist”, që në fakt është shpesh një “dues ex machine”, kalkuluar në mënyrë të ndërgjegjshme prej autorit. Personazhet e Kostës janë në fakt njerëz të thjeshtë, njerëz të punës, të cilëve u kundërvihen burokratë shpirtthate dhe “gjuetarë privilegjesh”, që fshihen nën retorikën “socialiste”.

Proza e Kostës është konceptuar përgjithësisht si një prozë karakteresh të kundërta. Pena e shkrimtarit, sidomos në pjesën më të madhe të tregimeve dhe të novelave, dëshmon mprehtësi e frymë kritike në zbulimin e dukurive negative dhe të konflikteve reale, që ai dëshmon jo pak mjeshtëri, që t’i shndërrojë besueshëm në konflikte artistike (pjesa më e madhe e personazheve të tij e kanë prototipin e tyre në jetë, ku shkrimtari i ka ndeshur dhe i ka zgjedhur si model). Kjo frymë e mprehtësi kritike doemos që binte ndesh me frymën idealizuese të drejtimit zyrtar të “realizmit socialist” dhe të skematizmit të tij, që i shndërronte të ashtuquajturit “heronj pozitivë” në personazhe skematike, pa jetë dhe pa botë të brendshme.

Personazhet e këtij autori në fillim kanë ndjekur parimin e riprodhimit të ligjshmërive të realitetit, duke ngritur në art me parimin e “mimezimit” karaktere të caktuara, zakonisht nga radhët e fshatarëve, herë-herë të punëtorëve, si dhe të shtresave të privileguara që u krijuan në socializëm. Ai depërton në vetëdijen dhe nënvetëdijen e personazheve të veta dhe skalit kështu thelbin individual psikologjik të tyre dhe herë-herë edhe ndjenjat më labirintike, të pleksura me doza instinktive, që ata shfaqin sipas rastit, në raport me situata ekstreme. Herë-herë shkrimtari i projektton personazhet e veta edhe në plane ekzistenciale, ku vihen në evidencë shenja të pankohësisë, si p.sh. kur ndalet në ndjenjat universale të dashurisë erotike (së cilës i jep një vend të ndjeshëm në krijimtarinë e vet, për ta vënë mandej në qendër të veprës kryesore të periudhës së dytë të kësaj krijimtarie “Nata e Sofie Kondilit”), të amësisë (hasim dendur tek ai figura të dhembshura dhe tragjike), të qëndrimit të personazheve përballë sfidës së vdekjes (duke përshkruar dramën e trazuar dhe stoicizmin, por edhe ndjenjat e forta njerëzore të frikës - përballë asaj gjëme apokaliptike, sikundër është vdekja).

Koço Kosta ka aftësinë të funksionalizojë në prozën e tij disa teknika artistike, që janë karakteristike për individualitetin e tij, si:

- të ashtuquajturin parimi të “ajsbergut”, sipas të cilit, teksti letrar i shfaqur/fiksuar grafikisht, është vetëm një pjesë e *megatekstit*, ku kanë vendin e tyre funksional dhe një sërë *kriptotekstesh* të tjerë si: nënteksti, parateksti, hiperteksti etj.;
- dinamizmin e stilit të narracionit, larg rrëfimit me strukturë lineare, që shprehet sidomos përmes këmbimit apo alternancave narrative, gjithashtu nëpërmjet frazës së shkurtër (rrëfimit sintezë), shprehjeve/shenjave që përsëriten me një frekuencë të caktuar, duke fituar atributet e një kodi që kërkon vëmendjen dhe bashkëpunimin/përfshirjen e lexuesit për ta kuptuar e shijuar/zbërthyer si duhet e deri në fund, brenda këtij rrjeti instrumentesh çelësa;
- drammatizmi nën vallon e së zakonshmes, së përditshmes;
- Kontrasti i zbuluar në personazhet me karaktere të kundërta, të cilët përcjellin kësisoj betejën e gjithëkohshme mes vlerës dhe vesit, dashurisë dhe urrejtjes, prirjes konstruktive dhe asaj shkatërruese/plojës, punës dhe vanitetit, progresit dhe regresit në tërë sferat ku ai shfaqet...
- Shumëllojshmëria apo pozita polifonike e figurës së rrëfimitarit, që herë prezantohet si narrator omnishent (i gjithëdijshtëm) e herë si narrator i pidentifikuar, herë me elemente autobiografike e herë me rrëfim për të tjerët, duke alternuar kështu mes tyre ato që përcaktohen si *rrëfim objektiv* dhe *rrëfim subjektiv*. Edhe ky pozicionim/kalkulim i autorit në veprën e tij, krijon variacion, krijon ritëm dhe një stil që shpesh përcaktohet si polifonik, nga pikëpamja e prirjes alternuese të atyre strukturave tekstore e jashtëtekstore brenda një krijimtarie.

Rrëfimitarët i ndeshim të rrëfejnë herë në vetën e parë (ku mosdija ose dija e paktë e rrëfimitarit përlligjet brenda logjikës artistike), por edhe në vetën e tretë në vokalizim tek njëri prej personazheve. Koço Kosta përdor edhe rrëfimin me dy zëra. Mënyra pavetore e narracionit gërshetohet ose alternohet me mënyrën personale. Në tregimet e tij shpesh vihet re mungesa e subjektit të jashtëzakonshëm dhe thërrmimi i subjektit, si dhe relativizmi i kronotoposit. Këto tipare të prozës së shkurtër vihen re edhe në romanet e tij, por jo me të njëjtën realizim estetik. Ky realizim që është i fuqishëm tek romani “Nata e Sofie Kondilit”, përcillet më i zbehtë tek “Buka e një stine me borë” dhe tek “Absurdi”. Në fund të periudhës së parë të krijimtarisë së Koço Kostës, elementet moderniste kanë arritur kulmin tek novela “Ata të dy dhe të tjerë”, ku mesazhi disident gjeti formën e vet të re moderne, të kalkuluar mjaft bindshëm estetikisht.

Në periudhën e dytë të krijimtarisë (pas viteve 90), vëmë re tipare të qarta moderniste që gjejnë kurorëzimin e vet në një nga romanet më të realizuara, ku vëmendja ndaj personazhit dhe botës së tij shpirtërore përcillet si një “rilindje” e personazhit me dialektikën e shpirtit të vet. Proza e Kostës ka zigzaget e veta, por ndjek në përgjithësi një vijë evolucioni (do të bënim një përjashtim për romanin “Absurdi”, të cilit, ndonëse nuk i mungojnë disa pasazhe të bukura lirike, vuan nga një fragmentarizëm që e dëmton).

Novela “Ata të dy dhe të tjerë” besojmë se shënon kulmin e periudhës së parë, dhe jo romani “Buka e një stine me borë”, ashtu si “Nata e Sofie Kondilit” përbën edhe kulmin e periudhës së dytë të krijimtarisë së autorit.

Koço Kosta, me veprat e tij më të realizuara, bashkë me shkrimtarë të tjerë bashkëkohës si Zija Çela, Vath Koreshi, Fatos Kongoli etj. ka kaluar nga shkrimtar periferik,

ndonëse i njohur dhe i vlerësuar, i periudhës së realizmit socialist, në shkrimtar të qendrës të letërsisë bashkëkohore shqipe. Gjithsesi, ky shkrimtar, për të cilin është shkruar shumë, qoftë për ta vlerësuar, qoftë për ta anatemuar, por që kryesisht kanë qenë kritika në nivel recensional, meriton studime më të thella, që të përcaktojnë vendin e tij në një histori të ardhshme të letërsisë shqipe.

Ndonëse vepra e këtij prozatori është e shtrirë në një kohë të gjatë, afër gjysmë shekulli, për më tepër në një kohë jo vetëm kalendarike, por që rezulton të jetë dhe kohë me dallime estetike, gjithsesi ajo vepër, ashtu si dhe për shkrimtarë të tjerë, është dhe mbetet një e tërë. Është pra vepra e shkrimtarit të njohur Koço Kosta, obligim që të studiohet si e pandarë, me tërë tiparet e modeluara prej tij, nëpër rrethana të ndryshme personale e sociale.

BIBLIOGRAFIA

1. Vepra të Koço Kostës

1. “Në rrugë”. Tregime dhe novela. “Naim Frashëri”, Tiranë, 1967.
2. “Shënime përmes shiut”. Skica, reportazhe, portrete. “Naim Frashëri”, Tiranë, 1968.
3. “Krishtë mes gurgullimash”. Tregime dhe novela. “Naim Frashëri”, Tiranë, 1969.
4. “Bisedë në mesnatë”. Tregime dhe novela. “Naim Frashëri”, Tiranë, 1971.
5. “Dademadhja”. Tregime dhe novela. “Naim Frashëri”, Tiranë, 1976.
6. “Buka e një stine me borë”. Roman. “Naim Frashëri”, Tiranë, 1979.
7. “Era e udhëve”. Tregime dhe novela. “Naim Frashëri”, Tiranë, 1981.
8. “Tregime të zgjedhura”. Tregime. “Naim Frashëri”, Tiranë, 1985.
9. “Paradite me shi”. Tregime dhe novela. Tiranë, 1991.
10. “Ata të dy dhe të tjerë”. Novelë. “Shtëpia botuese Enciklopedike”, Tiranë, 1994.
11. “Nata e Sofie Kondilit”. Roman. “Dudaj”, Tiranë, 2007.
12. “Absurdi”. Roman. “Dudaj”, Tiranë, 2009.

2. Literaturë teorike dhe kritika letrare e shfrytëzuar

1. Abazi, Xhezair. “Jeta dhe procesi letrar”. Tiranë, “Naim Frashëri”, 1984.
2. Abdihoxha, Ali. “Probleme të zhvillimit të letërsisë sonë”. .
3. Aliu, Ali. “Vepra të zgjedhura I, II, III, IV”. Shkup, 2005.
4. Aliu, Ali. “Artikuj kritikë”. Prishtinë, “Rilindja”, 1983.
5. Aliu, Ali. “Dëshmi letrare”. Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2008. Aliu, Ali. “Kërkime: studime, kritika, ese”. Tiranë, “Naim Frashëri”, 1990.
6. Aliu, Ali. “Koha dhe krijuesi”. Prishtinë, “Rilindja”, 1975.
7. Aliu, Ali. “Kritika”. Prishtinë, “Rilindja”, 1980.
8. Aliu, Ali. “Kronika letrare”. Shkup-Prishtinë-Tiranë, 2003.
9. Aliu, Ali. “Rrjedhave të letërsisë”. Prishtinë, “Rilindja”, 1977.
10. Aliu, Ali. “Shqyrtime”. Prishtinë, “Rilindja”, 1974.
11. “Analogjia-përfitesë e romanit modern bashkëkohor shqiptar”. Në librin “Rrjedhat e letërsisë bashkëkohore shqiptare”, Prishtinë 2005.
12. Ann Jefferson. “Teoria letrare moderne”, Tiranë, “Albas”, 2004.
13. Aristoteli. “Poetika”, Prishtinë, 1998.
14. “Artikuj dhe studime kritike për letërsinë e sotme shqipe”. Disp. 1. 2. Tiranë, 1974.

15. Grup autorësh. "Historia e letërsisë shqipe të realizmit socialist", Dispenca 1 dhe 2, Tiranë, 1986.
16. Bart, R. "Aventura semiologjike", Prishtinë, 1989.
17. Barthes, Roland. "Variazioni sulla scrittura seguite da Il piacere del testo", Einaudi, Torino, 1999.
18. Barthes, Roland: "Aventura semiologjike", Dukagjin, 2008.
19. Bashota, Sali. "Domethënia e ideve letrare".
20. Bashota, Sali. "Studime letrare". f. 304.
21. Beqiri, Xhavit. "Liria e leximit".
22. Berisha, Anton. "Mundësi interpretimi". Prishtinë, "Rilindja", 1979.
23. Bihiku, Koço. "Jeta bashkëkohore në romanin shqiptar të realizmit socialist të viteve 70". Studime filologjike. Tiranë, 1980, nr. 3.
24. Bihiku, Koço. "Letërsia dhe koha". Tiranë, "Naim Frashëri", 1982.
25. Bihiku, Koço. "Probleme letrare". Tiranë, "Naim Frashëri", 1979.
26. Bihiku, Koço. "Probleme të zhvillimit të romanit të sotëm shqiptar". 1/1976
27. Bihiku, Koço. "Studime filologjike". Tiranë, 1976, nr. 1.
28. Bihiku, Koço. "Studime filologjike". Tiranë, 1984, nr. 2.
29. Bishqemi, Astrit. "Unë dhe komiti (1969)". Në: A. Bishqemi, "Histori e letërsisë shqiptare për fëmijë e të rinj". Botimi i tretë i plotësuar dhe i përmirësuar. Tiranë: "Dy Lindje dhe dy Perëndime": Univ. "A. Xhuvani" - Elbasan. Depart, i Gjuhës dhe i Letërsisë, 2008.
30. Boçi, Luçiano. "Koha në poetikën e romanit: studim". Elbasan, "Sejko". 2005.
31. Boçi, Thanas. "Duke kërkuar të veçantën ...: studime letrare".
32. Brahimi, Razi. "Vepra dhe profile krijuese: studime dhe artikuj për letërsinë"
33. Brahimi. Razi. "Letërsia dhe artet në dritën e Partisë".
34. Bullo, Jorgo. "Tradita dhe risi letrare".
35. Buroviç, Kapllan. "Ngadhënjimi mbi vdekjen: studime, artikuj e recensione"
36. Croce, B. "Estetika si shkencë e shprehjes dhe gjuhësisë së përgjithshme". Tiranë 1998.
37. Çefa, Anton. "Në hullitë e fjalës artistike: kritikë letrare, analiza, interpretime, vlerësime".
38. Chevrel, Yves. "Letërsia e krahasuar". "Albin", Tiranë 2000.
39. Çiraku, Ymer. "Gjurmime në letërsinë shqiptare". "Albas", Tiranë 2003.
40. Çiraku, Ymer. "Në zbërthim të kodeve letrare". "Toena", Tiranë, 1998.
41. Çulli, Izet. "Dashuri dhe mall: recensione, reportazhe, portrete, aforizma".
42. Dado, Floresha. "Teoria e veprës letrare-Poetika". Tiranë 2003.
43. Dado, Floresha. "Intuitë dhe vetëdije kritike". Tiranë 2007.
44. Dado, Floresha. "Proza nëpër teknikat poetike". Tiranë, "Toena", 1997.
45. Dado, Floresha. "Sfida teorike të historiografisë letrare". Tiranë, 2009.
46. Dado, Floresha. "Teoria e veprës letrare-Poetika". Tiranë, 2002.
47. Dilaveri, Dilaver. "Disa karakterizime të prozës së Koço Kostës". Në librin: D. Dilaveri, "Në rrugën e zhvillimit të prozës sonë të shkurtër: studime dhe artikuj kritikë". Tiranë, 1982.
48. Dilaveri, Dilaver. "Meditime letrare: artikuj kritikë". Tiranë, 1972.

49. Dilaveri, Dilaver. "Nëpër faqet e prozës sonë". Tiranë, "Naim Frashëri", 1977.
50. Dykro, O. Todorov, Ç. "Fjalor enciklopedik i shkencave të ligjërimit". Prishtinë, 1984.
51. Eko, Umberto. "Si bëhet një punim diplome", Tiranë, 1997.
52. Eko, Umberto. "Struktura e papranishme", Pejë, 1988.
53. Elsie Robert. "Historia e letërsisë shqipe". Pejë, "Dukagjini", 1997.
54. Elsie, Robert. "Historia e letërsisë shqiptare". Tiranë-Pejë, 1997.
55. "Fenomeni i avanguardës në letërsinë shqipe". Aktet e seminarit shkencor: Tiranë, 3.5.2004. Tiranë, "Arbëria", 2004.
56. Fetiu, Sefedin. "Krijues dhe krijime: shënime kritike dhe eseistike". Prishtinë, 1979.
57. Fetiu, Sefedin. "Poetika e romanit shqiptar (1952 - 1977)". Prishtinë : Instituti Albanologjik, 1992.
58. Fraj Northrop : "Anatomia e kritikës". "Rilindja", 1990,
59. Fraj, Northrop. "Anatomia e Kritikës". Rilindja, Prishtinë 1990.
60. Garni, N. "Studime për letërsinë realiste". Tiranë, 1997.
61. Gashi, Sinan. "Vlerësime, preokupime, premtime: shkrime për letërsi, art e kulturë".
62. Gashi, Sinan. "Laryshi tematike: (shkrime për letërsi, art e kulturë)".
63. Gjergji, Demir. "Shtëpia e shkrimtarit". Tiranë, "Onufri", 2001.
64. Gjoka, Behar. "Sistemi letrar piramidal: shqyrtime teorike dhe tekstologjike".
65. Hamiti, Sabri. "Letërsia moderne shqipe".
66. Hamiti, Sabri. "Poetika shqipe: bioletra; tematologjia; albanizma".
67. Hamiti, Sabri. "V. 8: Letërsia moderne".
68. Hamiti, Sabri. "V. 9: Letërsia bashkëkohore".
69. Hasani, Hasan. "Faqe libri: (shënime letrare)".
70. "Historia e letërsisë si grindje metodike". Shkodër, Univ. i Shkodrës "Luigj Gurakuqi". Depart. i Letërsisë. Sekt. i Albanologjisë, 1995.
71. "Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist". Tiranë: Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 1978.
72. Ismaili Rifat. "Aspekte të prozës sonë". Prishtinë, "Rilindja", 1981.
73. Jasiqi, Ali D. "Premtime e realizime". Prishtinë, "Rilindja", 1976.
74. Jasiqi, Ali D. "Tridhjetë e një shkrime për prozën, studimet e të tjera". Prishtinë, 2007.
75. Jeferson, Ann; Robey, David. "Teoria Letrare Moderne". "Albas", Tiranë 2004.
76. Jefferson, A. Robbey, D. "Teoria Letrare Moderne", Tiranë-Tetovë, 2004.
77. Jorgaqi, Nasho. "Profile dhe probleme letrare: (studime, gjurmime, ese)".
78. Kadare, Ismail. "Krijimtaria letrare e rinisë. Artikuj dhe studime kritike për letërsinë e sotme shqipe". Disp.1, Tiranë: Univ. Tiranë, fakulteti Histori-Filologjisë, 1974.
79. Kaller, Xhonatan. "Teori letrare". "Era", Prishtinë, 2001.
80. Kallulli, Adriatik. "Pema e jetës: kritika, studime, ese". Tiranë, OMSCA-1, 2001.
81. Koliqi, Ernest. "Kritikë dhe estetikë". Tiranë, 1999.
82. Kristo Erion. "Afresk kritik".
83. Kuçuku, Bashkim. "Palimpset për vetshkatërrimin dhe vetpërmbajtjen, për romanin "Ulku dhe Uilli" të Vath Koreshit në dy pamje". Mësonjëtorja, Tiranë, 2005.

84. Kuçuku, Bashkim. "Periudha e realizimit dhe e modernitetit bashkëkohor". Në revistën "Studime albanologjike", 2008/2.
85. Kuçuku, Bashkim. "Ironia groteske në romanin "Im atë donte Adolfin Mehmet Krajës". Në përmbledhjen "Seminari XXVIII Ndërkombëtar për gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare". Prishtinë, 2009.
86. Kundera, Milan, "Arti i Romanit", Toena, Tiranë, 2001.
87. "Letërsia bashkëkohore shqiptare: pas Luftës së Dytë Botërore" / Ali ALIU, Shaban SINANI, Stefan ÇAPALIKU - Tonin ÇOBANI. - Tiranë – Tetovë, "Alb-aas", 2001.
88. "Letërsia dhe qyteti". Aktet e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare "Letërsia dhe qyteti", mbajtur në Tiranë, më 5-6 nëntor 2009.
89. "Letërsia jashtë kopshteve tanë". Autorë shqiptarë.
90. "Letërsia si e tillë: probleme të vlerësimit të trashëgimisë sonë letrare". Akte të konferencës shkencore me këtë temë mbajtur në Tiranë më 28-29 mars 1996. Tiranë, "Toena", 1996. Lezha, Neki. "Hulumtime letrare". Tiranë, "Naim Frashëri", 1976.
91. Lodge, David. "L'arte della narrativit", Bompiani, Milano 2001.
92. Loli, Pirro. "Dumvirati i një stine që shkoi: ese"
93. Loli, Pirro. "Sirenat: ese".
94. Lumi, Elvira. "Simbolika e shahut në letërsi: ese, tregime, kritikë".
95. Mato, Jakup. "Paradokset e satirës dhe të humorit". Tiranë, "Toena", 2000.
96. Milivoj Solar, "Hyrje në shkencën e letërsisë", Tiranë, "Julvin", 2004
97. Mustafa, A. "Hyrje në metodologjinë e punës kërkimore-shkencore në fushë të filologjisë". Shkup, 2006.
98. Mustafa, Xhemail. "Mrekullia e shkrimit".
99. Neziri, Z. "Variacione letrare". Shkup, 2004.
100. Omari, Donika. "Kulturë e ndërprerë: disa kujtime, shkrime publicistike, shkrime letrare".
101. Pepa, Agim. "Refleksione letrare: artikuj kritikë".
Plaku, Nuri. "Qyteti pa statuja: ese"
102. Plasari, Aurel. "Panteoni i gjymtuar". "Nëntori", nr. 4, 1991.
103. Pozzato, Maria Pia. "Semiotika e Tekstit". SHBLU, Tiranë, 2005.
104. "Probleme të zhvillimit të romanit të sotëm shqiptar". Tiranë, "Naim Frashëri", 1977.
105. Qosja, Rexhep. "Dialogje me shkrimtarët". Prishtinë, 1979.
106. Qosja, Rexhep. "Historia e letërsisë shqipe-Romantizmi I". Prishtinë, 1990.
107. Qosja, Rexhep. "Historia e letërsisë shqipe-Romantizmi II", Prishtinë, 1990
108. Qosja, Rexhep. "Historia e letërsisë shqipe-Romantizmi III", Prishtinë, 1990.
109. Qosja, Rexhep. "Tri mënyra të shkrimit shqip". "Toena", Tiranë, 2005.
110. Qosja, Rexhep. "Shkrimtarë dhe periudha".
111. Raifi, Mensur. "Mbi prozën bashkëkohëse shqiptare". Prishtinë, 1978.
112. Raifi, Mensur. "Mozaik letrar. I". Pejë, "Dukagjini", 1998.
113. Rugova, Ibrahim. Hamiti, S., Kritika letrare, Prishtinë, 1979
114. Rugova, Ibrahim. "Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare". "Eurorilindja", Prishtinë, 1996.
115. Rugova, Ibrahim. "Refuzimi estetik".

116. Rugova, Ibrahim: “Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983”. 2005.
117. Sartre, Zhan Pol. “Egzistencializmi është humanizëm”. Tiranë, 1997.
118. Sinani, Shaban. “Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të : (studime)”.
119. Sopaj, Nehas. “Rrëfimi në romanin shqiptar”. Shkup, “Shkupi”,
120. Spaho, Vjollca. “Tej mureve të fjalës: komente mbi tekste letrare”.Tiranë, “Fan Noli”, 2006.
121. “Studime dhe kritikë letrare”. (Nga autorë shqiptare të Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi). Tiranë, “Naim Frashëri”, 1983.
122. “Studime për autorë të ndaluar”
123. Shala, Kujtim. “Kujtesa e tekstit”. “Buzuku” Prishtinë, 2003.
124. Shapllo, Dalan. “Duke kërkuar të vërtetën dhe humanizmin”. Tiranë, “Toena”, 1999.
125. Shapllo, Dalan. “Letërsia dhe realiteti ynë”. - Tiranë: Naim Frashëri, 1968
126. Shapllo, Dalan. “Vepra dhe probleme të realizmit socialist (Artikuj kritikë)”. “Naim Frashëri” Tiranë, 1982.
127. Shema, Isak. “Aspekte të letërsisë”. “Rilindja” Prishtinë, 1985.
128. Shema, Isak. “Letërsia shqiptare e shekullit XX: studime dhe vështrime letrare”. Prishtinë, 2005.
129. Shema, Isak. “Procedime letrare”. Prishtinë, 1999.
130. Shema, Isak. “Studime letrare”. Prishtinë, 2008.
131. Shema, Isak. “Vlerësime të letërsisë shqiptare”. Prishtinë, 1996.
132. Shema, Isak. “Vrojtime letrare dhe artistike”. Prishtinë, 1995.
133. Terziu, Fatmir. “Kritika ndryshe: vëzhgim në brendësi të prozës e poezisë shqiptare I”.
134. Todorov, Ç. “Poetika”, Shkup, 1998.
135. Todorov, Ç. “Poetika e prozës”, Tiranë, 2000.
136. Topçiu, Luan. “Përmasa moderne në letërsinë shqiptare”.
137. Topçiu, Luan: “Tekstualizëm dhe stil”, Bukuresht, 2000.
138. Topollaj, Sh. “Armiq pa dashje: kritika letrare”.
139. Uçi, Alfred. “Probleme të estetikës”, Prishtinë, 1980.
140. Uçi, Alfred. “Barra tragjike e heronjve të letërsisë: eseistike kritiko – letrare”. “Mësonjëtorja e Parë” Tiranë, 2001.
141. “Vath Koreshi: profil në dy pamje: portrete - shënime kritikë – biseda”. Zgjodhi e përgatiti P. Palushi. “Mësonjëtorja” Tiranë, 2005.
142. Uellek, Rene / Uoren Ostin. “Teoria e letërsisë”, SHBE Tiranë, 1993.
143. Vellek, W. Austin. “Teoria e Letërsisë”, Tiranë, 1993.
144. “Vëzhgime kritike”. “Rilindja” Prishtinë, 1978.
145. Vinca Agim. “Alternativa letrare shqipe”, Sh. b. “Shkupi” Shkup,1995.
146. Vinca, Agim. “Kurs i Teorive Letrare”. Prishtinë, 2002.
147. Vozga, Ramazan. “Thellësitë e fjalës”. “Naim Frashëri” Tiranë, 1982.
148. Xhaferi, Hamit. “Shqyrtime letrare”.
149. Xhiku, Ali. “Letërsia shqipe si polifoni”. “Dituria” Tiranë, 2004.

150. Zisi Roland. "Miti i Narcisit në letërsinë shqipe. Studim monografik". "Alb Paper" Tiranë, 2013.
151. Zisi, Roland. "Veçoritë e narracionit e të përshkrimit". "Panteon & Afërdita" Tiranë 2001.
152. Zheji, Gjergj. "Vëzhgime metrike". Prishtinë, 1981.
153. Zhenet, Zh. "Figura". Prishtinë, 1985.
154. Zhyllia, D. "Fjalor i filozofisë". Tiranë, 1994.

3. Kritika letrare mbi veprën e Koço Kostës

1. Aliu Ali. "Koço Kosta". Në: "Jeta e re", Prishtinë, nr 5, shtator-tetor 1978.
2. Berisha Isuf / Shkëlzen Maliqi. "Novela e thyer. - Mbi prozën e Koço Kostës *Ata të dy dhe të tjerë*". Në: "Fjala", Prishtinë, nr 1, janar, 1987.
3. Bishqemi Astrit. "Unë dhe komiti". 1969. Në: "A. Bishqemi, Histori e letërsisë shqiptare për fëmijë e të rinj. Botimi i tretë i plotësuar dhe i përmirësuar. Tiranë; "Dy lindje dhe dy Perëndime". Universiteti "A. Xhuvani", Elbasan, Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë, 2008.
4. Bihiku Koço. "Njerëzit e ditëve tona në prozën e sotme". Studime filologjike, nr 2/1984, Tiranë, f. 8-9.
5. Bihiku, Koço. "Jeta bashkëkohore në romanin shqiptar të realizmit socialist të viteve 70". Në: Studime filologjike. Nr. 3/1980, Tiranë, f. 83-86.
6. Berati Lumira. "Probleme të pasqyrimin të heroit pozitiv në romanin e viteve të fundit". Në: "Gjuha shqipe dhe letërsia në shkollë", nr 9/1985, f. 86-89.
7. Brahimi, Razi. "Tregime të zgjedhura. (Vëllim nga Koço Kosta)". Në:
8. "Drita", 15 shtator 1985, f. 6, 12.
9. Brahimi, Razi. "Vlagë jete. (Romani *Buka e një stine me borë* i Koço Kostës). Në: "Drita", 3 shkurt 1980, f. 6-7.
10. Braho, Ibrahim. "Era e udhëve, një vëllim i bukur". Në: "Nëntori", nr. 7, korrik 1982, f. 70-72.
11. Bushaka, Gaqo. "Unë dhe komiti (Tregime)". "Naim Frashëri" Tiranë, 1969. Në: "Nëntori", nr. 6, qershor 1969, f. 172-173.
12. Bardhyli Esmeralda. "Të rrezikosh për letërsinë: Koço Kosta, shkrimtari që theu rregullat e letërsisë së realizmit socialist". Në: "55", nr. 318, 1 dhjetor 2005, f. 19.
13. Bllaci Jorgo. "Një libër jashtë skemës. (Koço Kosta, "Paradite me shi")". Në: "Drita", 28 qershor 1992, f. 3-4.
14. Boriçi Nuredin. "Vështrim panoramik i një konference imagjinare apo joimagjinare për artet dhe letërsinë në qytetin e Fierit". "Koha jonë", tetor 1994 .
15. Bihiku Koço. "*Ata të dy e të tjerë* e Koço Kostës". Në: "Zëri i popullit", 21 tetor 1995, f. 9.
16. Bllaci. Jorgo. "Një libër jashtë skemës. (Koço Kosta, "Paradite me shi")". Në: "Drita", 28 qershor 1992, f. 3-4.

17. Çela, Zija. "Jetë që vjen në art. (Vëllimi me tregime "Era e udhëve" i Koço Kostës)". Në: "Drita", 8 gusht 1982, f. 5-6.
18. Çausi Tefik. "Vesa e qerpikëve, (Anika). Koço Kosta dhe Anika, tregim në vëllimin "Dademadhja" (1976)". Në librin: "T. Çausi, Klubi i personazheve (shënime për personazhe të shquara të letërsisë shqipe)". "Dajti" Tiranë, 2000, f. 151-157.
19. Demo Elsa. "Duhet 200 palë sy që ta shohin qind për qind: Koço Kosta, "Ata të dy dhe të tjerë". Në: "Shekulli", nr. 329, 28 nëntor 2005, f. 18.
20. Demolli Skënder. "Kjo anomali duhet të ndalet, është urdhër kombëtar". (Marrë nga interneti).
21. Dilaveri, Dilaver. "Vëllimi Bisedë në mesnatë: Koço Kosta, Bisedë në mesnatë". "Naim Frashëri" Tiranë, 1971. Në: "Drita", 26 mars 1972, f. 3-4.
22. Dilaveri Dilaver. "Disa karakterizime të prozës së Koço Kostës". Në: "D. Dilaveri, Në rrugën e zhvillimit të prozës sonë të shkurtër: studime dhe artikuj kritikë", Tiranë 1982, f. 141.
23. "Diskutim krijues i temës aktuale për vëllimin me tregime dhe novela të K. Kostës". Në: "Drita", 6 qershor 1982.
24. Elezi Mehmet. "Shkrimtari nuk ka kohë të vdesë : "Paradite me shi". Në: "Drita", 16 shkurt 1997, f. 14.
25. "Era e udhëve. (Tregime e novela). Tiranë: "Naim Frashëri", 1981: Trajtimi artistik i temës aktuale". (Diskutim krijues i zhvilluar në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve për vëllimin me tregime dhe novela të Koço Kostës). Në: "Drita", 6 qershor 1982.
26. Elsie Robert. "Koço Kosta". Në: "R. Elsie, Histori e letërsisë shqiptare". "Dukagjini" Pejë, 1997.
27. Kallulli, Adriatik. "Fshati ynë socialist në një vëllim me tregime. (Mbi vëllimin Dademadhja të Koço Kostës)". Në: "Drita", 8 maj 1977, f. 6- 7.
28. Kallulli, Adriatik. "Kërkime dhe gjetje të reja novatore. (Mbi vëllimin me tregime e novela *Era e udhëve* të Koço Kostës)". Në: "Nëntori", nr. 6, qershor 1982, f. 17-30.
29. Kuçuku, Bashkim. "Me personazhet e një vëllimi: Koço Kosta, *Bisedë në mesnatë*". "Naim Frashëri" Tiranë, 1971. Në: "Nëntori", nr. 9, shtator 1972, f. 12-18.
30. Kuçuku, Bashkim. "Vendin e parë njeriut të tokës". Në: "Nëntori", nr. 8, gusht 1977, f. 144-154.
31. Kosta Koço. "Refleksion: Koço Kosta rrëfen vetveten. Diçka për vete dhe për romanin "Ata të dy dhe të tjerë". Në: "Tema", nr. 1641, 9 dhjetor 2005, f. 20-21.
32. Këlliçi Skifter. "Unë dhe komiti". Në: "Mësuesi", 21 qershor 1969.
33. Kosta Koço. "Fshatari Doke". Në: "Jeta e re", nr 5, f. 630-64.
34. Haxhia Miranda. "Përse e dua letërsinë e Koço Kostës". Në: "Standart", nr. 1239, 9 maj 2009, f. 18-19.
35. Gjata Trim. "Që të mos ketë më "shaka të rënda" me jetën e fshatarësisë. (Mbresa nga vëllimi: "Paradite me shi" i K. Kostës)". Në: "Zëri i popullit", 21 dhjetor 1991.
36. Gjata Trim. "Diktatura dhe vepra letrare "thellësisht e gabuar". (Me rastin e botimit të novelës "Ata të dy dhe të tjerë" të K. Kostës). Në: "Republika", 12 janar 1995, f. 3.
37. Laço, Teodor. "Lëngu i jetës. (Shënime për romanin *Buka e një stine me borë*)". Në: "Nëntori", nr. 3/1980, f. 31-41.

38. Londo Bardhyl. “Himn kundër së keqes: Koço Kosta, novela *Dhelpra*”, Në: “Albania”, 26 shkurt 2000, f. 10.
39. “Mbi novelën thellësisht të gabuar *Ata të dy e të tjerë* (autor Koço Kosta): (autokritika e redaksisë së revistës pas anulimit të botimit dhe asgjësimit të pjesës së botuar të novelës në numrin e mëparshëm). Në: “Nëntori”, nr. 5, maj 1986, f. 20-28.
40. Myftiu, Mehmet. “Dashuria e burimeve të jetës”. Në: “M. Myftiu, ESE, poezi, dokumente të letërsisë”. “Marin Barleti” Tiranë, 1998, f. 85-89.
41. Myftiu, Mehmet. “Letër Koço Kostës për romanin *Nata e Sofie Kondilit*”. Në: “Ndryshe” (“Drita Ndryshe”, suplement), nr. 16, 24 shkurt 2008, f. 17.
42. Moja, Llazar. “Atmosfera e fshatit të ditëve tona. (Mendime për veprat e K. Kostës)”. Në: “Zëri i Rinisë”, 12 korrik 1980.
43. Malo Foto. “Biseda të ditës: Koço Kosta, *Bisedë në mesnatë*”. Në: “Zëri i Rinisë”, 18 mars 1972, f. 3.
44. “Mbi novelën thellësisht të gabuar *Ata të dy dhe të tjerë*”. “Drita”, 23 janar 1994, f. 3.
45. Myftiu Mehmet. “Dashuria e burimeve të jetës. (Koço Kosta, Paradite me shi)”. Në: “Drita”, 23 shkurt 1992, f. 6.
46. “Në qendër të romanit puna e fshatarësisë kooperativiste”. (Diskutim krijues për romanin “Buka e një stine me borë” të Koço Kostës). Në: “Drita”, 23 dhjetor 1979, f. 6, 11.
47. Topallaj Shpend. “Koço Kosta- shkrimtari që foli aq trimërisht”. Në: “55”, nr. 33, 8 shkurt 2003, f. 20-21.
48. Topallaj Shpend. “Shpend Tersiti i letërsisë së realizmit socialist: rreth novelës: “Ata të dy dhe të tjerë” të shkrimtarit Koço Kosta”. Në: “Sh. Topallaj, Paqja –virtut i çivilizimit: kritika letrare”. “Globus” Tiranë, 2003, f. 15-28.
49. Stroni. Thoma. “Diskutim krijues për romanin *Buka e një stine me borë*”. Në: “Drita”, 29 qershor 1980, f. 6.
50. Seiti Arta. “Nevoja e një dëshmie. Njëzet vjet pas ndalimit të botimit të novelës “Ata të dy dhe të tjerë” të Koço Kostës, botuar në revistën “Nëntori”. Në: “Shqip”, nr. 216, 15 tetor 2006, f. 19.
51. Sinani Hysen. “Si dhe cilët e “kryqëzuan” shkrimtarin Koço Kosta”. Në: “Albania”, 25 dhjetor 2004, f. 10-11.
52. Stani, Lazër. “Proza e jokonformitetit: *Ata të dy dhe të tjerë*”. Në “Drita”, 11 qershor 1995, f. 3.
53. Yzeiri, Ilir. “Midis mëkatit, krimit dhe virtutit”. Në: “Shqip”, nr 2, 5 janar 2008.

ABSTRAKT

Objekt studimi i tezës së doktoraturës *Individualiteti i prozës së Koço Kostës*, është evidentimi i atyre shenjave stilistike, që përcaktojnë edhe profilin specifik dhe origjinal të këtij autori. Krijimtaria e tij shtrihet në një hark të gjatë kohor. Ajo nis qysh nga fundi i viteve '60 e rrjedh sistematikisht viteve në vazhdim, duke përcjellë tek lexuesi një varg veprash në prozë të shkurtër e prozë të gjatë. Ky krijues, spikat e përcaktohet si zë i veçantë e origjinal në letërsinë shqipe, para së gjithash, sepse ka dëshmuar prirjen për ta çliruar prozën e tij nga tonet rozë, entuziaste dhe sidomos, për ta çliruar nga modeli i interpretimit skematik/dogmatik të kohës së socrealizmit. Përgjithësisht, është një shkrimtar i prirë nga tonet e një realizmi të ashpër, sidomos në përcjelljen e mjediseve rurale, një botë kjo e vështruar në mënyrë komplekse e me tërë dritë-hijet e veta, si në rrafshin konceptual - ashtu edhe në modelimin e tërë asaj galerie të pasur të personazheve - të sjellë në veprën e tij.

Pikërisht këto tipare kanë qenë edhe shkas, jo në pak raste, i pritjes refuzuese e mjaft kritikuese prej censurës zyrtare të kohës. Në fakt, ato prirje dhe tendenca artistike *kundër rrymës*, ishin të kalkuluara ndërgjegjshëm prej vet autorit, pasi ato paradigma - me sens të qashtër provokues ndaj dogmës kanonike të kohës, ishin natyrshëm brenda vizionit të tij estetik antikonformist.

Fjalët kyç: *skema narrative, rrëfim paralel, vokalizim, rrëfim i alternuar, dialog narrativ, prozë pararomanore, narrator i gjithëdijshtëm, parimi i ajsbergut, procedime kohore, struktura tekstore, zërat e personazheve, kanon estetik. prozë poetike, monolog, dialog dramatik, retrospektivë, simbolikë.*